

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS PENALE

EKSTRADIMI DHE KONVENTAT
NDËRKOMBËTARE MBI EKSTRADIMIN NË
SHQIPËRI GJATË PERIUDHËS 2000-2010

Disertacion për gradën shkencore “Doktor”

Punoi:
Enkelejda Softa (Metaliaj)

Udhëheqës:
Prof. Dr. Maksim Haxhia

Tiranë, 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj me përgjegjësi se ky punim është autorial, i cili nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë i tëri. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Enkelejda Softa

DEDIKIM

Ia dedikoj këtë disertacion *Familjes sime*, pa mbështetjen e të cilëve do kishte qenë i pamundur përfundimi i kësaj teme, sepse më mësuan vlerat, rëndësinë e edukimit dhe më nxitën të hyj në labirinthe të dijes.

ABSTRAKT

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale midis shteteve ka njohur një stad të lartë zhvillimi, kjo sepse e drejta në përgjithësi dhe e drejta penale në veçanti karakterizohen nga dinamizmi çka do të thotë se me zhvillimin e shkencës, teknologjisë dhe shoqërisë pasurohet dhe e drejta penale me institute të reja të cilat do të luftojnë kriminalitetin. Instituti i Ekstradimit është ndoshta një nga format më të arrira të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale të realizuara që i përgjigjej më së miri domosdoshmërisë së kohës.

Synimi kryesor i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale është përpunimi i mjeteve dhe metodave më anë të të cilave shtetet ndihmojnë njeri-tjetrin, në synimin e përbashkët, ndëshkimit e individëve që kryejnë vepra penale. Një pjesë të rëndësishme në institutin e ekstradimit e zë sot Konventa mbi Ekstradimit e vitit 1954 me dy protokollet shtesë të saj. Me anë të këtij instituti u bë i mundur realizimi i drejtësisë penale, nëpërmjet kapjes së autorëve të veprave penale dhe dhënies së dënimit të tyre në vendin përkatës (shtetin kërkues). Po ashtu në kuadër të kësaj tematike numërohen sot mbi 25 Konventa e instrumente të tjera të cilat kanë për objekt ndihmën gjyqësore ndërkombëtare në fushën penale.

Në këtë punim jam mundur të trajtoj në formë analize të thelluar juridike legjislacionin penal lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale duke u mbështetur si në burimet e brendshme (si Kushtetuta, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale) ashtu edhe në burime të nivelit mbikombëtar si Konventat e Ndryshme Ndërkombëtare apo marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe të cilat janë nënshkruar nga Republika e Shqipërisë.

Fjalë kyçe: Instituti i Ekstradimit, bashkëpunimi në fushën penale, Marrëveshjet, Urdhëri Evropian i Ndalimit, ndihma gjyqësore ndërkombëtare etj.

Mirënjohje

Finalizimi i kësaj teme kaq të rëndësishme në jetën profesionale dhe akademike nuk ka qenë rezultat tërësisht individual pasi ka gjetur mbështetjen, përkrahjen dhe dashamirësinë e shumë personave të tjerë të cilëve do të doja t'ju dedikoja pjesën e falenderimeve dhe mirënjohjeve.

Për realizimin e këtij punimi dua të falenderoj, në radhë të parë, udhëheqësin tim Prof.Dr. Maksim Haxhia për përkrahjen e pakushtëzuar, ndihmesën në krijimin e ideve frytdhënëse dhe opinioneve të zgjeruara në lidhje me grumbullimin e materialit shkencor dhe mënyrës së shtjellimit të punimit.

Një falënderim edhe për profesorët e të cilit kanë qenë mbështetës dhe përkrahës në këto vite të përgatitjes së disertacionit të doktoraturës. Falenderoj stafin akademik për këshillat dhe sugjerimet gjatë konsultimeve me ta.

Së fundmi, falenderimet e mia i shkojnë pa dyshim familjes sime, bashkëshortit dhe fëmijëve të mi që me durim e përkushtim më kanë kuptuar dhe ndihmuar për ta përfunduar me sukses këtë punim doktoral.

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT (AKRONIMET).

BE - Bashkimi Evropian

KEDNJ-Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KSH-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

KP -Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

KPRP -Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

VKM-Vendimet e Këshillit të Ministrave

GJEDNJ-Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

MD-Ministria e Drejtësisë

KEE-Konventa Evropiane e Ekstradimit

UEN – Urdhëri Evropian i Ndalimit

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Deklarata e autorësisë	2
Abstrakt.....	3
Dedikim.....	4
Mirënjohje.....	5
Shkurtime	6
Përmbajtja e lëndës.....	7

KAPITULLI I : HYRJA, QELLIMI DHE RENDESIA TEORIKE DHE PRAKTIKE E STUDIMIT

1.1.Hyrje.....	11
1.2.Qëllimi i studimit dhe objektivat e tij.....	14
1.3.Rëndësia e studimit.....	16
1.4.Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura në studim.....	18
1.4.1 Pyetjet hulumtuese të studimit.....	18
1.4.2. Hipoteza.....	19
1.5. Metodologjia dhe metodat e kërkimit.....	19
1.6. Burimet e Referimit.....	21
1.7.Përmbajtja dhe struktura e punimit.....	22

KAPITULLI II: KUPTIMI, KARAKTERISTIKAT DHE FUNKSIONI I INSTITUTIT TE EKSTRADIMIT. NJË VËSHTRIM I SHKURTËR MBI HISTORIKUN E LINDJES DHE EVOLUIMIT TË TIJ.

2.1. Zanafilla e institutit të ekstrasudimit.....	25
2.2. Kuptimi i ekstrasudimit.....	29
2.3. Parimet e ekstrasudimit	33

2.3.1. Parimi i reciprocitetit.....	33
2.3.2. Parimi i specialitetit	34
2.3.2. Parimi i ekstradibilitetit.....	35
2.3.3 Parimi i identitetit të normave (reciprociteti i inkriminimeve).....	36
2.3.4.Parimet mbi të cilat mbështetet ekstradimi sipas legjislacionit penal shqiptar.	37
2.4. Vështrim historik mbi institutin e ekstradimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera.....	43
2.5. Evoluimi historik i ekstradimit në Evropë.....	45

KAPITULLI III: EKSTRADIMI NË KUADRIN E TË DREJTËS

NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

1.1.3.1. Ekstradimi në aktet juridike ndërkombëtare. Roli i marrëveshjeve

ndërkombëtare **në fushën**

ekstradimit.....48

3.1.1. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.....50

3.1.2. Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit.....53

3.2. Institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunimi i ndërsjellë juridik-

ndërkombëtar.....55

3.2.1 Roli dhe struktura e Interpol-it.....56

3.2.2. Interpoli dhe çështjet ligjore.....57

3.2.2. Funkzioni i Zyrës Qëndrore Kombëtare Interpol-Tirana.....58

3.2.3. Organizata e Inteligjencës Evropiane EVROPOL.....59

1.2.3.3. Mbi integrimin e së drejtës ndërkombëtare në legjislacionin kombëtar.....60

KAPITULLI IV EKSTRADIMI NË AKTET LIGJORE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

4.1. Ekstradimi në aktet juridike të Këshillit të Evropës.Vështrim i përgjithshëm.....64

4.1.1. Konventa Evropiane e Ekstradimit.....	66
4.1.2. Konventa Evropiane e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe ekstradimi.....	68
4.2. Vendimet e GJEDNJ-së lidhur me ekstradimin e shtetasve shqiptarë. Çështja Rrapo kundër Shqipërisë dhe çështja Haxhiakundër Shqipërisë.....	73

KAPITULLI V: EKSTRADIMI NË KUADRIN E BASHKIMIT EVROPIAN.

INTEGRIMI I LEGJISLACIONIT KOMUNITAR NË KUADRIN E BRENDSHËM LIGJOR

5.1. Baza ligjore. Traktatet e BE.....	79
5.1.1. Bashkëpunimi policor në nivel komunitar.....	81
5.2. Harmonizimi i legjislacionit penal në tërësi në kuadrin e Bashkimit Evropian.....	83
5.2.2. Bashkëpunimi gjyqësor dhe harmonizimi i procedurës penale dhe të drejtës penale në BE.....	88
5.3. Urdhëri Evropian i Ndalimit	93
5.3.1. Dallimi midis UEN-së dhe ekstradimit.....	95
5.3.2. Diskutime aktuale mbi Implementimin e Urdhërit Evropian të Ndalimit në legjislacionin tonë kombëtar.....	98
5.4. Progres-Raportet e Bashkimit Evropian lidhur me Shqipërinë.....	100

KAPITULLI VI: PROCEDURA E EKSTRADIMIT

6.1. Kushtet e ekstradimit.....	105
6.2. Kërkesa për ekstradimin e personave të kërkuar.....	107
6.3. Detyrimet që duhet të respektohen gjatë procedurës së ekstradimit.....	113
6.3.1. Detyrimet e shtetit që i është drejtuar kërkesa	113

6.3.2. Detyrimet e shtetit kërkues të ekstradimit.....	116
6.4. Pengesat për Ekstradimin (rastet e pezullimit të ekstradimit)	118
6.5. Ekstradimi për jashtë shtetit.....	125
6.6. Ekstradimi nga jashtë shtetit.	127
KAPITULLI VII. ROLI I EKSTRADIMIT NË LEGJISLACIONIN E BRENDSHËM.	
PROBLEMATIKAT AKTUALE NË LEGJISLACION DHE NË PRAKTIKË.	
7.1. Burimet parësore që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin tonë	129
7.2. Ekstradimi në legjislacionin e brendshëm.....	130
7.3. Konventat dhe Marrëveshjet ndërkombëtare për ekstradimin, të ratifikuara gjatë periudhës 2000-2010.....	135
7.3.1. Traktati i ekstradimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.	139
7.3.2. Marrëveshja e ekstradimit ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë.....	144
7.3.3. Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”	147
7.4. Institucionet përgjegjëse për çështjet e ekstradimit në Shqipëri dhe roli i tyre.....	153
7.1.1 Ministria e Drejtësisë.....	154
7.1.2. Prokuroria	155
7.1.3. Gjykata	156
KAPITULLI VIII. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	158
BIBLIOGRAFIA	172

KAPITULLI I : HYRJA, QELLIMI DHE RENDESIA TEORIKE DHE PRAKTIKE E STUDIMIT

1.3.Hyrje

Zhvillimi i vendeve evropiane pas Luftës së Dytë Botërore, u shoqërua nga një liberalizim i theksuar i marrëdhënieve shoqërore, sociale-politike dhe juridike të ndërsjellë që kërkonte domosdoshmërisht një institucionalizim të këtyre marrëdhënieve. Ky zhvillim diktoi ndryshime dhe në aspektin e marrëdhënieve juridiksionale për shkak të rritjes dhe zhvillimit të kriminalitetit në nivel global.

Pikërisht globalizimi i marrëdhënieve përherë e në rritje të kriminalitetit kërkonte thyerjen e kornizave procedurale juridike konservatore, të mbështetura në parimin e territorialitetit e të drejtave juridike kombëtare. Në këto kushte lindi nevoja për një bashkëpunim të ndërsjelltë midis shteteve, e cila u materializua në Konventat Evropiane të karakterit njëpalësh dhe shumëpalësh në kuadër të Komunitetit Evropian, për të mundësuar bashkëpunimin në çështjet penale, karakteristikë kjo vetëm për vendet evropiane perëndimore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale konsiston në zbatimin e parimit të solidaritetit midis shteteve të ndryshme në botë. Në procesin e vështirë të dhënies së drejtësisë, çdo shtet duhet të japë kontributin e tij dhe njëkohësisht të ndihmohet nga shtetet e tjera. Vetëm në këtë mënyrë do të përmbushet me sukses sfida për drejtësi. Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, shtetet bëjnë të mundur realizimin e një procedimi penal edhe përtej territorit ku ata shtrijnë juridiksionin e tyre. Format në të cilat shfaqet bashkëpunimi ndërkombëtar penal janë njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale të huaja, ndihma e ndërsjelltë juridike, transferimi i procedimeve penale dhe ekstradimi. Objekt i këtij studimi doktoral do të jetë pikërisht ekstradimi.

Studiuesi i njohur italian Cezare Beccaria, e konsideronte ekstradimin, një mjet efikas për luftimin e kriminalitetit. Kjo për faktin sepse nëpërmjet këtij institucioni realizohet dënimi i krimit në çdo shtet, në të cilin një individ që ka kryer një veprë penale, mund të fshihet ndaj dënimit të tij. Në këto kushte është e nevojshme që shtetet të mundësojnë dorëzimin e personave përgjegjës për veprat penale, me qëllim parandalimin e përhapjes së aktivitetit të tyre kriminal edhe në shtete të tjera. Ekstradimi në nivel ndërkombëtar bazohet në marrëveshjet ndërmjet shteteve. Ai ka një formë të veçantë në vendet e Bashkimit Evropian¹ dhe Këshillit të Evropës.² Këto rende juridike gjithsesi ndërthuren me njëri-tjetrin. Thelbin e rendit ligjor evropian³ e përbëjnë të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe demokracia pluraliste. Si Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian kanë arritur të krijojnë një legjislacion me qëllim parandalimin e përhapjes së aktivitetit kriminal dhe dënimit të autorëve të veprave penale edhe kur kapërcejnë kufijtë e një shteti. Sistemet rajonale zakonisht ofrojnë standarde më të larta për zbatimin e legjislacionit dhe implementimin e tyre. Në nivel të Këshillit të Evropës, aktet kryesore që rregullojnë institutin e ekstradimit janë Konventa Evropiane për Ekstradimin e vitit 1957⁴si dhe protokollet shtesë të saj të datës 15 Tetor 1975 dhe 17 Mars 1978. Konventa e Ekstradimit është ratifikuar nga të gjitha vendet anetare te Këshillit të Evropës.

Një vend të veçantë në këtë studim doktoral do të ketë edhe analiza e institutit të ekstradimit në vendin tonë. Marrëdhëniet e Shqipërisë përpara vitit 1990 në fushën e bashkëpunimit juridiksional kanë qenë shumë të kufizuara por me ndryshimet e vullshme demokratike pas viteve 1990, u krijua një situatë e re politike, sociale dhe ekonomike e cila favorizoi nënshkrimin dhe aderimin e shtetit shqiptar në shumë konventa të karakterit rajonal dhe ndërkombëtarë të vendit tonë. U realizuan gjithashtu zhvillime të rëndësishme në fushën

¹ Si nje rend juridik i vecante

² Ne nivel mbikombetar, rajonal.

³ Per me teper shih: Altin Shegani, “ *The Criminal Law of Public Order, as a Guardian of Public Interest, in terrorist acts scenarios* “, Sociology Studies Rewiev, March 2013, Volume 3, Number 3, fq. 172- 181

⁴ Hyre ne fuqi me 18 prill 1960.

juridike duke krijuar institucione të reja të së drejtës. Marrëdhëniet juridiksionale me vendet e tjera u bazuan në parimin universal të së drejtës ndërkombëtare sipas të cilit autoriteti i shtetit shtrihet deri aty ku përfundojnë edhe kufijtë e tij. Ky parim zbatohet edhe në kuadrin e procedimeve penale, kundër personave që kryejnë vepra të ndryshme penale.

Legjislacioni shqiptar penal në lidhje me ekstradimin u bazua në Konventën Evropiane për Ekstradimin të vitit 1957. Ekstradimi është sanksionuar në nenet 488-504 të Kodit të Procedurës Penale të RSH-se. Aktualisht procedura e ekstradimit realizohet në dy faza, ku nenkuptohet dhënia e një vendimi gjyqësor dhe e një vendimi administrativ, ku vendimi gjyqësor jepet nga gjykata pasi ajo shqyrton kushtet negative dhe pozitive të ekstradimit. Nëse vendimi gjyqësor është kundër kërkesës së ekstradimit, vendimi administrativ i cili mbështetet në vlerësimin që bën Ministria e Drejtësisë nuk mund të jetë i ndryshëm. Nëse vendimi gjyqësor e lejon kërkesën e ekstradimit asgjë nuk e pengon Ministrinë e Drejtësisë të marrë një vendim të kundërt në lidhje me kërkesën. Pra, procedura e ekstradimit nuk është një procedurë tërësisht në kompetencën ekskluzive të gjykatës, nga pikepamja e realizueshmërisë.

Procedurat e ekstradimit në vende të ndryshme nuk ndryshojnë shumë njëra nga tjetra duke u nisur nga fakti që të gjithë shtetet respektojnë procedurat e parashikuara nga Konventa Evropiane e Ekstradimit dhe lirinë e palëve në hartimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe të ekstradimit. Bashkimi Evropian ka patur si synim kryesor të revolucionarizojë sistemin tradicional të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar përtej koncepteve dhe parimeve tradicionale të bashkëpunimit që mbështeten ende në marrëdhëniet mes shteteve.⁵ Në Bashkimin Evropian, është krijuar tashmë një politikë penale si tërësia e përpjekjeve të strukturave dhe organizmave të BE-së për të harmonizuar legjislacionet e brendshme penale të shteteve anëtare dhe është krijuar një kuadër ligjor “suprakombëtar” për të çuar më përpara e

⁵ Nje gje e tille nenkupton vullnetin e shprehur te secilit shtet per t'i dhene njeri-tjetrit ndihme te ndersjelltë ne fushen penale.

për ta bërë më efikase luftën kundër formave të reja të kriminalitetit. Ekstradimi në vendet e BE-së aktualisht bazohet përveç Konventës edhe te Urdhëri Evropian i Ndalimit, ku ky i fundit ka një fushë veprimi tejte të specifikuar duke e shtrirë veprimin e tij vetëm brenda territorit të Bashkimit Evropian. BE-ja si një strukturë shtetesh e dallueshme nga organizma të tjerë, me anë të këtij Urdhëri ka unifikuar legjislacionin për aspektet që ai mbulon brenda shteteve anëtare.

Urdhëri Evropian i Ndalimit lindi si një domosdoshmëri e hapësirës dhe vështirësive që linin aktet e mëparshëm të miratuar në këtë fushë dhe si një nevojë e kohës. **Urdhëri Evropian i Ndalimit erdhi si akt, si pasojë e një vendimi në kuadër të ngjarjeve të 13 Qershorit të vitit 2002 dhe jo si pasojë e një konvente pasi ratifikimi i një konvente domosdoshmërisht do më shumë kohë për arsye të procedurave krahasuar më një vendim kuadër.** Ky është ndryshimi i parë edhe me ekstradimin i cili erdhi në jetë në bazë të një konvente. Nevoja për Urdhrin Evropian të Ndalimit ishte një nevojë imediate. Nëpërmjet Urdhërit Evropian është e mundur të lëshohet një urdhër arresti edhe për shtetasin e një shteti anëtar, kundrejt legjislacioneve të shumë shteteve dhe parashikimeve të procedurave të ekstradimit të cilat në themel kanë parimin e shtetësisë, dhe mosekstradimit të shtetasve me përjashtim të rastit kur ka një marrëveshje mes shteteve e cila e rregullon këtë gjë. Në themel të ekstradimit qëndron një parim i inkriminimit të dyfishtë. Ky parim nënkupton që vepra të jetë parashikuar nga të dyja legjislacionet e vendeve në të cilat do të kryhet ekstradimi.

Për sa më sipër, është ndërmarrë ky punim në cilësinë e një trajtесе në të cilën problemet janë trajtuar në këndvështrim krahasues. Njohja e mirë e dispozitave ligjore që shprehin eksperiencën evropiane në këtë fushë, si dhe e dispozitave tona ligjore të bashkërenduara me ato që përcaktojnë konventat evropiane, do të ndihmojnë për zbatimin me efikasitet të tyre në praktikën tonë.

1.4. Qëllimi i studimit dhe objektivat e tij

Ky studim ka rëndësi të veçantë pasi instituti i ekstradimit është aktualisht një nga institutet bazë të së drejtës penale në Republikën e Shqipërisë, me dobishmeri të lartë nëpërmjet të cilit synohet të arrihet një bashkëpunim në luftën, parandalimin dhe në uljen e kriminalitetit. Ekstradimi është instituti i së drejtës penale nëpërmjet të cilit shtetet ndihmojnë njëra-tjetrën për zhvillimin e procedurës penale apo ekzekutimit të sanksioneve të ndryshme penale. Si një ndër instrumentet më të vjetër të bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale, ekstradimi përbën një mekanizëm të nevojshëm dhe të domosdoshëm në luftën kundër kriminalitetit.

Rëndësia e studimit duket qartë edhe në kuadër të angazhimeve të vendit tonë për luftën ndaj krimit të organizuar dhe bashkëpunimit me shtetet e tjera për të dhënë kontributin në uljen dhe luftimin e kriminalitetit në nivel global. Kjo për faktin se aktualisht një numër i konsiderueshëm veprash penale janë të karakterit ndërkombëtar dhe pa ndihmesën e institutit të ekstradimit, kriminaliteti do të sfidojnë kufijtë territorial të shteteve duke synuar padënueshmërinë e tyre. Vazhdon të mbetet një çështje mjaft komplekse bashkëpunimi midis shteteve në luftën kundër kriminalitetit, kjo për faktin se kjo çështje gjen rregullim si nëpërmjet dispozitave materiale dhe procedurale si në dispozitat ndërkombëtare ndërmjet marrëveshjeve dhe traktateve bilaterale. Pjesë e analizës do të jenë gjithashtu detyrimet e shteteve për të ndërmarrë hapat e duhura për respektimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e ekstradimit dhe në mbrojtjen e jetës së personave që ndodhen brenda juridiksionit të tyre. Këtu studimi do të fokusohet në analizën konstruktive mbi debatet që mbartin sot çështjet e ekstradimit për shtetasit shqiptarë si dhe problematikat që shfaq vendi ynë.

Qëllimi kryesor i punimit është të hulumtojë të gjithë elementët kryesorë të ekstradimit duke nxjerrë në pah detyrën juridike të ekstradimit, që konsiston në mbrojtjen e qytetarëve dhe shoqërisë nga kriminaliteti, sidomos nga kriminaliteti ndërkombëtar për ato vepra penale me elementë kriminalë ndërkombëtarë.

Për këtë arsye konsiderohet absolutisht e nevojshme të caktohen qartë kufijtë kohorë dhe territorialë brenda kornizës të së cilëve gjen zbatim ekstradimi.

Tema është një përpjekje për të dhënë një ndihmesë modeste në pasurimin e arkivës studiuese në lidhje me institutin e ekstradimit dhe rëndësisë së tij në mbrojtjen e shoqërisë dhe luftën ndaj krimit.

Objektivat kryesore të këtij studimi mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Analiza historike dhe juridiko-penale e lindjes dhe evoluimit të institutit të ekstradimit. Vështrim mbi kuptimin dhe funksionin e ekstradimit.
- Studimi i zhvillimit të akteve ndërkombëtare në këtë fushë pasi ky evolucion është shoqëruar me përmirësime të vazhdueshme edhe në legjislacionet e brendshme të shteteve anëtare të këtyre organizmave.
- Analiza e detajuar e legjislacionit aktual evropian në kuadër të harmonizimit të legjislacionit penal i cili në të vërtetë përfaqëson aktivitetin nëpërmjet të cilit realizohet eliminimi i ndryshimeve legjislative. Ky ka si synim final një përafrim të sistemeve ligjore penale ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.
- Një nga etapat e rëndësishme në kuadrin e stabilizimit asociativ, përveç aktiviteteve dhe marrëdhënieve të ndryshme, është edhe adoptimi gradual i legjislacionit të BE-së. Në këtë këndvështrim i një rëndësie tepër të veçantë është edhe përafrimi i legjislacionit penal të vendit tonë, pra studimi i arritjeve të Shqipërisë në kuadër të përafrimit të legjislacionit kombëtar në përputhje me atë evropian.

1.5.Rëndësia e studimit

Bashkëpunimi gjyqësor në fushën penale bazohet në parimin e solidaritetit ndërmjet shteteve të ndryshme, ku secili shtet duhet të ndihmojë dhe njëkohësisht të ndihmohet në përmbushjen e detyrimit parësor të parandalimit të veprave penale, dhënies së drejtësisë dhe ekzekutimit të dënimeve penale. Në sajë të këtij bashkëpunimi bëhet i mundur realizimi i drejtësisë penale, në mënyrë që autorët e veprave penale, pavarësisht ku strehohen apo ku kanë kryer aktivitetin kriminal, të vihen përpara drejtësisë e njëkohësisht të marrin dhe të ekzekutojnë dënimin përkatës.

Kohët e fundit mendohet se rruga më e mirë, të paktën për mbrojtjen e vlerave të përbashkëta dhe unike në rrafsh ndërkombëtar apo rajonal të jetë përafrimi i legjislacioneve të brendshme drejt uniformitetit në fusha të caktuara. Përsa i përket përkrahësve të idesë së kundërt “për ndërkombëtarizimin e të drejtës penale”, e cila përqendrohet rreth faktit se kriminaliteti është ndërkombëtarizuar dhe për rrjedhojë edhe përgjigjja e institucionalizuar duhet të jetë e tillë, mund të themi se është e saktë në thelb, por jo në dimensionet e saj. Përgjigjja ndaj krimit në nivel ndërkombëtar mund dhe duhet të arrihet nëpërmjet ndihmës së ndërsjellë juridike, policore, gjyqësore etj., e cila gjithsesi futet në kuadratin procedural, dhe në një farë mënyre lë të paprekur të drejtën penale materiale, e cila mjaftohet thjesht me përafrimin e legjislacioneve të brendshme në kuadrin e inkriminimit të formave të reja të kriminalitetit ndërkombëtar.

Në kuadrin e përgjithshëm të procesit të integritetit në të cilin ndodhet Shqipëria, përafrimi i legjislacionit të brendshëm që rregullon bashkëpunimin gjyqësor në fushën penale me *acquis communautaire*, paraqitet si një prioritet në fushën e reformave ligjore e institucionale. Në sistemin shqiptar të së drejtës, ekstradimi rregullohet nga Kushtetuta, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale dhe Marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë. Në bazë të nenit 39 të Kushtetutës “Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar

shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor”. Gjithashtu, ekstradimi rregullohet edhe nga dispozitat e kodit të procedurës penale, respektivisht nenet 488 deri 504, dispozita të cilat janë hartuar në pajtueshmëri të plotë me rregullimin e Konventës Evropiane “Për Ekstradimin”. Gjithsesi rëndësia paraqitet pikërisht në kuadër të nevojës për përmirësim të mëtijshëm të këtij legjislacioni. Një vend të veçantë do të ketë edhe analiza e Urdhërit Evropian të Ndalimit dhe sidomos problematikën e përfshirjes së Urdhërit Evropian të Ndalimit në të drejtën tonë të brendshme, parë nga këndvështrimi i parimeve kushtetuese.

1.6. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit

Tema në tërësi do të fokusohet në institutin e ekstradimit, duke u ndalur në fillesat e tij, trajtimin e instrumenteve juridike ndërkombëtare dhe evropiane. Analiza jonë konsiston në përmirësimet dhe evoluimin ligjor të ekstradimit në vendin tonë. Arkitektura e një hulumtimi shkencor kurrësi nuk do të ishte e plotë, nëse nuk do të përmbante dy elementë domethënës të tij, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura. Pyetjet hulumtuese kanë rëndësi të veçantë për projektin kërkimor, sepse janë ato të cilat na japin drejtimin kryesor të studimit. Punimi është një analizë e rëndësishme për të kuptuar se sa efektiv është legjislacioni në fushën e ekstradimit dhe cilat janë këto ndryshime që do e përmirësonin më tej këtë institut.

1.4. 1 Pyetjet hulumtuese të studimit

Për të analizuar këtë tematikë kemi ngritur fillimisht disa pyetje kërkimore të cilat janë:

1. Çfarë është ekstradimi?
2. Mbi cilat parime mbështetet instituti i ekstradimit në vendin tonë?
3. Cilat janë instrumentet juridike ndërkombëtare dhe evropiane në lidhje me njohjen dhe zbatueshmërinë e ekstradimit në nivel global?

4. Cilat janë pengesat e ekstradimit?
5. Cilat janë marrëveshjet dypalëshe për ekstradimin e personave?
6. A është e nevojshme dhe a mund të realizohet përfshirja e Urdhërit Evropian të Ndalimit në të drejtën tonë të brendshme? Nëse po, me cilat instrumente?

Studimi që do të ndërmarrim në këtë fushë ka karakter studimor dhe synon të evidentojë risitë që ka pasur instituti i ekstradimit por dhe përmirësimet të cilat duhet ta pasojnë atë. Punimi është realizuar për qëllime kontributive modeste akademike nisur nga fakti se aktualisht ka studime të mirëfillta dhe të arrira të cilat trajtojnë dhe analizojnë në detaje institutin e ekstradimit në vendin tonë. Por punimi i kësaj teme është konceptuar si një sfidë profesionale, nisur nga konstatimi personal i problematikave me të cilat përballemi shpesh për ekstradimin si dhe i nevojave për përditësim.

1.4.2. Hipotezat e studimit

Elementi i dytë i rëndësishëm në arkitekturën e punimit doktoral është hipoteza e studimit, e cila paraqitet në funksion dhe mbështetje të pyetjeve kërkimore. Studimi përpiqet të tregojë vërtetësinë e hipotezës në të gjithë paragrafët e tij.

Në mënyrë që t'i jepet një përgjigje pyetjes kërkimore dhe pyetjeve të tjera që ky punim doktoral ngre për shqyrtim, hipoteza kryesore mbështetet mbi premisën se përafrimi i legjislacionit të brendshëm që rregullon bashkëpunimin gjyqësor në fushën penale me *acquis communautaire*, paraqitet si një prioritet në fushën e reformave ligjore e institucionale. Për përmbushjen e këtij objektivi, ligjvënësi shqiptar duhet të synojë miratimin e një ligji të posaçëm për bashkëpunimin gjyqësor në fushën penale ndërmjet shteteve anëtare të BE-së, i cili do të bëjë të mundur që në marrëdhëniet me to, të zbatohen dispozita të posaçme që lehtësojnë në mënyrë të ndjeshme bashkëpunimin gjyqësor dhe policor në fushën penale.

1.7. Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor

Metodologjia përfaqëson një reflektim korrekt dhe të logjikshëm të analizës shkencore të projektit doctoral. Metodologjia në këtë studim përfaqëson analizën logjike, juridike të institucionit të ekstradimit. Studimi ka në fokus institutin e ekstradimit duke parashtruar problemet që has legjislacioni shqiptar në lidhje me ekstradimin si ndihmesë në përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar. Për të arritur këtë qëllim mbledhja e të dhënave të këtij studimi mbështetet në një kombinim të disa metodave shkencore të përdorura, siç janë:

Metoda Historike: Studimi ndër të tjera synon të japë dhe një panoramë më të detajuar lidhur me evoluimin e ekstradimit deri në ditët e sotme dhe për realizimin e këtij qëllimi është përdorur metoda historike. Kjo ka një rëndësi të veçantë për të kuptuar rëndësinë e kësaj të drejte. Konkretisht kjo metodë është parashikuar në Kapitullin e dytë.

Metoda Cilësore: Për një analizë më të thelluar është përdorur edhe metoda cilësore e mbledhjes së të dhënave si një model i efektshëm që na jep mundësi të përfshihemi më shumë në kontekstin aktual të ekstradimit duke marrë në studim përjasjen që ka ligjvënësi shqiptar për ekstradimin duke e krahasuar me legjislacione të disa vendeve të zhvilluara.

Metoda e analizës së legjislacionit: Për vetë karakteristikat që ka punimi, jemi mbështetur në metodën cilësore të analizimit të çështjeve të trajtuara në të. Kjo metodë e përdorur në këtë studim bazohet kryesisht në analizën e dispozitave ligjore e Kushtetuese, instrumenteve apo akteve ndërkombëtare që kanë në fokus ekstradimin, në analizën e dimensionin social të tij në luftën ndaj kriminalitetit dhe rolin në uljen e tij.

Metoda hulumtuese: Është përdorur gjatë gjithë studimit. Kjo metodë përfshin procesin e mbledhjes së materialeve në format e shkruara dhe elektronike; të mbledhjes së vendimeve gjyqësore në funksion të shkrimit dhe strukturës së temës. Hulumtimi është një proces që ka shoqëruar gjithashtu fazën e sistemimit të zërave bibliografik në funksion të finalizimit të këtij punimi.

Metoda përshkruese: Kjo metodë e përdorur në këtë studim ka pasur si qëllim përshkrimin dhe studimin e rasteve konkrete të përzgjedhura në mënyrë të kujdesshme për të zbuluar në thellësi mënyrën sesi është trajtuar dhe zbatuar ekstradimi në Shqipëri dhe vende të tjera. Gjithashtu metoda përshkruese e përdorur është një mjet i domosdoshëm për sqarimin e termave dhe koncepteve të ndryshme nga aspekte ligjore në ato praktike.

1.8. Burimet e Referimit

Aktualisht jemi pjesë e një shoqërie bashkëkohore në të cilën ekzitojnë një sërë instrumentesh mbi bazën e të cilave shtetet e zhvillojnë bashkëpunimin midis tyre në çështjet penale. Ky bashkëpunim në nivel të përgjithshëm realizohet mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të legjislacionit të brendshëm të shteteve. Bashkëpunimi i shteteve në çështjet penale realizohet edhe me instrumente të tjerë, kështu Këshilli i Evropës ka përdorur instrumente si Konventat, Marrëveshjet dhe Rekomandimet e ndryshme. Burim referimi bazë për këtë punim është legjislacioni kombëtar, ndërkombëtar dhe evropian mbi ekstradimin. Do t'i referohemi dispozitave ligjore shqiptare, për të nxjerrë në pah zbatimin e legjislacionit të ekstradimit me përmirësimet që janë bërë dhe problematikat që mbart akoma. Shqyrtimi i literaturës kombëtare do të na japë një panoramë të qartë të standardit të cilësisë aktualisht në lidhje me ekstradimin në vendin tonë.

Literatura e huaj është pjesë esenciale e këtij studimi me anë të së cilës evidentohen përparësitë, eksperiencat e vendeve evropiane në lidhje me institutin e ekstradimit. Aktet që e trajtojnë drejtpërdrejtë ekstradimin si formë të luftës ndaj kriminalitetit, me anë të të cilave kemi arritur dhe të evidentojmë deficitin ligjor kombëtar në këtë fushë, janë të karakterit ndërkombëtar dhe rajonal. Aktet e karakterit ndërkombëtar janë: Konventa Evropiane për Ekstradimin dhe dy Protokollat e saj, Konventa Evropiane për Transferimin e Ndjekjes në çështjet Penale, Konventa për Ndhimën Juridike në Fushën Penale, Urdhëri Evropian i

Ndalimit etj. Pjesë e rëndësishme e studimit tonë do të jenë autorë dhe studiues shqiptarë e të huaj. Nëpërmjet këtyre botimeve do të njihemi me përkufizime e vlerësime teorike, me analiza praktikash e studimesh të institucioneve ndërkombëtare duke analizuar në raport me kuadrin ligjor ekzistues shqiptar.

1.9.Përmbajtja dhe struktura e punimit

Punimi doktoral është strukturuar në bazë të një analize teorike gjithëpërfshirëse, dhe jurisprudenciale të ndarë në gjashtë krerë kryesorë. Secili nga kapitujt ka nënndarjet e veta dhe trajton aspekte të veçanta të punimit, të artikuluar në paragrafë dhe nënparagrafë.

Kreu i parë, shqyrton aspektin hyrës dhe bazën metodologjike të studimit mbi ekstradimin. Analiza e këtij kapitulli zhvillohet mbi bazën e një informimi të përgjithshëm, në lidhje me temën e projektit dhe me situatën në të cilën është vendosur objekti i studimit, pra, elementët thelbësorë të ekstradimit, me fokus të veçantë respektimin dhe zbatimin e tij. Kapitulli i parë hyrës analizon qëllimin e përgjithshëm, problematikën që mbart studimi si dhe rëndësinë që ai mbart në mjedisin shqiptar të kërkimit shkencor, ashtu sikurse dhe nevojën për studime të thelluara. Pjesa e dytë e këtij kapitulli zhvillon një analizë të dy elementëve bazë të studimit, pyetjen kërkimore të tij dhe hipotezën mbi bazën e të cilës është ngritur studimi. Themelet e projektit janë mbështetur tek metodologjia dhe llojet e metodave mbi të cilat është bazuar studimi.

Kapitulli i dytë i punimit trajton nocionin e ekstradimit duke ofruar një vështrim krahasimor të lindjes dhe zhvillimit të tij. Në këtë kapitull gjenden të trajtuar parimet e ekstradimit, një vështrim historik mbi institutin e ekstradimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera dhe evoluimi historik i ekstradimit në Evropë. Objekt tjetër i trajtimit të këtij kapitulli janë dhe burimet parësore që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin tonë aktual.

Në kapitullin e tretë gjendet i trajtuar në mënyrë të detajuar ekstradimi në kuadrin e të drejtës ndërkombëtare në çështje penale. Luftimi i kriminalitetit në nivel ndërkombëtar ka qenë

përparësi e punimit tonë dhe në këtë kapitull janë trajtuar aktet juridike ndërkombëtare të Ekstradimit si: Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit.

Në luftën kundër kriminalitetit krijimi dhe dhe implementimi i akteve ndërkombëtare përbën një rëndësi të veçantë. Zbatimi i akteve në praktikë realizohet nga institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunimi i ndërsjellë juridik ndërkombëtar për çështjet e ekstradimit. Kështu, bashkëpunimi policor në nivel ndërkombëtar realizohet nëpërmjet institucioneve të specializuara për këtë fushë. Një rëndësi të veçantë në këtë drejtim kanë analiza e Interpol-it dhe të Evropol-it.

Në kapitullin e katërt trajtohet ekstradimi në aktet e Këshillit të Evropës. Ekstradimi është një çështje që menaxhohet edhe në nivel të vendeve evropiane, që këtë kapitull gjendet i sanksionuar nëpërmjet akteve juridike të krijuara nga Këshilli i Evropës si: Konventa Evropiane e Ekstradimit dhe Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut dhe ekstradimi. Kemi trajtuar në këtë pjesë edhe jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut në lidhje me ekstradimin si dhe vendimet e GJEDNJ-së lidhur me ekstradimin e shtetasve shqiptarë duke analizuar çështjen *Rrapo* dhe çështjen *Haxhia*.

Në kapitullin e pestë trajtohet integrimi i legjislacionit ndërkombëtar dhe komunitar në kuadrin e brendshëm ligjor duke analizuar rolin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e ekstradimit dhe harmonizimin e legjislacionit penal në tërësi në kuadrin e Bashkimit Evropian. Pjesë e këtij kapitulli do të jetë edhe analizimi i Urdhërit Evropian të Ndalimit dhe jurisprudenca e gjykatave për ekstradimin duke trajtuar dy çështje në lidhje me ekstradimin.

Në kapitullin e gjashtë trajtohet procedura e ekstradimit duke filluar me kushtet e ekstradimit, kërkesën për ekstradimin e personave të kërkuar dhe detyrimet që duhet të respektohen gjatë procedurës së ekstradimit si nga ana e shtetit që i është drejtuar kërkesa dhe

nga shteti kërkues i ekstradimit. Rastet e pezullimit të ekstradimit janë pjesë e trajtimit të këtij kapitulli duke përfshirë ekstradimin për jashtë shtetit dhe ekstradimin nga jashtë shtetit.

Në *kapitullin e shtatë* trajtohet ekstradimi në legjislacionin e brendshëm. problematikat aktuale në legjislacion dhe në praktikë. Pjesë e legjislacionit tonë kombëtar, janë dhe aktet e ekstradimit si: Traktati i Ekstradimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Marrëveshja e Ekstradimit ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Objekt tjetër i trajtimit të këtij kapitulli janë dhe burimet parësore që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin tonë aktual duke marrë si pikë reference të bazës ligjore ligjin nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

Në përfundim të punimit do të trajtojmë evidentimet tona lidhur me punimin, që përbëhen nga konkluzionet dhe rekomandimet.

KAPITULLI II: KUPTIMI, KARAKTERISTIKAT DHE FUNKSIONI I INSTITUTIT TE EKSTRADIMIT. NJË VËSHTRIM I SHKURTËR MBI HISTORIKUN E LINDJES DHE EVOLUIMIT TË TIJ.

2.1. Zanafilla e institutit të ekstradimit

Ekstradimi është konsideruar si forma e parë e bashkëpunimit në fushën penale midis dy shteteve.⁶Format e para të ekstradimit i gjejmë në shekullin e XIII në qytet-shtetet dhe principatat italiane. Ky lloj bashkëpunimi embrional në fushën penale i krijonte mundësinë monarkëve të merrnin masa dhe të ndëshkonin armiqtë e tyre personal, kur ata largoheshin në territorin e një shteti tjetër. Ashtu si dhe aktualisht në varësi të motiveve të ekstradimit vendimin për pranim ose mospranimin e ekstradimit të të kërkuarit e jepte monarku i shtetit ku strehohej i kërkuari nga shteti tjetër dhe të drejtat e personit të kërkuar nuk merreshin në konsideratë.

Në Mesjetë ekstradimi ka një përdorim të ulët, kjo falë izolimit të tejskajshëm të shteteve duke e bërë pjesë të sovranitetit individual të shteteve. Në këtë periudhë ekstradimi realizohej vetëm nëpërmjet marrëveshjeve të bazuara në interesat e monarkëve. Me zhvillimin e shoqërisë filluan të evidentoheshin dhe konceptet e para të “shtetit” duke krijuar distancimin e tij nga monarkitë e shumta dhe shndërrimin e individit juridikisht nga objekt në subjekt të disa të drejtave të mohuara nga mungesa e civilizimit të shoqërisë.

Gjatë kësaj etape të vështirë por tejet të rëndësishme transformimesh në disa shtete evropiane filloi të krijohej tradita e bashkëpunimit ndërmjet tyre mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe të ekstradimit, gjë e cila siguroi një zgjerim të juridiksionit dhe të autoriteteve gjyqësore të këtyre shteteve kundrejt juridiksionit të një shteti tjetër. Detyrimi për ndëshkueshmëri të krimit krijoi dhe parimin “*aut dedere aut judicare*” që do të thotë “ose

⁶ Shih ne lidhje me kete argument Martin Dixon, *E drejta nderkombetare publike*, fq.46.

ekstrado ose ndëshko”.⁷Në një vepër të tijën Hugo Grocius parashtroi tezën se detyrimisht shtetet ose duhet të ekstradonin ose duhet të merrnin masa ndëshkuese ndaj personit të kërkuar nga shteti tjetër, pavarësisht se kjo tezë nuk gjeti përkrahje.

Instituti i ekstradimit do të përfshihej në legjislacionin e shteteve më vonë dhe traktati më i vjetër në fushën e ekstradimit është konsideruar sipas disa studiueseve traktati ndërmjet Italisë dhe Monakos⁸. Ky traktat u krijua në 19 Maj të vitit 1866 dhe pas 4 vitesh u pasua nga një tjetër marrëveshje dypalëshe midis Belgjikës dhe Suedisë. Këto marrëveshje shërbyen si një jurisprudencë tejet pozitive për krijimin e disa marrëveshjeve të tjera dypalëshe në lidhje me institutin e ekstradimit mes shteteve evropiane. Një faktor tjetër i cili stimuloi ekstradimin ishte kolonizimi, kjo sepse shumë shtete evropiane kishin koloni të tyre në Azi e Afrikë dhe ky kolonizim bëri që të lindte nevoja e bashkëpunimit penal⁹.

Shtetet e Benelux-it si Belgjika, Luksemburgu dhe Holanda e çuan Institutin e ekstradimit në një stad më të avancuar duke i zgjeruar marrëdhëniet e tyre dypalëshe në marrëdhënie shumëpalëshe, në lidhje me bashkëpunimin e ndërsjellë penal ndërkombëtar.

Në shekullin e XX ekonomia, kultura dhe në veçanti politika e shumë shteteve pësuan një zhvillim të konsiderueshëm duke i shndërruar ato në destinacione kryesore të emigracionit. Në kushtet ku u rrit ndjeshëm qarkullimi i individëve u shfaq një fizionomi (fytyre) e re e krimin, parandalimi i të cilit rriti nevojën e bashkëpunimit mes shteteve. Kështu për t`iu shmangur dënimit autorët e veprave penale mund të largoheshin lehtësisht nga vendi ku kishin kryer veprën duke u zhvendosur në një vend tjetër, duke gjetur një terren të përshtatshëm ose një rrugëdalje për t`iu shmangur drejtësisë.¹⁰

⁷ Shih Hoxha, A., Ekstradimi sipas instrumentave ligjore të Bashkimit Evropian. Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentat e Këshillit të Evropës, 2010, fq.30.

⁸ Shih Skendaj, K., Hoxha A., *Perspektivat e legjislacionit procedural penal shqiptar në kuadrin e integritetit në Bashkimin Evropian*, Revista Politikja nr. 1, fq.121; Gruda. Z - E Drejta Ndërkombëtare Publike, Universiteti i Prishtinës, 2003.

⁹ Shih Jola Xhafo, E drejta penale Ndërkombetare, Tiranë, 2009 fq 84.

¹⁰ Shih Shefqet Muci, E Drejta Penale (Pjesa e përgjithshme), Botimet Universitare Dudaj. Tiranë, 2007, faqe 88.

Në këto kushte ishte evidente që kontrolli i krimit dhe parandalimi i tij nuk mund të realizohej dot vetëm duke u bazuar në parimet tradicionale të së drejtës penale. Përball një shtete të tillë politika evropiane u përqendrua në gjetjen e rrugëve dhe formave më të përshtatshme për të luftuar kriminalitetin. Lufta ndaj krimit dhe parandalimi i tij forcoi më shumë bashkëpunimin ndërmjet shteteve dhe krijoi konceptin e ekstradimit. Po kështu, fenomene si terrorizmi apo trafiku ndërkombëtar kanë dalë jashtë sferës komunitare duke u globalizuar dhe kërcënuar në mënyrë të vazhdueshme gjithë shoqërinë njerëzore dhe detyrimi kryesor i një shteti kundrejt qytetarëve të tij është garantimi i paqes dhe sigurisë.¹¹ Traktati i parë për ekstradim është nënshkruar me Greqinë. Pas tij vijojnë traktate të tjerë ekstradimi të nënshkruara me Britaninë e Madhe dhe me Mbretërinë e Serbisë, Kroacisë e Sllovenisë¹².

Në të drejtën ndërkombëtare me ekstradim kuptohet një veprim juridik midis shteteve me të cilin shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi i dorëzohet shtetit tjetër me qëllim që atje të gjykohej apo ndaj tij të ekzekutohej dënimi apo lloji tjetër sanksioni penal. Ekstradimi bëhet sipas kontratave ndërkombëtare, zakonisht sipas kontratave bilaterale. Nëse midis shteteve nuk ekziston kontrata ndërkombëtare, ekstradimi bëhet sipas ligjit të vendit nga i cili kërkohet dorëzimi i kryesit të veprës penale.¹³ Kështu, dorëzimi i personit që ka kryer vrasje në Shqipëri dhe është larguar në Greqi për t'iu fshehur organeve tona për marrjen e tij në përgjegjësi, jo vetëm se bën të mundur që fajtori të dënohet për krimin konkret, por ndikon drejtpërdrejtë në parandalimin e krimeve të tjera, sepse personi e di që do të dorëzohet dhe do të gjykohej nga gjykata për krimin e kryer.

Në legjislacionin tonë, dhe pikërisht bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë me ekstradim do të kuptohet: “*Dorëzimi i një personi të një shteti*

¹¹Shih Revista Juridike Shkencore “Jeta Juridike” – Shkolla e Magjistraturës. Nr 1, Viti VII i botimit. Tiranë2, Mars, 2010, fq 113.

¹²Shih Skendaj, K., Hoxha A., *Perspektivat e legjislacionit procedural penal shqiptar në kuadrin e integritetit në Bashkimin Evropian*, Revista Politikja nr. 1, fq.121.

¹³Shih Ismet Salihu, *E Drejta Penale Ndërkombëtare*, Prishtinë, 2005. fq 130.

të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale, mund të bëhet vetëm nëpërmjet ekstradimit”.¹⁴ Pra, siç mund ta vëmë re nga kuptimi që i ka dhënë Kodi ynë penal ekstradimi ndodh midis dy shteteve. Për t`u bërë e mundur kjo duhet të jetë e parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.¹⁵ Ekstradimi si një mjet i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale është i shprehur në dy forma:

- a. për jashtë shtetit, kur personat ndodhen në Shqipëri dhe kërkohen nga shtetet e tjera dhe
- b. nga jashtë shtetit, kur ai ndodhet në një shtet tjetër dhe kërkohet nga shteti shqiptar.¹⁶

Kushtet e ekstradimit janë sanksionuar në nenin 11 të Kodin Penal¹⁷ ku përcaktohen edhe rastet kur nuk lejohet ekstradimi sipas legjislacionit tonë të brendshëm.¹⁸ Kërkesa e një shteti të huaj drejtuar shtetit shqiptar për dorëzimin e një personi i paraqitet Ministrisë së Drejtësisë. Ajo verifikon nëse në rastin konkret ekzistojnë ose jo kushtet konkrete të parashikuara nga K.P.Penale. Kur konstatohet se këto kushte nuk plotësohen Ministria e Drejtësisë e refuzon kërkesën, ndërsa kur kushtet plotësohen, ajo i përcjell prokurorit, pranë gjykatës së vendbanimit ose vendqëndrimit të personit që kërkohet, të gjithë dokumentacionin e kërkuar

¹⁴Shih: Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në nenin 488, Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Tiranë, Tetor, 2010, fq 243.

¹⁵Shih neni 11, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë,

¹⁶Shih Njohuri për ligjin- Libër për të gjithë. Fondacioni Soros & Horizont. Tiranë, 2001. faqe 105.

¹⁷Shih nenin 11 të Kodit Penal i cili thotë: “Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë. Ekstradimi lejohet kur vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim është e parashikuar si e tillë njëkohësisht si nga ligji shqiptar dhe ai i huaj.”

⁷ Shih: Njohuri për ligjin- Fondacioni Soros & Horizont. Tiranë, 2001.fq 106.

¹⁸Shih: nenin 11 të Kodit Penal i cili thotë se: *Ekstradimi nuk lejohet: a) në qoftë se personi që do të ekstradohet është shtetas shqiptar, veç rasteve kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe; b) në qoftë se vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim ka një karakter politik ose ushtarak; c) kur ka arsye për të dyshuar që personi i kërkuar të ekstradohet do të persekutohet, dënohet ose kërkohet për arsye të bindjeve të tij politike, fetare, kombëtare, racore ose etnike. d) në qoftë se personi që kërkohet të ekstradohet është gjykuar nga një gjykatë kompetente shqiptare për veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi.*

nga shteti që ka bërë kërkesën. Prokurori bën verifikimet dhe plotësimet e nevojshme dhe mandej i paraqet kërkesë gjykatës, në territorin e së cilës ai vepron.¹⁹

Anëtarësimi i Shqipërisë në BE²⁰, si një ndër prioritet kryesore të vendit tonë, kërkon domosdoshmërisht plotësimin e objektivave të Traktatit të Bashkimit Evropian për krijimin e një hapësire lirie, sigurie dhe drejtësie duke iu përgjigjur kërkesave të drejtësisë penale evropiane, e cila bazohet në Urdhërin Evropian të Ndalimit. Implementimi i UEN-së në sistemin tonë ligjor është një proces i cili kërkon ndryshime thelbësore të sistemit të brendshëm ligjor duke filluar që nga Kushtetuta, Kodi Penal, K.Pr.P, dhe angazhimin e studiuesve të së drejtës. Implementimi i UEN-së në sistemin tonë ligjor do të tregonte një nivel më të lartë bashkëpunimi me vendet evropiane në luftën kundër kriminalitetit. Kjo çështje do të jetë objekt analize në kreun e fundit.

2.2. Kuptimi i ekstradimit

Ekstradimi është një formë bashkëpunimi hetimor gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale, nëpërmjet të cilit një shtet pranon t'i dorëzojë një shteti tjetër një individ që gjendet në territorin e tij, i cili ndiqet penalisht ose është dërguar në gjykatë për kryerjen e një vepre penale ose kërkohet për të ekzekutuar një dënim penal në shtetin përkatës.²¹ Ekstradimi si institucion i të drejtës penale ka si qëllim ndëshkueshmërinë e autorit të veprës penale në rastet kur arratiset

¹⁹Shih Njohuri për ligjin- Fondacioni Soros & Horizont. Tiranë, 2001.fq 106.

²⁰Ideja për një Evropë të Bashkuar e ka zanafillën e vet në vitin 1951 me nënshkrimin e Traktatit të Parisit, i cili themeloi Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut. Kjo ide u konsolidua akoma më tepër në vitin 1957, kur në Romë u nënshkruan dy Traktate për krijimin përkatësisht të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike dhe Komunitetin Ekonomik Evropian. Me nënshkrimin e Traktateve të Romës, synimi ishte tepër i qartë nëpërmjet shprehjes deklarative të vullnetit të nënshkruesve se ishin të vendosur të hidhnin themelet e një bashkimi gjithnjë e më të ngushtë dhe eficient midis popujve të Evropës. Përmes akteve të aderimit, dhe Traktateve të Mاستrihtit , të Amsterdambit dhe të Nisës, BE-ja jo vetëm u zgjerua, por edhe u përsos juridikisht, dhe sot i ofron qytetarëve një nivel të lartë sigurie, kryesisht me anë të parandalimit të kriminalitetit, të bashkëpunimit mes autoriteteve policore dhe të drejtësisë si dhe përafrimit të legjislacionit. Shih: Canaj Bana, *E drejta e Bashkimit Evropian*, Onufri, 2014.

²¹Shih: Hoxha.A, *Ekstradimi sipas instrumentave ligjore te BE-se.Ngjashmerite dhe ndryshimet me instrumentat e Keshillit te Evropes*, Tirane 2010 fq 124; Hoxha.A,Panda, *Komentari e Drejta Procedurale Penale*.

nga një shtet në një shtet tjetër ose vuajtjen e dënimit të caktuar në rastet kur ai përpiqet që t'i shmanget dënimit. Pra, ekstradimi konsiderohet si mekanizmi juridik i së drejtës penale kombëtare dhe asaj ndërkombëtare penale nëpërmjet të cilit shtetet ndihmojnë njëri-tjetrin për zhvillimin e procedurës penale apo ekzekutimin e sanksioneve penale. Ekstradimi si një ndër institutet më të vjetër të bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale²² përbën aktualisht një domosdoshmëri në luftën kundër kriminalitetit sidomos në planin ndërkombëtar.

Ekstradimi si një institut mjaft i rëndësishëm i të drejtës penale sanksionohet nga dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë ku në nenin 11 të Kodit Penal përcaktohen rastet kur lejohet dhe kur nuk lejohet ekstradimi. Në nenin 488 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se *“ekstradimi është dorëzimi i autorit të një vepre penale nga njëri shtet në tjetrin për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale.”*²³

Ekstradimi realizohet kur:

- a. një person kryen një vepër penale në një shtet të caktuar dhe gjatë procedurës penale, apo pas caktimit të dënimit, largohet në një shtet tjetër qellim shmangien e dënimit. Në këtë rast shteti ku gjendet i kërkuari i'a dorëzon personin shtetit kërkues ku ai ka kryer veprën penale.
- b. një person kryen një vepër penale në shtetin e huaj kundër një shteti tjetër ose shtetasve të huaj.

Në këto raste shteti në të cilin është kryer vepra penale mund të heqë dorë nga juridiksioni i tij penal dhe t'ia dorëzojë shtetasin e kërkuar shtetit kërkues. Autorë dhe studiues të shumtë të ekstradimit e trajtojnë atë në dy aspekte. Kështu, disa autorë të kryesuar nga Hugo Groci-n, e konsiderojnë ekstradimin si një detyrim që ka shteti që ka marrë kërkesën për ekstradim për

²²Shih: Jola Xhafo, *E drejta penale Ndërkombetare*, Tiranë, 2009 fq 285.

²³Shih: Nenin 448 i Kodit të Procedurës Penale.

dorëzimin e personit të kërkuar ose dënimin e tij. Në bazë të këtij mendimi është krijuar dhe parimi “*aut dedere aut punire*” që do të thotë “dorëzoje ose ndëshkoje”. Disa autorë të tjerë mendojnë se ekstradimi duhet konsideruar më shumë si një detyrim moral dhe propozojnë që kjo formë bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar të realizohet vetëm nëpërmjet marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, të cilat përcaktojnë kushtet dhe detyrimet që duhet të respektojnë shtetet gjatë procedurës së ekstradimit. Sipas tyre ekstradimi është një akt vullnetar i materializuar në marrëveshje ndërmjet shteteve. Aktualisht në praktikën bashkëkohore gjen më shumë zbatim ekstradimi i bazuar në marrëveshjet midis shteteve dhe vetëm në raste shumë të rralla ekstradimi duhet të bëhet edhe në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare. Shtetet të cilat nuk pranojnë ekstradimin në mungesë të një marrëveshjeje janë kryesisht shtetet e sistemit *Common Law*, si ShBA-ja dhe Britania e Madhe. Ndërsa, në shtetet e të drejtës kontinentale, ekstradimi mund të lejohet edhe në raste kur nuk ekziston marrëveshje ndërkombëtare, me përjashtim të Holandës, Norvegjisë, dhe Turqisë.²⁴

Akoma më interesante paraqitet situata në vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Lëvizja e lirë në BE, si një nga liritë dhe të drejtat themelore që garantohen aty, ka krijuar mundësinë që autorët e veprave penale të vendosen nga njëri shtet në tjetrin me qëllim shmangien nga përgjegjësia penale dhe vuajtjes së dënimit përkatës. Ekstradimi krijon mundësinë që me marrëveshje shtetet të bashkëpunojnë për të dorëzuar nga shteti ku janë strehuar tek shteti që i kërkon këta persona të cilët kanë konsumuar vepra penale.²⁵ Në këtë mënyrë bëhet i mundur zbatimi i ligjit, luftohet dhe njëkohësisht parandalohet kriminaliteti. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë për të ekstraduar një person kërkohet plotësimi i disa kushteve ku më kryesorët janë:

²⁴Shih: Azem Hajdari, *Ndihma Juridike dhe Ekstradimi*, Prishtinë, 2014. fq 24.

²⁵Shih: Shefqet Muci, *E Drejta Penale (Pjesa e përgjithshme)*, Botimet Universitare Dudaj. Tiranë, 2007. Fq.89.

1. Nevoja që të parashikohet shprehimisht në marrëveshje ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë.²⁶ Pra, lind nevoja e ekzistencës së marrëveshjeve dypalëshe, marrëveshjeve shumëpalëshe ose konventave ndërkombëtare për ekstradimin në mënyrë që ky institut të gjejë zbatim. Neni 39/2 i Kushtetutës së Shqipërisë bën lidhjen e ekstradimit jo vetëm me parashikimin e tij shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare por edhe me detyrimin që të bëhet vetëm me vendim gjyqësor. Republika e Shqipërisë aderon në mjaft konventa dhe traktate ndërkombëtare që lidhen me ekstradimin. Ndër to mund të përmendim këtu Konventën e Parisit “Për Ekstradimin” datë 13 nëntor 1957, Konventën Evropiane “Për transferimin e personave të dënuar” ratifikuar me ligjin Nr. 8499 datë 10.06.1999, Marrëveshjen mes Shqipërisë dhe Greqisë “Për ndihmën e ndërsjelltë gjyqësore në fushën penale, civile dhe atë të transferimit të të burgosurve” datë 17.05.1993, Konventën e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në fushën penale” ratifikuar me ligjin Nr. 8498 datë 10.06.1999, e mjaft të tjera²⁷.
2. Kushti i dytë i domosdoshëm që kërkohet është parashikimi i objektit të kërkesës për ekstradim si vepër penale si nga ligji shqiptar ashtu edhe nga ai i huaj njëkohësisht.²⁸ Sikurse i pari, edhe ky kusht është mjaft i rëndësishëm. Mungesa e tij bën të pamundur ekstradimin. Thënë më qartë, në qoftë se vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi nuk parashikohet edhe në dispozitat e legjislacionit tonë penal, atëherë organet shtetërore shqiptare nuk legjitimohen për të kryer ekstradimin e personit të kërkuar nga shteti i huaj. Anasjelltas, edhe shteti shqiptar nuk mund të kërkojë ekstradimin e një personi, vepra penale e konsumuar prej të cilit nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni i shtetit ku ai strehohet.

²⁶Ibid.

²⁷Shih: QPZ - Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare për Drejtësinë, Tiranë 2006

²⁸Shih: Shefqet Muci, E Drejta Penale (Pjesa e përgjithshme), Botimet Universitare Dudaj. Tiranë, 2007, fq.91.

Nisur nga sa më sipër, ekzistojnë një grup veprash penale si vrasja, genocidi, krimet kundër njerëzimit, veprat e terrorit, prostitucioni, trafikimi i lëndëve narkotike e mjaft të tjera, për të cilat ekstradimi mund të realizohet pa pengesa pasi njihen si vepra penale nga të gjitha shtetet që aderojnë në konventa ku aderon edhe Shqipëria. Kodi i Procedurës Penale rendit kushtet e tjera, edhe ato jo pak të rëndësishme, për të bërë të mundur ekstradimin e personave.

2.3. Parimet e ekstradimit

Bashkëpunimi gjyqësor në fushën penale bazohet në parimin e solidaritetit ndërmjet shteteve të ndryshme, ku secili shtet duhet të ndihmojë dhe njëkohësisht të ndihmohet në përmbushjen e detyrimit parësor të parandalimit të veprave penale, dhënies së drejtësisë dhe ekzekutimit të dënimeve penale. Në sajë të këtij bashkëpunimi bëhet i mundur realizimi i drejtësisë penale, në mënyrë që autorët e veprave penale, pavarësisht ku strehohen apo ku kanë kryer aktivitetin kriminal, të vihen përpara drejtësisë e njëkohësisht të marrin dhe të ekzekutojnë dënimin përkatës²⁹. Në legjislacionin penal të shteteve bashkëkohore si dhe në marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare janë sanksionuar disa kritere ose parime të përgjithshme të cilat duhet të respektohen në çdo akt ekstradimi. Këto parime parashtrojnë kushtet e caktuara që duhet të përmbushen për të mundësuar dorëzimin e personit për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose ndjekjen dhe vënien e tij përpara përgjegjësisë penale. Parimet mbi të cilat mbështetet ekstradimi sipas Konventës Evropiane për Ekstradim e vitit 1957 janë disa. Do i kendveshtrojmë në mënyrë analitike këto parime.

²⁹Shih: Hoxha Artan, *Perspektivat e legjislacionit procedural penal shqiptar në kuadrin e integritimit në Bashkimin Evropian*, vep e cit. fq.121.

2.3.1. *Parimi i reciprocitetit*

Ky parim realizohet kryesisht në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe, si rrjedhojë, ekstradimi bazohet në të drejtën e brendshme. Sipas këtij parimi, nga vetë kuptimi i fjalës reciprocitet, ekstradimi do të realizohet vetëm në rast se shteti kërkues ka realizuar më përpara kërkesa ekstradimi ndaj shtetit që po i parashtron kërkesën ose do të realizojë në të ardhmen.³⁰Pra ky parim është shumë i rëndësishëm në rastin e ekstradimit sepse krijon dhe një precedent në këtë fushë në raportet mes dy shteteve.³¹Pra, nga analizimi i kësaj fjalie dalim në përfundimin se kemi 2 lloje reciprociteti: atë faktik dhe reciprocitetin juridik. Në reciprocitetin faktik duhet që shteti kërkues i ekstradimit të ketë lejuar ekstradimin në situata të njëjta ekstradimin drejt shtetit pritës të kërkesës ndërsa reciprocitet juridik kemi në rastet kur shteti kërkon ekstradimin *ad hoc*, dhe kërkesës për ekstradim i bashkëngjit dhe një deklaratë ku përcakton se do të veprojë në të njëjten mënyrë në të ardhmen në situata të njëjta.

2.3.2. *Parimi i specialitetit*

Principi i specialitetit i shërben respektimit të principeve tradicionale të ekstradimit. Sipas kuptimit klasik bëhet fjalë për një kompensim të heqjes dorë nga shteti që i drejtohet kërkesa në mënyrë të pjesshme nga të drejtat e tij sovrane, i cili nuk merr përgjegjësi për veprimet e një shteti tjetër të ndodhura jashtë sferës së vet të pushtetit. Në themel të këtij parimi qëndron pohimi se një person mund të ndiqet penalisht apo të ndëshkohet vetëm për atë veprë penale për të cilën kërkohet të ekstradohet dhe jo për vepra penale të cilat nuk janë objekt i kërkesës së ekstradimit. Nëpërmjet aplikimit të këtij parimi i sigurohet mbrojtje personit ndaj të cilit është paraqitur kërkesa e ekstradimit, për veprat penale të kryera pas kërkesës së ekstradimit.

³⁰Shih: A. Hajdari, *Ndihma Juridike dhe Ekstradimi*, Prishtinë, 2014, fq. 31.

³¹Shih: Salihu Ismet, *E drejta penale ndërkombëtare*, fq.160.

Detyrimi i shtetit që bën kërkesën për të ruajtur specialitetin rrjedh nga një konventë ekstradimi. Parimi i specialitetit është i sanksionuar në nenin 14 të Konventës Evropiane për Ekstradimin ku sipas këtij neni *“Individi që dorëzohet nuk duhet të ndiqet, as të gjykohet dhe as të burgoset për vuajtjen e një dënimi ose të një mase sigurimi; as duhet t’i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale për çfarëdo veprimi që është kryer para dorëzimit, dhe që nuk hyn në motivet e ekstradimit, me përjashtim të disa rasteve.”*³² Konventa në këtë nen përcakton dy përjashtime nga ky parim të cilët konsistojë në rastet:

- *Kur pala që e ka dorëzuar jep pëlqimin e vet.* Për këtë qëllim bëhet një kërkesë, e shoqëruar kjo me dokumentet që parashikohen në nenin 12 dhe në një proces verbal gjyqësor me deklaratimet e të ekstraduarit. Ky pëlqim do të njoftohet kur shkelja, për të cilën ai është kërkuar, përmban në vetvete detyrimin e ekstradimit të bazuar në këtë Konventë³³. Pra, ky konsiderohet ndryshe si ekstradimi aksesor sepse shteti ekstradues jep autorizimin që personi të ekstradohet edhe për vepra të tjera penale që nuk janë objekt i kërkesës.
- *Kur individi i ekstraduar edhe pasi ka mundësinë të largohet, nuk është larguar gjatë 45 ditëve që pasojnë lirimin e tij përfundimtar nga territori i Palës së cilës i është dorëzuar ose kur është rikthyer aty pasi është larguar.*³⁴ Deklarata që i ekstraduari heq dorë nga parimi i specialitetit behet në gjykatën kompetente të shtetit ku ai ndodhet.

Nëse në një vend që nuk zbatohet Konventa atëherë do të zbatohen dispozitat e legjislacionit vendas, ndërsa për kërkesat që dërgohen prej tij zbatohet legjislacioni i vendit që i drejtohet kërkesa.

³²Shih: Nenin 14 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për Ekstradimin.

³³Shih: Nenin 14 paragrafi 1 pika a) të Konventës Evropiane për Ekstradimin.

³⁴Shih: Nenin 14 paragrafi 1 pika b) të Konventës.

2.3.2. Parimi i ekstradibilitetit

Ky parim konsiston në pranimin e kërkesës së ekstradimit vetëm në rastet kur janë vepra penale për të cilat personat mund të ekstradohen. Pra, lejohet ekstradimi vetëm për vepra penale për të cilat është parashikuar ekstradimi me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare ose me legjislacionin e brendshëm. Rëndësia e veprës penale është në vlerësim të legjislacionit penal të shtetit kërkues të ekstradimit ose dhe sipas legjislacioneve penale të të dyjave shteteve. Konventa Evropiane për Ekstradimin përcakton se Ekstradimi përjashtohet për vepra penale me burgim deri në një vit³⁵ dhe për ekzekutimin e dënimit me burgim deri në 4 vjet.³⁶

2.3.3 Parimi i identitetit të normave (reciprociteti i inkriminimeve)

Nëpërmjet këtij parimi pranohet ekstradimi vetëm nëse vepra penale që është objekt ekstradimi konsiderohet e tillë në vendin pritës dhe në shtetin kërkues (shtetin që kërkon ekstradimin). Verifikimi i këtij parimi realizohet nëpërmjet bashkëngjitjes me kërkesën e ekstradimit të një kopje të ligjit penal të vendit kërkues në mënyrë që të verifikohet që vepra në fjalë konsiderohet krim në vendin kërkues. Ky parim ka lindur si domosdoshmëri për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve për të mos u privuar nga liria dhe të drejtat e tjera në shtetin ku është duke banuar, për shkak të kërkesës për ekstradim për një vepër që nuk konsiderohet si krim në atë shtet. Këtë parim e gjejmë të sanksionuar në të gjitha marrëveshjet dypalëshe dhe në Konventën Evropiane për Ekstradimin ku në nenin 2 të saj përcakton se ekstradimi do të lejohet për veprat penale që janë të dënueshme në të dyja shtetet³⁷ sepse nëpërmjet ekstradimit nënkuptohet se ndërmjet dy shteteve ekziston një marrëveshje mbi vlerat që duhen mbrojtur.³⁸

³⁵Shih: A. Hajdari, *Ndihma Juridike dhe Ekstradimi*, Prishtinë, 2014, fq. 33

³⁶Shih: Nenin 2 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për Ekstradimin.

³⁷Shih: Nenin 2 paragrafi 2 të Konventës Evropiane për Ekstradimin.

³⁸Konventa Evropiane për Ekstradimin e vitit 1957 dhe dy protokollat shtesë Hoxha.A, Ekstradimi sipas instrumenteve ligjore të BE-së. Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentet e Këshillit të Evropës, Tiranë 2010.

2.3.4. Parimet mbi të cilat mbështetet ekstradimi sipas legjislacionit penal shqiptar

Në frymën e KEDNJ, ku ‘*e drejta për liri dhe siguri*’ i takon cdo individ si një e tërë dhe është e patjetërsueshme, ecën edhe Konventa tjetër evropiane, e titulluar “Për ekstradimin”³⁹, e cila është bërë pjesë përbërëse e legjislacionit shqiptar⁴⁰ dhe është transpozuar në një masë të konsiderueshme edhe në dispozitat e Kodit Penal⁴¹ (këtu e në vazhdim K.P.), si dhe të Kodit të Procedurës Penale (këtu e në vazhdim K.Pr.P.).

Kështu, legjislacioni shqiptar, për ekstradimin në referencë të konventës bazohet mbi këto parime:

1. Parimi i veçorisë ose specialitetit; ka të bëjë me procedimin e personit të kërkuar vetëm për atë veprë penale që parashikohet në kërkesën për ekstradim. Shteti kërkuar do të procedojë vetëm për veprën penale, që i atribuohet personit në kërkesë dhe do të bëjë drejtësi vetëm për të. Ky parim rregullohet në nenin 14 të Konventës dhe nenin 490 të K.Pr.P.⁴²

Parimi i veçorisë ose specialitetit, shprehet me përcaktimin e saktë të veprës penale që i atribuohet personit të kërkuar. Parimi i veçorisë përbën kusht të shprehur, mungesa e të cilit sjell mospranim kërkesë dhe moskryerje procedurash të mëtejshme ekstradimi. Ekstradimi do të lejohet vetëm nëse personi i ekstraduar nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe nuk do t’i dorëzohet një shteti tjetër për një veprë penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.

2. Parimi i fajësisë së dyfishtë; ka të bëjë me parashikimin e veprës penale si të tillë në legjislacionin e të dy vendeve në marrëdhënie ekstradimi. Në legjislacionin shqiptar ky

³⁹Ligji nr.8322, datë 02.04.1998 “*Mbi ratifikimin e Konventës evropiane për ekstradimin dhe dy Protokollat shtesë*”.

⁴⁰Neni 122, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

⁴¹Ketu e ne vazhdim do citohet si KP.

⁴²Ky parim i ka rrënjët e tij në frymën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në mirëbesimin mes shteteve. Në të kundërt, do të kishim një çënim të shtetit që kryen ekstradimin dhe personit të ekstraduar dhe abuzim nga shteti kërkuar. Procedura e ekstradimit është diskrecionare dhe në të pasqyrohet shprehimisht shkelja e vërejtur duke cituar edhe akuzën që i atribuohet personit.

parim rregullohet nga neni 2/1 i Konventës Evropiane për Ekstradimi, neni 11 i K.P., dhe neni 491 i K.Pr.P.

Parimi i fajësimit së dyfishtë të veprës lidhet edhe me problematikën e përbashkët që haset mes shteteve në lidhje me veçoritë e krimit dhe formave të shfaqjes së tij, duke mbajtur në themel synimin për të luftuar kriminalitetin.

Fleksibiliteti i Kodit Penal ku janë kryer vazhdimisht shtesa, ndryshime, shfuqizime, parashikimit në të, të figurave të reja të veprave penale, është tregues i nivelit dhe formave të shfaqjes së kriminalitetit, që ka lidhje me rrethanat dhe forma të reja të shfaqjes së kriminalitetit.⁴³

Mungesa e dënueshmërisë së dyfishtë të veprës penale është një arsye refuzimi. Në nenin 2/1 të Konventës Evropiane të Ekstradimit thuhet se i japin shkas ekstradimit veprat që ndëshkohen nga ligjet e vendit të palës kërkuese dhe të kërkuar me privimin e lirisë. Neni 491/d i K.Pr. P., sanksionon rregullin se: “Ekstradimi nuk mund të jepet kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë në legjislacionin shqiptar”. Neni 11 i K.P. përcakton se ekstradimi lejohet kur vepra penale, që përbën objektin e kërkesës për ekstradim, është e parashikuar si e tillë njëkohësisht nga ligji shqiptar dhe i huaj.

Si përfundim, cdo shtet mund ta refuzojë ekstradimin me mungesën e dënueshmërisë së veprës penale.

3. Parimi i mosdorëzimit për një vepër penale me karakter politik. Sipas nenit 3/1 të Konventës Evropiane “Për Ekstradim”, nenit 11, gërma (b) të K.P., nenit 491 gërma (a) të K.Pr.P., ekstradimi nuk do të jepet në rastet e kryerjes së një vepre me karakter politik.

⁴³Të tilla ndryshime, mund të përmendim ato të bëra në figurën e veprës penale të: “*Trafikimit të femrave për prostitucion*”; “*Mosdeklarimi në kufti i shumave monetare dhe sendeve me vlerë*”, apo ndryshimet e kryera në nenin 287 të K.P në lidhje me veprën penale të “*Pastrimi i produkteve të veprës penale*”, i cili është ndryshuar disa herë duke iu përshtatur formave të shfaqjes së kësaj vepre penale, apo shtimi i një sërë dispozitave në lidhje me krimin kompiuterik, të cilat janë kryer si pasojë e evoluimit të teknologjik, si dhe përshtatjen e formave të kriminalitetit me këtë evoluim.

Nuk ekziston një definicion në lidhje me krimin politik, por është e drejtë e çdo shteti, dhe mekanizmave të tij për të çmuar nëse një veprë penale mund të konsiderohet me karakter politik apo jo. Në një këndvështrim të përgjithshëm, krimi politik është përkufizuar si një veprim i kryer me qëllim për të kundërshtuar dhe sfiduar autoritetin shtetëror.⁴⁴ Madje, duke i shkuar më tej këtij përcaktimi, veprime të tilla si: trafiku i armëve, rrëmbimet, etj, janë konsideruar si të motivuara politikisht dhe anasjelltas. Pra, në këtë kuptim, qëllimi justifikon mjetin dhe mjetet përdoren për të arritur një qëllim.

Pikëpamja mbizotëruese që një krim të konsiderohet i tillë, duhet të ekzistojnë motivet politike, por ky motiv duhet të shoqërohet nga ekzistenca e dy kushteve, të cilat duhet të shfaqen njëkohësisht: (1) të drejtohet kundër një shteti pa dëmtuar interesat e qytetarëve të thjeshtë, dhe (2) nuk shoqërohet me vepra penale të zakonshme.

Kodi Penal nuk parashikon vepra me karakter politik, sepse ai udhëhiqet nga parime demokratike mbi të cilat është ngritur dhe funksionon shteti shqiptar. Por, bazuar në një konceptim të caktuar mund të thuhet se: veprat penale që drejtohen kundër rendit kushtetues, autoritetit të shtetit, etj., mund të karakterizohen si të tilla.⁴⁵

4. Parimi i mosekstradimit të personit kur vlerësohet se ekstradimi i tij kërkohet në mënyrë që t'i nënshtrohet persekutimeve apo diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, bindjeve politike, gjendjes personale apo shoqërore ose dënimeve apo

⁴⁴Duhet të mbahet në konsideratë se përkufizimi i krimit politik është konsideruar sfidë për çdo shtet, pasi këndvështrimi i çdo shteti, të cilit i drejtohet kërkesa, duhet të lidhet jo vetëm me konceptin e krimit politik në përgjithësi, por edhe me politikën e përvijuar nga ana e kërkuarit. Sipas një pikëpamje në një interpretim të ngushtë, perceptimi i krimit politik është fakultativ, dhe si i tillë ai duhet parë si i shtyrë nga motivet politike. Një këndvështrim tjetër, që konsiderohet si absolut, krimi i cili drejtohet kundër shtetit ekskluzivisht dhe nuk shoqërohet me dëmtim të interesave të shtetasve të çfarëdo lloji qofshin ato, do të konsiderohet si krim politik. Të tilla mund të konsiderohen tradhëtia apo spiunazhi.

⁴⁵Në legjislacionin penal shqiptar në vite janë kryer ndryshime përkatëse në lidhje me veprat penale të kryera me qëllime terroriste. Ato parashikohen nga kreu 7-të i Kodit Penal - nenet 230 e në vijim. Ndryshimet konsistojnë në anën objektive të veprës penale, si p.sh neni 230, ku jepet koncepti i aktit terrorist dhe veprimet konkrete aktive, sic janë vrasja ose plagosja e shtetasve, pengmarria, shkatërrimi serioz i pronës publike e private, rrëmbimi i avionëve etj. Janë shtuar nene të vecanta si p.sh neni 230/a "*Financimi i terrorizmit*" etj. Ndryshime janë kryer në marzhet e dënimit duke i ashpërsuar ato, për të pasur një efikasitet në luftën kundër këtij fenomeni që është shfaqur edhe në Shqipëri.

trajttimeve të egra, çnjerëzore apo poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore.

Ky parim zë një vend të rëndësishëm në Konventë dhe në këtë frymë ecën edhe legjislacioni shqiptar, ku përkatësisht neni 11, gërma (c) e K.P., dhe neni 491, gërma (b) e K.Pr.P., janë hartuar në frymën e këtij parimi.

Në këtë rast vendin themelor e zënë motivet dhe këto motive duhen vlerësuar në çdo rast lidhur ngushtë me shtetin kërkues dhe kushtet e tij sociale dhe politike. Gjithashtu, duhet marrë në konsideratë politika fetare dhe racore që ekziston në një shtet, niveli i respektimit të të drejtave të njeriut dhe të shqyrtohen me vëmendjen e duhur rastet e diskriminimit, të çdo lloji që mund të jenë bërë publike.

Nga ana tjetër, rëndësi e veçantë i duhet dhënë personit të kërkuar, i cili mund të ketë shfaqur mendime të kundërta me doktrinat fetare, racore që janë në fuqi ose normale/zakonshme në këtë vend dhe karakterin e shkeljes që i atribuohet atij.

Mosekstradimi për këto arsye, gjen vend edhe në nenin 5 të Konventës “Për shtypjen e terrorizmit”⁴⁶, ku megjithëse i ka konsideruar tepër të rënda aktet terroriste, përsëri nuk ka neglizhuar mbrojtjen që u duhet bërë autorëve të veprave penale. Për të favorizuar mbrojtjen e individit Konventa mjaftohet me dyshimin, i cili sipas teorisë së të drejtës penale, duhet të jetë i fortë, i arsyeshëm, dhe i bazuar.

5. Suprimimi i parimit *prima facie*. Ky parim nënkupton faktin, se gjykimi i zhvilluar për një kërkesë ekstradimi, nuk përbën në vetvete një gjykim themeli për veprën penale që i atribuohet personit të kërkuar për ekstradim.

Gjykata disponon me vendim lejimi ose jo për ekstradimin, duke u mbështetur në këto kritere:

(1) gjykata nuk vlerëson ekzistencën ose jo të akuzës, ajo nuk analizon provat. Kjo përbën

⁴⁶Ligji nr. 8642, datë 13.07.2000 Për ratifikimin e Konventës evropiane “Për shtypjen e terrorizmit”, Fletore Zyrtare nr.22/2000.

kompetencë të gjykatës së vendit kërkues; (2) në kërkesën për ekstradim, shteti kërkues parashikon rrethanat e kryerjes së veprës penale, në mënyrë që të jetë sa më bindëse tek pala e kërkuar, në lidhje me fajësinë ose shkallën e implikimit të personit në kryerjen e veprës penale, por këto nuk janë objekt gjykimi nga gjykata e vendit të kërkuar.

Në rastet kur kemi ekstradim për shkak të ekzekutimit të një vendimi ose mase sigurimi, gjendemi përpara një vendimi penal të formës së prerë, i cili nuk rishikohet për efekt provueshmërie nga gjykata e vendit të kërkuar. Disponimi i gjykatës kompetente të palës kërkuese merret i mirëqenë. Në rastet kur personi i kërkuar mund të ketë statusin e të pandehurit ose personit nën hetim me masë sigurie heqje lirie, autoriteti gjyqësor i shtetit të kërkuar nuk mund të ngrejë akuzë, nuk mund të ndryshojë ose të vlerësojë cilësimin juridik të bërë dhe as të aludojë mbi mënyrën e zgjidhjes. E gjithë kjo përbën suprimimin e parimit *prima facie*.

6. Parimi i mosekstradimit të shtetasve.⁴⁷ Ky është një parim i rëndësishëm i ekstradimit, dhe i ka themelet në ushtrimin e sovranitetit të shtetit në të gjithë territorin dhe veçanërisht mbi njerëzit që jetojnë dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre në të. Shtetasit e një shteti kanë një status të veçantë në lidhje me qeverinë dhe territorin në të cilin ata jetojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Çdo vend ka të drejtë të refuzojë ekstradimin e shtetasve të tij, sipas nenit 6/1 gërma (a) të Konventës Evropiane “Për Ekstradim”. Neni 491/8 i K.Pr.P. parashikon se ekstradimi nuk lejohet kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe kur nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe.

Ky parim nuk ka karakter imperativ përsa kohë që shteteve u lihet vullneti i lirë për të vepruar ndryshe, duke e parashikuar këtë fakt në marrëveshjet dypalëshe.⁴⁸

⁴⁷Koncepti i shtetësisë nuk duhet ngatërruar me kombësinë, pasi një person nuk lidhet me origjinën e tij por me nënshtetësinë e vendit ku jeton, e cila mund të jetë e ndryshme nga kombësia. Cdo shtet ka rregjistrin e tij të shtetasve dhe këta të fundit kanë të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga shtetësia.

⁴⁸Parashikimi i një fakti të tillë është kapërcim i një parimi dhe rezerve që përcakton konventa dhe që është mbrojtur me fanatizëm duke qenë dhe shprehje e sovranitetit të shtetit mbi shtetasit e tij. Parashikimi i këtij fakti në marrëveshjet dypalëshe mund të bëhet për motive të ndryshme.

Përsa i përket vendit tonë, Konventa Evropiane “Për ekstradimin” është ratifikuar me rezervë për mosekstradimin e shtetasve shqiptarë. Kështu, në rastin e shtetasve shqiptarë që kryejnë veprë penale jashtë shtetit dhe kapen në Shqipëri, procedimin i tyre bëhet sipas nenit 6 të K.P., i cili në këtë rast ia jep juridiksionin gjykatave shqiptare. Kështu, në këtë nen sanksionohet rregulli se: “Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar për kryerje krimi në territorin e një shteti tjetër ku krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj”. Ky nen, përveçse ‘justifikon’ mosekstradimin e shtetasve shqiptarë, përmban disa nga parimet bazë të ekstradimit, siç është ai i fajësimit dyfish, *'ne bis in idem'* (që do trajtohet më poshtë).

7. Parimi *'non bis in idem'*, rregullohet nga nenet 8 dhe 9 të Konventës Evropiane të Ekstradimit. Neni 8 vendos refuzimin e ekstradimit për një person, i cili po hetohet dhe procedohet për një ose më shumë vepra penale për të cilat kërkohet ekstradimi, kurse neni 9 i Konventës, parashikon mosdhënien e ekstradimit kur personi është dënuar përfundimisht nga autoritetet gjyqësore të shtetit të kërkuar për një ose me shumë vepra objekt të kërkesës për ekstradim.

Ky rregull është përcaktuar edhe në nenin 11 të Kodit Penal Shqiptar, ku thuhet se: “Ekstradimi nuk lejohet nëse personi që kërkohet të ekstradohet është gjykuar nga një gjykatë kompetente shqiptare për të njëjtën veprë penale, për të cilën kërkohet ekstradimi”. Këtë fakt e rregullon edhe neni 491, gërma (ç) e K.Pr.P.

Vlen të theksohet fakti, se ky parim ka vlerë për veprat penale, të cilat kanë të katër elementë të njëjtë të veprës penale dhe nuk nënkupton konsumim të disa veprave penale, pra që personi të ketë kryer disa vepra penale, nga të cilat, një ose disa janë hetuar, gjykuar ose është dhënë vendim nga shteti shqiptar.

Nga ana tjetër, titulli II-të i Protokollit shtesë të Konventës Evropiane “Për Ekstradimin” ka plotësuar nenin 9 të saj, kështu në 3 paragrafët e shtuar përcaktohet se ekstradimi nuk jepet as

në ato raste kur nga gjykata e shtetit të kërkuar është dhënë një vendim i formës së prerë dënimi ose pafajësie para shtetit kërkues, dhe as kur masa e burgimit apo çdo masë tjetër është ekzekutuar plotësisht apo ka qenë objekt i një falje apo amnistie, sipas ligjeve të brendshme të shtetit të kërkuar.

Sipas këtij parimi, një shtetas i huaj, që ka kryer një vepër penale në vendin e tij dhe aktualisht ndodhet në territorin shqiptar, nuk do të ekstradohet nëse kjo vepër është amnistuar në Shqipëri nga ligjvënësi. Vendimi i amnistisë në këtë rast do të konsiderohet si vendim i formës së prerë nëse është dhënë nga gjykata dhe nëse për shkak të ligjit të amnistisë është pushuar ose për të mosfilluar me vendim të prokurorisë. Ky parim gjen vend në nenin 491, gërma (e) të K.Pr.P.⁴⁹

2.4. *Vështrim historik mbi institutin e ekstradimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera*

Pas shpalljes së pavarësisë shteti ynë krijoi një bazë ligjore në lidhje me institutin e ekstradimit duke u bërë palë në disa traktate të rëndësishme të kësaj periudhe. Traktati i parë i Shqipërisë për ekstradim është Traktati me Greqinë i hartuar në 25 Qershorit 1926 (Hoxha, 2010: 71).⁵⁰ Më pas gjatë këtij viti u hartuan traktate me Britaninë e Madhe, Serbinë, Kroacinë dhe Slloveninë. Në vitin 1933 u nënshkrua Traktati për Ekstradim mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë, asokohe mbretëri (Mici, 2004; 113). Përveç rëndësisë juridike dhe historike të këtij traktati ai konsiderohet edhe si tregues i vullnetit të klasës politike për të

⁴⁹E njëjta llogjike duhet ndjekur edhe në rastin e faljes. Specifikat e këtij rasti lidhen me organin që e jep faljen dhe me specifikat e rastit për të cilën jepet falja. Neni 70 i K.P. përcakton se ajo jepet për personin i cili e inicion vetë procedurën e faljes. Ajo jepet duke marrë parasysh rethanat dhe karakteristikat personale të personit, që mund të jenë familjare, profesionale, etj. Pra, në një rast të tillë procedohet me akt të vecantë dhe personi është i njohur për autoritetin gjyqësor kompetent, që i drejtohet kërkesa e ekstradimit. Në këtë rast refuzimi për ekstradim do të mohohet si *ne bis in idem*.

⁵⁰Shih Hoxha.A. Ekstradimi sipas instrumentave ligjore të BE –se .Ngjashmerite dhe ndryshimet me instrumentat e Keshillit të Evropës , Tirane 2010 fq 71

vendosur bashkëpunimin në fushën penale jo vetëm me vendet e rajonit por edhe me vendet perëndimore të zhvilluara.⁵¹

Gjatë viteve 1944-1990 Shqipëria ishte në një periudhë izolimi jo vetëm ekonomik por dhe juridik. Marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria u bë palë gjatë kësaj periudhe ishin vetëm me shtetet komuniste ndër të cilët mund të përmenden marrëveshjet me Rusinë, Çekoslovakinë, Hungarinë dhe Rumaninë. Gjithsesi duhet theksuar fakti se edhe pse këto marrëveshje ekzistonin, marrëdhëniet e ekstradimit kanë qenë pothuajse inekzistente⁵². Kjo edhe për vetë faktin se hyrja apo dalja e personave nga kufiri i Shqipërisë ka qenë thuajse e pamundur. Hyrja brenda territorit të Shqipërisë kishte si sanksion pushkatimin e personit. Ai asgjësohej pasi konsiderohej armik i popullit me qëllime terroriste.⁵³ Po kështu edhe dalja nga kufiri i Shqipërisë konsiderohej si vepër penale. Ky fakt pra, shpjegon pse ekstradimi në këto vite ishte inekzistent. Marrëveshjet më të rëndësishme të kësaj periudhe janë: Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Çekoslovakisë “Për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë në fushën penale e vitit” 1959; Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Rumanisë “Për ndihmën juridike në çështjet e vitit 1960.”; Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë dhe Hungarisë “Për Ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë në fushën penale” e vitit 1960.

Pas viteve 1990 ishte periudha kur u zhvilluan marrëdhëniet e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe autoriteteve të huaja⁵⁴. Në këtë periudhë Shqipëria u anëtarësua në disa organizata ndërkombëtare. Pas vitit 1990 Shqipëria ratifikoi mjaft marrëveshje dhe u anëtarësua në disa organizata ndërkombëtare për të përmirësuar dhe për ta çuar në një tjetër stad bashkëpunimin në fushën penale. Me ndryshimet e viteve 90 që pësoi pjesa më e madhe e

⁵¹Hoxha.A, Ekstradimi sipas instrumentave ligjore te BE –se .Ngjashmerite dhe ndryshimet me instrumentat e Keshillit te Evropes , Tirane 2010 fq 71-72 Neni 13 i Traktatit te Ekstradimit midis Shqiperise dhe Shteteve te Bashkuara te Amerikes,botimi i Fletoren Zyrtare 32 date 12 qershor 1935 Myrtja. Y. “Fuqia Juridike e marreveshieve nderkombetare te lidhura nga shtetit Shqipetar para miratimit te kushtetutes viti 1998

⁵²Përmbledhës i Përgjithshëm i Legjislacionit në Fuqi të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1945-1985) Vëllimi II , Kreu XIII (aktet në lidhje me marrëdhëniet me jashtë, fq.1525) – Tiranë 1986

⁵³Kodifikim i Përgjithshëm i Legjislacionit në Fuqi të Republikës Popullore të Shqipërisë (1945-1957) Vëllimi III – Botim i Kryeministrit, Tiranë 1958

⁵⁴QPZ - Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare për Drejtësinë, Tiranë 2006.

vendeve evropiane ndaj krimit të organizuar, terrorizmit apo formave të reja në të cilat shfaqet fenomeni i kriminalitetit nuk la pa prekur edhe Shqipërinë. Qarkullimi i lirë i mallrave dhe shërbimeve, lëvizja e lirë e individëve shtroi për Shqipërinë nevojën e intensifikimit të bashkëpunimit gjyqësor penal me vendet e tjera. Kështu modernizimi i legjislacionit, me hyrjen në fuqi të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale e afroi legjislacionin shqiptar me atë evropian. Pas viteve '90 Shqipëria ratifikoi dhe marrëveshje dypalëshe kryesisht me shtete fqinje si Greqia, Turqia, Maqedonia por edhe me Rusinë. Shqipëria synon krijimin e një kuadri ligjor dhe institucional që t'i përgjigjet nevojave bashkëkohore të luftës kundër kriminalitetit.⁵⁵

2.5. Evoluimi historik i ekstradimit në Evropë

Këshilli i Evropës u themelua në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, për të mbështetur dhe themeluar ndërtimin evropian mbi bazën e vlerave të respektimit të qenies njerëzore dhe të demokracisë. Synimi i tij është të krijojë një hapësirë demokratike e juridike të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁵⁶. Këshilli i Evropës zhvillon një bashkëpunim të gjithanshëm për një numër të madh çështjesh si edukimi, kohezioni shoqëror, mbrojtja shëndetësore, lufta kundër të gjitha formave të intolerancës dhe kriminalitetit. Kjo e fundit nuk mund të kërkonte daljen nga kornizat e një koordinimi veprimesh dhe bashkëpunimesh të ngushta ndërmjet shteteve anëtare të kësaj organizate. Në këto kushte Këshilli i Evropës parashikoi forma dhe mekanizma konkretë të cilët do të vendosnin bazat e marrëdhënieve të bashkëpunimit.

⁵⁵Shih Myrtja .Y, “Fuqia Juridike e marreveshieve nderkombetare te lidhura nga shtetit Shqiptar para miratimit te Kushtetutes viti 1998.Hoxha.A, Ekstradimi sipas instrumentave ligjore te BE –se .Ngjashmerite dhe ndryshimet me instrumentat e Keshillit te Evropes , Tirane 2010 fq 73,74,75,76,77Neni122,123 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

⁵⁶Konventë e miratuar më 1950, sipas të cilës shtetet anëtare të Këshillit të Evropës zotohen të respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, të drejtat qytetare e politike

Vendet e Evropës fillimisht kishin operuar në fushën e ekstradimit me anë të marrëveshjeve dypalëshe por ardhja gjithmonë e në rritje e kriminalitetit kërkonte në mënyrë emergjente harmonizimin e legjislacionit në nivel komunitar dhe në këto kushte Këshilli i Evropës hartoi dhe miratoi me vullnetin e shteteve anëtare një sërë konventash në fushën e bashkëpunimit gjyqësor dhe penal në veçanti.⁵⁷ Konventat e hartuara nga KE-ja luajtën një rol parësor duke mundësuar bashkëpunimin në fushën penale midis shteteve evropiane për shumë vite duke synuar parandalimin e krimit dhe një administrim më të mirë të drejtësisë. Konventa kryesore në fushën e ekstradimit është Konventa mbi Ekstradimin e 1957 me dy protokollet shtesë të saj.

Aktualisht kemi mbi 25 konventa e instrumente të tjerë që synojnë ndihmën gjyqësore ndërkombëtare në fushën penale. Krijimi i këtyre instrumenteve juridik nga KE-ja ka kaluar në disa etapa. Kështu në vitet 1951-1959 hartohen dhe nënshkruhen dy konventa, rëndësia e të cilave vazhdon edhe në ditët e sotme. Ato janë: Konventa për Ekstradimin e vitit 1957 dhe Konventa për Ndihmën e Ndërsjellë në Ceshtjet Penale, e vitit 1959. Periudha gjatë viteve 1961-1971 e cila konsiderohet si inovative ku objekti i bashkëpunimit synonte përballimin me efikasitet të një kriminaliteti tashmë më të organizuar dhe më kompleks.⁵⁸ Në këtë rrjedhë vlen të theksohet që burimet e bashkëpunimit penal ndërmjet vendeve anëtare në origjinën e tyre u bazuan ekskluzivisht në sistemin e bashkëpunimit penal të krijuar në kuadër të Këshillit të Evropës.⁵⁹

Me hartimin e Konventës Evropiane për Ekstradimin u krijua një regjim juridik unik për ekstradimin midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Konventa shfuqizon traktatet dypalëshe dhe harmonizon legjislacionet e brendshme të shteteve në lidhje me këtë institut. Në

⁵⁷Hoxha, A., *Ekstradimi sipas instrumentave ligjore të BE –se .Ngjashmerite dhe ndryshimet me instrumentat e Keshillit të Evropes*, Tirane, 2010, fq 115-116; Canaj, Bana, E drejta e Bashkimit Evropian, 2014.

⁵⁸Shih: Hajdari, A, *Ndihma Juridike dhe Ekstradimi*, Prishtinë, 2014. fq. 26

⁵⁹Shih nenin 3 i Statutit Themelues të Këshillit të Evropës , nënshkruar me 5 maj 1949., cituar ne: Hoxha, A., *Ekstradimi sipas instrumenteve ligjore të BE –së .Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentat e Keshillit të Evropes*, Tiranë 2010, fq 118.

këtë konventë parashikohet mundësia e refuzimit të ekstradimit nga ana e shteteve nënshkruese⁶⁰ të shtetasve të saj. Në lidhje me procedurën që shtetet duhet të ndërmarin për shqyrtimin e kërkesave për ekstradim duhet të themi që Konventa për Ekstradimin nuk shprehet duke ia lënë kompetencën territoriale vetë shteteve. Shumica e shteteve kanë shprehur rezerva ndaj Konventës. Rezervat e shprehura kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit shtetëror, mbrojtjen e shteteve dhe mungesën e vlerave të përbashkëta. Pengesë për ekstradimin është ekzistenca e rretheshme juridike të ndryshme si dhe nga shumëllojshmëria e koncepteve që ekzistojnë mbi kufijtë e vendosur për sjelljet sociale dhe mbi masën e ndërhyrjes së pushtetit politik në çështjet personale. Konventa e vitit 1957 ka bërë një hap të madh drejt harmonizimit të së drejtës evropiane në fushën e ekstradimit, por ajo akoma nuk ka arritur të bëjë një njehsim të vërtetë.

⁶⁰Shih: Nenin 6 të Konventës Evropiane për Ekstradimin të vitit 1957.

KAPITULLI III: EKSTRADIMI NË KUADRIN E TË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONET PERGJEGJËSE

3.1. Ekstradimi në aktet juridike ndërkombëtare. Roli i marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e ekstradimit

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale midis subjekteve të së drejtës ndërkombëtare me kalimin e kohës ka njohur një stad të lartë zhvillimi duke u pasuruar me institute të reja penale.⁶¹ Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale ka si qëllim kryesor përpunimin e mjeteve dhe metodave me anë të të cilave shtetet ndihmojnë njeri-tjetrin, në synimin e përbashkët, ndëshkimin e individëve që kryejnë vepra penale duke realizuar një drejtësi të aftë për të vënë në vend të drejtën e shkelur.⁶² Rritja e ndjeshme e kriminalitetit ndërkufitar që e bëri procesin e ndëshkimit mjaft të vështirë ishte një nga shkaqet kryesore të zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale të plotë e efektiv nga ana e shteteve. Realizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar kërkonte domosdoshmërisht hartimin e kuadrit ligjor të nevojshëm në fushën penale. Ekstradimi në legjislacionin tonë⁶³ kushtëzohet ngakonventat ndërkombëtare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar pa pasur një marrëveshje ka disavantazhe të shumta kryesisht në rrugë diplomatike.⁶⁴ Marrëveshjet ndërkombëtare sjellin avantazhe të shumta duke detyruar palët që në kushte të caktuara të japin ndihmën e ndërsjelltë. Ndërmjet këtyre marrëveshjeve përcaktohen procedurat ndërshtetërore që duhet të zbatohen dhe lehtësojnë komunikimin e organeve që janë të integruara direkt në proces.

⁶¹Shih: Daci, J. (2011). *Të drejtat e njeriut*, fq. 58.

⁶²Shih: <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/urdheri-evropian-i-ndalimit-valbona-ndrepepaj.html#B3Svsjdpfd3rIpLk.99>

⁶³Shih: Nenin 39/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

⁶⁴Shih: Odeta Barballushi, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, cikël leksionesh, Tirane, fq 2.

Në momentin e lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare në fushën e ekstradimit dhe të ndihmës juridike shtetet kanë mundësinë e zgjedhjes ndërmjet marrëveshjes bilaterale dhe konventave multilaterale të cilat në varësi të përpilimit të tyre kanë avantazhe dhe disavantazhe. Kështu, marrëveshjet dypalëshe kërkojnë veprim vetëm me një partner, dhe në këtë mënyrë është më e lehtë për t'u lidhur dhe mund të shtohen edhe rregulla të reja, me shumë nga ç' mund të shtohen kur janë një numër i madh shtetesh. Por ka disavantazh faktin që mbulon vetëm një zonë të ngushtë dhe mund të bien ndesh me parimet, frymën dhe dispozitat e konventave shumëpalëshe. Kështu në rastin e A.R., ekstradimi i tij drejt SHBA-ve, u konsiderua në kundërshtim me normat dhe rregullat procedurale të konventave ndërkombëtare. Ky ekstradim u realizua në kuadër të marrëveshjes me SH.B.A., nënshkruar në 1-mars 1933. Roli i konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare është i rëndësishëm në lidhje me ekstradimin pasi në këto akte parashikohet procedura ligjore e aprovimit në të gjitha shtetet dhe në këtë mënyrë kemi një unifikim të këtij instituti në vija të përgjithshme.⁶⁵ Marrëveshjet ndërkombëtare kanë dhe rol detyrues sepse ato i detyrojnë palët që në kushte të caktuara të ofrojnë ndihmën e ndërsjelltë. Marrëveshjet ndërkombëtare përcaktojnë procedurën ndërshtetërore që duhet të zbatohet dhe lehtësojnë komunikimin e organeve që janë të integruara direkt në poces. Nëse duhet të lidhen marrëveshje ndërkombëtare, atëherë është mundësia e zgjedhjes ndërmjet marrëveshjes dypalëshe dhe konventave shumëpalëshe. Marrëveshjet dypalëshe lidhen ndërmjet dy shteteve dhe përcaktojnë procedurën e ekstradimit vetëm ndërmjet këtyre shteteve. Konventat ndërkombëtare paraprihen nga disa biseda midis shteteve të interesuara duke synuar të ofrohet një rregullim i përgjithshëm dhe njëhënjë një bashkëpunimin mes të gjitha shteteve anëtare. Më poshtë do të trajtojmë konventat e miratuara nga ana e OKB-së⁶⁶ në lidhje me luftën ndaj kriminalitetit në nivel ndërkombëtar.

⁶⁵Shih: Gruda. Z - E Drejta Ndërkombëtare Publike, Universiteti i Prishtinës 2003.

⁶⁶Organizata e Kombeve të Bashkuara (shkurt: OKB), është themeluar pas Luftës së Dytë Botërore me qëllim forcimin e bashkëpunimit midis shteteve të botës, zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e paqes në botë. Qendra e

Dokumentet ndërkombëtare të cilët sanksionojnë ekstradimin si formë për të luftuar kriminalitetin janë:

1. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar
2. Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit

Më poshtë do të trajtojmë në mënyrë të detajuar fushën e mbulimit dhe mbrojtjen që këto akte përcaktojnë për ekstradimin në lidhje me krimet që ato parashikojnë.

3.1.1. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar

Gjatë viteve 1990-'97 në Shqipëri u shfaqën struktura kriminale hierarkike në formën e bandave të armatosura, organizatave kriminale dhe grupeve të strukturuar kriminale luftimi i të cilave u kthye në një sfidë për vendin tonë, kjo sepse me kalimin e viteve u zhvillua dhe u zgjerua sfera e veprimtarive ku ato u përfshinë. Gjendur në këto kushte Kuvendi në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave miratoi ligjin Nr.8920 datë 11.07.2002 për ratifikimin e "*Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar*" dhe dy protokolleve shtesë të saj. Ekstradimi realizohet për vepra të ndryshme penale të cilat mund të prekin interesat e një ose disa shteteve. Në nenin 2 të kësaj Konvente përcaktohet se "*Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar*". Konventa nxit bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet vendeve anëtare lidhur me çështje globale, me qëllim marrjen e masave kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, dhe formave të tjera të krimit. Konventa identifikon bashkëpunimin dhe krijon detyrime për

OKB-së është në Gjenevë, ndërsa aktivitetet i zhvillon në qendrën e selisë në Nju Jork, SHBA. Per kete shih: https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Organizata_e_Kombeve_t%C3%AB_Bashkuara

shtetet nënshkruese lidhur me çështje të tilla si: grumbullimi dhe shkëmbimi i informacionit kriminal, ndihma e ndërsjelltë juridike lidhur me ekstradimin, transferimin e çështjeve penale, dhe transferimin e personave të dënuar etj. Fusha e aplikimit të kësaj Konvente është përcaktuar në nenin 3 paragrafi 2 nga ku përcakton se *“një veprë penale ka një natyrë ndërkombëtare në qoftë se: (a) kryhet në më shumë se një shtet; (b) kryhet në një shtet, por pjesa thelbësore e përgatitjes, planit, drejtimit ose kontrollit kryhet në një shtet tjetër; (c) kryhet në një shtet, por në të është përfshirë një grup kriminal i organizuar, i cili angazhohet në aktivitete kriminale në më shumë se një shtet; ose (d) kryhet në një shtet, por efektet thelbësore i ka në një shtet tjetër.”* Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar. Në këtë Konventë gjen rregullim dhe çështja e ekstradimit e cila është e një rëndësie relevante në luftën kundër krimit të organizuar dhe ndëshkueshmërisë së tij. Në nenin 16, paragrafin 1 të Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar përcaktohet se ekstradimi *“do të aplikohet ndaj veprave penale që mbulohen nga kjo Konventë⁶⁷ ose në rastet kur një veprë penale që përmendet në nenin 3 paragrafi 1 (a) ose (b) përfshin një grup kriminal të organizuar dhe personi, i cili është subjekt i kërkesës për ekstradim, ndodhet në shtetin palë të kërkuar, me kusht që vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi të jetë e ndëshkueshme në bazë të legjislacionit të brendshëm të shtetit palë kërkuar dhe të shtetit palë të kërkuar”*. Në rastet kur kërkesa për ekstradimin e një personi përfshin edhe vepra penale të cilat nuk mbulohen nga neni 3 i Konventës atëherë shteti i kërkuar mund të aplikojë nenin 3 edhe për vepra të cilat ai nuk i mbulon.⁶⁸ Në lidhje me gamën e veprave penale që mund të kërkohet ekstradim, Konventa përcakton se Shtetet Palë marrin përsipër që të përfshijnë veprat penale objekt i kësaj Konvente si dhe vepra të ekstradueshme në çdo traktat mbi ekstradimin që lidhin ndërmjet tyre. Nëse një shtet merr një

⁶⁷Shih nenin 3 paragrafi 1 të Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar ku thuhet se *“Përveç rasteve që parashikohen ndryshe në tekst, kjo Konventë do të aplikohet në lidhje me parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të: (a) veprave penale të parashikuara në nenet 5, 6, 8 dhe 23 të kësaj”*

⁶⁸Shih: Nenin 16 paragrafi 2 i të Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

kërkesë ekstradimi nga një shtet me të cilin nuk ka asnjë traktat dy palësh ekstradimi atëherë ky shtet mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazën ligjore për ekstradimin për çdo vepër penale ndaj të cilës aplikohet neni 16.⁶⁹Në nenin 16 paragrafi 7 i kësaj Konvente përcaktohet se *“Ekstradimi duhet t'i nënshtrohet kushteve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i shtetit palë të kërkuar ose traktateve që aplikohen ndaj ekstradimit, përfshirë, ndër të tjera, kushtet në lidhje me dënimin minimal të kërkuar për ekstradim dhe arsytet në bazë të të cilave shteti palë i kërkuar mund të refuzojë ekstradimin.”*. Pra shtetet, duhet të përpiqen që të lehtësojnë procedurat e ekstradimit dhe të bashkëpunojnë në mbledhjen e provave. Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar i garanton personit të ekstraduar të drejtën e një trajtimi të drejtë në të gjitha shkallët e procedurave gjyqësore duke përfshirë gëzimin e të gjitha të drejtave dhe garancive të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i Shtetit palë, në territorin e të cilit ndodhet ai person. Konventa ndalon ekstradimin nëse shteti palë i kërkuar, ka arsye thelbësore për të besuar se personi i cili do të ekstradohet do të jetë subjekt i ndëshkimit për shkak të seksit, racës, besimit fetar, kombësisë, origjinës etnike ose opinioneve politike të tij ose prej këtyre shkaqeve.⁷⁰Po kështu, ndalohet refuzimi i ekstradimit nga ana e shtetit të kërkuar kur vlerësohet se vepra penale do të përfshijë çështje të karakterit fiskal. Konventa inkurajon shtetet të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, për të zbatuar ekstradimin me qëllim rritjen e efektivitetit të luftës ndaj krimit të organizuar në veçanti dhe kriminalitetit në tërësi.⁷¹

⁶⁹Shih: Nenin 16 paragrafi 4 i të Konventës.

⁷⁰Shih: Nenin 16 paragrafi 14 i të Konventës së OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar.

⁷¹Shih: Nenin 16 paragrafi 17 i të Konventës.

3.1.2. Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit

Korrupsioni është një fenomen i cili përbën një rrezik për stabilitetin dhe sigurinë e shoqërisë, duke dëmtuar institucionet, demokracinë, drejtësinë dhe duke rrezikuar zhvillimin thelbësor dhe shtetin ligjor. Lufta ndaj korrupsionit është një ndër sfidat në të cilat vendi ynë duhet të punojë fortë për eliminimin e tij. Gjendur në kushtet e një niveli shumë të lartë të korrupsionit në vend dhe nevojës emergjente të luftimit të tij, vendi ynë ndërmori disa masa në këtë fushë. Kështu në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, u miratua ligji Nr. 9492, datë 13.3.2006 për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit.⁷²

Korrupsioni është një vepër penale e cila kryesisht është e lidhur ngushtësisht dhe me forma të tjera të krimin si: krimi i organizuar, krimi ekonomik, pastrimi i parave etj. Korrupsioni nuk është një vepër penale vetëm e një vendi, sepse me globalizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare ai ka marrë përmasa të konsiderueshme të cilat ndonjëherë ndërthurin dhe interesat e disa shteteve. Shtetet anëtare të OKB-së ishin të vendosur për të parandaluar dhe çrrënjësuar korrupsionin. Gjendur në këto kushte ata vendosën që duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të krijuar një instrument juridik i cili do të përshpejtonte procedurat burokratike dhe do të ndihmonte në luftimin sa më të shpejtë dhe efikas të korrupsionit. Kështu u krijua Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit e cila ishte e hapur për nënshkrim për të gjitha shtetet nga 9 deri më 11 Dhjetor të vitit 2003 në Merida, Meksikë dhe pastaj në Qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, deri më 9 Dhjetor të vitit 2005. Konventa hyri në fuqi në vitin 2005.⁷³Në fakt, edhe Këshilli i Evropës ka miratuar disa konventa të cilat kanë në fokus luftën kundër korrupsionit, si: Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtën Penale mbi

⁷²Shih: Ligjin Nr. 9492, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit”

⁷³Shih: http://www.pp.gov.al/web/ligj_nr_9492_date_13_3_817.pdf

Korrupsionin⁷⁴ dhe Konventa e Këshillit të Evropës për të Drejtën Civile mbi Korrupsionin,⁷⁵ megjithëse ato nuk janë në fokus të analizës sonë.

Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit⁷⁶ synon bashkëpunimin ndërkombëtar për veprat penale në fushën e korrupsionit,⁷⁷ dhe harmonizon kryerjen e veprimeve për parandalimin dhe goditjen e këtij fenomeni, që shfaqen në shoqëritë demokratike në forma të ndryshme, të tilla si: dhënia ryshfet nëpunësve për të përfituar lehtësira, abuzimi me detyrën dhe me fondet publike nëpërmjet tenderëve dhe forma të tjera, shpërdorimi i funksionit nga nëpunësit e administratës publike dhe private, vjedhja e përvetësimi i realizuar me shpërdorim të pozitës, falsifikimi i dokumenteve, krijimi i privilegjeve të padrejta etj.

Konventa cilëson si shkelje penale pengimin e drejtësisë në lidhje me kryerjen e shkeljeve të sipërcituara dhe parashikon masa parandaluese në sektorin publik dhe atë privat, për të cilat shtetet palë detyrohen të bashkëpunojnë në këtë drejtim lidhur me mbledhjen e provave për t'u përdorur në ndjekjen penale, gjurmimin, sekuestrumin dhe konfiskimin e pasurive të vëna me korrupsion, deri në ekstradimin e autorëve. Ekstradimi si formë e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit është sanksionuar në nenin 44 të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit. Në paragrafin 1 të nenin 44 të Konventës përcaktohet se *“ekstradimi zbatohet edhe për veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë kur personi që përbën subjektin e kërkesës, për ekstradim është i pranishëm në territorin e shtetit palë pritës, me kusht që vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi është e dënueshme sipas ligjit të brendshëm si të shtetit palë kërkues, ashtu edhe të shtetit palë pritës”*. Kjo Konventë është ndër të vetmet dhe më të rëndësishmet, që lejojnë ekstradimin për veprën penale të korrupsionit edhe nëse kjo vepër nuk konsiderohet si vepër penale në shtetin

⁷⁴Kjo Konventë e cilëson korrupsionin si vepër penale.

⁷⁵Kjo Konventë parashikon dëmshpërblimin e viktimave të korrupsionit.

⁷⁶Konventa e OKB-së Kundër Korrupsionit, synon të nxisë dhe forcojë masat e luftës kundër korrupsionit në sektorin publik dhe privat, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (hyri në fuqi në vitin 2005).

⁷⁷Shih nenin 1 të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit.

kërkues.⁷⁸ Ashtu si Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar edhe Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit lejon ekstradimin edhe për vepra penale të cilat “Nëse kërkesa për ekstradim përfshin disa vepra penale të veçanta, të paktën një prej të cilave është e ekstradueshme sipas këtij neni dhe disa prej të cilave nuk janë të ekstradueshme për shkak të periudhës së burgimit, por kanë të bëjnë me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë, shteti palë pritës mund të zbatojë këtë nen edhe në lidhje me këto vepra penale”.⁷⁹ Nëse shteti kërkues dhe shteti i kërkuar nuk kanë marrëveshje ekstradimi midis tyre atëherë ata mund të përdorin këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me çdo vepër penale për të cilën zbatohet neni 44.

Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit i jep të drejtën e refuzimit të kërkesës së ekstradimit shtetit të kërkuar nëse ai ka arsye të forta për të besuar se personi do të jetë subjekt dënimi për shkak të seksit, racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike ose bindjeve politike të personit ose kur përmbushja e kësaj kërkesë do të shkaktonte dëme në gjendjen e personit për ndonjë nga këto arsye.⁸⁰ Konventa detyron shtetet që ti garantojë të drejtat dhe liritë themelore individit në shtetin kërkues.

3.2. Institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunimi i ndërsjellë juridik ndërkombëtar.

Organizata e parë policore ndërkombëtare më e madhe,⁸¹ që mundeson dhe lehtëson bashkëpunimin policor ndërkombëtar është INTERPOL. Institucioni i INTERPOL-it u krijua në vitin 1923⁸² dhe është organizata e parë policore ndërkombëtare që lehtëson bashkëpunimin policor ndërkombëtar, ndihmon dhe asiston të gjithë autoritetet dhe shërbimet, misioni i të

⁷⁸Shih: Nenin 44 paragrafi 2 të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit ku thuhet se: “Pa cenuar dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, një shtet palë, nëse ligji i tij e lejon, mund të lejojë ekstradimin e një personi për një nga veprat penale të mbuluara nga kjo Konventë që nuk janë të dëmshme sipas ligjit të vet të brendshëm.”

⁷⁹Shih: Nenin 44 paragrafi 3 të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit.

⁸⁰Shih: Nenin 44 paragrafi 15 të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit.

⁸¹Kushtetuta e INTERPOL-it, 3 qershor 1956. Botim shqip, anglisht dhe frëngjisht.

⁸²Shih: Dr. Hasan Shkëmbi, “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Evropian”, Shtëpia Botuese “GEER”, Tiranë, 2006, fq. 206. Elezi, M., *Bashkëpunimi policor*, Teme Doktorature on line, Tirane, 2015 aksesuar me 15.01.2016.

cilave është parandalimi dhe lufta kundër krimit ndërkombëtar.⁸³ Kjo organizatë nuk merr veprime të karakterit politik apo ushtarak sepse qëllimi i saj është promovimi i asistencës ndërmjet të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kornizës ligjore së Deklaratës Universale të së Drejtave të Njeriut dhe krijimi i institucioneve që kontribuojnë në parandalimin e kriminalitetit.⁸⁴

INTERPOL-i e realizon punën nëpërmjet kanaleve të cilët janë *alerte* ndërkombëtare që bëjnë të mundur shkëmbim të rëndësishëm informacioni kriminal në gjithë vendet anëtare. Kartelat përmbajnë informacion të detajuar mbi identitetin e personit që është objekt i saj, mundësisht foto, gjurmë gishtash, profil AND, etj, si dhe një përmbledhje të shkurtër faktesh, informacion mbi dispozitat ligjore dhe mbi vendndodhjen e personit. Kështu *Karteli i Kuq* përmban informacione personat në fjalë janë të kërkuar nga juridiksione kombëtare dhe kartelat e kërkuara janë të bazuara në një urdhër arresti ose vendim gjykate. Roli i INTERPOL-it është të ndihmojë policitë kombëtare në identifikimin dhe lokalizimin e këtyre personave me qëllim arrestimin dhe ekstradimin e tyre. INTERPOL-i është i njohur si kanal zyrtar për të transmetuar kërkesë për arrestim paraprak, bazuar në disa marrëveshje bilaterale ose multilaterale, si p.sh: Konventa Evropiane mbi Ekstradimin. Ai zë një vend unik në arenën ndërkombëtare të agjensive të zbatimit të ligjit, falë rrjetit të tij të gjerë. Sistemi i tij i veçantë I-24/7 dhe i sigurt i komunikimit, databas-et e tij globale, mbështetja operacionale dhe ndihma në krijimin e kapaciteteve, siguron vendet anëtare me përfitime të mëdha operacionale që ndihmojnë agjensitë e zbatimit të ligjit të bëjnë botën më të sigurtë.

⁸³Sekretariati kryesor i organizatës është i vendosur në Lion, Francë. Staf i tij përbëhet nga 540 zyrtarë prej 80 shteteve të ndryshme.

⁸⁴Republika e Shqipërisë u pranua si anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - INTERPOL, më 4 nëntor 1991, në Sesionin e 60-të të Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it, që u mbajt në Punta del Este të Uruguajit, miratuar me ligjin Nr.8427 date 14.12.1998, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - INTERPOL”. Fletore Zyrtare nr.30 date 23.12.1998, fq. 1157.

3.2.1. Roli dhe struktura e Interpol-it

Përgjithësisht, Interpol-i njihet si organizatë, që është e përfshirë më shumë në çështje të luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar, trafikimit ndërkombëtar të drogës, kundër tregtisë ndërkombëtare të paligjshme të armëve, kundër praktikave ndërkombëtare të mashtrimeve financiare, në ndjekjen e të arratisurve anekënd globit etj.⁸⁵ Por, bazuar në nenin 2 të Kushtetutës së kësaj organizate, e cila ka hyrë në fuqi më 13 qershor 1956, qëllimet kryesore të saj janë: “të sigurojë dhe të nxisë ndihmën e ndërsjellë të mundshme mes të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kufijve të ligjeve ekzistuese në vende të ndryshme dhe në frymën e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut", si dhe të krijojë dhe të zhvillojë të gjitha institucionet e mundshme për të kontribuar në mënyrë efektive në parandalimin dhe goditjen e krimeve të parashikuara me ligje të zakonshme (Kushtetuta e Interpol-it, 1956: neni 2).

Në aktivitetet kundër kriminalitetit të organizuar ndërkombëtar Interpoli luan një rol të rëndësishëm duke realizuar katër funksione kryesore: shërbimin e komunikimit të policisë globale, të dhënat operative të shërbimeve dhe bazat e të dhënave për policinë, mbështetjen e shërbimeve të policisë operative, si dhe trajnimin dhe zhvillimin e shërbimeve të policisë.⁸⁶ Në rastet e dështimit të sistemeve nacionale të shteteve policisë ju duhen tri elemente themelore për të bllokuar kriminelët: informata, dëshmi dhe për të identifikuar kriminelët.⁸⁷

Baza e të dhënave e Interpol-it është e zhvilluar në pesë drejtime: të dhënat nominale, vjedhja e dokumenteve të udhëtimit, vjedhja e veturave, DNA, dhe gjurmët e gishtërinjve (Committee of Ministers of the Council of Evrope, 2007). Kjo bazë të dhënash përmban informata për rreth 170.000 kriminelë dhe për afro 38.000 persona të kërkuar (Committee of Ministers of the Council of Evrope, 2007). Pra, ajo është një burim mjaft i dobishëm për zhvillimin me sukses

⁸⁵ Shih: Fooner, vep e cit.fq. 7.

⁸⁶ Shih: Eterno & Das, 2010, fq.229.

⁸⁷ Shih: Durmaz, 2005, fq. 2.

të luftës kundër kriminalitetit nga shtete të ndryshme dhe nga organizatat policore. Në vitin 2003, Interpol-i filloi punën me bazën e internetit të sigurisë së lartë në infrastrukturën e vet të komunikimit, të njohur si I-24/7. Atë vit, për herë të parë, numuri i të dhënave arriti në më shumë se 3 milionë. Ky sistem mundëson bashkëpunim të shpejtë dhe efikas në luftimin e të gjitha formave të krimit të rëndë ndërkombëtar.

Përmes këtij sistemi lidhen me njëri-tjetrin: Sekretariati i Përgjithshëm, Zyrat Qendrore Kombëtare dhe oficerët e policisë të vendeve anëtare, të cilët mund të dërgojnë dhe të marrin me shpejtësi informacione policore, përfshirë imazhe, në të gjithë botën, në kohë reale, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë⁸⁸. I-24/7 u mundëson përdoruesve të autorizuar të ndajnë informata të ndjeshme dhe urgjente të policisë me homologët e tyre nëpër botë. Ai është rrjeti që mundëson hetuesit për të hyrë në bazën e të dhënave kriminale të Interpolit. Në vitet e fundit, Interpol-i ka përshtatur mundësitë për të kontribuar në ngjarje të rëndësishme botërore⁸⁹. Pas sulmeve të 11 Shtatorit, ai themeloi një komandë qendrore, që është operacionale dhe krijoi bazën e të dhënave, e para në botë, për persona të lidhur me veprimtari terroriste (Dosen *at al.* 2013: 427). Roli i Interpol-it përmendet në shumë instrumente, respektivisht, rekomandime të Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (Committee of Ministers of the Council of Evrope, 2007).

Kjo organizatë ka një anëtarësi prej 190 vendesh dhe një buxhet prej afro 60 milionë eurosh prej kontributeve vjetore. Sekretariati i Përgjithshëm i Interpol-it, aktualisht, ka një staf prej 673 vetash që përfaqësojnë 93 vende anëtare. *Struktura organizative* e Interpol-it është e rregulluar me kushtetutën e saj. Në të janë të përcaktuara këto organe të Interpol-it: Asambleja e Përgjithshme, Komiteti Ekzekutiv, Sekretariati i Përgjithshëm, Zyrat Kombëtare Qendrore, Këshilltarët, Komisioni për Kontrollimin e Dosjeve (Kushtetuta e Interpol-it, 1956: neni 5).

⁸⁸ Shih H. Abadinsky, 2010, fq. 398.

⁸⁹ <http://www.interpol.int/INTERPOL-expertise/Data-exchange/I-24-7>.

Asambleja e përgjithshme është autoriteti suprem i organizatës, ajo përbëhet nga delegatët, të cilët emërohen nga anëtarët e organizatës (Kushtetuta e Interpolit, Neni 6). Çdo anëtar mund të përfaqësohet nga një ose disa delegatë, megjithatë, për secilin vend do të ketë vetëm një kryetar delegacioni, i emëruar nga autoriteti qeveritar kompetent i atij vendi. Kushtetuta, nenin 8 përcakton edhe funksionet e asamblesë së përgjithshme. Kjo mbledhet në sesion të zakonshëm çdo vit. Në seancë të jashtëzakonshme mund të mbledhet me kërkesë të Komitetit Ekzekutiv ose të shumicës së anëtarëve (Kushtetuta e Interpolit, 1956: Neni 10). Vetëm një delegat nga secili vend ka të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë, përveç rasteve kur kërkohet shumica prej dy të tretave me Kushtetutë (Kushtetuta e Interpolit, 1956: Neni 13 dhe 14). *Komiteti Ekzekutiv* - përbëhet nga presidenti i Organizatës, tre nënkryetarët dhe nëntë delegatë. Të gjithë këta anëtarë janë nga vende të ndryshme, në mënyrë që të ketë një përfaqësim më të mirë gjeografik. Presidenti dhe nënkryetarët i zgjedh Asambleja e përgjithshme në mesin e delegatëve, presidenti zgjidhet me dy të tretat e votave, ndërsa pas votimit të dytë mjafton shumica e thjeshtë, dhe është rregull që presidenti dhe nënkryetarët të jenë nga kontinente të ndryshme.

Presidenti zgjidhet me mandat katërvjeçar, ndërsa nënkryetarët me mandat trevjeçar, asnjëri prej tyre nuk kanë të drejtë rizgjedhjeje, si dhe nuk kanë të drejtë të zgjidhen si delegatë në Komitetin Ekzekutiv (Kushtetuta e Interpol-it, 1956:neni 17). Detyrat e Komitetit Ekzekutiv i përcakton qartë Kushtetuta e Interpol-it, në nenin 22.

Sekretariati i Përgjithshëm - përbëhet nga departamentet e përhershme të Organizatës Ai vendos në zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Ekzekutiv; shërben si një qendër ndërkombëtare në luftën kundër krimit të zakonshëm dhe si qendër teknike dhe e informacionit; siguron administrimin efikas të organizatës etj.

Sekretari i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e personave kompetentë në çështjet policore dhe propozohet nga Komiteti Ekzekutiv dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej pesë vjetësh, por edhe mund të rrimërohet për periudha të tjera.

Zyrat Qendrore Kombëtare u krijuan për të siguruar një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe aktiv të anëtarëve të saj. Organizata e Interpol-it ka paraparë që secili vend të emërojë një trupë, e cila të shërbejë si Zyrë Qendrore Kombëtare, për të siguruar ndërlidhje me departamentet e ndryshme të vendit, me Zyrat e vendeve të tjera, si dhe me Sekretariatën e përgjithshëm të organizatës. *Këshilltarët* janë funksionarë policorë me të cilët Organizata mund të konsultohet për çështjet shkencore. Roli i tyre është thjesht këshillues. Ata emërohen për tre vjet, nga Komiteti Ekzekutiv. Emërimi i tyre bëhet zyrtar vetëm pas njoftimit nga Asambleja e Përgjithshme. Ata zgjidhen ndër personat që kanë një reputacion të gjerë botëror në disa fusha me interes për Organizatën

Komisioni për Kontrollin e Dosjeve është një organ i pavarur, i cili siguron që përpunimi i të dhënave personale nga organizata të jetë në pajtim me rregulloret e saj. Ky Komision i paraqet organizatës mendime lidhur me ndonjë projekt apo operacion, vendos rregulla ose çështje të tjera që përfshijnë përpunimin e të dhënave personale. (Kushtetuta e Interpolit, 1956). Në vitet e fundit, Interpol-i ka përshtatur mundësit për të kontribuar në ngjarje të rëndësishme botërore. Pas sulmeve të 11 shtatorit, Interpol ka themeluar një komandë qendrore që do të jetë operacionale gjatë tërë kohës, kjo u pasuaedhe me krijimin e bazës së të dhënave, e para në botë, për persona lidhur me veprimtari terroriste, si dhe një bazë të të dhënave lidhur me dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit. Interpol-i gjithashtu ka bazën e të dhënave të shenjave të gishtërinjve, si dhe një bazë të dhënash të ADN-së⁹⁰.

⁹⁰ Shih Dosen *at al.* 2013 fq.427.

3.2.2. Interpol-i dhe çështjet ligjore

Interpol-i funksion primar ka bashkëpunimin ndërkombëtar ndaj luftimit të kriminalitetit. Me aktet juridike që rregullojnë funksionimin e tij, qëllimet e Interpol-it janë:

a) Garantimi dhe zgjerimi i ndihmës reciproke midis të gjithave shërbimeve policore në bazë të dispozitave ligjore të shteteve të ndryshme dhe në frymën e Deklaratës Universale mbi të drejtat e njeriut.

b) Themelimi dhe zhvillimi i institucioneve që mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në parandalimin dhe ndëshkimin e autorëve të veprave penale të përgjithshme.

Por, siç e kemi thënë edhe më sipër, aktiviteti i tij në ndjekjen penale dhe në ruajtjen e sigurisë publike është i kufizuar funksionalisht: Si një trupë kordinuese, që nuk ka hetuesit apo agjentët e vet të zbatimit të ligjit, Interpol-i nuk ka kompetenca për të kryer hetime vetë apo të ndërhyjë me operacione më vete. Këto janë detyra që u takojnë autoriteteve të policive kombëtare, të cilat mund të përdorin Organizatën si një platformë për bashkëpunimin ndërkombëtar⁹¹. Kjo, sepse ndërhyrja e një policie të një shteti në shtetin tjetër nënkupton shkelje të sovranitetit shtetëror, gjë për të cilën shtetet janë të ndjeshme. Kompetencat e shtetit për këto veprime nuk transferohen as tek Interpol-i, as te shtetet anëtare që veprojnë në kuadër të bashkëpunimit nëpërmjet Interpol-it. Kështu, nga perspektiva e ligjeve kombëtare, masat administrative për çështje të tilla, si ekstradimi, përcaktimi i identitetit dhe masa të tjera standarde të policisë në parandalimin ose ndjekjen e krimit mbeten përgjegjësi e vetë shteteve. Kompetenca kombëtare ruhet edhe kur bëhet fjalë për të dhënat e arkivave dhe për qasjen në to.

Për të ruajtur neutralitetin, Interpol-it, sipas kushtetutës së tij, nuk i lejohet të ndërmarrë asnjë ndërhyrje apo aktivitet të natyrës politike, ushtarake, fetare apo lidhur me racën e njerëzve. Prandaj kompetencat e Interpol-it përqendrohen tek administrimi i informacionit, i të dhënave,

⁹¹ Shih me për më shumë Haubold, Vol. 09 No.11, fq. 1720.

dhe tek këmbimi i tyre. Për këtë Interpol-i ofron kanalet e ndryshme dhe mënyrat e shkëmbimit të informacionit në kuadrin e procedurave dhe standardeve të veta⁹².

Kjo veprimtari fokusohet në informacionet që lidhen me çështjet e sigurisë publike, dhe me të gjitha format krimine të organizuar dhe të terrorizmit, si dhe me krimet kundër njerëzimit, me krimet e luftës etj.

Siç shihet, roli i Interpol-it në luftimin e kriminalitetit është i shumanshëm: ai është një pikë reference për çështje ndërkombëtare, është një rrjet i komunikimit të gjithanshëm mes shteteve, burim për informata kriminale dhe inteligjente, një shërbim ndërlidhës dhe një medium i vendosjes së politikave të bashkëpunimit ndërkombëtar policor. Aktivitetet e veta Interpol-i i realizon në shumë fusha dhe në forma të ndryshme. Edhe mënyrat e komunikimit të tij janë të shumta, ndër to edhe ajo përmes lidhjeve të internetit dhe nëpërmjet zyrave që ai ka në shtetet anëtare të tij.

Në kuadrin e bashkëpunimit midis policive të shteteve për zhvillimin e hetimeve për zbulimin e autorëve të veprave penale, si edhe të viktimave dhe të dëshmitarëve të veprave, gjithnjë mbi baza juridike të miratuara, Sekretariati i Përgjithshëm u shpërndan rregullisht fletarreste speciale byrove nacionale, si fletarrestin e “**KUQ**” për personat që kërkohen për t’u privuar nga liria dhe për t’u ekstraduar.

Fletarresti “**GRI**”, kërkon që shteti marrës “të ofrojë informacione për *modus operandin*, për procedurën, objektet, pajisjet apo për vendet e fshehta të përdorura nga kriminelët dhe të përcaktojë vendbanimin dhe adresën”.

Në funksion të zbulimit të shpejtë të veprave penale dhe të autorëve të tyre Interpol-i bashkëpunon edhe për identifikimin e personave dhe të kufomave. Për konstatimin e identitetit të kufomës përgatitet dhe shpërndahet buletini i posaçëm me ngjyrë të “**ZEZË**”, me fotografi,

⁹² Shih Bogdandy, vep e cituar, fq.249.

me gjurmë të gishtërinjve ose çështje të tjera, me ndihmën e të cilave mund të konstatohet identiteti i personit.

Ndërsa për personat që kanë kryer vepra penale të rënda në territorin e disa shteteve, Interpol-i, nëpërmjet Sekretariatit të përgjithshëm, shpërndan kartonin e “**JESHIL**”, duke i paralajmëruar dhe duke u kërkuar që t’i përcjellin aktivitetet dhe sjelljet e kriminelëve seriozë. Sistemi i komunikimit të Interpolit lidhë Sekretariatit e Përgjithshëm, Zyrat Qendrore Kombëtare, dhe oficerë të policisë në vendet anëtare në mënyrë që ata të mund të dërgojnë dhe të marrin informacion të policisë, duke përfshirë imazhe, në të gjithë botën, për një siguri, bazë kohore reale, 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

Pas sulmeve të 11 Shtatorit, Interpol-i forcoi edhe më shumë bashkëpunimin më të madh policor ndërkombëtar me FBI-në, si edhe me agjencitë e tjera, si: DEA, CIA, NSA etj. si dhe duke filluar një bashkëpunim policor me FBI-në, si edhe me agjencitë e tjera, si: DEA, CIA, NSA etj. si dhe duke filluar një bashkëpunim policor me të gjitha shtetet aleate në mënyre bilaterale edhe përmes Interpolit⁹³

Disa javë pas sulmeve terroriste në SHBA, nga 24-28 shtator 2001, Asambleja e Përgjithshme e Interpol-it mbajti takimin e tij të 70-të në Budapest, Hungari, ku përveçme FBI-në, si edhe me agjencitë e tjera, si: DEA, CIA, NSA etj. si dhe duke filluar një bashkëpunim policor me të gjitha shtetet aleate në mënyre bilaterale edhe përmes Interpolit

Disa javë pas sulmeve terroriste në SHBA, nga 24-28 shtator 2001, Asambleja e Përgjithshme e Interpol-it mbajti takimin e tij të 70-të në Budapest, Hungari, ku përveçmiratimit të Rezolutës që dënonte sulmet vrastare, u vendos që për të luftuar terrorizmin dhe krimin e organizuar në mënyrë më efektive t’i jepet prioritet më i lartë lëshimit të ashtuquajturave *njoftime të KUQE (urdhërarrestet ndërkombëtare të Interpol-it për të kërkuar arrestimin dhe ekstradimin)* për terroristët që kërkohen lidhur me sulmet.

⁹³ Shih Latifi & Beka, vep e cit. 246.

Ndërsa, në tetor 2001, Interpol mbajti Simpoziumin e tij të 16-të për Terrorizmin, në të cilën 110 ekspertë nga 51 vende diskutuan iniciativa të reja afatgjata anti-terroriste, si mundësinë e ngritjes së një baze të dhënash të veçantë të aviacionit, financimin e terrorizmit dhe zgjerimin e masave kundër pastrimit të parave. Baza e të dhënave e Interpolit është zhvilluar në pesë drejtime: të dhënat nominale, vjedhja e dokumenteve të udhëtimit, vjedhja e veturave, DNA, dhe gjurmët e gishtërinjve (Committee of Ministers of the Council of Europe, 2007: 23).

3.2.2. Funkzioni i Zyrës Qëndrore Kombëtare Interpol-Tirana.

Në Shqipëri funksionon një Zyrë Kombëtare për komunikimin me EVROPOL-in,⁹⁴ e cila shkëmben informacion të klasifikuar nëpërmjet kanalit të sigurtë SIENA⁹⁵. Baza ligjore e veprimtarisë së Zyrës Kombëtare EVROPOL janë: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, ligji nr. 9699, datë 26.03.2007, “Për ratifikimin e Marrëveshjes Strategjike të bashkëpunimit mes Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Policor Evropian -EVROPOL” etj.

Qendra Kombëtare Interpol – Tiranë është institucioni i cili merret me ndjekjen e procedurale lidhur me kërkimet dhe ekstradimet, në Shqipëri⁹⁶. Interpol-Tirana e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me aktin themeltar të tij Kushtetutën e Interpolit, Kushtetutën e Shqipërisë, ligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale

⁹⁴ZKE - Zyra Kombëtare EVROPOL në Shqipëri, strukturë në Drejtorinë e Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë. Ngritur me Urdhër të ministrit të Brendshëm në dhjetor 2010. Canaj, E., Levizja e lire e personave ne Bashkimin Evropian, Tirane, 2014.

⁹⁵EVROPOL REVIEW: General Report on Evropol Activities, Hague 2012, p.7. ISSN 1681-1550.

⁹⁶ZQK, është një strukturë e posaçme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përgjegjëse për lidhjet me strukturat qendrore të Interpolit, si dhe me Zyrat Qendrore Kombëtare homologe. Ajo zbaton standardet e shërbimit të një Zyre Qendrore Kombëtare Miratuar nga Konferenca e 33-të Rajonale Evropiane e Interpolit, në Kiev, më 12-14 maj 2004.

- INTERPOL”⁹⁷, legjislacionin kombëtar penal⁹⁸ dhe procedural penal⁹⁹, ligjin “Për Policinë e Shtetit”¹⁰⁰, si dhe çdo marrëveshje ndërkombëtare¹⁰¹ ku Republika e Shqipërisë është palë. Në Republikën e Shqipërisë ekstradimi¹⁰² lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor.¹⁰³ ZQK Interpol Tirana pasi merr njoftimin për arrestimin provizor me qëllim ekstradimi, bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme për dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm në rrugë diplomatike, brenda afatit kohor 40 ditor¹⁰⁴ të parashikuar në Konventë¹⁰⁵ ose marrëveshjet dypalëshe.

Gjatë procedurave për ekstradimin e personave të kërkuar, ka vonesa lidhur me shkëmbimin e dokumentacionit përkatës, ndërmjet ministrive të vendeve homologe. Disa vende si Australia, Anglia e Holanda janë tepër strikt në lidhje me afatin kohor të mbërritjes së dokumentacionit, madje kërkojnë tepër detaje lidhur me identifikimin, ngjarjen, provat e mbledhura, etj. Gjithashtu, lidhur me personat shqiptar të arrestuar jashtë vendit, nga autoritet policore vendase ka vonesa të tejskajshme në dërgimin e dokumentacionit për identifikimin e plotë të personit, jashtë afatit ligjor që është brenda dyzetë ditësh. Ndodh që personi që ekstradohet nuk disponon asnjë dokument identifikimi të vlefshëm, për lëvizjen nga njëri shtet në tjetrin. Ky problem vështirësohet më shumë gjatë kalimit tranzit nëpër aeroporte.¹⁰⁶ Për më

⁹⁷Ligji nr. 8427, datë 14.12.1998 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në INTERPOL”.

⁹⁸Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, ndryshuar me Ligjin nr. 9188, datë 12.02.2004.

⁹⁹Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar.

¹⁰⁰Ligji nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”.

¹⁰¹Miratuar me ligjin nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.

¹⁰²Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 488, viti 2004.. Ekstradimi nuk është gjë tjetër, veçse një proces, nëpërmjet të cilit një shtet, pra, shteti të cilit i kërkohet, i dorëzon një person të gjendur në territorin e tij një shteti tjetër, ose shtetit kërkues, ku ai kërkohet për t’u hetuar apo gjykuar për një krim të cilin ka të ngjarë ta ketë kryer, ose për të kryer masën e dënimit penal të shpallur ndaj tij, nëse ai është shpallur fajtor

¹⁰³Kushtetua e Shqipërisë, neni 39, pika 2, faqe 7.

¹⁰⁴Neni 27, i Ligjit nr. 8778, datë 26.01.2011 “Për ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin”, i azhurnuar me Ligjin nr. 9369, datë 14.04.2005.

¹⁰⁵Neni 16, pika 3, e Konventës Evropiane për Ekstradim.

¹⁰⁶Ky fakt u prezantua nga intervistimi i EP specialist në ZQK Interpol -Tirana.

tepër, hasen vështirësi për ekstradimin e personit të dënuar në mungesë, kryesisht të arrestuar për t'u ekstraduar nga Britania e Madhe, për faktin se nevojitet garancia, që pas kryerjes së ekstradimit personi do të rigjykohet. Këtë fakt e justifikojnë me parimin e shkeljes të së drejtave të njeriut. Kështu që, autoritet policore që kryejnë transferimin e personit, nuk kanë tagër ligjor për të dhënë një garanci të tillë.¹⁰⁷

3.2.2. Organizata e Inteligjencës Evropiane - EVROPOL

Pas kanalit të INTERPOL-it, bashkëpunimi ndërkombëtar policor ndërmjet agjensive të zbatimit të ligjit në Evropë organizohet në nivele të ndryshme; në nivelin e Evropës së Bashkuar (EVROPOL, Schengen, etj), dhe në nivelin bilateral ose rajonal SEPCA¹⁰⁸, Task-Forcë e detit Baltik dhe SECI¹⁰⁹ (Iniciativa e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore). Në përgjithësi, 50 vendet anëtare të INTERPOL-it për rajonin e Evropës përdorin më shumë se një kanal për bashkëpunimin ndërkombëtar policor.

Në veçanti, Bashkimi Evropian ka ndërtuar një arkitekturë të rëndësishme sigurie me pesë agjensi (EVROPOL, EUROJUST, FRONTEX, OLAF, CEPOL). Këto agjensi janë të koordinuara në komitete të përcaktuara në nivel qendror, siç është COSI¹¹⁰ dhe mbështeten nga ana politike nga JHA¹¹¹. Programi i Stokholmit, i cili përcakton politikën e Bashkimit Evropian, JHA për 2010-2014, konsideron INTERPOL-in si një partner të rëndësishëm veçanërisht kur bëhet fjalë për dimensionin e jashtëm të politikës së JHA, por gjithashtu kur bashkëpunimi ndërkombëtar policor global është në rrezik.

¹⁰⁷Intervistë me oficerin ndërlidhës të Ministrisë së Brendshme R.B, i atashuar në Mbretërinë e Bashkuar.

¹⁰⁸SEPCA - Shoqata e Krerëve të Policisë për Evropën Juglindore

¹⁰⁹SECI - Iniciativa e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore

¹¹⁰COSI - Komiteti mbi Sigurinë e Brendshme

¹¹¹JHA - Çështjet e Brendshme dhe të Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Lidhur me kete argument per me shume shih Canaj, E., *Levizja e lire e personave ne Bashkimin Evropian*, Tirane, 2014. Canaj E., Bana S., *E drejta e Bashkimit Evropian*, Onufri, 2014.

Themelimi i Evropol-it. Evropol është një organizatë mjaft e re. Ideja e krijimit të një agjencie të specializuar të Inteligjencës Evropiane për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar policor u hodh në fillim të viteve nëntëdhjetë dhe, në vitin 1992, në Traktatin e Mاستrihtit për Unionin Evropian, u miratua themelimi i Evropol-it. Zyra Qendrore, Drejtoria e Evropol-it ndodhet në Hagë, të Holandës. Themelimi i Evropolit është miratuar në traktatin e Mاستrihtit për Unionin Evropian më 1992. Fillimisht e përfshirë vetëm në luftën kundër drogës, organizata ka zhvilluar detyrat e saj dhe tani merret me krimet, tema bazike e të cilave është paraparë në konventën e Evropolit, e cila ka hyrë në fuqi më 1998¹¹²

Në zhvillimin e Evropol-it mund të identifikohen tri faza. Faza e parë, përfshin periudhën nga viti 1999 deri në vitin 2006. Në këtë kohë, kjo organizatë që e përfshirë vetëm në luftën kundër drogës dhe bashkëpunimi i policive ende dominohej kryesisht nga marrja e vendimeve ndërqeveritare. Për këtë arsye dhe, për shkak të origjinës ndërqeveritare të strukturave të bashkëpunimit të policisë që i paraprinë Evropol-it, roli i Parlamentit Evropian në mbikëqyrjen e tij ishte i kufizuar. Në një fazë të dytë, nga viti 2006 deri në vitin 2009, korniza ligjore e Evropol-it u ndryshua krejtësisht dhe një vendim i Këshillit të Evropës, i 6 prillit 2009, e transformoi Evropol-in, nga 1 janari 2010, në një agjenci të BE-së, që financohet nga buxheti i Komunitetit Evropian dhe jo nga kontributet e shteteve anëtare, siç e përcaktonte Konventa e Evropol-it.

Faza e tretë është në vazhdim e sipër. Në këtë fazë do të përcaktohet e ardhmja e Evropol-it Tani, një rregullore e re ka zëvendësuar Vendimin e Këshillit, me qëllim zbatimin e dispozitave të reja të Traktatit të Lisbonës, sidomos, duke iu referuar pjesëmarrjes së parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit Evropian në monitorimin politik të agjencisë. Zyra Evropiane e Policisë (Evropol) është një organizatë policore ndërkombëtare, e cila u formua për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit në BE, 1993 dhe me fillimin e

¹¹² Shih ne lidhje me kete argument, Madsen, veper e cituar 98-99.

operacioneve të njësisë së drogave të Evropolit në vitin 1994 në mënyrë që të parandalohet dhe të luftohet kriminaliteti i rëndë ndërkombëtar. I përshtatur brenda kontekstit të Traktatit të Bashkimit Evropian, mandati i Evropol-it përfshin luftimin e të gjitha formave të rënda të krimit ndërkombëtar, duke përfshirë edhe terrorizmin ndërkombëtar¹¹³ Evropol nuk u krijua për t'u marrë me vepra lokale apo të vogla, por për të dhënë një dimension evropian për hetimin e krimit¹¹⁴

Ndërsa organizatat e tjera ndërkombëtare policore janë formuar jashtë kontekstit të ndonjë organi politik ndërkombëtar, mandati i Evropol-it ka një specifikë, ai është përcaktuar në mënyrë të qartë nga BE-ja dhe operacionet e saj mbikëqyren nga organet rregullatore të BE-së. Megjithatë, pavarësisht nga fakti se Evropol-i është themeluar brenda strukturave politike dhe ligjore të BE-së, është argumentuar dhe provuar se organizata ka tipare të rëndësishme të ekspertizës profesionale, të ngjashme me ato që i karakterizojnë organizatat e tjera ndërkombëtare policore

Objektivat e Evropol-it janë që të përmirësojë efektivitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve policore të vendeve anëtare të BE-së. Në përputhje me to, edhe mandati i tij është zgjeruar dhe tani Evropol-i merret me një gamë të gjerë të luftimit të formave të ndryshme të kriminalitetit. Numuri i nismave për bashkëpunim policor dhe gjyqësor në Bashkimin Evropian, për çështjet kriminale, është mbresëlënëse. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (1999) ky set politikash u ristrukturua nën termin “Zona e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë” Kontributi i Evropolit jepet në dy forma të veçanta bashkëpunimi: Aktivitetet e ekipeve hetimore të përbashkëta dhe pjesëmarrja e tij në këto aktivitete. Megjithatë, korniza ligjore e Evropol-it është subjekt i një debati të vazhdueshëm, lidhur me format e ndryshme në të cilat do të mund të vendosen dispozitat e Traktatit të Lisbonës.

¹¹³ Deflem, 2006: 336.

¹¹⁴ Shih Cools, *at al*, 2010fq. 63.

Struktura Organizative e Evropol-it

Evropol-i, si organizatë për bashkëpunim policor në kontinentin e Evropës ka katër seksione: 1) seksionin për analiza, 2) seksionin e oficerëve ndërlidhës, 3) seksionin për informata, 4) seksionin e administratës. Ajo ka si organe drejtuese: Bordin drejtues, Drejtorin, Kontrolluesin Financiar dhe Komitetin Financiar, të përcaktuara me Konventën e Evropol-it).

Bordi drejtues. Sipas nenit 28 të Konventës së Evropol-it, merr pjesë në zgjerimin e objektivit të Evropol-it, përcakton të drejtat dhe obligimet e oficerëve ndërlidhës, vendos për numrin e oficerëve të kontaktit që shtetet anëtare mund të dërgojnë në Evropol, merr pjesë në miratimin e rregullave mbi marrëdhëniet e Evropol-it me shtetet e treta dhe trupave të tretë brenda kuptimit të nenit 10 (4). Veprimtaria e tij shtrihet, gjithashtu, në pjesëmarrjen në emërimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe të zëvendës drejtorëve, në mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave të Drejtorit/së, në miratimin e rregulloreve të stafit, në përgatitjen e marrëveshjeve mbi besueshmërinë dhe në miratimin e dispozitave për mbrojtjen e fshehtësisë.

Neni 28 i Konventës së Evropol-it përcakton shprehimisht se Bordi Drejtues përbëhet nga një përfaqësues të secilit vend anëtar. Çdo anëtar i Bordit ka një votë (Konventa e Evropolit, 1956: Neni 28 paragrafi 2).

Drejtori. Emërohet për një periudhë katërvjeçare nga Këshilli i Evropës, në pajtim me procedurën e përcaktuar në Titullin VI të TBE, Ai ndihmohet nga disa zëvendës drejtorë. Drejtori është përgjegjës për kryerjen e detyrave të caktuara për Evropol-in; për administrimin e përditshëm; menaxhimin e personelit; përgatitjen dhe zbatimin e vendimeve të Bordit drejtues; përgatitjen e projektbuxhetit, të projektplanit të themelimit dhe të projektplanit të financimit pesëvjeçar dhe për zbatimin e buxhetit të Evropol-it. Drejtori dhe zëvendës drejtorët mund të shkarkohen me vendim të Këshillit të Evropës (Neni 29 i Konventës së Evropolit).

Stafi. Drejtori, zëvendës drejtorët dhe nëpunësit e Evropol-it udhëhiqen në veprimet e tyre nga objektivat dhe detyrat e Evropol-it dhe nuk marrin ose nuk kërkojnë urdhra nga asnjë qeveri, autoritet, organizatë ose person jashtë Evropol-it, përveç kur parashikohet ndryshe në Konventë, dhe pa paragjykim të Titullit VI të TBE-së.

3.3. Mbi integrimin e të drejtës ndërkombëtare në legjislacionin kombëtar.

E drejta ndërkombëtare ka evoluar në mënyrë graduale në varësi të zhvillimeve sociale politike dhe ekonomike. Nëse deri përpara luftës së dytë botërore ajo ishte thjesht një e drejtë që rregullonte marrëdhëniet midis shteteve në fusha të ndryshme, pas luftës së dytë botërore del në pah edhe individi si subjekt i saj. Për këtë arsye mund të themi që në gjysmën e dytë të shekullit XX, legjislacionet e disa vendeve pësuan transformime të ndryshme duke e ngritur atë në lartësinë e merituar.¹¹⁵

Shumë kushtetuta të shteteve të ndryshme e parashikojnë epërsinë e të drejtës ndërkombëtare në krahasim me të drejtën e brendshme. Këtu mund të përmendim: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e cila shpreh që *“një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”*.¹¹⁶ Pastaj Kushtetuta e Austrisë parashih që *“rregullat e përgjithshme dhe të pranuarat të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë integrale e ligjit federal”*.¹¹⁷ Ekzistojnë dy mënyra për zbatimin e të drejtës ndërkombëtare në sistemin e brendshëm. Mënyra e parë: ka të bëjë me zbatimin e drejtpërdrejtë të normave të së drejtës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme. Kjo do të thotë që këto norma të inkorporohen ose të shndërrohen automatikisht në norma të së drejtës së brendshme, pa pasur nevojë për nxjerrjen e ndonjë akti ligjor për miratimin e tyre. Mënyra e dytë për zbatimin e normave të së

¹¹⁵Daci, J. (2011). *Të drejtat e njeriut*. fq: 58 – 59.

¹¹⁶Shih nenin 122 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹¹⁷Shih nenin 9 paragrafi 1 të Kushtetutës Federale të Austrisë.

drejtës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme është inkorporimi nëpërmjet legjislativit të normave të së drejtës ndërkombëtare. Kjo do të thotë që këto norma bëhen të zbatueshme, vetëm pasi miratohen me ligj të veçantë nga organet ligjvënëse. Miratimi me akt të veçantë juridik behet nëpërmjet përfshirjes së normave të së drejtës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme ose kur organi ligjvënës me akt të veçantë barazon normat e të drejtës ndërkombëtare me normat e të drejtës së brendshme pa i ndryshuar ato ose pa i riformuluar.¹¹⁸

E drejta penale ndërkombëtare është fokusi i studimit tonë dhe do të trajtojmë epërsinë e saj kundrejt legjislacionit kombëtar. Nëse me të drejtën penale kombëtare do të kuptojmë legjislacionin e një shteti të caktuar që vepron dhe zbatohet brenda territorit të tij, me të drejtë ndërkombëtare penale do të kuptojmë sistemin e normave penale që u dedikohet në tërësi marrëdhënieve ndërkombëtare.¹¹⁹

Raporti midis dispozitave kombëtare dhe atyre të së drejtës ndërkombëtare është tejet i ndryshëm. Kështu Konventat ndërkombëtare përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet vetëm shteteve anëtare të tyre si subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare shtetet anëtare detyrohen t'i japin njeri-tjetrit ndihmë të ndërsjellë në masën e parashikuar. Për të integruar në sistemin ligjor kombëtar marrëveshje me shtete të tjera ekzistojnë disa mundësi. Mundësia e parë është që kushtetuta e një shteti të përcaktoj integrimin e tyre si pjese e legjislacionit të brendshëm.

Në legjislacionin tonë të brendshëm për integrimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare ka rendësi vetëm ligji vendas, pra dispozitat e Titullit 10 të KPP-së, se para kësaj e drejta ndërkombëtare nuk mund të ketë efekt brenda shtetit. Në nenin 10 të K.Pr,P përcaktohet se *“Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga*

¹¹⁸Daci, J. (2011). Të drejtat...vep. e cit. fq: 75 – 76.

¹¹⁹Ismet Salihu . E drejta penale. Tirane.2010, fq.42

marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij Kodi". Pra nuk ka ka një rregull të përgjithshëm në rastin kur një normë e marrëveshjes dhe një normë e ligjit vendas mund të përcaktojnë rregullime të ndryshme për të njëjtën çështje.

Në momentin e përcaktimit të prioritetit të normës së zbatueshme duhet të themi që në përgjithësi procedura brenda shtetit rregullohet vetëm sipas ligjit vendas sepse marrëveshjet nuk përbejnë rregulla për procedurën e shteteve pale të marrëveshjes në lidhje me verifikimin dhe plotësimin e kërkesa vepër ndihme të ndërsjellët juridike. Kështu në lidhje me afatin maksimal të arrestit të përkohshëm për ekstradim në Konventë Evropiane të Ekstradimit ndalohet lakimi i afatit maksimal 40 ditor i arrestit të përkohshëm për ekstradim parashikuar në nenin 16 paragrafi 1 KEE-së.¹²⁰ Në legjislacionin tonë të brendshëm në nenin 495 paragrafi 5 të KPP të Republikës së Shqipërisë lejohet një afat më i gjatë arresti, nëse Ministria e Drejtësisë bënë kërkesë për zgjatje brenda 20 ditëve nga caktimi i arrestit. Por në çdo raste duhet respektuar kufiri maksimal prej 20 ditësh, pasi neni 16 paragrafi 4 pika 1 i KEE-së nuk lejon përjashtimet për zgjatjen e afatit nëpërmjet zbatimit të ligjit vendas.

Bazuar në nenin 122 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet se *“Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë. “ marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi,*

¹²⁰Shih nenin 16 të Konventës Evropiane të Ekstradimit.

në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Në ligjin Nr. 8920, date 11.7.2002 “ Për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar" në nenin 16 të saj përcaktohet se *“Shtetet Palë që e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një traktati duhet që: (a) të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në kohën e depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, nëse ata do ta konsiderojnë këtë Konventë si bazën ligjore të bashkëpunimit në lidhje me ekstradimin me Shtetet e tjera Palë në të; dhe*

(b) Në qoftë se nuk e konsiderojnë këtë Konventë si bazën ligjore për bashkëpunim në fushën e ekstradimit, duhet të përpiqen, aty ku është e mundur, që të lidhin traktate mbi ekstradimin me Shtetet e tjera palë të kësaj Konvente, me qëllim që të zbatohet ky nen.”. Pra, nëse shtete që kanë aderuar në konventë e kanë konsideruar atë si bazë ligjore atëherë ata duhet t’i përmbahen normave të kësaj Konvente. Kur disa marrëveshje ndërkombëtare prekin të njëjtën çështje, edhe në këtë rast ka rendësi përmbajtja dhe masa e rregullave ekzistuese. Së pari, këtu zbatohen përkatësisht parime në lidhje me raportin ndërmjet konventave ndërkombëtare dhe ligjit kombëtar. Pra, do të zbatohet rregullisht rregulli i asaj marrëveshje që është më i favorshëm dhe më i gjerë përveç kur interpretimi nxjerr në pah se prioritet duhet të ketë rregull me një veprim më të ngushtë.

KAPITULLI IV EKSTRADIMI NË AKTET LIGJORE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

4.1. Ekstradimi në aktet juridike të Këshillit të Evropës. Vështrim i Përgjithshëm.

Këshilli i Evropës u themelua në vitin 1949, pas Luftës së Dytë Botërore, për të mbështetur dhe themeluar ndërtimin evropian mbi bazën e vlerave të respektimit të qenies njerëzore dhe të demokracisë.¹²¹ Qëllimi i krijimit të kësaj organizate është arritja e një bashkëpunimi me të ngushtë ndërmjet shteteve anëtare për të ruajtur dhe nxitur idealet dhe parimet që përbejnë pasurinë e tyre të përbashkët dhe të përkrahin zhvillimin e tyre ekonomik e shoqëror.

Që në momentin e krijimit të legjislacionit penal qëllimi i këtij të fundit ka qenë mbrojtja dhe siguria e rendit juridik të shtetit të së drejtës duke qenë se në momentin e krijimit të këtij shteti krimi i ka shtrire përmasat dhe kufijtë e tij në territorin në të cilin ky shtet ushtronte veprimtarinë e tij. Bashkëpunimi ndërshtetëror kryesisht evropian, filloj në shekullin e XIX, me Konventën Franko-Belge të 12 Gushtit 1843 mbi “Ndihmën e ndërsjellë në fushën e taksave”, kryesisht mbi mbledhjen e gjobave. Me ndryshimet politike, ekonomike e shoqërore lindi nevoja e bashkëpunimit ndërshtetëror sidomos në fushën penale që u konkretizua me disa marrëveshje ndërshtetërore mjaft të rëndësishme siç ishin “Konventa Evropiane e Ekstradimit” e vitit 1957 dhe “Konventa Evropiane e Ndihmës së ndërsjellë Juridike “ e vitit 1959. Vitet 1961 -1971 të cilat mund të konsiderohen si periudha e novacioneve, objekti dhe metoda e bashkëpunimit u rishikuan tërësisht duke synuar kështu përballimin më efikas të një kriminaliteti më të organizuar dhe më kompleks. Nëpërmjet konventave të miratuara gjatë kësaj periudhe metodat e bashkëpunimit njohën një zgjerim të ndjeshëm.

¹²¹Synimi i tij është të krijojë një hapësirë demokratike e juridike të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹²¹. Këshilli i Evropës zhvillon një bashkëpunim të gjithanshëm për një numër të madh çështjesh si edukimi, kohezioni shoqëror, mbrojtja shëndetësore, lufta kundër të gjitha formave të intolerancës. Shih Canaj - Bana (2014), *E drejta e Bashkimit Evropian*, Onufri, fq. 13-15; Donna Gomien, *Këshilli i Evropës*, Botime, 2006, Daci J., *Te drejtat e njeriut ne Evrope*, 2011.

Ekstradimi është një nga mënyrat dhe teknikat ligjore më të veçanta të ndihmës së ndërsjelltë ndërshtetërore me anë të së cilës një shtet, pa hequr dorë nga sovraniteti i tij, kërkon ndihmën e një shteti tjetër, në mënyrë që të përmbushë sa më mirë misionin e tij për të zbatuar ligjin. Të gjithë e përkufizojnë ekstradimin si procedurë ligjore sipas të cilës një shtet, i dorëzon një shteti tjetër kërkues, një person të strehuar në territorin e tij, me qëllim që shteti kërkues të mund ta gjykojë (ekstradim për gjykim) ose të ekzekutojë dënimin (ekstradim për ekzekutim) e dhënë më parë për të.

Ekstradimi është forma më e vjetër e bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërkombëtar shtetëror. Ekstradimi ka qenë një nga marrëveshjet më të rëndësishme në luftën kundër kriminalitetit duke u bërë një proces i efektshëm parandalues për kriminelët. Vetë fakti që të gjitha shtetet kanë rënë dakord të ekstradojnë kriminelë në vendet ku ata kërkohen nga drejtësia, ka bërë që të rrënjoset dhe të jetën reale bindja se nuk ka vend të botës dhe cep të botës që mund të fshihesh nëse ke kryer një krim. Në vendet e Evropës ekstradimi ka qenë dhe është një mjet mjaft i efektshëm duke pasur parasysh karakterin gjithnjë e më ndërkufitar e ndërshtetëror të kriminalitetit.¹²²

Konventat kanë luajtur një rol parësor dhe kanë mundësuar bashkëpunimin në fushën penale ndër vite midis shteteve evropiane duke synuar parandalimin e krimit dhe administrimin më të mirë të drejtësisë. Një ndër konventat dhe traktatet kryesore të cilat kanë si bazë të përbashkët epërsinë e së drejtës, është Konventa mbi Ekstradimin e 1957 me dy protokollet shtesë të saj. Në kuadër të kësaj organizate numërohen sot mbi 25 konventa e instrumente të tjerë që kanë për objekt ndihmën gjyqësore ndërkombëtare në fushën penale. I gjithë ky mekanizëm në fushën e bashkëpunimit në kuadër të Këshillit të Evropës nuk ka qenë i lehtë pasi ka kaluar nëpërmjet fazash dhe zhvillimesh në rritje. Ne do i analizojmë ato në vijim.

¹²²Hoxha.A, Ekstradimi sipas instrumentave ligjore të BE –së .Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentet e Këshillit të Evropës , Tiranë 2010 fq 115-116, .Konventa për Ekstradimin e vitit 1957 dhe dy protokollet shtesë të saj, Konventa përNdihmën e Ndërsjelltë në Cështjet Penale e vitit 1959.

4.1.1. Konventa Evropiane e Ekstradimit

Tashmë baza e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale është konsoliduar nga ana e Këshillit të Evropës. Ky institucion ka miratuar një sërë aktesh si traktate ndërkombëtare dhe konventa, sepse rritja e kriminalitetit në nivel global dhe marrja e masave për parandalimin e tij kërkonin domosdoshmërisht krijimin e akteve të cilët do të krijonin dhe bazën ligjore të veprimtarisë penale në nivel ndërkombëtar. Kështu në fund të vitit 1951, Asambleja Konsultative e Këshillit të Evropës paraqiti një rekomandim për masat që duhen ndërmarrë për përgatitjen e një konvente të vetme me të cilën do të rregullohej ekstradimi. Më datë 13.12.1957 u krijua Konventa Evropiane për Ekstradim e cila hyri në fuqi më 18.04.1960. Konventa është ratifikuar nga të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

Marrëdhëniet e KEE-së me konventat e tjera dypalëshe në rastet kur vepra parashikohet nga të dyja aktet realizohen duke shfuqizuar të gjitha traktatet e mëparshme sa i përket vendeve ku Konventa Evropiane për Ekstradimin zbatohet dhe në rast se palët dëshirojnë të nënshkruajnë marrëveshje dy apo shumëpalëshe, këto marrëveshje mund të nënshkruhen vetëm nëse kanë synimin për të plotësuar dispozitat e Konventës së vitit 1957 ose lehtësimin e zbatimit të parimeve të saj.

Konventa Evropiane për ekstradimin krijon një regjim juridik unik në lidhje me çështjet e ekstradimit midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Ajo shfuqizon traktatet dypalëshe si dhe sjell harmonizim të legjislacioneve të brendshme të shteteve në lidhje me këtë institut.¹²³ Konventa në lidhje me ekstradimin e shtetasve përcakton se secili vend nënshkruar gëzon të drejtën e refuzimit të ekstradimit të shtetasve të tij.¹²⁴ Konventa e vitit 1957 nuk përcakton procedurën që duhet ndjekur për shqyrtimin e kërkesave për ekstradim sepse sipas saj çdo shtet

¹²³Shih *Ndihma juridike dhe ekstradimi*, AZEM Hajdari, Prishtinë 2014 fq. 26.

¹²⁴Shih nenin 6 të Konventës evropiane të ekstradimit.

i kërkuar është i lirë të përdorë procedurën që i duket më e përshtatshme që do të krijojë mospërputhje midis shteteve sepse jo të gjitha ofrojnë të njëjtat garanci në lidhje me individët që kërohen të ekstradohen. Me Konventën Evropiane të Ekstradimit e drejta evropiane në fushën e ekstradimit ka bërë një hap të madh drejt harmonizimit, akoma është arritur të bëhet njehsimi i vërtetë nga buron edhe nevoja e ndërmarrjes së veprimeve të tjera që do të mundësonin një gjë të tillë.

Në lidhje me institutin e ekstradimit KEE-ja ka sanksionuar në nenin 14 të saj si një ndër kushtet kryesore parimin e specialitetit. Në bazë të këtij parimi Konventa përbën një garanci për personin i cili kërkohet të transferohet duke i siguruar atij mos dominim /procedimin për një vepër penale të kryer para kërkesës së ekstradimit. Por Konventa ka edhe përjashtime nga ky parim. Kështu në rastet kur shteti që ka ekstraduar personin ka dhënë pëlqimin që personi të mund të procedohet edhe për vepra penale të kryera para bërjes së kërkesës në këto raste shtetit kërkues i lind e drejta që të procedoj edhe në lidhje me vepra të tjera penale.¹²⁵ Në nenin 2 të KEE-së përcaktohet se nuk mund të ekstradohet një person nëse vepra për të cilën ai akuzohet nuk përbën vepër penale në vendin ku ai ndodhet, me përjashtim të rasteve kur shtetet përjashtojnë nga fusha e aplikimit të konventës disa vepra penale. Po kështu nuk lejohet ekstradimi i personave të cilët akuzohen se kanë kryer në shtetin kërkues krime politike.¹²⁶ Konventa ofron mbrojtje ndaj diskriminimit. Kështu nuk lejohet ekstradimi në raste se ka dyshime të bazuara që personi do të jetë subjekt i persekutimeve dhe diskriminimeve për shkak të racës, fesë, shtetësisë, bindjeve politike etj. Në nenin 9 të Konventës parashikohet parimi *Ne Bis In Idem* i cili ndalon ekstradimin e personave nëse ata

¹²⁵Shih J.Qeleshi & F.Kalaja & R.Bozo “Ekstradimi midis kuadrit normative të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian” Jeta Juridike , 2010, fq.116.

¹²⁶Shih nenin 3 paragrafi 1 të Konventës Evropiane të Ekstradimit.

janë gjykuar përfundimisht nga pala e kërkuar si dhe kur autoritetet kompetente të palës së kërkuar vendosin të mos e ndjekin personin apo të pushojnë ndjekjen e tij.

Synimi i KE-së me krijimin e Konventës ishte që shtetet të dispononin një mjet tejet efektiv që garantonte të drejtat e njeriut . Por zbatimi i saj në praktikë u kthye deri diku në një sfidë pasi kërkonte domosdoshmërisht ndryshimin e legjislacionit të brendshëm dhe përmirësimin e tij në mënyrë që bashkëpunimi në fushën e ekstradimit të ishte më i shpejtë dhe produktiv.

4.1.2. Konventa Evropiane e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe ekstradimi

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)¹²⁷, në nenin 5, pika 1 të saj titulluar : “E drejta për liri dhe siguri”, ka parashikuar shprehimisht se: “Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që parashikohen shprehimisht, dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj”.

E drejta e individit për liri dhe siguri, është një e drejtë e qënësishme e tij, është një e drejtë unike, e cila i takon atij si një e tërë.¹²⁸ Privimi nga kjo e drejtë, në fokusin e nenit 5, pika 1 njeh tre situata, sipas të cilave duhet justifikuar heqja e lirisë, në funksion të një procesi penal, ku bëjnë pjesë:

¹²⁷Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996 Për ratifikimin e Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Fletore Zyrtare, nr.20/1996.

¹²⁸Monika Makovei, *E drejta për lirinë dhe sigurinë e personit*. Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut Këshilli i Evropës. Këshilli i Evropës, 2002, faqe 6.

“Siguria e personit”duhet kuptuar në kontekstin e lirisë fizike dhe nuk mund të interpretohet sikur i referohetçështjeve të ndryshme (si për shembull detyrimi i një shteti për t’i suguruar dikujt mbrojtje personale kundrejt një sulmi nga të tjerë, ose të drejtën për sigurime shoqërore).

1. Ndalimi i një personi të dyshuar për përfshirje në kryerjen e një veprë penale (pika 1/ c);
2. Burgosja e një personi si dënim se ka kryer një vepër penale (pika 1/ d);
3. Ndalimi i një personi në vijim të kërkesës për ekstradimin e tij/saj në një shtet tjetër (pika 1/ f.).

Këto kufizime të imponuar nga neni 5, pika 1 (c,d,f) nuk duhet të interpretohen ngushtë, sepse:

“Synimi i Konventës është që të sigurojë të drejta të vërteta për individët, që do të thotë se të drejtat duhet të jenë ato me përmbajtje substantive dhe të mos konsiderohen thjesht si garantuese të një të drejte thjesht formale. [...], kufizimet mbi të drejtën e lirisë duhet të shihen si përjashtuese dhe të lejohen vetëm kur jepet për to një justifikim bindës”.¹²⁹

Në situatat e mësipërme, të cilat sjellin ‘kufizimin e lirisë’, duhet të mbahen në konsideratë, se në referencë të gërmës (c) të pikës 1, të nenit 5-së të Konventës, cilësimi i një veprë si vepër penale, duhet t’i drejtohet të drejtës kombëtare, e cila përcakton se cilat janë ato veprime, që janë të dënueshme nga legjislacioni penal kombëtar.

Kështu, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ka mbajtur qëndrim, sipas së cilës:

“[...] ajo që përbën një vepër penale i përket kryesisht të drejtës vendase, ky është një koncept që është konstatuar se ka kuptim autonom për qëllimet e Konventës dhe është e kuptueshme që përdorimi i së drejtës penale në disa rrethana mund të shihet si disproporcionale dhe si rrjedhim arbitrare”.¹³⁰

Në lidhje me situatën e dytë, të parashikuar nga gërma (d), e pikës 1, të nenit 5 heqja e lirisë së një individi, do të jetë e realizueshme vetëm nëse ajo diktohet nga dyshimi i kryerjes së një

¹²⁹*Ibid*, faqe 7.

¹³⁰*Ibid*, faqe 23.

vepre penale në të ardhmen, nevoja për të parandaluar që një e tillë të ndodhë ose largimin e mundshëm të të dyshuarit.

Kështu, GJEDNJ, ka mbajtur qëndrimin se:

“Nevoja për të nisur një proces penal kundër dikujt të dyshuar se ka kryer një vepër penale, ose nevoja për të parandaluar kryerjen e një vepre të tillë mund të japë justifikimin fillestar për t’i hequr lirinë personit të dyshuar, por kjo nuk përbën një bazë të mjaftueshme për vazhdimin e mbajtjes në paraburgim pas kësaj faze. Vazhdimi i paraburgimit duhet t’i nënshtrohet hetimit të menjëhershëm gjyqësor që jo vetëm duhet të shqyrtojë së pari nëse është një masë e justifikuar, por edhe nëse ende është e përshtatshme për t’u vazhduar”.¹³¹

GJEDNJ ka njohur katër arsye si të përshtatshme për të vazhduar masën e paraburgimit, kur ende ekziston një dyshim i arsyeshëm që personi ka kryer një vepër penale, të cilat janë:

- risku i largimit;
- risku i ndërhyrjes në procesin e drejtësisë;
- nevoja për të ndaluar krimin;
- nevoja për të ruajtur rendin publik.

Nga ana tjetër, neni 5, në pikën 1, gërma (a) lejon “ndalimin e ligjshëm të një personi pas dënimit të tij nga një gjykatë kompetente”, ku sipas jurisprudencës së GJEDNJ:

“Një vendim i caktuar me burgim duhet të ketë një bazë në dhënien e dënimit nga një ‘gjykatë kompetente’ dhe se faktet me të cilat lidhet marrja e vendimit përbëjnë një vepër të jashtëligjshme duke lejuar imponimin e burgimit në përputhje me ligjin vendas në kohën kur është kryer ajo vepër”.¹³²

¹³¹Shih *Ibid*, faqe 28.

¹³²Shih *Kemmache vs. France* (1991); *Mansur vs. Turkey* dhe *Yağci dhe Sargin vs. Turkey* (1995).

Së fundmi, në gërmën (f), të pikës 1 të nenit 5, është parashikuar shprehimisht edhe një tjetër situatë se: “Lejohet arrestimi i ligjshëm ose ndalimi i një personi kundrejt të cilit është marrë masa për dëbim ose ekstradim”.

Ndalimi, sipas interpretimit të GJEDNJ në këtë rast:

“Do të këtë lidhje me këtë dispozitë edhe nëse dëbimi ose ekstradimi në fakt nuk ndodh ose edhe në mungesë të një kërkesë formale ose urdhëri për ekstradim, duke pasur parasysh se janë kryer hetimet e duhura”.¹³³

Gërma (f), e pikës 1, të nenit 5 të Konventës, në vetvete përmban dy garanci, të cilat sigurojnë që: (1) arrestimi ose ndalimi duhet të jetë i ‘ligjshëm’ në kuptimin, që duhet të jenë në përputhje me ligjin vendas dhe Konventën Evropiane për Ekstradim”, dhe (2) nuk duhet të jenë arbitrare. Jurisprudenca e GJEDNJ ka bërë dallimin midis ligjshmërisë së ndalimit dhe ligjshmërisë së ekstradimit (çështja: *Caprino kundër Mbretërisë së Bashkuar*).¹³⁴

Në këtë çështje u konstatua, se në:

“rishqyrtimin e ligjshmërisë së ndalimit, ligjshmëria e ekstradimit shpesh do të ngrihet si çështje në veçanti kur vetë ligji vendas parashikon varësinë midis ligjshmërisë së ndalimit dhe atij të ekstradimit. Për këtë arsye është e rëndësishme që të shtyhet ekstradimi ose dëbimi derisa të kryhet rishqyrtimi i ligjshmërisë së ndalimit, duke qënë se rezultati do të mund të ndikojë në vetë ligjshmërinë e ekstradimit apo dëbimit”¹³⁵.

Gjithashtu, duke pasur parasysh garancitë e dhëna në pikën 4 të nenit 5, ku parashikohet shprehimisht se: “Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirinë, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”,

¹³³Shih *Op. Cit.*, note 2, faqe 40

¹³⁴Shih *Caprino vs. UK* (1975), ku GJEDNJ (Komisioni) konstatoi se përfundimi i proceseve internuese është i pavend për arsyetimin e ndalimit, nëse një procedurë internimi të ligjshëm është nisur dhe ka vazhduar me seriozitet.

¹³⁵Shih *Op. Cit.*, note 2, faqe 41

do të thotë, se ekstradimi apo dëbimi gjithnjë duhet të shtyhet derisa gjykata të ketë mundësinë për të rishqyrtuar ligjshmërinë e ndalimit dhe, nëse është e përshtatshme, të urdhërojë lirimin e personit.¹³⁶

Ligjshmëria e ndalimit në lidhje me nenit 5 (1) (f), do të jetë e vlefshme:

1. Kur ndalimi, kryhet nga një organ kompetent, se pavarësisht se ekzistonte baza ligjore për dëbimin në ligjin vendas, dëbimi urdhëruar nga një organ tjetër dhe jo nga ai që parashikohet nga ligji kombëtar – sic mund të jetë një dëbimin administrativ, dhe që shoqërohet me arsyetimin ‘rrezik për publikun’, nuk përmbush kushtet e ligjshmërisë së ndalimit, sepse dëbimi administrativ nuk përbënte një të ‘drejtë me cilësi’ të mjaftueshme për të qënë brenda kuptimit të Konventës.¹³⁷
2. Kohëzgjatja e ndalimit, nuk është e përcaktuar në kohë, por pavarësisht kësaj, procedurat e ekstradimit ose dëbimit duhet të realizohen me ‘kujdesin e duhur’.

Në çështjen *Lynas kundër Zvicrës*¹³⁸, gjykata bëri të qartë faktin se nëse procedimet nuk drejtohen me kujdesin e duhur ose nëse ndalimi vjen si rezultat i keqpërdorimit të pushtetit, ai pushon së qeni i justifikueshëm në bazë të nenit 5 (1) (f).

Megjithatë, nëse ndalimi në pritje të ekstradimit zgjatet në interes ose me kërkesë të personit të interesuar, ky i fundit nuk mund të pretendojë që është viktimë e ndalimit të tejzgjatur.

¹³⁶*Bozano vs. France*¹³⁶ - Gjykata konstatoi se ndalimi i kërkuarit ishte i paligjshëm dhe si rrjedhojë, në kundërshtim me nenin 5 (1) (f).

Gjykata vendosi që dëbimi i kërkuarit nga Franca në Zvicër ishte arbitrar: megjithëse një gjykatë franceze refuzoi kërkesën e Italisë për ekstradimin e kërkuarit, qeveria franceze e lëshoi urdhrin e dëbimit kundër tij; autoritetet priten për rreth një muaj përpara se të vinin në zbatim urdhrin e dëbimit duke ndaluar kërkuarin që të përdorte ndonjë rrugë gjyqësore për të kontaktuar me gruan e tij dhe avokatin ose për të caktuar një shtet për dëbimin e tij; kërkuari u dërgua forcërisht nga policia nga Franca për në kufirin zvicerian ku iu dorëzua autoriteteve të shtetit zvicerian dhe më pas u ekstradua për në Itali.

Gjykata konstatoi se rrethanat e çështjes provuan se ndalimi i kërkuarit përbënte një formë të fshehtë të ekstradimit që nuk do të mund të justifikohet në bazë të Konventës.

¹³⁷*Op Cit.* note 2, faqe 42.

¹³⁸*Lynas vs. Switzerland*(1993)

Për shembull, në çështjen *Kolompar kundër Belgjikës*¹³⁹, gjatë gati tre viteve të ndalimit në pritje të ekstradimit këto vite u konstatuan të justifikuara duke qënë se vetë kërkuesi në mënyra të ndryshme kishte vonuar ose kontribuar në shtyrjen e procedimeve.

3. Kushti i ligjshmërisë përfshin edhe cilësinë e ligjit vendas, në kuptimin që ai të jetë i aksesueshëm dhe i parashikueshëm dhe i formuluar në saktësinë e duhur.

4.3. Vendimet e GJEDNJ-së lidhur me ekstradimin e shtetasve shqiptarë. Çështja Rrapo kundër Shqipërisë

Organi kompetent për gjykimin e mosmarrëveshjeve në fushën e ekstradimit është Gjykata. Konfliktet që paraqiten për gjykim, janë pjesë e juridiksionit penal të gjykatës. Në gjykatë realizohet e drejta e individëve për t`iu drejtuar gjykatës dhe sigurohet ruajtja e paqes sociale nëpërmjet zgjidhjes me gjyq të mosmarrëveshjeve.

E drejta për t`iu drejtuar gjykatës, dhe e drejta për një proces të rregullt janë të drejta universale, themelore të njeriut dhe shërbejnë si garanci kushtetuese. Një proces i rregullt arrihet atëherë kur gjykata respekton procedurat ligjore gjyqësore, gjykon në mënyrë të drejtë e brenda një afati të arsyeshëm dhe është e pavarur dhe e paanshme. Duhet që t`u sigurohen mundësi të dy palëve për të sqaruar çështjen, jo favorizime, jo diskriminime, të dy palët të barabartë.¹⁴⁰Kështu, në një rast të tillë, Gjykata Kushtetuese, në vendimin 6/2006, arsyeton se parimi i sigurisë juridike, kërkon që vendimet gjyqësore të formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim për t`u zbatuar. Kërkesa e kërkuesit me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një afati të arsyeshëm, duhet pranuar edhe për një shkak

¹³⁹*Kolompar vs. Belgium (1985)*

¹⁴⁰E Drejta Kushtetuese, Prof. Dr. Aurela Anastasi, Tiranë, 2004, faqe 106.

tjetër, sepse moszbatimi i një vendimi të tillë, cenon të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës.¹⁴¹

Në praktikën e GJEDNJ-se nuk ka shumë çështje që të kenë trajtuar ekstradimin e shtetasve shqiptarë. Në vijimësi do të trajtojmë të vetmet çështje që lidhen me ekstradimin në Republikën e Shqipërisë që janë Çështja Rrapo kundër Shqipërisë dhe Çështja Haxhia kundër Shqipërisë.

Çështja *Rrapo kundër Shqipërisë* lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rastet e dëbimit apo ekstradimit të një individi, shtetas shqiptar, ku si pasojë mund të rezultonte vdekja e tij, edhe pse kjo është trajtuar së bashku me nenin 3 për mbrojtje nga trajtimi çnjerëzor dhe degradues¹⁴². Shtetasi A.Rrapo me shtetësi shqiptare dhe amerikane iu drejtua gjykatës në 11 Tetor 2010, me një kërkesë nr. 58555/ bazuar në nenin 34 të KEDNJ-së. Ankuesi pretendonte se kishte ndodhur një shkelje e neneve 2, 3 dhe 34 të Konventës si rezultat i ekstradimit të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës pasi atje do të dënohej me dënimin kapital për tetë vepra penale të kryera në këtë vend.

Më 2 Korrik 2010, ankuesi bëri kërkesë pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për rinovim të pasaportës së tij amerikane dhe po të njëjtën ditë ai u arrestua nga policia shqiptare me kërkesë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara. Ambasada e Shteteve të Bashkuara dërgoi shënimin diplomatik nr. 55, me anë të së cilit kërkonte arrestimin paraprak të ankuesit, me qëllim ekstradimin e tij në përputhje me nenin XI të Traktatit të Ekstradimit. Sipas shënitimit diplomatik, më 28 Maj 2010, nga një gjykatë e Shteteve të Bashkuara ishte lëshuar një urdhër arresti për ankuesin.¹⁴³ Prokurori kërkoi konfirmimin e ndalimit paraprak të

¹⁴¹Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 31.03.2006, Fletore Zyrtare nr. 26/2006, faqe 873

¹⁴²Shih nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

¹⁴³Më 30 Gusht 2010, Ambasada e Shteteve të Bashkuara i dërgoi Ministrisë Shqiptare të Punëve të Jashtme, shënimin diplomatik nr. 071, duke i kërkuar ekstradimin e ankuesit. Sipas shënitimit diplomatik, ankuesi ishte akuzuar, së bashku me të pandehur të tjerë, me tetë akuzat e mëposhtme: 1) antarësi në një organizatë kriminale e përfshirë në vrasje, rrëmbim personi, shpërndarje droge, zjarrvënie të qëllimshme, vjedhje, grabitje dhe transportimi brenda përbrenda shtetit të mallrave të vjedhura; 2) komplot për të përfshirë në një organizatë kriminale; 3) komplot për të shpërndarë dhe zotërim me qëllim shpërndarjen e 100 kilogramëve dhe më shumë

ankuesit me synim ekstradimin e tij drejt Shteteve të Bashkuara. Në rastin konkret, ankuesi u arrestua me synimin për t'u ekstraduar në Shtetet e Bashkuara. Më 30 Gusht 2010, autoritetet e Shteteve të Bashkuara kërkuan në mënyrë zyrtare ekstradimin e tij, inter alia, mbi një akuzë kapitale dhe më 30 Shtator 2010 dhe 1 Nëntor 2010, Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit respektivisht, vendosi në favor të ekstradimit të ankuesit. Gjykata nuk i kërkoi asnjë garanci shtetit amerikan që shtetasi A.Rrapo nuk do të dënohej me vdekje.

Kjo problematikë u ngrit si çështje gjatë procedurave përpara Gjykatës së Lartë, fazë në të cilën, me keqardhje, ankuesi ishte ekstraduar. Në lidhje me këtë situatë, gjykata kujton se protokoli nr. 13, i cili në Shqipëri hyri në fuqi më 1 Qershor 2007, së bashku me detyrimet e shtetit përgjegjës bazuar në nenet 1, 2 dhe 3 të Konventës, pohonte se, për çfarëdo arsye, ai nuk do t'i ndalonte individët me synimin për t'i ekstraduar ata dhe më pas të gjykoreshin me dënim kapital. Gjithashtu, shteti përgjegjës brenda juridiksionit të tij, nuk duhet t'i bënte në asnjë mënyrë individët subjekt të një rreziku real për t'u dënuar me dënim me vdekje dhe më pas të ekzekutoheshin nëse nuk kërkohet dhe ofrohet siguri e mjaftueshme dhe e detyrueshme nga autoritetet përgjegjëse të shtetit që bënte kërkesën.

Gjykata nuk gjeti asnjë fakt në materialet e paraqitura përpara saj që mund të ngjallë dyshime mbi sigurinë që dënimi kapital nuk do të kërkohet apo të ushtrohet mbi ankuesin nga shteti i cili ka paraqitur kërkesën. Siguria e dhënë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte specifike, e qartë dhe aspak ekuivoqe. Siç u konfirmua më vonë në një tjetër shënim diplomatik të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, më 24 Shkurt 2001, *“kjo siguri është e detyrueshme për Departamentin e Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara”*. Më tej, gjykata duhet t'i japë rëndësi faktit se nën kontekstin e një kërkesë për ekstradim, asnjëherë nuk janë raportuar shkelje të sigurisë së dhënë nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara kundrejt një shteti

marihuanë; 4) komplot për shpërndarjen dhe zotërim me qëllim shpërndarjen e subsatncave të ndaluar; 5) komplotim për të bërë një grabitje; 6) zotërimin, përdorimin, mbajtjen dhe kërcënimin me armë zjarri, duke

kontraktues. Vetëm interesi afatgjatë i Shteteve të Bashkuara për të respektuar angazhimet e veta mbi ekstradimet do të ishte i mjaftueshëm për të dhënë mirëbesimin dhe heqjen e çdo dyshimi për mundësinë e rrezikut që kjo siguri të shkelej. Së fundmi, siç evidentohet edhe nga procesverbali i datës 19 Korrik 2011, në të cilin ankuesi pranon fajësinë ndaj akuzave, Shtetet e Bashkuara nuk kanë përmendur asnjë rrezik që mund të përballë ankuesin me dënimin me vdekje. Nën rrethanat e paraqitura më sipër, gjykata mendon se ekstradimi i ankuesit në Shtetet e Bashkuara nuk përbënte shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr. 13 për sa ka të bëjë me rrezikun për ushtrimin e dënimit me vdekje.

Çështja Haxhia kundër Shqipërisë

Shtetasi I.H. pas ngjarjeve të vitit Janar 2001 ku mbeti i vrarë ish-deputeti i Republikës së Shqipërisë A. H. u largua drejt Turqisë. Prokuroria e cilësoi Haxhinë si të dyshuarin kryesor të vrasjes së ish-deputetit Hajdari dhe vrasjen e trupprojës tjetër Z.N. Ankuesi ishte truproja i presidentit të atëhershëm të Shqipërisë, z. S.Berisha. Në kohën e paraqitjes së ankimit, ai është ndaluar në Turqi në pritje të rezultatit për ekstradimin e tij në Shqipëri. Gjatë procesit gjyqësor procedimet gjyqësore kundër ankuesit janë kryer në mungesë dhe u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga familja e tij sipas nenit 48 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale.¹⁴⁴Haxhia u gjykua dhe dënua me 25 vjet burg në mungesë në Prill të vitit 2004 nga ana e autoriteteve gjyqësore shqiptare. Vendimi i dënimit u ankua në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë nga avokati i ankuesit, i caktuar nga familja, si dhe i të bashkëpandehurve të tjerë. Në Qershor 2006, ankuesi u arrestua në Turqi nga ana e autoriteteve turke bazuar në urdhër-arrestin e lëshuar nga autoritetet shqiptare ku dhe kërkonin ekstradimin e ankuesit por gjykatës nuk i është paraqitur një kopje e kërkesës për ekstradim.

¹⁴⁴Shih nenin 48 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale.

Bazuar në Konventën Evropiane për Ekstradimin e cila është ratifikuar nga shteti Shqiptar më 19 Maj 1998, në nenin 3 të protokollit të dytë shtesë parashikon se për: *“Vendimet në mungesë 1. Kur pala kontraktuese i kërkon një pale tjetër kontraktuese ekstradimin e personit për të kryer dënimin apo urdhër-ndalimin sipas vendimit të marrë kundër tij në mungesë, pala së cilës i kërkohet ekstradimi mund të refuzojë ekstradimin për këtë qëllim nëse, sipas mendimit të saj, procedimet që çuan në këtë vendim nuk përmbushnin të drejtat minimale të mbrojtjes të njohura për pasojë për çdo person të akuzuar për një vepër penale. Megjithatë, ekstradimi lejohet nëse pala kërkuese jep siguri të mjaftueshme për t’i garantuar personit të pretenduar të drejtën për rigjykim, gjë që mbron të drejtën e mbrojtjes. Ky vendim autorizon palën kërkuese ose të zbatojë vendimin konkret, nëse personi i dënuar nuk kundërshton ose, në të kundërt, të fillojë procedimet kundër personit të ekstraduar. 2. Kur pala së cilës i kërkohet ekstradimi informon personin për të cilin është kërkuar ekstradimi për vendimin e marrë kundër tij në mungesë, pala kërkuese nuk duhet ta vlerësojë këtë komunikim si njoftim zyrtar për qëllimet e procedurës penale në atë shtet”*. Bazuar mbi këtë argument gjykata nuk pranoi ekstradimin e shtetasit Haxhia.

Haxhia pretendoi në gjykatë se ndaj tij ishte bërë një proces i parregullt ligjor në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Gjykata vërejti se kërkuesi nuk kishte mundësinë për një ankim sepse ai vendimin e dënimit e kishte marrë në vitin 2006 në Turqi kur kishte kaluar afati 2 vjeçar për të bërë ankim para Gjykatës Kushtetuese. Dy argumentet kryesore të papranueshmërisë që qeveria ngriti ishin se kërkesa ishte depozituar jashtë afatit gjashtëmuor dhe se ankuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore. Sipas qeverisë shqiptare kërkuesi nuk depozitoi ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese për të ankuar, për padrejtësinë e procedimeve dhe

as ankim për rishikimin e dënimit të formës së prerë në mungesë sipas nenit 450¹⁴⁵ të KPP-së dhe as për rivendosjen në afat sipas nenit 147 të KPP-së.¹⁴⁶

Ankuesi parashtroi se në momentin e arrestimit nga ana e qeverisë turke ishte vënë në dijeni mbi vendimin e autoriteteve shqiptare në mungesë dhe depozitoi një ankim pranë gjykatës. Gjykata në lidhje me mosrespektimin e afatit gjashtë mujor vendosi se perioda gjashtëmujore fillon që nga data në të cilën ankuesi ka marrë dijeni të mjaftueshme dhe efektive mbi vendimin e brendshëm të formës së prerë¹⁴⁷. Është detyrë e shtetit, i cili bazohet në mosrespektimin e afatit gjashtëmujor të përcaktojë datën kur ankuesi u njoftua për vendimin e brendshëm të formës së prerë¹⁴⁸.

Kështu gjykata konstaton se dënimi i ankuesit në mungesë është lënë në fuqi me anë të vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Lartë më 14 Shkurt 2003 dhe ankuesi është njoftuar për këtë vendim më 3 Qershor 2006 kur është arrestuar nga autoritetet turke. Ky fakt nuk është kundërshtuar. Ankuesi brenda afatit gjashtëmujor të njoftimit të dënimit të tij në mungesë që nga data 28 Gusht 2006 depozitoi një ankesë në gjykatë. Në këto rrethana, gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë dhe i jep të drejtën Haxhias që të kërkojë të drejtën e një gjykimi të ri duke e dënuar shtetin shqiptar me një dëmshpërblim prej 1.400 Euro për shpenzimet gjyqësore.

¹⁴⁵Shih nenin 450 të Kodit të Procedurës Penale.

¹⁴⁶Shih nenin 147 të Kodit të Procedurës Penale.

¹⁴⁷Shih çështjen Baghli k. Francës, nr. 34374/97, § 31, ECHR 1999-VIII.

¹⁴⁸Shih çështjen nr. 37415/97, 1 prill 2003 Sahmo kundër Turqisë.

KAPITULLI V: EKSTRADIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN. INTEGRIMI I LEGJISLACIONIT KOMUNITAR NË KUADRIN E BRENDSHËM LIGJOR

5.1. Baza ligjore. Traktatet e BE-së

Idetë për një Evropë të bashkuar janë hedhur që pas Luftës së dytë Botërore duke u konsoliduar hap pas hapi ndër vite. Kështu, Evropa e Bashkuar¹⁴⁹ i ka rrënjët e veta në vitin 1951 me nënshkrimin e Traktatit të Parisit, i cili themeloi Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut. Kjo ide u konsolidua akoma më tepër në vitin 1957, kur në Romë u nënshkruan dy traktatet për krijimin përkatësisht të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike dhe Komunitetit Ekonomik Evropian. Me nënshkrimin e Traktateve të Romës, synimi ishte tepër i qartë nëpërmjet shprehjes deklarative të vullnetit të nënshkruesve se ishin të vendosur të hidhnin themelet e një bashkimi gjithnjë e më të ngushtë dhe eficient midis popujve të Evropës. Përmes akteve të aderimit, dhe Traktateve të Mاستrihtit, të Amsterdimit dhe të Nisës, BE-ja jo vetëm u zgjerua, por edhe u përsos juridikisht dhe sot i ofron qytetarëve një nivel të lartë sigurie, kryesisht me anë të parandalimit të kriminalitetit, të bashkëpunimit mes autoriteteve policore dhe të drejtësisë si dhe përafrimit të legjislacionit. Evropa e Bashkuar përbën sot mishërimin e vlerave më të larta, të përbashkëta dhe unike të të gjitha shteteve anëtare. Konsolidimi i këtyre vlerave dhe rruga drejt përsosmërisë së tyre është tashmë një realitet, i mbështetur në dëshirën e mirë, por edhe në mekanizma juridik me fuqi detyruese.¹⁵⁰

Kuadri ligjor i BE-së përbëhet nga e drejta komunitare parësore dhe dytësore . E drejta parësore përbëhet nga traktatet, ku përfshihen: Traktati i Parisit, Traktatet e Romës, Traktati i Mاستrihtit, Traktati i Amsterdimit, Traktati i Nisës dhe traktati i fundit i cili është ende në fuqi,

¹⁴⁹Shih *Roux*, *Droit general de l' Union Europeenne*, Litec, 2006, *Jean Pradel*, *Geert Corstens*, *Gert Vermeulen*, *E Drejta Penale Evropiane*, Papirus, 2009, fq. 15 e në vijim.

¹⁵⁰E.Canaj "E drejta e Bashkimit Evropian" Tirane 2011, fq.22.

Traktati i Lisbonës. Këto akte formojnë, bashkë me të drejtën komunitare të prejardhur, të drejtën komunitare të shkruar. Këtyre akteve u bashkohen dhe parimet e përgjithshme të së drejtës, të nxjerra nga Gjykata e Drejtësisë, që ndërtojnë të drejtën komunitare jo të shkruar.

E drejta komunitare dytësore përbëhet nga:

1. *Rregulloret*, të cilat përbëjnë burimin kryesor të së drejtës dytësore. Ajo behet pjese e legjislacionit të brendshëm, ka një fushë veprimi të përgjithshme dhe është e drejtpërdrejtë dhe e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare.
2. *Direktivat* që nuk kane efekte të drejtpërdrejta zbatimi, por shfaqen në formën e një akti që domosdoshmërisht duhet të plotësohet nga akte normative të miratuara nga shtetet. Në këtë mënyrë rezultati i synuar arrihet me forma dhe mënyra të ndryshme, të përzgjedhura nga vetë shtetet sipas specifikave të tyre.
3. *Vendimet* që janë të detyrueshëm në të gjithë elementët, por nuk kanë karakter të përgjithshëm, sepse është i detyrueshëm vetëm për palët të cilëve u drejtohet drejtpërdrejt.
4. *Rekomandimet* dhe *Opinionet* nuk kanë asnjë forcë detyruese, por shprehin një mendim ose opinion në formën e një sugjerimi për një qëndrim të caktuar.

Por sa i përket të drejtës penale duhet të themi që ajo ka një rëndësi relevante dhe është e trajtuar në të gjitha burimet e të drejtës parësore. Kështu, procesi i përafrimit të legjislacioneve penale të shteteve anëtare është zhvilluar gradualisht dhe në Traktatin e BE- së nuk kemi dispozita të cilat trajtojnë këtë çështje. Në vonë institucionet evropiane hartuan një kuadër ligjor që rregullonte ekstradimin si edhe ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet penale. Ky kuadër ligjor kishte si qëllim ndër të tjera, zëvendësimin gradual të kuptimit të legjislacioneve të

brendshme të shteteve anëtare dhe të një pjese të konventave të Këshillit të Evropës në fushën e bashkëpunimit penal.¹⁵¹

Me krijimin e Traktatit të Amsterdimit në vitin 1997, u sanksionua për herë të parë mundësia e përafrimit të legjislacionit në fushën penale dhe do të zhvillohej sa herë që kjo do të ishte e nevojshme. Gjithashtu, Traktati i Amsterdimit parashikonte ndërmarrjen e veprimeve të përbashkëta, me qëllim që të përcaktoheshin rregullat minimale në lidhje me elementët përbërës të veprave penale dhe të sanksioneve në fusha të tilla si krimi i organizuar, terrorizmi dhe droga.

5.1.1. Bashkëpunimi policor në nivel komunitar

Agjencia e cila realizon zbatimin e ligjit në BE është Shërbimi Policor Evropian, me qendër në Hagë¹⁵², dhe misioni i tij është të asistojë autoritetet e agjencive të zbatimit të ligjit në vendet anëtare në luftën e përbashkët kundër krimit të organizuar dhe formave të tjera të krimeve të rënda. EVROPOL-i¹⁵³, si organizatë e BE-së për zbatimin e ligjit që trajton informacionin sekret kriminal, synon të përmirësojë efektivitetin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente të shteteve anëtare për parandalimin dhe luftën kundër krimit të rëndë

¹⁵¹Hoxha, A – Ekstradimi sipas instrumentave ligjore të Bashkimit Evropian. Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentat e Këshillit të Evropës, Morava, Tiranë 2010

¹⁵²Shtabi i EVROPOL e ka vendndodhjen në Hagë, Holandë. Ka një staf prej 660 zyrtarë nga 27 vende anëtare evropiane. Personeli është i rekrutuar nga shumë agjensi të përforsimit të ligjeve, në vendet e tyre të origjinës ku përfshihen policitë, doganat, policia kufitare dhe shërbimet e sigurimit.Canaj, E., *Levizja e lirë e personave në Bashkimin Evropian*, Tiranë, 2014.

¹⁵³EVROPOL është një agjenci për forcimin e ligjit e krijuar nga një bashkim i vendeve evropiane për të qenë të gjitha koherente për përbashkëtimin e inteligjencës kriminale. Evropol filloi si një Njësi për Drogat Evropol në luftën kundër drogave. Me kalimin e kohës u shtuan fusha të tjera të krimit. Që në janar 2002, Evropol merret me të gjitha format e krimit të rëndë të renditura në nenin 2 të Konventës Evropol dhe në Aneksin e Konventës Evropol. Shih: Vendimin e Këshillit të 6 dhjetorit 2001 që shtrin mandatin e Evropol për të përfshirë format e krimit të rëndë ndërkombëtare të renditura në Aneksin e Konventës Evropol, OJ C 362, 18.12.2001, fq.1.Shih gjithashtu Canaj, E., *Levizja e lirë e personave ne Bashkimin Evropian*, Tirane, 2014.

të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit. Bazuar në nenin 2 të Konventës EVROPOL-i¹⁵⁴, i cili ka si objektiv përmirësimin e efektivitetit dhe bashkëpunimit të autoriteteve kompetente¹⁵⁵ në shtetet anëtare për të parandaluar dhe luftuar krimin e rëndë ndërkombëtar, nëse ka të dhëna që është e përfshirë një strukturë e organizuar kriminale, preken dy ose më shumë shtete anëtare dhe kërkohet përjasje e përbashkët nga shtetet anëtare.

Ky institucion është krijuar fillimisht në vitin 1991, kur u propozua krijimi i një policie evropiane, që më pas u quajt EVROPOL duke mbajtur si datë zyrtare të krijimit të tij datën 07.02.1992 në Mاستriht¹⁵⁶.

Misioni i kësaj agjencie policore është të japë një kontribut të rëndësishëm në veprimin e zbatimit të ligjit të BE-së kundër veprave të rënda kriminale trans-nacionale, duke vënë theksin në goditjen e organizatave kriminale. Ajo ka zyra ndërlidhëse¹⁵⁷ me përfaqësinë e të 28-të vendeve evropiane, e cila siguron një database dhe infrastrukturë të sigurt për shkëmbimin e informacionit kriminal dhe kanë një rol shumë të rëndësishëm në koordinimin e operacioneve ndërkombëtare policore.

Shtetet anëtare të EVROPOL-it, të cilat përballen ose preken me një krim të përbashkët, mund të kërkojnë ndihmën e EVROPOL-it dhe hapjen e një dosje analizuese për hetimet lidhur me atë çështje.

¹⁵⁴Shkëmbi, H “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Evropian”, Shtëpia botuese “GEER”, Tiranë, 2006, faqe 215; Canaj, E., *Levizja e lire e personave në Bashkimin Evropian*, Tirane, 2014.

¹⁵⁵Për qëllim të kësaj Konvente “autoritete kompetente” do të thotë të gjitha organet publike që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të cilat janë përgjegjëse sipas legjislacionit të brendshëm për të parandaluar dhe luftuar veprat penale. Neni 2 i zëvendësuar nga Akti i Këshillit që miraton në bazë të nenit 43(1) të Konventës për Krijimin e Evropol-it, një Protokoll që ndryshon atë Konventë (2004/C 2/01), Akt i Këshillit i 27 Nëntorit 2003 (Fletore Zyrtare 002, 06/01/2004, fq. 0003)

¹⁵⁶Nenin K.1, Titullit VII- Dispozita kryesore, Traktatit për Bashkimin Evropian parashikon se shtetet anëtare të BE duhet të konsiderojnë si çështje të interesit të përbashkët:

“Bashkëpunimin policor me qëllim parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe formave të tjera të krimeve të rënda, duke përfshirë disa aspekte të bashkëpunimit doganor, në lidhje me organizimin e një sistemi të gjerë në Bashkimin Evropian për shkëmbimin e informacionit brenda EVROPOL-it” Dr.Hasan Shkëmbi, “Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Evropian”, Shtëpia botuese “GEER”, Tiranë, 2006, faqe 215. Titullit VII i Traktatit për BE përmban dispozita për bashkëpunimin në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme, e ashtuquajtur Shtylla e Tretë

¹⁵⁷Aktiviteti thelbësor i Zyrës Ndërlidhëse është të mbështesë vendet anëtare në mbledhjen, analizimin dhe organizimin e informacionit kriminal si dhe koordinimin e operacioneve policore.

EVROPOL-i ka disa detyra kryesore duke u dhënë mbështetje vendeve anëtare për problemet në fushën e sigurisë, lidhur me parandalimin e kriminalitetit në vende si shkëmbimin e informacionit lehtësisht ndërmjet shteteve anëtare. Kryerjen e ekspertizës dhe mbështetjes teknike për hetime dhe operacione të kryera brenda BE-së, nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë ligjore të shteteve anëtare të interesuara.¹⁵⁸

EVROPOL bashkëpunon si mes shteteve anëtare, ashtu edhe për njësitë e emëruara në çdo palë të tretë, si pikë kontakti me EVROPOL-in për shkëmbimin e informacionit brenda kuadrit të marrëveshjes së bashkëpunimit. Këto njësi quhen Pika Kombëtare të Kontaktit dhe operojnë si njësi kombëtare të EVROPOL-it, me përjashtimin që ato nuk kanë akses në sistemin e EVROPOL-it. Ato mund të lidhen me EVROPOL-in me linja elektronike të dedikuara të pajisura me pajisje kriptuese për mbrojtje të nivelit të lartë.

5.2. Harmonizimi i legjislacionit penal në tërësi në kuadrin e Bashkimit Evropian

Përpos të drejtave penale të një vendi, ekziston edhe e drejta penale në nivel komunitar e cila gjen zbatim në disa vende duke u konsideruar si e drejta penale ndërkombëtare.¹⁵⁹ Sipas doktrinës, e drejta penale ndërkombëtare është ajo degë e së drejtës kriminale që zgjidh në përgjithësi të gjitha problemet kriminale që dalin në nivel ndërkombëtar. Ekzistojnë disa të drejta penale ndërkombëtare. E drejta penale midis dy shteteve ku më vonë u shfaq dhe e drejta penale ndërkombëtare e drejtuar nga OKB-ja. Dhe e drejta penale në nivel evropian, e cila do të jetë edhe objekt i studimit të këtij kreu. E drejta penale evropiane, përbëhet nga një tërësi normash penale me karakter material, procedural të përbashkëta për disa shtete evropiane me

¹⁵⁸ Mathieu Deflem, *Evropol and the Policing of International Terrorism: Counter-Terrorism in a Global Perspective*, *Justice Quarterly*, Volume 23 nr 3, shtator 2006, fq. 342. Canaj, E., *Lëvizja e lirë e personave në Bashkimin Evropian*, Tirane, 2014.

¹⁵⁹ Jean Pradel, Geert Cortens, Gert Vermeulen "E drejta penale evropiane" 2009, fq. fq 11

qëllim luftimin e kriminalitetit në nivel ndërkombëtar.¹⁶⁰ Ndërtimi i politikave penale për të parandaluar kriminalitetin në nivel evropian aktualisht është kushtëzuar kryesisht nga karakteri ndërkombëtar i krimit dhe globalizimi i tij. Në Bashkimin Evropian, me termin politikë penale do të kuptojmë tërësinë e përpjekjeve të strukturave dhe organizmave të BE-së për të harmonizuar legjislacionet e brendshme penale të shteteve anëtare dhe për të krijuar një kuadër ligjor më efikas në luftën kundër formave të reja të kriminalitetit.

Që prej 1 Prillit 2009 ka hyrë në fuqi MSA-ja¹⁶¹, e cila ka si prioritet përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së. Në lidhje me përafrimin e legjislacionit në kuadrin e shtyllës së katërt duhet të përmendim nenet: 4, 82, 83, 84 dhe 85, ku përcaktohen qartë detyrat për përafrimin e legjislacionit penal në kuadrin e një sërë veprash si kontrabanda, trafikimi i qenieve njerëzore, korrupsioni, në sektorin privat dhe publik, trafikimi i paligjshëm i drogave dhe lëndëve psikotrope, i armëve, falsifikimi i dokumenteve, trafikimi i paligjshëm i makinave, vepra me qëllime terroriste etj.¹⁶² Vendi ynë ka përmbushur të gjitha detyrimet për përafrimin e legjislacionit në lidhje me përafrimin e legjislacionit të pjesës së përgjithshme të KP.

Kështu vendi ynë ka riformuluar nenin 36 KP me anë të ligjit 9086 dt. 19.6.2003 në përputhje të plotë me vendimet-kuadër të 26 Qershorit 2001 mbi identifikimin, gjetjen, bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin si dhe të 24 Shkurtit 2005 mbi konfiskimin.

Po kështu, është në përputhje të plotë me vendimet-kuadër dhe ligji për inkrimimin nr. 9686 dt. 26.02.2007 dhe përvetësimin e parave ose mallrave të vjedhur.¹⁶³ Në lidhje me regjimin e provës dhe dënimet zëvendësuese ligjvënësi ynë ka ndryshuar të gjithë kapitullin VII të pjesës së përgjithshme të KP në përputhje me vendimin-kuadër të 27 Nëntorit 2008, ku parashikohen

¹⁶⁰Shih A.Laquieze "Pour une histoire de l'dee d' Etats-Unis d' Europe »2007,

¹⁶¹Shih MSA-Iva Zajmi, alb PAPER, 2009, fq. 17 " Kuadri i përgjithshëm i MSA-së përbëhet nga katër shtylla ku futen: 1- dialogu politik dhe bashkëpunimi rajonal, 2-dispozitat tregtare lidhur me liberalizimin progresiv të këmbimeve deri në vendosjen e një zone tregtie të lirë, 3-liritë komunitare dhe 4-bashkëpunimi në fushat prioritare (në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme).

¹⁶²Shih *Altin Shegani*, Zhvillimet Evropiane në të drejtën penale, Konferenca Shkencore Sfidat e shoqërisë shqiptare në procesin e integritetit evropian, alb PAPER, 2009, fq. 415 e në vijim.

¹⁶³Shih nenin 248 paragrafi b të Kodit Penal

alternativat e dënimit me burgim. Janë krijuar amendimet e Kodit Penal të cilat do të konsiderohen si një risi në të drejtën penale, jo vetëm për faktin se përbëjnë një përmbushje të detyrimeve për përafrimin e legjislacionit, por edhe sepse përbëjnë një reflektim të mendimit juridik shqiptar me mendimet bashkëkohore evropiane dhe më gjerë në fushën penale.

Ka ndryshuar mënyra e përdorimit të sanksioneve penale, duke u shfaqur me tendenca gjithnjë e në rritje në lidhje me përdorimin sa më të gjerë të mënyrave alternative, ashtu si edhe në të gjitha vendet me një demokraci të zhvilluar dhe liberale, ku mënyra e përdorimit të sanksioneve penale në një farë mënyre konsiderohet “barometër” për të treguar shkallën e zhvillimit të demokracisë.

Me ndryshimet e ndodhura në vitin 2008, janë bërë ndryshime të tjera si : heqja e dënimit të copëzuar dhe janë shtuar alternativa të reja për të zëvendësuar dënimin me burgim.¹⁶⁴ Neni 67 i KP është gjithashtu në përputhje të plotë me Konventën mbi pamundësinë e parashkrimit të krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës.

Në kuadrin e përafrimit të legjislacionit penal, janë bërë një sërë ndryshimesh edhe në pjesën e posaçme të Kodit Penal. Kështu kemi miratimin e ligjit 10023 datë 27.11.2008 me të cilin janë ndryshuar disa nene të rëndësishme të Kodit Penal.¹⁶⁵ Këto vepra penale janë në përputhje të plotë me projekt vendimin-kuadër të këshillit të datës 11 Korrik 2007 në lidhje me luftën me anë të së drejtës penale kundër disa formave dhe shfaqjeve të racizmit dhe ksenofobisë. Po kështu, bazuar në vendimin kuadër, ku pasqyrohet edhe detyrimi për të parashikuar si rrethanë rënduese rastin kur vepra të tjera penale kryhen për motive raciste dhe ksenofobe, ligjvënësi ynë e ka parashikuar këtë detyrim në ligjin 9686 datë 26.2.2007.¹⁶⁶ Me anë të këtij ligji, ligjvënësi ka riformuluar nenin 86 KP ku parashikohet vepra penale e torturës,

¹⁶⁴Shih nenet 58 dhe 59 paragrafi a të Kodit Penal

¹⁶⁵Shih nenet për shpërndarjen kompjuterike të materialeve pro genocidit ose krimeve kundër njerëzimit (neni 74/a), kanosjen me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 84/a), shpërndarjen e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 119/a), fyerjen me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 119/b) të Kodit Penal

¹⁶⁶Shih neni 50 të Kodit Penal

ndryshim i cili nuk konsiderohet shumë pozitiv nga ana e studiuesve të ligjit pasi dhe vetë nocioni që jep Konventa kundër torturës në lidhje me kuptimin e veprës penale të torturës, përbën një standard minimal duke lejuar legjislacionet e brendshme të kenë dispozita të karakterit me të gjerë. Gjatë riformulimit të torturës janë bërë edhe gabime teknike, në rastin kur në listën e qëllimeve është shtuar edhe çdo akt tjetër ç’ njerëzor apo poshtërues.

Në përputhje me detyrimet e vendosura nëpërmjet Konventës Penale mbi korrupsionin të vitit 1999, protokollin e saj shtesë si dhe vendimit-kuadër të 22 Korrikut 2003 në lidhje me luftën kundër korrupsionit në sektorin privat ligjvënësi ynë penal, nëpërmjet ligjit 9275 datë 16.9.2004, ka inkriminuar korrupsionin aktiv si dhe korrupsionin pasiv në sektorin privat. Me ligjin 9275 datë 16.9.2004 kanë ndodhur edhe ndryshime të tjera në pjesën e posaçme të KP dhe më konkretisht është riformuluar dhe është ndryshuar titulli i disa neneve.¹⁶⁷ Gjithashtu, me anë të ligjit 9275 datë 16.9.2004, ligjvënësi ka inkriminuar edhe dy vepra të cilat janë : *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave me funksion publik”* (neni 245/1 KP) si dhe *“Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”*.

Me anë të ligjit 9275 datë 16.9.2004, ka pasur një rikonceptim të veprave penale të korrupsionit, ndryshim i cili nuk konsiderohet pozitiv për arsye sepse kemi një shmangie nga tradita e deritanishme që ka ndjekur doktrina jonë.¹⁶⁸ Në përputhje me Konventën kundër terrorizmit (2005) si dhe vendimin kuadër të 13 Qershorit 2002 mbi luftën kundër terrorizmit, ligjvënësi ynë e ka përshtatur legjislacionin e brendshëm duke e ristrukturuar totalisht, me anë të ligjit 9686 datë 26.2.2007, kreun VII të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjithashtu, në kuadrin e luftës së gjithanshme kundër terrorizmit, janë inkriminuar një sërë veprash si financimi i terrorizmit¹⁶⁹ fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin,¹⁷⁰

¹⁶⁷ Shih nenet 244, 245 KP, 259, 260, 312, 319 të Kodit Penal.

¹⁶⁸ Shih *Sokol Mëngjesi*, 2011, fq. 653.

¹⁶⁹ Shih nenin 230 paragrafi a të Kodit Penal.

¹⁷⁰ Shih nenin 230 paragrafi b të Kodit Penal.

dhënia e informacioneve që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit etj.

Nisur nga fakti që çdo shoqëri ka individualitetin e vet, edhe veprimet apo mosveprimet që për zgjedh për të ngritur në piedestalin e veprave penale, janë e drejtë ekskluzive e saj për të garantuar benefitet juridike të cilat i konsideron të një rëndësie të veçantë pa respektimin e të cilave nuk mund të sigurohet kjo bashkëjetesë harmonike. Për këtë arsye, e drejta penale mund të shihet vetëm si një produkt i brendshëm i pamundur të importojë vlera nga shoqëri të huaja. Por, mundet të themi se garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut arrihet me efikasitet maksimale vetëm nëse respektohet sistemi i drejtësisë penale të cilin ligjvënësi i një shteti e ka ngritur në bazë të traditave dhe kulturës së vet juridike.

Krimi në nivel ndërkombëtar mund dhe duhet të arrihet nëpërmjet ndihmës së ndërsjellët juridike, policore, gjyqësore etj., e cila gjithsesi futet në kuadrin procedural dhe në një farë mënyre lë të paprekur të drejtën penale materiale, e cila mjaftohet thjesht me përafrimin e legjislativave të brendshme në kuadrin e inkriminimit të formave të reja të kriminalitetit ndërkombëtar. Në kuadrin e përafrimit të legjislativave penal kombëtar ka rëndësi dhe teknika legislative, me anë të së cilës arrihet ndryshimi i kuadrit të legjislativave të brendshëm sepse disa herë ligjvënësit kombëtarë tregohen joelastik në përthithjen e direktivave dhe udhëzimeve apo në përmbushjen e detyrimeve të rrjedhura nga traktatet apo konventat ndërkombëtare duke bërë pjesë të legjislativave të brendshëm dispozitat e këtyre akteve “mutatis mutandis”. Kjo është një teknikë e gabuar dhe deri diku e rrezikshme, e cila gradualisht çon në disekuilibrin e sistemeve të brendshme. Detyrat që e kanë burimin në akte ndërkombëtare duhet të jenë tepër të studiuar, pra duhet të kalojnë më parë në analizën e pozicionimit të saktë brenda sistemit të brendshëm. Në këtë mënyrë rritet jo vetëm efikasiteti i dispozitivave në kuadrin e luftës së përbashkët ndaj krimit në nivel ndërkombëtar, por realizohet me garancitë që ofron sistemi i brendshëm ndaj abuzimeve me sanksionet penale, sepse dy misionet e të drejtës penale, siç i

kemi parashtruar edhe më sipër, në një shtet me demokraci të zhvilluar dhe liberale, jo vetëm që nuk kanë hierarki ndaj njeri-tjetrit por janë totalisht të baraz-vlefshëm dhe krejtësisht të ndërruarur midis tyre.

5.2.2. Bashkëpunimi gjyqësor dhe harmonizimi i procedurës penale dhe të drejtës penale në BE

E drejta evropiane penale ka përparësi në zbatim përkundrejt të drejtave kombëtare, por nuk mund të anashkaloj këto të fundit. Pra, përparësia e të drejtës komunitare në krahasim me atë kombëtare duhet të studiohet në varësi të situatave. Traktati i BE-së e trajton përafrimin e legjislacioneve penale në nenin 29, gërma (d) ku harmonizimi kur është i nevojshëm, i normave të së drejtës penale të shteteve anëtare, bëhet në zbatim të nenit 31, gërma (e).¹⁷¹

Me nocionin “harmonizim” nuk do të kuptohet eliminimi i çdo ndryshimi ndërmjet sistemeve kombëtare të shteteve anëtare, por jo vetëm rritjes së cilësisë dhe të koherencës ndërmjet këtyre sistemeve të së drejtës, duke synuar kështu një përafrim të sistemeve ligjore penale ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Pra, harmonizimi përfaqëson procesin e organizimit të instituteve të së drejtës penale e asaj procedurale penale në shtetet anëtare, në harmoni me një standard të paracaktuar nëpërmjet instrumenteve ligjore Evropiane në mënyrë që të shmangen sa më tepër të jetë e mundur ndryshimet ndërmjet *acqui communautaire* dhe legjislacionit kombëtar të shteteve anëtare. Shtetet, të cilat kanë prioritet të përafrimit e legjislacionit kombëtar me atë evropian, duhet të miratojnë një legjislacion penal, material dhe procedural, i cili duhet të jetë në harmoni me tekstin evropian. Pra, përafrimi i legjislacionit penal konsiston në përjasje të legjislacioneve dhe jo në një unifikim të tyre. Për pasojë,

¹⁷¹Shih nenin 31 gërma e të Traktatit të Bashkimit Evropian.

ekziston një bazë ligjore për realizimin e aktivitetit harmonizues, si në drejtim të dispozitave materiale, ashtu edhe atyre procedurale penale.¹⁷²

Bashkimi Evropian ka si objektiv të rëndësishëm t'i ofrojë qytetarëve një nivel të domosdoshëm mbrojtjeje, në një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie. Kështu, nevoja për harmonizimit të legjislacionit penal duhet , në mënyrë që autorët e veprave penale mos të kenë mundësinë të përfitojnë nga ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet sistemeve të ndryshme të së drejtës, dhe të shmangin kështu, forcën e ligjit.¹⁷³ Kur autorët e krimeve planifikojnë të kryerjen një krim në një vend dhe më pas largohen drejt një vendi tjetër, atëherë autoritetet gjyqësore hasin vështirësi në zgjedhjen e legjislacionit që duhet të aplikojnë. Në këto kushte vetëm harmonizimi i legjislacionit penal mundëson një bashkëpunim gjyqësor efektiv dhe efikas në fushën penale. Ekzaminimi i ndërsjellët i legjislacioneve të autoriteteve që bashkëpunojnë kërkon kohë të gjatë. Rregullimi i një sistemi harmonik dhe të qartë rregullash bëhet i domosdoshëm në kushtet kur, bazuar në një legjislacion penal kaotik në çdo Shtet anëtar, çdo individ i një shteti mund të ndalohet dhe dorëzohet në bazë të një Urdhri Evropian Ndalimi të lëshuar nga një shtet tjetër. Në këto kushte, zbatimi i parimit *nemo censurare ignorare lege*, (askush nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia penale për shkak të mosnjohjes së ligjit), do të ishte një aspiratë, por jo një realitet i mundshëm. Harmonizimi i legjislacionit penal dhe atij procedural shërben edhe si një garanci në drejtim të respektimit të të drejtave të personit nën hetim, i cili do të përfitonte nga të njëjtat standarte, pavarësisht nga shteti në të cilin hetohet apo kryhet dorëzimi. Në nenin 29 gërma d të Traktatit të BE-së parashikohet përafrimi i legjislacioneve penale i cili synon harmonizimin, për sa ky është i nevojshëm, të normave të së drejtës penale të Shteteve anëtare. Pas miratimit të Traktatit të Amsterdimit, Këshilli Evropian ka zbatuar në drejtim të harmonizimit të legjislacionit penal një politikë më të gjerë. Kështu,

¹⁷²Artan Hoxha "Harmonizimi i legjislacionit penal në kuadrin e hapësirës Evropiane" Jus and Justicia ,Tiranë 2010. Fq 79

¹⁷³Jean Pradel, Geert Cortens, Gert Vermeulen "E drejta penale evropiane"2009.fq.607

aktualisht Komisioni Evropian ndërmerr vazhdimisht iniciativa për të intensifikuar procesin e harmonizimit të legjislacionit në fushën penale.

Harmonizimi i procedurës penale e gjejmë të sanksionuar në nenin 31 gërma (c) të Traktatit të BE-së, i cili parashikon: “*Veprimi i përbashkët në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në fushën penale, synon ndërmjet të tjerash: c) sigurimin, në masën që është e nevojshme për një bashkëpunim të tillë, të pajtueshmërisë së normave të zbatuara në shtetet anëtare*”. Pra, pajtueshmëria e normës së zbatueshme nënkupton përjasjen e procedurave penale të Shteteve anëtare.

Çdo procedurë penale duhet të përfaqësojë një ekuilibër ndërmjet efikasitetit nga njëra anë dhe respektimit të të drejtave të njeriut nga ana tjetër. Për rrjedhojë, përpjekjet nuk duhet të drejtohen vetëm kundrejt efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor, duke lënë mënjanë e duke mos llogaritur dimensionin e garancive procedurale. Kjo problematikë, ka gjetur përgjigje në Kartën e të Drejtave Themelore, në Nisë 2001¹⁷⁴. Standartet më të rëndësishëm në fushën e procedurës penale Evropiane janë: Vendimi i Këshillit që themelon Evrojust dhe Vendimi-Kuadër i datës 13 Qershor 2002 në lidhje me Urdhrin Evropian të Ndalimit. Evrojust është organizmi gjyqësor evropian : që bashkërendon të gjitha hetimet kundër formave të rënda të krimit të organizuar; që mund t’u japë shtysë hetimeve; që mund t’u kërkojë autoriteteve të çdo vendi të vlerësojnë mundësinë e krijimit të skuadrave hetimore të përbashkëta dhe të sigurojnë informacione të ndërsjella mes autoriteteve të përfshira në raste të veçanta.¹⁷⁵ UEN-ja shërben për të thjeshtuar ndjeshëm procedurat që brenda një kohe të shkurtër të mund të arrihet një nga rezultatet maksimale të bashkëpunimit gjyqësor. Konventa Evropiane për Ndhimën Gjyqësore në Fushën Penale ka disa risi që kanë nevojë për disa ndryshime në legjislacionet e brendshme

¹⁷⁴JOCE C 364/01, 18 dhjetor 2000. Karta ka një kapitull të emërtuar “Drejtësia”, neni 47 deri 50.

¹⁷⁵Artan Hoxha “Harmonizimi i legjislacionit penal në kuadrin e hapësirës Evropiane“ Jus and Justicia ,Tiranë 2010. Fq 77.

të shteteve anëtare. Kështu, Konventa ka aplikuar disa formalitete të reja për kërkesën e letërporosive si dërgimin spontan dhe të drejtpërdrejtë të informacioneve; transferimin e përkohshëm të personave të burgosur; krijimin e skuadrave hetimore të përbashkëta dhe përgjimet telefonike. Vendet e Bashkimit Evropian kanë filluar të kapërcejnë metodat tradicionale të bashkëpunimit mes shteteve të ndryshme, duke pranuar kështu se bashkëpunimi gjyqësor ndodh tashmë brenda një entiteti të ri, pra me mekanizma që pasqyrojnë këtë realitet të ndryshëm politik. Me qëllim realizimin e objektivës së fuqizimit të bashkëpunimit gjyqësor brenda BE-së, janë konfiguruar disa struktura që kontribuojnë në rritjen e efektivitetit të këtij bashkëpunimi si Evropoli, Rrjeti Gjyqësor Evropian etj.

Bazuar në Vendimin-kuadër Nr. 2002/584/JAI, parashikohet që janë pikërisht shtetet anëtare ato që kanë detyrimin që nëpërmjet legjislacionit të tyre të brendshëm të arrijnë një bashkëpunim më të mirë gjyqësor në çështjet penale duke përafuar legjislacionin e tyre me atë komunitar. Në këto kushte dhe vendi ynë nisur nga aspirata për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian, i takon të përzgjedhë instrumentin ligjor apo formën në të cilën do të kryhet ky proces. Këto norma juridike mund të përfshihen në kodin e procedurës penale sikurse ka ndodhur në sistemin francez të së drejtës¹⁷⁶, apo në një ligj të posaçëm, sikurse ka ndodhur në sistemin italian¹⁷⁷. Por, sa i përket teknikës legjislative në përgjithësi dhe veçanërisht hartimit të përmbajtjes së ligjit për zbatimin e urdhrin Evropian të Ndalimit, ligjvënësi shqiptar do të bazohet fillimisht në dispozitat e Vendimit kuadër, i cili ka elementët proceduralë bazë mbi të cilat mbështetet ky instrument ligjor. Nga ana tjetër, një rëndësi e veçantë do t'u kushtohet dispozitave të kodit të procedurës penale, i cili përfaqëson kuadrin ligjor ku parashikohen parimet të cilave i nënshtrohet procesi penal dhe për pasojë, duhen evidentuar ato elementë të

¹⁷⁶Shih *Vasilika Hysi*, Politika penale shqiptare në fushën e veprave penale të korrupsionit, Studime Juridike 1, 2007, fq. 31 e në vijim.

¹⁷⁷Shih *Shpëtim Kurti*, Metodologjia dhe teknikat e pastrimit të parave, Studime Juridike 2,2007, fq. 172 e në vijim.

cilët do t'i nënshtrohen në vazhdimësi këtij rregullimi apo do të përfitojnë nga një rregullim i posaçëm.

5.3. Urdhri Evropian i Ndalimit

Në fushën penale sistemi i bashkëpunimit ndërkombëtar përbehet si nga normat penale të legjisllacionit të brendshëm ashtu dhe nga norma penale mbikombëtare, që veprojnë në këtë fushë ,ku të fundit kanë rëndësi të madhe në dobësimin e parimit të sovranitetit. Kështu, në fushën penale janë krijuar disa akte të karakterit rajonal dhe ndërkombëtar, të cilat do të ndihmojnë në këtë drejtim. Aktualisht forma më e lartë e bashkëpunimit ndërkombëtar rajonal që sot aplikohet në BE është Urdhëri evropian i ndalimit (UEN).

UEN u krijua për të zgjidhur problematikën e ekstradimit të shtetasve me qëllim që të thjeshtonin procedurën klasike të ekstradimit mes shteteve anëtare. Kështu që ideja evropiane për një procedure më të thjeshtë e efikase në luftën kundër krimit ndërkufitar, organizatave kriminale dhe terrorizmit filloi të konkretizohej fillimisht me parimin e njohjes reciproke të vendimeve, si një parim themelor i cili duhet të udhëheqë bashkëpunimin evropian në fushën gjyqësore (penale). Më vonë u vendos zëvendësimi i procedurave formale të ekstradimit me një sistem më efikas dhe më të shpejtë të dorëzimit të personit të kërkuar, ku si bazë ligjore shërbeu Traktati i Amsterdimit¹⁷⁸. Pra, Evropa synonte të krijonte një hapësirë gjyqësore të përbashkët, në të cilën qytetarët evropianë t'i drejtohen organeve të drejtësisë së një shteti anëtar, njësoj si shtetit të vet. Në këtë mënyrë do të eliminohet mundësia që autorët e veprave penale të mos përfitojnë nga divergjencat që ekzistojnë ndërmjet sistemeve ligjore në vendet

¹⁷⁸Shih <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/urdheri-evropian-i-ndalimit-valbona-ndrepepaj.html#B3Svsjdpfd3rIpLk.99>.

evropiane dhe të vihen para drejtësisë. Kështu, gjatë këtij takimi u pa e nevojshme dhe emergjente një njohje reciproke e vendimeve gjyqësore penale, të cilat pra duheshin ekzekutuar jo vetëm në shtetin anëtar në të cilin qenë dhënë, por dhe në territorin e një shteti tjetër anëtar, duke e bërë të panevojshëm zbatimin e rregullave klasike të ekstradimit, të cilat donin një kohë të gjatë dhe kontroll solemn.

Nisur nga fakti që terrorizmi përfaqëson një shqetësim të vërtetë për Evropën, për gjithë njerëzimin dhe lufta kundër tij duhej shndërruar në një prioritet të BE-së, ishte e nevojshme që të bëheshin ndryshime të mëdha në këtë drejtim jo vetëm në legjislacionet e brendshme të shteteve anëtare por dhe në vete *aquis communautaire*. Në këto kushte, Këshilli vendosi të thjeshtojë procedurën e ekstradimit dhe për pasojë të lehtësojë dorëzimin e një personi, i cili pasi ka kryer një vepër penale në territorin e një shteti anëtar apo është dënuar përpiqet të shmangët ndjekjes penale apo dënimit ,duke u fshehur në territorin e një shteti tjetër anëtar duke miratuar UEN në vitin 2002.

UEN-ja është stadi më i lartë i bashkëpunimit në fushën penale ndërmjet shteteve evropiane, i cili u miratua më anë te Vendimit–kuadër nr. 584, të datës 13 qershor 2002. Urdhëri zëvendëson procedurën klasike të Ekstradimit në shtetet anëtare të BE-së, me përjashtim të rasteve kur disa shtete anëtare kanë deklaruar që do të vazhdojnë të zbatojnë konventat e Ekstradimit. Në këtë moment procedura e Ekstradimit u zëvendësua më një procedure më të thjeshtë të ngjashme më procedurën e arrestit që aplikohet nga autoritetet përkatëse në një vend anëtar. Kështu, duke filluar nga 1 janari 2004, ndërmjet shteteve anëtare të BE-së nuk zbatohen më marrëveshjet dypalëshe apo shumëpalëshe ndërkombëtare të Ekstradimit por funksionon UEN-ja.

UEN-ja është një vendim gjyqësor i dhënë nga një shtet anëtar që materializohet nëpërmjet ndalimit dhe dorëzimit të një personi të kërkuar më qëllim :

- a) Realizimin e ndjekjes penale
- b) Ekzekutimin e një dënimi penal
- c) Ekzekutimin e një urdhër arresti.

UEN-ja realizohet nëpërmjet një kërkesë të bërë nga autoriteti gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së me qëllim ndalimin dhe dorëzimin e një personi të kërkuar që gjendet në një shtet tjetër anëtar. Në këto kushte autoritetet gjyqësore të shtetit pritës të kërkesës janë të detyruar të njohin vendimin e dhënë nga autoriteti gjyqësor i shtetit që ka lëshuar urdhrin dhe të dorëzojnë personin e kërkuar. Në nenin 1 paragrafi e parashikon që shtetet anëtare “do të ekzekutojnë çdo urdhër evropian ndalimi”, ndërsa në nenin 2 parashikohen rastet kur autoriteti gjyqësor kompetent lëshon UEN.¹⁷⁹ Urdhëri Evropian i Ndalimit duhet të përmbajë informacion mbi identitetin dhe shtetësinë e personit të kërkuar, autoritetin lëshues gjyqësor, vendimin e gjykimit përfundimtar, karakterin e fakteve të kryera dhe cilësimin juridik të tyre, përshkrimin e rrethanave në të cilën ka ndodhur vepra, natyrën e veprës penale etj, sipas një formulari tip të miratuar të përcaktuar në vendim,¹⁸⁰ dhe i dërgohet autoritetit gjyqësor në territorin e të cilit ndodhet personi i kërkuar direkt me çdo mjet të sigurt, ose nëpërmjet Sistemit Informativ Schengen (SIS), nëpërmjet Rrjetit Gjyqësor Evropian EVROJUST, apo zyrave të Interpolit.¹⁸¹

Në momentin kur shteti tjetër merr kërkesën për UEN-në dhe dorëzimin e personit të kërkuar, vendimi kuadër parashikon plotësimin e disa kushteve që duhet të përmbushën për dorëzimin e personit të kërkuar. Kushtet ndahen në fakultative, ekzistenca e të cilave çon në aplikimin e UEN-së dhe kushtet detyrueshme prezenca e të cilave bënë që shteti të refuzojë kërkesën e

¹⁷⁹Shih nenin 2 të Vendimit Kuadër të UEN-së ku përcaktohet se “Për kryerjen e ndjekjes penale apo gjykimit, nëse vepra penale ndëshkohet nga ligji i shtetit lëshues me heqje lirie së paku 1ë muaj, Për ekzekutimin e një mase sigurimi me heqje lirie më shumë se 4 muaj, Për ekzekutimin e një dënimi, të formës së prere, është më i lartë se 4 muaj. për vepra penale të dënueshme me burgim ose të një urdhër-arrest për një periudhë maksimale prej të paktën një viti.”

¹⁸⁰Neni 8 i Vendimit Kuadër për UEN.

¹⁸¹Council Framework Decision [2002/584/JHA](#) of 13 June 2002 on the European Arrest Warrant, **General principles.**

UEN-së.¹⁸² Si kushte negative ose të detyrueshme, pa të cilat do të refuzohej UEN-ja, janë përcaktuar parimi *ne bis in idem*, nominimi i veprës penale në vendin e ekzekutimit të UEN-së dhe mungesa e përgjegjësisë penale për shkak të moshës, sipas ligjit të vendit të ekzekutimit. Kushtet fakultative i nënshtrohen vlerësimit të lirë të gjyqtarit që ka çështjen në ngarkim në varësi të bindjes së tij të brendshme.¹⁸³ Arrestimi i personit të kërkuar në bazë të UEN-së duhet të realizohet sipas garancive të parashikuara në kodin e procedurës penale të vendit të ekzekutimit. Gjykata kompetente që merr UEN verifikon paraprakisht legjitimitetin e kërkesës pastaj verifikon nëse përmbushen kushtet formale për të përmbushur UEN-në.

5.3.1. Dallimi midis UEN-së dhe ekstradimit

UEN është vazhdim dhe përsosje e ekstradimit. UEN-ja dhe kuadri ligjor i ekstradimit kanë thelb dhe qëllim të njëjtë, por ndryshojnë në formë, ku kjo e fundit ka ndikuar në pozitivisht në suksesin e UEN-së në krahasim me ekstradimin. Kështu, UEN-ja dhe ekstradimi ndryshojnë në kushtet e tyre dhe procedurat. Pra, UEN-ja ka reduktuar ndjeshëm numrin e kushteve të detyrueshme duke e çuar atë nga 10 në tre, fakt ky që ndikon në përshtetimin e procedurave më vonë. UEN-ja nuk përfshinë në kushtet fakultative motivet politike, apo veprat penale që kryhen nga ushtarakët. Është realizuar eliminimi i fazës administrative, duke bërë që autoriteti qendror të informohet thjesht për korrektesë.

Nëse në procedurën e ekstradimit procedura administrative zhvillohet nga autoriteti qendror i Ministrisë së Drejtësisë e cila verifikon nëse dokumentacioni i dërguar plotëson ose

¹⁸²Shih nenet 3 dhe 4 Vendimit Kuadër të UEN-se.

¹⁸³Kushtet fakultative janë “kushti i fajësimit të dyfishtë,më perjashtim të veprave penale në fushën e tatimeve,taksave,doganave e këmbimeve valutore, Personi është duke ju nënshtuar një procedure penale në vendin e ekzekutimit të UEN_së ,për të njejtin fakt objekt i UEN_së. Personi është gjykuar me vendim të formës së prerë nga një vend jo anëtar i BE_së5, UEN_ja përfshin vepra penale ,të cilat sipas ligjit të shtetit të ekzekutimit,janë kryer në territorin e këtij shteti,Sipas ligjit të shtetit të ekzekutimit fakti objekt i UEN_së është parashkruar,etj.”

jo kushtet e parashikuara në Konventën Evropiane për Ekstradimet, me UEN-në procedura e ekzekutimit të saj dhe e dorëzimit të personit të kërkuar është kompetencë e autoriteteve gjyqësore, të cilat bëjnë vlerësimin paraprak të legjitimitetit të UEN, duke eliminuar filtrin e ushtruar nga autoriteti politik.¹⁸⁴ Eliminimi i procedurës me dy etapa si ajo e ekstradimit ka bërë që UEN të ketë sukses në këtë drejtim. Dokumentet për ekstradim në rastin e ndalimit të një personi të kërkuar i dërgohen autoriteteve gjyqësore të shtetit të ekzekutimit në rrugë diplomatike brenda 40 ditësh, ndërsa në rastet kur aplikohet UEN, ky urdhër dërgohet brenda 48 orësh. Vendimin për shqyrtimin e kërkesës për ekstradim e ka çdo gjykatë në territorin e së cilës është arrestuar subjekti, ndërsa lidhur me UEN, si rregull këtë të drejtë e kanë gjykatat e Apelit në juridiksionin e së cilës është gjendur personi i kërkuar, por kjo varet nga përcaktimi i parashikuar në legjislacionin e brendshëm të shteteve anëtare. Vendimi kuadër për UEN parashikon procedurë të përsheptuar në rastet ku personi ndaj të cilin është lëshuar ky urdhër jep pëlqimin e tij për dorëzim, dhe brenda 10 ditësh¹⁸⁵ nga momenti kur vendimi ka marr formë të prerë, personi duhet t'i dorëzohet autoriteteve të shtetit që e kërkon. Ndërsa në rastet e një procedure normale dorëzimi i personit duhet të bëhet brenda 60 ditëve. Një procedurë e tillë nuk parashikohet në rastet e ekstradimit.

Fajësimi i dyfishtë është kusht i detyrueshëm në rastet e ekstradimit, pra vepra penale për të cilin kërkohet ekstradimi të parashikohet si në vendin kërkues edhe në atë ekzekutues, ndërsa në rastet e UEN parashikohet dorëzimi i menjëhershëm për veprat penale të cilat parashikojnë dënim me 3 vjet burgim, pa qenë i nevojshëm verifikimi i fajësimit të dyfishtë në legjislacionin e brendshëm të shteteve anëtare.¹⁸⁶ Në nenin 3 paragrafi 1 të Konventës Evropiane “Për ekstradimin”, parashikohet refuzimi i ekstradimit në rastet se vepra penale për të cilin është kërkuar ekstradimi konsiderohet si shkelje politike, ndërsa në Vendimin Kuadër

¹⁸⁴Shih Artan Hoxha, “Ekstradimi dhe Urdhëri Evropian i Ndalimit”, shtëpia botuese Morava, Tiranë 2011, faqe 211.

¹⁸⁵Shih Neni 13 i Vendimit Kuadër për UEN.

¹⁸⁶Shih nenin 2, paragrafi i dytë i Vendimit Kuadër.

për UEN nuk parashikohet refuzimi i dorëzimit të personit për vepra të karakterit politik dhe ushtarak. Në lidhje me animimin e vendimit në Gjykatën e Apelit UEN-ja parashikon afatin 48 orësh, dhe për rekurs në Gjykatën e Lartë afati është brenda 5 ditësh, dhe Gjykata e Lartë duhet të shprehet brenda 3 ditësh nga data që depozitohet kërkesa. Në rastet e konkurrimit të kërkesës së ekstradimit dhe të UEN-së atëherë gjykata kompetente gëzon të drejtën të vendos se cilit shtet do t'i dorëzoj personin e kërkuar, ndërsa në rast se kërkesa për ekstradim vjen nga Gjykata Ndërkombëtare Penale, kjo e fundit ka përparësi¹⁸⁷.

Dorëzimi i përkohshëm i personit nuk parashikohet në procedurat e ekstradimit, ndërsa sipas vendimit Kuadër parashikohet dorëzimi i përkohshëm i personit para se vendimi i ekzekutimit të UEN-së të ketë marrë formë të prerë, me qëllim për të dhënë deklaramë para organeve gjyqësore që kanë lëshuar UEN, dhe rikthimin për t'iu nënshtruar procedurave gjyqësore për ekzekutim. Vendimi kuadër për UEN ka shfuqizuar parimin e shtetësisë, në ndryshim nga procedura e ekstradimit, e cila parashikon refuzimin e ekstradimit në rastet kur subjekti i kërkuar është shtetas i palës së kërkuar dhe shtetet nuk kanë marrëveshje dypalëshe ekstradimi ndërmjet tyre. Një kufizim i tillë parashikohet edhe nenin 491¹⁸⁸ të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë.

5.3.2. Diskutime aktuale mbi Implementimin e Urdhërit Evropian të Ndalimit në legjislacionin tonë kombëtar.

Aktualisht nisur nga fakti që vendi ynë aspiroon aderimin në BE, është duke punuar intensivisht për të përafuar legjislacionin kombëtar me atë evropian. Me hartimin e MSA-së

¹⁸⁷Shih, Neni 16, paragrafi i katërt i Vendimit Kuadër.

¹⁸⁸Shih Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2009. Neni 491- Mospranimi i kërkesës për ekstradim, pika 1, paragrafi "f", parashikon se: "Nuk mund të jepet ekstradimi kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikoj ndryshe".

vendi ynë ka bërë hapa konkretë në përafrimin e legjislacionit me *aquis communautaire* në përgjithësi e atij penal në veçanti. Kështu, shteti shqiptar ka ratifikuar një sërë konventash të cilat kanë bërë të mundur që dispozitat e Kodit penal dhe procedural penal që parashikojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale të jenë në sinkron me *aquis communautaire*. Në këtë legjislacion duhet përfshirë instrumenti i Urdhërit Evropian të Ndalimit, i cili ka si objektiv zëvendësimin e procedurave të ekstradimit me procedurën e thjeshtëzuar të ndalimit dhe të dorëzimit të personit të kërkuar që ndodhet në hapësirën e përbashkët.¹⁸⁹ Vendimi-Kuadër 2002/584/JAI i Këshillit të BE-së, i 13 Qershorit 2002 që ka për objekt lëshimin dhe ekzekutimin e Urdhërit Evropian të Ndalimit, nuk zbatohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ndaj pas aderimit të Shqipërisë në BE nuk pritet një “*dorëzim automatik*” i personave që i kërkohen, apo sipas rastit, që do të kërkohen nga Shqipëria, por duhet që më parë Shqipëria të implementojë këtë vendim-kuadër në legjislacionin e saj të brendshëm. Zëvendësimi ndërmjet konventave të Këshillit të Evropës dhe normave juridike të BE-së, do të funksionojë ekskluzivisht në marrëdhëniet e bashkëpunimit penal ndërmjet shteteve anëtare, ndërkohë që ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera jo anëtare të BE-së do të vazhdojë të zbatohet procedura klasike e ekstradimit, ashtu sikurse kjo rregullohet nga konventat e Këshillit të Evropës.¹⁹⁰

Në nenin 11 të Kodit Penal, parashikohet sikurse neni 39 paragrafi i dytë i Kushtetutës se “*Ekstradimi nuk do të lejohet në qoftë se personi që do të ekstradohet është shtetas shqiptar, veç rasteve kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe*”. Hartimi i UEN-së ka bërë që shtetet anëtare nuk mund të refuzojnë dorëzimin e të akuzuarit apo dënuarit me motivin se personi ka shtetësinë eventit të ekzekutimit të Urdhërit Evropian të Ndalimit. Në këtë kontekst evropian, edhe ligjvënësit shqiptar i duhet të pranojë se vendimi-kuadër që rregullon Urdhërin

¹⁸⁹ Shih <http://juridiksi.e-monsite.com/faqe/e-drejta-penale/urdhëri-evropian-i-ndalimit-valbona-ndrepepaj.html>

¹⁹⁰ Artan Hoxha “Harmonizimi i legjislacionit penal në kuadrin e hapësirës Evropiane” Jus and Justicia ,Tiranë 2010. Fq 77.

Evropian të Ndalimit ka shfuqizuar parimin e shtetësisë. Megjithatë, ligji shqiptar mund ta përfshijë objeksionin e shtetësisë shqiptare të personit të kërkuar ndër motivet fakultative për refuzimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ndalimit, në zbatim të nenit 5 paragrafi i tretë i vendimit -kuadër, i cili e parashikon këtë mundësi të kushtëzuar nga disa premisa. Kështu, kur ky urdhër është lëshuar me qëllimin e kryerjes së ndjekjes penale, gjykata mund të kushtëzojë dorëzimin me faktin që personi i kërkuar të kthehet në Shqipëri për të ekzekutuar dënimin që eventualisht do të jepet kundër tij.

Në të kundërt, kur UEN është lëshuar për ekzekutimin e dënimit të një shtetasi shqiptar, ligjvënësi duhet të mbajë parasysh "*objeksionin e nacionalitetit*" dhe në ato raste kur dënimi është i pajtueshëm me legjislacionin shqiptar dhe autoritetet kompetente shqiptare marrin përsipër të vënë në ekzekutim këtë vendim, gjykata mund të refuzojë dorëzimin e shtetasit shqiptar. Në çdo rast, ekzekutimi i dënimit në vendin e origjinës do të bëhet me pëlqimin e shteteve anëtare që ka lëshuar Urdhërin e Ndalimit.

5.4. Progres- Raportet e Shqipërisë ndër vite në kuadër të procesit të integrimit.

Procesi i integrimit i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një proces i gjatë i cili kërkon përmbushjen e disa kritereve të domosdoshme për integrimin. Procesi i integrimit është në një moment tejet të rëndësishëm që dikton konkretizim në përmbushjen e detyrimeve të vendosura. Një ndër hapat më të rëndësishëm të cilat duhet të realizohen nga vendi ynë për të pasur akses në BE është dhe përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë evropian.¹⁹¹

Procesi i përafrimit të legjislacionit përfshin : implementimin e dispozitave të legjislacionit evropian në legjislacionin kombëtar, zbatimin në praktike të këtyre dispozitave

¹⁹¹E Canaj, *E drejta e Bashkimit Evropian*. Tiranë 2011.

nga autoritetet kombëtare publike kompetente dhe garantimi i zbatimit në praktikë të legjislacionit evropian nëpërmjet gjykatës apo dhe agjensive të tjera zbatuese ligjore. Në legjislacionin e brendshëm përveç MSA-së, procesi i përfarimit të legjislacionit në Shqipëri realizohet duke u bazuar në:

1. Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 486, date 25.07.2012 mbi miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-s (2012-2015) dhe përcaktimin e përgjegjësiave institucionale për përafrimin në legjislacionin shqiptar të çdo akti të Bashkimit Evropian i cili përditësohet çdo vit.
2. Vendimin Nr 201 datë 29.3.2006 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 584, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”.
3. Vendim Nr.4 data 7.1.2009 një shtesë në vendimin Nr.584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

Detyrimi dhe angazhimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë evropian sanksionohet në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Sipas këtij neni, Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me legjislacionin evropian, por njëkohësisht duhet të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet. Bashkëpunimi në çështjet penale sanksionohet në nenin 85 të MSA-së, i cili i nxi palët që të bashkëpunojnë në luftën dhe parandalimin e veprimtarive kriminale si dhe nxiti bashkëpunimin rajonal dhe respektimin e standardeve të njohura ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar.¹⁹²

Procesi i përafrimit të legjislacionit monitorohet periodikisht nga ana e Bashkimit Evropian në lidhje me progresin që bën vendi për të plotësuar detyrimet e vendosura nga MSA-ja.

¹⁹²Shih nenin 85 të MSA-së.

Komisioni i raporton rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin e bërë nga vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor drejt integrimit evropian, duke vlerësuar përpjekjet e tyre për të përmbushur kriteret e Kopenhagenit dhe kushtëzimet e Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit.¹⁹³

Kështu, çdo vit Komisioni Evropian¹⁹⁴ monitoron progresin e bërë nga ana e vendit tonë në lidhje me masat e marra që janë bërë për përafrimin e legjislacionit të detyrimeve të tjera që përcaktohen në MSA. Në progres-raportin e datës 16.10.2013, është pasqyruar procesi i integrimit dhe strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore për periudhën 2013-2014. Ky raport mbulon periudhën nga Tetori i 2012-ës deri në Shtator të 2013-ës. Progresi matet mbi bazën e vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar dhe masave të zbatuara. Si rregull, legjislacioni apo masat që janë në fazat e përgatitjes ose që presin miratimin e parlamentit, nuk merren parasysh. Kjo përjasje garanton trajtim të barabartë në të gjitha raportet dhe mundëson vlerësim objektiv.

Në lidhje me luftën ndaj krimit të organizuar progres-raporti thekson se është miratuar një strategji e re dhe plani i veprimit mbi krimin e organizuar. Është forcuar bashkëpunimi me policinë ndërkombëtare. Ndryshimet në Kodin Penal kanë adresuar çështjen e trafikimit të brendshëm të qenieve njerëzore dhe kanë përfshirë kriminalizimin e përdorimit të shërbimeve të viktimave të trafikimit. Krimi i organizuar mbetet një shqetësim serioz dhe nevojiten përpjekje të mëtjshme të rëndësishme për të përmirësuar vijimësinë e të dhënave të Shqipërisë. Mbeten në pritje ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale.

Në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale në këtë progres rapor është theksuar se ka nisur zbatimin e Protokollit të Tretë Shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimin. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Austrinë dhe Mbretërinë e

¹⁹³Shih progres- raportin e datës 16.10.2013

¹⁹⁴E Canaj, *E drejta e Bshkimit Evropian*. Tiranë 2011.

Bashkuar. Përgatitjet për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi me Evrojust-in nuk kanë përparuar, por legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale është në fazë rishikimi. Përparim është bërë në fushën e bashkëpunimit policor dhe luftës kundër krimit të organizuar, një nga prioritetet kyçe të Opinionit të KE-së. Bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë ka vazhduar të japë rezultate të mira për sa i përket operacioneve policore, arrestimeve dhe bashkëpunimit në hetime dhe gjithashtu bashkëpunimin kundër pasurisë nga krimi. Policia shqiptare dhe Prokuroria e kanë rritur bashkëpunimin, edhe në lidhje me shërbimet e inteligjencës penale. Megjithatë, krimi i organizuar vazhdon të jetë shqetësim serioz në Shqipëri. Vazhdojnë problemet në zbatim të ligjit “Antimafia”, sidomos në lidhje me konfiskimin e pasurisë. Në Maj është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me CEPOL-in. Në selinë e Evropol-it është caktuar një oficer ndërlidhës shqiptar përgjegjës për mbajtjen e kontakteve ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Evropol-it me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit.

Në progres-raportin e datës 4.6.2014 trajtohet progresi i Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe në reformën në gjyqësor. Në këtë progres raport Komisioni shprehet se në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar policor dhe gjyqësor është ratifikuar Protokollin e Katërt Shtesë të Konventës Evropiane për Ekstraditimin. Në total, 25 komisione-rogatore kanë mbërritur në Shqipëri nga Shtetet Anëtare të BE-së nga Tetori i 2013-ës deri në fund të Prillit të 2014-ës. Në të njëjtën periudhë, 34 persona janë ekstraduar nga Shtetet Anëtare të BE-së, ndërsa autoritetet shqiptare ekstraduan 49 persona drejt shteteve anëtare të BE-së. Në Dhjetor, Shqipëria nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi operacional me Evropol-in, që u ratifikua më 20 Mars. Shkëmbimi i informacioneve lehtësohet nga vendosja e një oficeri ndërlidhës shqiptar pranë Evropol-it. Gjatë periudhës raportuese, Shqipëria mori pjesë në një operacion ndërkombëtar, policor me mbështetjen e Evropol-it, për zbulimin e automjeteve të vjedhura dhe të trafikuar; si rezultat, u ndoqën penalisht 24 autorë. Autoritetet

duhet të përdorin në mënyrë më aktive të gjitha mjetet në dispozicion për bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe të rrisin dislokimin e ekipeve të përbashkëta hetimore. Kapacitetet për të përdorur teknikat speciale të hetimit duhet të forcohen përmes forcimit të kuadrit ligjor dhe procedural.

Po kështu, në progres-raportin e datës 8.10.2014 është përcaktuar se në luftën kundër krimit të organizuar janë miratuar një sërë nismash legislative për reformimin e policisë dhe ngritjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Bashkëpunimi ndërkombëtar policor dhe gjyqësor është rritur përmes zbatimit të marrëveshjeve të ekstradimit. Shqipëria ka ratifikuar një marrëveshje operacionale me Evropol-in dhe ka filluar zbatimin e saj. Hetimet financiare, sekustrimet dhe konfiskimet e pasurisë janë shtuar. Mekanizmi kombëtar i referimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore është përmirësuar dhe është forcuar koordinimi i autoriteteve dhe aktorëve relevantë, përfshirë dhe nivelin vendor. Janë kapur më shumë sasi droge, dhe gjithashtu plani kombëtar për luftën ndaj kultivimit të *cannabis*-it është zbatuar me rezultate pozitive.¹⁹⁵

Në progres raportin e vitit 2015 Komisioni vlerëson faktin që Shqipëria është palë në Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit dhe që do të ndjek dispozitat e kësaj konventë në luftën kundër korrupsionit. Progres-raporti evidenton faktin që vendi ka nënshkruar dhe ratifikuar konventat përkatëse të Këshillit të Evropës për luftën kundër korrupsionit dhe Konventën e OECD-së për luftën kundër korrupsionit të nëpunësve publikë të huaj në transaksionet e biznesit ndërkombëtar. Shqipëria ka ende punë për të përafuar plotësisht kuadrin e saj ligjor me rekomandimet e bëra nga seancat e vlerësimit të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit.¹⁹⁶ Shqipëria ka mbajtur një bashkëpunim të mirë gjyqësor në çështjet civile dhe penale, përfshirë me shtetet anëtare të BE-së. Megjithatë bashkëpunimet ndërkombëtare kanë nevojë të përmirësohen bazuar në zbatimin në kohë të instrumenteve

¹⁹⁵Për analizë të hollësishme mbi zhvillimet në luftën kundër krimit të organizuar, shih Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

¹⁹⁶Shih progress raportin 2015, fq.17

shumëpalësh dhe kapacitetit më të madh institucional. Nevojitet përpjekje të mëtejshme për rritjen e bashkëpunimit me Evrojust. Vlerësimi i standardeve të mbrojtjes së të dhënave nga Eurojust vazhdon.

KAPITULLI VI: PROCEDURA E EKSTRADIMIT

6.1. Kushtet e ekstradimit

Kushtet e ekstradimit të parashikuar në Konventën Evropiane të Ekstradimit janë shumë të rëndësishme dhe luajnë një rol kryesor duke përbërë bazën për procedimin e ekstradimit. Këto kushte janë përthithur dhe implementuar në legjislacionin tonë të brendshëm, ku i gjejmë të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale.¹⁹⁷

Në nenin 490 të K.P.r.P janë përcaktuar kushtet e ekstradimit. Kështu lejohet:

1. “me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t’i dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi.”¹⁹⁸

Sipas këtij kushti, shteti kërkues duhet të garantojë se personi i ekstraduar : nuk do të procedohet, nuk do të dënohet e as nuk do të mbahet me qëllim për ekzekutimin e një vendimi dënimi ose mase sigurimi dhe as do t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera individuale për një vepër tjetër penale përveç asaj për të cilën jepet ekstradimi. Në këtë situatë gjendemi përpara një shkeljeje apo cënimi të një të drejte ndaj vetë personit që do të ekstradohet, duke dalë kështu jashtë rregullit të parashikuar nga Konventa për Ekstradim dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Pra, kur një person kërkohet të ekstradohet me akuzën e kryerjes së një vrasjeje të një shtetasi, por kohë më përpara se të ekstradohet të ketë kryer në po këtë shtet edhe veprën penale të plagosjes së lehtë dhe për këtë vepër nuk është kërkuar ekstradimi, atëherë në këto kushte

¹⁹⁷Shih Kodin e Procedurës Penale.

¹⁹⁸Shih nenin 490 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale.

ekstradimi duhet të lejohet vetëm nëse shteti kërkues jep garancinë që personi i kërkuar nuk do të procedohet për veprën e plagosjes së lehte por vetëm për atë të vrasjes.¹⁹⁹

2. Kur pala dorëzuese jep pëlqimin se i ekstraduari do të ndiqet edhe për veprën penale tjetër dhe për këtë i ekstraduari nuk ka kundërshtim.²⁰⁰

Në këtë rast, shteti kërkues i ekstradimit duhet të shoqëroje kërkesën për ekstradim edhe me një kërkesë të veçante për aplikimin e këtij përjashtimi. Po kështu, personi që do të ekstradohet duhet të japë pëlqimin e tij dhe më pas përgjigja e tij duhet t'i bashkëngjitet dosjes përkatëse.

3. Kur i ekstraduari edhe pse ka pasur mundësi nuk ka lënë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar, pasi kane kaluar 45 ditë nga lirimi i tij ose pasi e ka lënë atë është kthyer në mënyrë vullnetare.²⁰¹

Këto përjashtime kanë vlerë ligjore vetëm nëse :

- Personi i ekstraduar është i lirë nga detyrimi penal për të cilin ishte ekstraduar dhe është në gjendje të lirë.
- Personi i ekstraduar ka mundësi të lërë territorin e shtetit të cilit i është dorëzuar . Elementi i "mundësisë së largimit "vjen në zbatim të nenit 14 të Konventës për Ekstradim.
- Personi i ekstraduar me vullnetin e tij është kthyer përsëri në territorin e vendit ku ai ishte ekstraduar.

¹⁹⁹Dispozita e nenit 490 të Kodit të Procedure Penale Hoxha.A, Ekstradimi sipas instrumentave ligjorë të BE –se Ngjashmeritë dhe ndryshimet me instrumentat e Këshillit të Evropës , Tiranë 2010 fq 128-129 Konventa për Ekstradim neni 14 i saj.

²⁰⁰Shih nenin 490 paragrafi 2 pika a të Kodit të Procedurës Penale.

²⁰¹Shih nenin 490 paragrafi 2 pika a të Kodit të Procedurës Penale.

4. Rasti tjetër është kur Ministria e Drejtësisë mund të vërë edhe kushte të tjera që i çmon të përshtatshme pa tejkalar parashikimet e akteve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe rezervat e deklaramet ligjore.

Nëse këto kushte do të shkelen ose nuk do të plotësohen atëherë nuk mund të aplikohet procedura e ekstradimit. Ekstradimi është një nga format më të rëndësishme të bashkëpunimit hetimor gjyqësor ndërkombëtar në fushën penale dhe për rrjedhojë plotësimi i kushteve të ekstradimit përben një ndër elementët më të rëndësishëm, pa ekzistencën e të cilave ky institut nuk do të funksiononte.

6.2. Kërkesa për ekstradimin e personave të kërkuar

Procedura e ekstradimit përmban një tërësi veprimesh të cilat duhen të ndërmerren nga organet e autorizuar të shtetit kërkues dhe shtetit të kërkuar. Ajo zhvillohet në dy faza: në fazën e parë përgatitet kërkesa për ekstradim nga shteti kërkues për shtetin e kërkuar, kurse në fazën e dytë shqyrtohet kërkesa për ekstradim nga ana e shtetit të kërkuar. Sipas legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar rezultojnë dy lloje ekstradimi; ekstradim për jashtë ose ekstradim pasiv, dhe nga jashtë brenda ose aktiv. Kërkesa për ekstradim është një dokument i formuluar me shkrim që i drejtohet shtetit të kërkuar në rrugë diplomatike. Është kusht që shteti kërkues të jetë palë e marrëveshjes në kuadrin e Konventës së Evropës dhe protokolleve shtesë të saj. Në paragrafin e 1 të nenit 489 përcaktohet se kërkesa për ekstradim i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë. Kërkesa është një akt i shkruar që dërgohet në rrugë diplomatike. Kështu, në nenin 12 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për ekstradimin përcaktohet se kërkesa për ekstradim përgatitet në forme të shkruar dhe dorëzohet përmes kanaleve diplomatike. Kjo dispozitë lejon edhe mënyra të tjera të dorëzimit të kërkesës ku shteti kërkues dhe ai i kërkuar nëpërmjet marrëveshjeve direkte mes tyre përcaktojnë procedurat e dorëzimit të kërkesës për ekstradim.

Kur ndaj një personi që gjendet jashtë shtetit është caktuar një masë sigurimi për kufizimin e lirisë ose nëse ndaj tij është dhënë një vendim dënimi me burgim i formës së prerë, Ministri i Drejtësisë mund të paraqesë kërkesë për ekstradimin e tij, bazuar mbi informacionin dhe dokumentet e përcjella nga Prokurori i Përgjithshëm. Kërkesa përcillet nëpërmjet Ministrisë së Jashtme²⁰² dhe shoqërohet edhe nga dokumentacioni plotësues, në të cilin përfshihen këto materiale shkresore, të detyrueshme, të renditura si më poshtë:

- Origjinali ose kopja e vërtetuar autentike, e vendimit për një dënim për t'u zbatuar, e një urdhëri arresti, apo çdo akti tjetër që ka të njëjtën fuqi vepruese, lëshuar sipas rregullave që përmban ligji i palës kërkuese.
- Një pasqyrë e fakteve në bazë të të cilave është kërkuar ekstradimi, sikurse janë koha dhe vendi i kryerjes, koha dhe vendi i kryerjes së shkeljeve në fjalë, cilësimi i tyre ligjor dhe referimet ndaj dispozitave ligjore që janë të zbatueshme në këto raste, të cilat duhet të zbatohen sa më saktë që të jetë e mundur, si dhe një relacion i plotë lidhur me aktet procedurale, mbi bazën e të cilave identifikohet personi si autor i ngjarjes.
- Një kopje e dispozitave ligjore të zbatueshme, ose në rast se kjo nuk është e mundur, një deklaratë mbi të drejtën e zbatueshme, si dhe një përshkrim sa më të saktë të tipareve të individit të kërkuar, si dhe çdo informacion që mund të shërbejë për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e tij, në lidhje me provat që vërtetojnë identifikimin e plotë të personit, si fotografi, pasaportë, kartelë daktiloskopike e gjurmëve, etj.²⁰³

Në praktikën e përditshme ndeshemi me situata në të cilat dy ose më shumë shtete kërkojnë ekstradimin e një personi i cili mund të ketë kryer disa vepra penale në vende të ndryshme. Në nenin 17 të KEE-së përcaktohet se nëse për të njëjtin person behet kërkesë për ekstradim nga

²⁰²Kodi i Procedurës Penale, të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, i ndryshuar me ligjin nr. 9276, datë 16.09.2004.

²⁰³Interpretimi pasqyrohet në Kodin e Procedurës Penale, neni 489, i cili i referohet Konventës Evropiane të Ekstradimit, viti 1957, neni 12.

më shumë se një shtet, lejueshmëria verifikohet për çdo shtet të tillë në mënyrë të veçantë. Më pas organi miratues i shtetit i cili ka personin duhet të vlerësojë rrethanat e rëndësishme dhe të vendosë se ciles kërkesë t'i japi prioritet. Shteti të cilit i është drejtuar kërkesa merr në vlerësim rëndësinë e veprës, vendin e veprës, radhën e paraqitjes së kërkesave dhe mundësinë e ekstradimit të mëvonshëm në një shtet.

Prioritet i jepet shtetit ku është kryer vepra penale në krahasim me shtetin e vendlindjes së tij, çka zbatohet para së gjithash atëherë kur ky nuk ekstradon shtetas të vet. Është gjithmonë e rekomandueshme për shtetin që bënë kërkesën, që njëkohësisht të kërkojë edhe miratimin për ekstradim në një shtet të tretë, nëse ka kërkesa për ekstradim edhe nga shtete të tjera. Shtetit të cilit i drejtohet kërkesa duhet të vendosë për të gjitha. Në këtë mënyrë është e përcaktuar që në fillim nëse personi do të ekstradohet në një shtet të tretë pasi ndaj tij të ketë përfunduar ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit në shtetin kërkues. Një gjë e tillë është e rekomandueshme për të kursyer shpenzimet procedurale.

Do të trajtojmë rastin e kërkesës për ekstradimin e shtetasit shqiptar A.Sh, i kërkuar për disa krime të rënda në Shqipëri, si dhe i kërkuar për trafikim ndërkombëtar droge nga disa shtete. Nga ana e ZQK Interpol Tirana, më datë 21.01.2003 është bërë shpallja në kërkim ndërkombëtar i shtetasit shqiptar A.Sh²⁰⁴, pasi Gjykata e Apelit Durrës me Vendimin nr. 289, datë 21.12.2001 e ka dënuar me 7 vjet burg për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Gjithashtu, ky shtetas ishte i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma, pasi Gjykata e Torinos kishte vendosur ndaj tij masën e sigurisë “arrest në burg” për akuzën e trafikut ndërkombëtar të drogës. Shtetasi në kërkim u arrestua më datë 25.03.2006 në lagjen “Batiken” në Ankara/Turqi, me qëllim ekstradimi, bazuar në kërkesën e ZQK Interpol Tirana. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, dërgoi në Ankara kërkesën për ekstradimin e

²⁰⁴http://www.asp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=509%3A-ekstradohet-aldobare&catid=82%3Aekstradime-2009&Itemid=249&lang=sq

shtetasit A.Sh. një kërkesë e tillë u bë edhe nga Ministria e Drejtësisë së Italisë. Njëkohësisht, këtë shtetas e kërkonin dhe vende të tjera si Gjermania, Bullgaria, Rumania, Maqedonia, ku sipas kërkesës së tyre për ekstradim, ai rezultonte si drejtues i një rrjeti të trafikut ndërkombëtar të drogës. Gjithashtu, prej vitit 1997 e në vijim, ky person ishte nën hetim për disa vepra të rënda kriminale ndodhur në Shqipëri, si: për më tepër se 20 vrasje, për vrasje dhe *dekapitim* (prerjen e kokës dhe shëtitjen në publik), për rrëmbim personi, shkatërrim prone, dhunim varresh, kryerje veprash penale në bashkëpunim nga organizata kriminale, etj. Shtetasi shqiptar fillimisht kërkoi azil politik në Turqi, por kërkesa e tij nuk u miratua nga autoritetet e ministrisë së Brendshme të Turqisë, me arsyetimin se nuk përmbushte kriteret e kërkuara ligjore. Pasi përfunduan të gjitha procedurat ligjore përkatëse, Ministria e Drejtësisë së Turqisë miratoi ekstradimin e shtetasit A.Sh drejt Shqipërisë, ekstradim i cili u krye më datë 25.11.2009. Si përfundim, duhet theksuar se, arrestimi i shtetasit A.Sh, u arrit si rezultat i një pune inteligjente policore në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar, nëpërmjet së cilës u finalizua identifikimi i tij, dhe përbën një sukses të Policisë së Shtetit. Ky ekstradim tregoi rritjen e shkallës së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të besimit të ndërsjellë ndërmjet autoriteteve ligj zbatuese të të dy vendeve.

Kur vepra penale mbi bazën e të cilit kërkohet ekstradimi ndëshkohet me vdekje nga ligji i palës kërkuese, dhe në rast se ky dënim nuk parashikohet si dënim në legjislacionin e palës së kërkuar ose kur në përgjithësi nuk zbatohet në atë vend, ekstradimi mund të mos akordohet, përveçse me kusht, që pala kërkuese të jap sigurime të vlerësuara dhe të mjaftueshme, se dënimi me vdekje nuk do të zbatohet.²⁰⁵ Konkretisht, rast tipik është refuzimi i ekstradimit nga pala shqiptare, i kërkesës së Interpol-Pekinit/Kinë, lidhur me ekstradimin e pesë ujugurëve kinezë të cilët janë akomoduar në Qendrën e Pritjes së Azilkërkuesve, në Linzë, Tiranë. Pra, vepra penale për të cilën akuzohen ujugurët kinezë, në kodin penal kinez

²⁰⁵Interpretim sipas Kodit të Procedurës Penale.

parashikohet dënim me vdekje, dhe në rast se do të ekstradoheshin në Kinë, ky dënim do të ekzekutohej.

Në rastin konkret, vendimi për refuzim është bërë duke i'u përmbajtur jo vetëm dokumenteve themelore ndërkombëtare lidhur me ekstradimin, si: Konventa Evropiane për Ekstradim, Statuti i Romës, dhe Kushtetuta e Interpol-it, por dhe legjislacionit tonë të brendshëm. Kjo e drejtë buron nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, të cilën vendi ynë e ka ratifikuar atë me ligj. Gjithashtu, ekstradimi nuk akordohet edhe në rast se shkelja për të cilën është kërkuar, konsiderohet nga pala e kërkuar si shkelje politike ose si një fakt që lidhet me këtë shkelje.

Lidhur me këtë rast të veçantë, mund të përmendim refuzimin e ekstradimit nga disa shtete si Belgjika apo Zvicra, lidhur me kërkesat e palës shqiptare për anëtarët e organizatës kriminale “Hakmarrja për drejtësi”.²⁰⁶ Për më tepër, pala mbrojtëse e të dënuarve, përdori si argument lidhjet familjare të të dënuarve me ish-funksionarë të lartë politik të regjimit komunist në Shqipëri, si dhe përfshirjen e tyre në debate ndërmjet deputetëve të ndryshëm apo forcave politike brenda dhe jashtë parlamentit, duke i etiketuar me epitete nga më të ndryshmet. Pra, në rastin konkret, këto fakte dhe të dhëna të tjera u shfrytëzuan nga pala mbrojtëse e të dënuarve, të cilat i'a paraqitën autoritete gjyqësore belge dhe zvicerane, duke pretenduar se të dënuarit janë viktima të një lufte të egër politike, dhe nëse do të ekstradohen do të përndiqen politikisht.

Gjithashtu, theksojmë se i njëjti rregull zbatohet në rast se pala e kërkuar ka arsye serioze të besojë se kërkesa për ekstradim të personit të shpallur në kërkim ndërkombëtar është motivuar me një shkelje që përbën faj ordiner, por është paraqitur me qëllim që të ndiqet ose

²⁰⁶Burimi i informacionit është marrë nga Seksioni i Anti-Terrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, e cila disponon dosjen operative.

të dënohet një individ për arsye race, feje, kombësie dhe opinioni politik ose kur pozita e këtij individ i rrezikon të dënohet për një të tjetër nga këto arsye.²⁰⁷

Ministria e Drejtësisë ka refuzuar kërkesën për ekstradim të shtetasit shqiptar H.H, i arrestuar në Suedi. Nga ana e ZQK Interpol Tirana, më datë 13.03.2006 është bërë shpallja në kërkim ndërkombëtar i shtetasit shqiptar H.H, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me Vendimin nr. 18, datë 17.05.2005 ka caktuar masën e sigurisë “*arrest në burg*” pasi akuzohet për veprën penale të vrasjes. Në dosjen hetimore rezulton se ky shtetas është autor i : një vrasjeje të ndodhur në Tropojë në vitin 1993, një vrasje e ndodhur në vitin 1998, si dhe vrasjen e dy shtetasve shqiptar, ndodhur në Tropojë në vitin 2005. Dosja e transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila e ka dënuar shtetasin në fjalë me 25 vjet burgim. Shtetasi i mësipërm më datën 12.02.2007 u arrestua në qytetin Goteborg në Suedi, me qëllim ekstradimi drejt Shqipërisë, bazuar në kërkesën e ZQK Interpol Tirana për shpalljen në kërkim ndërkombëtar. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, dërgoi në Goteborg kërkesën së bashku me dokumentacionin përkatës për ekstradimin në Shqipëri të shtetasit H.H, për tu hetuar dhe gjykuar për veprat penale për të cilat akuzohej.

Gjykata e Shkallës së Parë e Goteborgut në Suedi, pasi u njoh me kërkesën e autoriteteve shqiptare për ekstradimin shtetasit, si dhe dëgjo pretendimet e palës mbrojtëse të shtetasit shqiptar H.H, vendosi mos akordimin e ekstradimit. Të njëjtin vendim dha edhe Gjykata Suedeze e Apelit, bazuar në kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme shqiptare e cila apelo vendimin e Gjykatës së Goteborgut. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë Suedeze (HD), la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të Suedisë, me arsyetimin se të drejtat e tij në Shqipëri nuk do të respektoheshin dhe jeta e tij nuk do të ishte e sigurt. Madje, në arsyetimin e vendimit, gjykata duke marr në konsideratë kërkesën e shtetasit H.H për azil politik në Suedi, ka cituar një raport të vitit 2007 të Ministrisë së Jashtme suedeze mbi situatën e të drejtave të njeriut në

²⁰⁷Konventa Evropiane e Ekstradimit, viti 1957, nenet 10 dhe 11.

Shqipëri. Gjithashtu, gjykata i`u referua dhe komenteve të disa politikanëve shqiptarë të pasqyruara në disa media vizive dhe të shkruara në Shqipëri, lidhur me vrasjet e ndodhura dhe rrezikshmërinë e të dënuarit H.H dhe të afërmeve të tij. Kështu, që prej vitit 2008 shtetasi shqiptar H.H, i dënuar në Shqipëri me 25 vjet burgim për veprën penale të vrasjes, gëzon statusin e azilkërkuesit politik në Suedi.

6.3. Detyrimet që duhet të respektohen gjatë procedurës së ekstradimit

Procedura e ekstradimit është mjaft komplekse dhe sjell domosdoshmërisht detyrime për të dyja shtetet të cilat janë bërë pjesë e saj. Gjatë procedurës së ekstradimit si shteti kërkues po ashtu dhe ai pritës kanë detyrime të cilat duhet t`i përmbahen dhe respektojnë. Më poshtë do të trajtojmë në mënyrë individuale detyrimet e secilit shtet.

6.3.1. Detyrimet e shtetit që i është drejtuar kërkesa

Shteti i kërkuar është subjekt i disa detyrimeve të cilat duhet ti respektojë gjatë procedurës së ekstradimit. Kështu ai ka detyrimin e:

- *Dorëzimit të personit të kërkuar nëpërmjet ekstradimit*

Në nenin 18 të Konventës Evropiane të Ekstradimit përcaktohet se shteti i kërkuar duhet të lajmërojë sa më parë shtetin kërkues në lidhje me vendimin e pranimi ose të refuzimit të kërkesës për ekstradim nëpërmjet rrugëve diplomatike. Në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se vendimi i refuzimit duhet të jetë i arsyetuar mirë.²⁰⁸ Nëse shteti i kërkuar do të vendosë pranimin e kërkesës së ekstradimit, ai duhet të njoftojë shtetin kërkues në lidhje me

²⁰⁸Shih nenin 18 paragrafi 2 të Konventës Evropiane të Ekstradimit “Çdo refuzim i plotë ose i pjesshëm duhet të JeteëI arsyeshëm.”

këtë vendim dhe për formën e dorëzimit duke përcaktuar datën, vendin si dhe për kohëzgjatjen e mbajtjes në burg gjatë procedurës së ekstradimit.²⁰⁹

Nëse dorëzimi i personit nuk do të ishte i mundur për ndonjë arsye e cila nuk varet nga asnjë shtet atëherë Konventa Evropiane e Ekstradimit përcakton në paragrafin e 5 të nenin 18 që *“Në rast force madhore që pengon dorëzimin ose pritjen e individit që ekstradohet, pala e interesuar informon për këtë palën tjetër; të dy palët bien dakord për një datë tjetër të dorëzimi, dhe dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni janë përsëri të zbatueshme.”* Pra, sipas këtij neni duhet të vendoset një datë tjetër për dorëzimin e personit të kërkuar dhe nëpërmjet këtij paragrafi Konventa i bën me dije shteteve që dorëzimi i personit të kërkuar është detyrim ndërkombëtar dhe nuk mund të anashkalojnë këtë fakt.

Në paragrafin 4 të nenit 18/ të Konventës përcaktohen afatet e lirimit të personit të kërkuar në rast se dorëzimi nuk mund të ndodh për shkaqe të cilat nuk varen nga shtete pjesë të procesit të ekstradimit. Kështu, personi i kërkuar për ekstradim mund të lirohet nga paraburgimi në rastet se nga dita kur duhej të dorëzohej shtetit kërkues kane kaluar 15 ditë, por në çdo rast ai nuk mund të mbahet më shumë se 30 ditë në paraburgim në mungesë të dorëzimit.²¹⁰ Si situata të mos dorëzimit të cilat nuk varen nga shtetet legjislacioni parashikon rrethana që lidhen me fuqinë madhore si tërmetet, përmbytjet etj. Pala e kërkuar mundet, pasi të ketë vendosur për kërkesën e ekstradimit, ta shtyjë dorëzimin e individit të kërkuar, në mënyrë që ky të mund të ndiqet prej saj ose, në rast se është dënuar më përpara, të mund të vuajë dënimin në territorin e saj, kur ky dënim është dhënë për shkak të një veprë që nuk ka të bëjë me ekstradimin e kërkuar. Në vend që të shtyjë dorëzimin, pala e kërkuar mund t’ia

²⁰⁹Shih nenin 18 paragrafi 3 të Konventës Evropiane të Ekstradimit.

²¹⁰Shih nenin 18 paragrafi 4 të Konventës Evropiane të Ekstradimit ku thuhet se *“Lidhur me rezervën që parashikon paragrafi 5 i këtij neni, kur individi i kërkuar nuk është pritur në datën e caktuar, ai mund të lihet i lirë pas skadimit të një fati 15-ditësh, duke filluar nga data në fjalë, në çdo rast, ai do të lirohet pas skadimit të një afati 30-ditësh; Pala e kërkuar mund të refuzojë të ekstradojë për të njëjtën veprë.”*

dorëzojë përkohësisht palës kërkuese individin e kërkuar, në kushte që përcaktohen me një marrëveshje të përbashkët të palëve.²¹¹

- *Dorëzimi i objekteve (sendeve)*

Në praktikën e së drejtës ndërkombëtare penale është vendosur që ekstradimi i një individi nuk ka vlerë nëse bashkë me të nuk do të bëhet dhe dorëzimi i sendeve më të cilat është realizuar vepra penale. Mungesa e këtyre sendeve do të ndikonte negativisht në procesin e gjyqimit duke rrezikuar dhe pandëshkueshmërinë e tij. Kështu, në të gjitha aktet ndërkombëtare është parashikuar se shteti që do të dorëzojë personin e kërkuar, është i detyruar të bëjë dhe dorëzimin e mjeteve me të cilat është kryer vepra penale shtetit që kërkon ekstradimin. Dorëzimi i sendeve do të realizohet edhe në rastet kur dorëzimi i personit nuk mund të realizohet për arsye se ai ka vdekur.²¹² Konventa Evropiane për Ekstradimin në nenin 20 paragrafi përcakton se shteti i kërkuar duhet t'ia dorëzojë shtetit kërkues mjetet me të cilat është kryer vepra penale.²¹³

Në lidhje me dorëzimin e sendeve të cilat janë gjetur gjatë hetimit të veprës penale, ashtu si legjislacioni ndërkombëtar dhe ai kombëtar përcakton se dorëzimi duhet të realizohet në përputhje me normat e të drejtës penale. Kështu, Konventa përcakton si kufizim lidhur me dorëzimin e sendeve:

- Legjislacionin e shtetit të kërkuar. Pra, dorëzimi duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin e shtetit të kërkuar. Ky kufizim vjen edhe si pasojë e ndryshimeve që kanë disa legjislacione në lidhje me këtë gjë. Ka disa legjislacione të cilat parashikojnë

²¹¹Shih nenin 19 të Konventës Evropiane të Ekstradimit.

²¹²Shih nenin 20 paragrafi 2 të Konventës Evropiane të Ekstradimit

²¹³Shih nenin 20 paragrafi 1 të Konventës Evropiane të Ekstradimit ku thuhet se: "Me kërkesën e Palës kërkuese, Pala e kërkuar mbledh dhe dorëzon, në shkallën e lejuar nga ligjet e saj këto objekte:

a) ato që mund të shërbejnë si dokumente të akuzës; ose

b) ato që lidhen me shkeljen dhe që i janë gjetur individit të kërkuar në çastin e arrestimit ose janë zbuluar më pas."

shkatërrimin e sendeve që konsiderohen të rrezikshme për shëndetin edhe pse këto janë objekte të një vepre penale.

- Mbajtja nga ana e shtetit të kërkuar përkohësisht të sendeve kur procedura penale është ende zhvillim ose mund të bëhet dorëzimi me kusht kthimin e tyre përsëri këtij vendi.
- Të drejtat që kanë shtetet mbi sendin e kërkuar.

Konventa i rezervon shtetit të kërkuar ose një shteti të tretë të drejtat mbi sendet e konfiskuara.

6.3.2. Detyrimet e shtetit kërkuar të ekstradimit

Në lidhje me procedurën e ekstradimit subjekt të detyrimeve përkatëse në bazë të Konventës Evropiane për Ekstradimin është edhe shteti kërkuar. Detyrimet e tij konsistojnë në:

- Ndalimi i dorëzimit të personit për të qenë subjekt i procedimit, gjykimit dhe burgosjes për vepra penale të tjera që nuk janë objekt i kërkesës së ekstradimit.

Në nenin 14 paragrafi 1 të KEE-së përcaktohet se *“Individi që dorëzohet nuk duhet të ndiqet, as të gjykohe dhe as të burgoset për vuajtjen e një dënimi ose të një mase sigurimi; as duhet t’i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale për çfarëdo veprim që është kryer para dorëzimit, dhe që nuk hyn në motivet e ekstradimit, “* Pra, i ekstraduari nuk mund të gjykohe ose arrestohet për një vepër që nuk është objekt i ekstradimit dhe që personi mund ta ketë kryer para dorëzimit. Vlen të theksohet që kjo dispozitë është dhe subjekt i rishikimeve ndërmjet traktateve dypalëshe që mund të kenë shtetet ndërmjet tyre në lidhje me ekstradimin. Nëpërmjet kësaj dispozite sigurohet mbrojtja e të drejtave dhe interesave të personit të ekstraduar duke evituar situata që ndikojnë negativisht në mbrojtjen e tij.

Në nenin 14 paragrafi përcaktohen rastet përjashtimore nga çka u tha më sipër. Pra, nëse shtete arrijnë dakordësinë ndërmjet tyre, atëherë ekstradimi mund të shtrihet edhe për

vepra te tjera të kryera para ekstradimit.²¹⁴ Në këtë rastë shteti kërkues duhet të paraqesë një kërkesë shtesë të shoqëruar me dokumentet përkatëse bashkë me kërkesën për ekstradim. Dokumentacionit duhet të bashkëngjitet dhe dosja gjyqësore me deklaratën e personit të ekstraduar lidhur me veprën penale të re. Paragrafi 2 i nenin 14 të KEE-së lejon mundësinë e një dënimi në mungesë për një vepër që i plotëson kushtet e ekstradimit të personit të ekstraduar. Dhe në këto raste cilësimi i veprës penale ndryshon gjatë procedurës, ku personi i ekstraduar kërkohet të procedohet vetëm kuptohet nëse elementet që e përbejnë atë vepër sipas cilësimit të ri lejojnë ekstradimin.²¹⁵

- *Pëlqimi për riekstradim*

Rieskradim kemi kur shteti kërkues pasi e ka marre në dorëzim personin e ekstraduar nga shteti i kërkuar, ia dorëzon atë një shteti të dyte kërkues duke marre kështu rolin e shtetit të dytë të kërkuar. Por a është i mundur riekstradimi i një personi? Studiues të ndryshëm japin mendime të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Kështu, Jean Pradel argumenton se nëse kërkesa për riekstradim e bërë nga shteti i dytë kërkues ka si objekt ngjarje që kanë ndodhur pas dorëzimit të personit tek shteti i parë kërkues, atëherë nuk kemi riekstradim, por jemi para një rasti ekstradimi normal. Nëse kërkesa për ekstradim ka si objekt ngjarje të ndodhura para dorëzimit nga shteti i parë i kërkuar, atëherë shteti i parë kërkues di t' ia dorëzojë shtetit të dytë kërkues bazuar në mirëbesim, por bazuar në Konventën Evropiane për Ekstradimin kërkohet pëlqimi i shteti të parë të kërkuar.²¹⁶

- *Kufizimet lidhur me ekstradimin*

²¹⁴Shih nenin 14 paragrafi 1 pika a të Konventës Evropiane të Ekstradimit.

²¹⁵Shih Ndihma juridike dhe ekstradimi, Dr, Azem Hajdari, Prishtinë ,2014. Fq.69.

²¹⁶Shih nenin 15 të Konventës Evropiane të Ekstradimit ku thuhet se” Me përjashtim të rastit të parashikuar në paragrafin 1, kryerreshti “b” i nenit 14, pëlqimi i palës së kërkuar do të jetë i nevojshëm për t’i dhënë mundësi palës kërkuese t’i dorëzojë një pale tjetër apo një shteti të tretë individin që i është kthyer dhe është kërkuar nga pala tjetër ose nga shteti i tretë për shkelje të kryera para dorëzimit. Pala e kërkuar mund të vërë si kusht paraqitjen e dokumenteve të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 12.”

Çdo shtet në momentin e shqyrtimit të kërkesës për ekstradim mund të vendosë kufizime të caktuara. Këto kufizime, sipas KEE-së, duhet të respektohen dhe konsistojnë në faktin që personi i ekstraduar nuk mund të ndiqet penalisht për veprë penale tjetër të kryer para ekstradimit dhe për të cilën veprë ekstradimi nuk është lejuar, nëse me marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe nga shtetet. Ndaj të ekstraduari nuk i caktohet dënim më i rëndë se ai për të cilin është dënuar dhe nuk mund t'i dorëzohet shtetit të tretë nëse me marrëveshje nuk parashikohet ndryshe. Një kufizim tjetër është dhe ndalimi i dëimit me vdekje. Në kuadër të sensibilizimit të shteteve për të hequr dënimin me vdekje edhe dispozitat që rregullojnë ekstradimin nuk e parashikojnë atë në rast se për veprën penale objekt ekstradimi personi do të dënohej me vdekje.²¹⁷ Respektimi i kufizimeve mbetet në deskricionin e brendshëm të shteteve brenda limiteve të përcaktuara në ligj për veprën penale për të cilën zhvillohet procedure penale.

6.4. Pengesat për Ekstradimin (rastet e pezullimit të ekstradimit)

Nisur nga fakti që legjislacione të ndryshme kanë nivel të ndryshëm zhvillimi po kështu dhe sistemet politike nuk janë të njëjta, në respektim të të drejtave të individëve lindin dhe kufizimet në procedurën e ekstradimit. Kështu, përveç kushteve materiale juridike ka edhe disa shkaqe të tjera të cilat mund të mos lejojnë ekstradimin e personave të cilat përcaktohen edhe nga legjislacioni i ynë i brendshëm. Pengesat e ekstradimit do i klasifikojmë sipas:

1. Autorit të veprës penale.

²¹⁷Shih 11 të Konventës Evropiane të Ekstradimit ku përcaktohet se “Në rast se vepra, mbi bazën e së cilës kërkohet ekstradimi, ndëshkohet me dënimin me vdekje nga ligji i Palës kërkuese dhe, në këtë rast, ky dënim nuk parashikohet në legjislacionin e Palës së kërkuar ose kur në përgjithësi nuk zbatohet në atë vend, ekstradimi mund të mos akordohet, përveçse me kusht që Pala kërkuese të japë sigurime të vlerësuara të mjaftueshme nga Pala e kërkuar, se dënimi me vdekje nuk do të zbatohet”.

2. Llojit të veprës penale.
3. Procedurës së ekstradimit.
4. Parimeve të ekstradimit.
5. Kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë në legjislacionin e shtetit të kërkuar.
6. Kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut.

Në vazhdim do të trajtohen individualisht këto pengesa ekzistenca e të cilave nuk lejojnë realizmin e ekstradimit.

1. Për autorin e veprës penale.

Ashtu si bënë disa marrëveshje ndërkombëtare dhe në legjislacionet e brendshme të shteteve si pengesa për ekstradim që lidhen ngushtësisht me autorin e veprës penale, është konsideruar shtetësia dhe shkaqet humanitare.

Shtetësia

Parimi i shtetësisë është një parim i cili është sanksionuar si në legjislacionet e brendshme të shumë shteteve por edhe në atë ndërkombëtar. Kështu në legjislacionin tonë ai gjendet i sanksionuar në nenin 11 të Kodit Penal ku përcaktohet se *“nuk lejohet ekstradimi, në qoftë se personi që do të ekstradohet është shtetas shqiptar, veç rasteve kur në marrëveshje është parashikuar ndryshe”*²¹⁸ Parimi i shtetësisë gjendet i sanksionuar edhe në nenin 491 pika g ku përcaktohet se nuk lejohet ekstradimi nëse *“personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe”*. Pra, legjislacioni i brendshëm i jep prioritet

²¹⁸Shih nenin 11 paragrafi 2 pika a të Kodit Penal

gjykimit nga ana e gjykatave të vendit të shtetësisë duke vendosur në plan të parë vënien e drejtësisë nga ana e shtetit të shtetësisë për shtetasit e tyre.

Parimi i shtetësisë është i përcaktuar edhe në Konventën Evropiane për Ekstradimin ku:: në nenin 6 paragrafi 1 pika a e Konventës parashikohet që çdo palë nënshkruese gëzon të drejtën të refuzojë ekstradimin e shtetasve të vet.²¹⁹ Por ka shtete të cilat bëjnë përjashtime nga ky nen, si rasti i Traktatit mes Francës dhe Spanjës në vitin 1376 ku parashikohet mundësia e dorëzimit të shtetasve të tyre ndërmjet këtyre palëve kontraktuese.²²⁰ Por ka disa vende anglosaksone si Britania e Madhe, e cila pranon të ekstradojë shtetasit e saj të cilët kanë kryer vepra penale jashtë vendit.

Shkaqet humanitare

Doktrina konsideron si shkaqe humanitare moshën e individit ku përfshihet: mosha e thyer dhe e mitur, sëmundjet dhe statusi i refugjatit. Vlen të theksohet se shkaqet humanitare mbeten diskrecioin i legjislacionit të brendshëm sepse nuk janë të përcaktuar në KEE-në. Po kështu edhe legjislacioni ynë i brendshëm nuk i ka sanksionuar shkaqet humanitare si pengesë për ekstradimin, përveç rasteve kur me marrëveshje është përcaktuar ndryshe.

2. Për llojin e veprës penale

Konventa Evropiane për Ekstradimin, disa marrëveshje bilaterale të lidhuara midis shteteve por dhe legjislacioni i brendshëm kanë përcaktuar disa vepra penale për të cilat nuk lejohet ekstradimi i personave të kërkuar. Veprat penale të cilat i ka përcaktuar KEE-ja dhe një pjesë e konsiderueshme e marrëveshjeve janë : veprat penale politike, veprat penale ushtarake, veprat penale financiare, veprat penale të kryera me anë të shtypit dhe veprat penale që ndiqen sipas

²¹⁹Shih nenin 6 të Konventës Evropiane për Ekstradimin ku përcaktohet që “Çdo palë kontraktuese do të ketë të drejtë të refuzojë ekstradimin e shtetasve të vet”.

²²⁰Shih A. Hajdari, *Ndihma juridike dhe ekstradimi*, Prishtinë, 2014. fq.37.

padisë private. Në legjislacionin tonë të brendshëm janë sanksionuar vetëm veprat penale politike, veprat penale ushtarake, të cilat do të jenë dhe objekt trajtimi.²²¹

Veprat penale me karakter politik

Demokratizimi i shoqërive solli dhe heqjen nga legjislacionet e brendshme të veprave penale me karakter politik. Shteti i parë, i cili i hoqi veprat penale me karakter politik, ishte Belgjika në vitin 1833 dhe më vonë ky koncept u përqafua edhe nga shumë vende të tjera.²²² Në nenin 11 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë parashikohet se “*nuk lejohet ekstradimi në qoftë se vepra penale që përbën objektin e kërkesës për ekstradim ka një karakter politik*”. Po kështu, në nenin 491 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se nuk mund të jepet ekstradimi për një vepër me karakter politik ose kur rezulton që ai kërkohet për qëllime politike, pra legjislacioni ynë i brendshëm e ndalon kategorikisht ekstradimin për vepra penale me karakter politik. Në këto rrethana shtetit të cilit i kërkohet ekstradimi, pra shtetit Shqiptar i takon të vendosë se kur një vepër penale është politike. Nocioni “vepër penale politike” mund të interpretohet në disa mënyra. Së pari, është i nevojshëm një lloj interpretimi i këtij koncepti në kushtet e legjislacionit shqiptar dhe sipas kuptimit që i jepet këtij në Shqipëri. Së dyti, ky përcaktim do të bëhet në varësi të situatave apo rrethanave, që lidhen me kohën kur kërkohet ekstradimi. Së treti, ky interpretim do të realizohet bazuar në karakteristikat e vendit i cili kërkon ekstradimin sikurse janë forma e regjimit, shkalla e demokracisë apo çdo rrethanë tjetër që paraqet rëndësi për të përcaktuar motivet për të cilat është kërkuar ekstradimi. Edhe Konventa Evropiane për ekstradimin në nenin 3 paragrafi 1 përligj refuzimin e ekstradimit për vepra me karakter politik.²²³

²²¹Shih nenin 11 të Kodit Penal dhe nenin 491 të Kodit të Procedurës Penale.

²²²Shih I. Salihu, E drejta Penale ndërkombëtare, fq.171.

²²³Shih nenin 3 të Konventës Evropiane të Ekstradimit ku thuhet se “Ekstradimi nuk akordohet në rast se shkelja për të cilën është kërkuar konsiderohet nga pala e kërkuar si një shkelje politike ose si një fakt që lidhet me këtë shkelje”.

Veprat penale me karakter ushtarak

Në legjislacionin tonë ndalohet ekstradimi i personave për vepra me karakter ushtarak.²²⁴ Me veprat penale ushtarake do të konsiderojmë ato vepra të cilat cenojnë shërbimin ushtarak, detyrimet e posaçme të personave ushtarakë dhe në përgjithësi detyrimet ndaj mbrojtjes së vendit. Si vepra penale ushtarake konsiderohen në bazë të Kodit Penal Ushtarak të Republikës së Shqipërisë, shmangia nga evidenca ushtarake, shmangia nga thirrja për shërbim ushtarak, mashtrimi për rekrutim, rekrutimi i paligjshëm etj.²²⁵ Konventa Evropiane për ekstradimin parashikon ekstradimin për veprat e pastra ushtarake si dezertimi dhe jo për vepra të tjera siç vjedhja e ndonjë arme etj. Në lidhje me veprat penale ekonomike-fiskale dhe veprat penale të kryera me anë të shtypit nuk paraqesin bazë për përjashtimin e ekstradimit sipas dispozitave të legjislacionit tonë dhe për këtë arsye nuk do të jenë objekt trajtimi këtij punimi.

3. Procedurës së ekstradimit

E drejta e brendshme dhe e drejta ndërkombëtare përcaktojnë disa shkaqe procedurale të cilat mund të behen pengesë për ekstradimin e personave. Si të tilla janë amnistia, kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit etj.

Kur është gjykuar në Shqipëri

Në rastin kur personi është gjykuar në Shqipëri për këtë vepër penale ai nuk mund të ekstradohet në një shtet tjetër, po për të njëjtën vepër sepse nuk lejohet dënimi për të njëjtën vepër penale dy herë. Pra, jemi përpara rastit të parimit *Ne Bis In Idem* sipas të cilit autori i veprës penale nuk mundet të gjykohet serish për të njëjtën vepër penale. Ky parim është sanksionuar në nenin 491 të Kodit të Procedurës Penale.²²⁶ Parimi *Ne Bis In Idem* është sanksionuar edhe në nenin 9 të Konventës Evropiane për Ekstradimin ku thuhet shprehimisht

²²⁴Shih nenin 11 të Kodit Penal.

²²⁵Shih Kodin Penal Ushtarak të Republikës së Shqipërisë nenet 15-97.

²²⁶Shih nenin 491 pika ç të Kodit të Procedurës Penale.

se “Ekstradimi nuk do të akordohet nëse personi i kërkuar është gjykuar përfundimisht nga organet kompetente”.

Amnistia

Në nenin 491 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se nuk lejohet të jepet ekstradimi nëse “për veprën penale objekt ekstradimi është dhënë amnisti nga shteti shqiptar”. Po kështu, shumë konventa ndërkombëtare dhe KEE-ja dhe protokollet e saj e ndalojnë ekstradimin nëse vepra penale është subjekt amnistie ose është amnistuar në momentin e paraqitjes së kërkesës së ekstradimit. Në rast se edhe në shtetin kërkuar vepra penale është amnistuar, atëherë kërkesa për ekstradim nuk merret në konsideratë pasi nuk mund të ekstradosh një individ për një vepër penale e cila është amnistuar në të dyja vendet ose dhe vetëm në vendin kërkuar. Në legjislacionin ndërkombëtar përcaktohet se nuk lejohet ekstradimi në rast se vepra penale për të cilën personi kërkohet të ekstradohet është parashkruar, në rast të litispencës, respektimit të të drejtës në mbrojtje, mungesës së padisë. Këto raste nuk parashikohen në legjislacionin tonë të brendshëm.

4. Parimeve të ekstradimit

Si shkak tjetër që mund të paraqitet si pengesë për ekstradim konsiderohet edhe:

Parimi territorial i ekstradimit

Në bazë të këtij parimi legjislacioni penal i një shteti aplikohet ndaj të gjithë personave që kryejnë vepra penale në territorin e tij pa marre parasysh a janë shtetas të tij, shtetas të huaj apo persona pa shtetësi.²²⁷ Ekzistenca e këtij parimi arsyetohet me sovranitetin e shtetit në të cilin është kryer vepra penale. Kështu, në nenin 491 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet në pikën c të tij se nuk lejohet ekstradimi “kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri”. Kuptimi i territorit jepet në nenin 5 të Kodit Penal ku thuhet se territori i Republikës

²²⁷Shih A. Hajdari *Ndihma juridike dhe ekstradimi*, Prishtinë, 2014. fq. 59.

së Shqipërisë në kuptim të ligjit penal quhet *hapësira tokësore*, gjerësia e ujerave territoriale dhe të brendshme detare , hapësira ajrore që shtrihet mbi hapësirën tokësore dhe të ujerave territorial dhe të brendshëm detarë, si dhe çdo vend tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqiptar. Kryesor është fakti se, jo vetëm vepra në tërësi por edhe në qofte se një pjesë e saj është kryer në Shqipëri, ekstradimi nuk mund të jepet.

Edhe Konventa Evropiane për ekstradim në nenin 7 paragrafi 2 ka përcaktuar se shteti mund të refuzojë kërkesën për ekstradim për veprën penale e cila sipas të drejtës të tij të brendshme konsiderohet se është kryer në tërësi apo pjesërisht në territorin e tij apo në vendin që konsiderohet pjesë e territorit të tij.²²⁸

1. Kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë në legjislacionin e shtetit të kërkuar.

Kjo do të thotë se vepra e kryer nga individë nuk njihet si e tillë nga legjislacioni i shtetit kërkuar, pra këtu do të ndodheshim përpara dënimit të paparashikuar si të tillë nga legjislacioni i vetë shtetit. E thënë ndryshe në këtë kontekst do të viheshim përpara një inkriminimi të veprës penale dhe në këtë mënyrë ekstradimi automatikisht nuk mund të lejohej. Kështu, kur personi që kryen veprën penale të shpërdorimit të detyrës por kjo vepër penale nuk njihet nga legjislacioni i shtetit kërkuar. Gjithashtu, ky kusht është i njohur edhe si parimi i “dënimit të dyfishtë” i parashikuar jo vetëm nga ligji shqiptar por edhe neni 2 i Konventës “Për Ekstradim”.²²⁹

3. Kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t’u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut.

²²⁸Shih nenin 7 paragrafi 2 të Konventës Evropiane për Ekstradimin ku thuhet se “Kur shkelja, që përligj kërkesën e ekstradimit, kryhet jashtë territorit të palës kërkuese, ekstradimi mund të refuzohet vetëm kur legjislacioni i palës së kërkuar nuk autorizon ndjekjen për një shkelje të njëjtë, të bërë jashtë territorit të saj, ose nuk e autorizon ekstradimin për shkeljen që është objekt i kërkesës.”

²²⁹Shih nenin 2 të Konventës “Për Ekstradim”.

Ekstradimi nuk mund të lejohet dhe do të pezullohej automatikisht në rastin kur vlerësohet se individi i kërkuar do t'u nënshtrohet persekutimeve apo diskriminimeve për shkak të racës, fesë seksit, gjuhës, shtetësisë, bindjeve politike ose dënimeve apo trajtimeve të egra çnjerëzore ose poshtëruese që përbejnë shkelje të një të drejte themelore. Këto raste që përmendëm përbejnë në mënyrë absolute shkelje dhe cenim të të drejtave jetësore të njeriut ndaj nuk mund të procedohet me ekstradimin sepse do të ndodheshim përpara mosrespektimit të të drejtave themelore të njeriut të cilat gjenden të garantuara në Konventën Evropiane” Për Ekstradim” si dhe në Kodin e Procedurës Penale.²³⁰

6.5. Ekstradimi për jashtë shtetit.

Ekstradimi funksionon si një institut i dyanshëm, çka do të thotë që një shtet gëzon të drejtën për të ekstraduar një person, i cili kërkohet nga një shtet për vepra penale të kryera atje, po kështu gëzon dhe të drejtën të kërkoj ekstradim të një personi në një shtet tjetër. Pra kemi ekstradim për jashtë shtetit dhe ekstradim nga jashtë shtetit. Legjislacioni i brendshëm në lidhje me ekstradimin për jashtë shtetit, pra të ekstradosh një individ duke pranuar kërkesën e një shteti tjetër, kërkon plotësimin e kushtit të marrëveshjes ndërkombëtare midis dy vendeve.²³¹ Shteti ynë duhet të verifikojë nëse shteti i cili kërkon kryerjen e ekstradimit është palë në marrëveshjet shumëpalëshe në të cilat Shqipëria ka ratifikuar konkretisht Konventën e Këshillit Evropian “Për Ekstradim” dhe dy protokollet shtesë të saj apo nëse ekziston marrëveshje dypalëshe me atë shtet. Pra, nëse lejohet ekstradimi për jashtë shtetit, duhet të shikohet nëse Shqipëria ka lidhur marrëveshje ose me saktë është palë me shtetin që kërkon ekstradimin.

²³⁰Komentari e Drejta e Procedures Penale Hoxha.A;Panda.I Hoxha.A:Ekstradimi sipas instrumentave ligjore te BE –se Ngjashmerite dhe ndryshimet me instrumentat e Keshillit te Evropes , Tirane 2010 fq 133-138 Neni 500 Kodi I Procedures Penale

²³¹Shih nenin 10 të Kodit të Procedures Penale, sku thuhet se “*Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij Kodi.*”

Mos përmbushja e këtij kushti bëhet shkak për mospranimin e kërkesës së ekstradimit nga vendi ynë. Pra, Shqipëria nuk mund të nisë kryerjen e ekstradimit për arsye se nuk plotësohet kushti kryesor, ai i marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet shteteve. Mungesa e marrëveshjes mes shteteve si kusht për pranimin e kërkesës së ekstradimit përcaktohet edhe në nenin 11 të Kodit Penal.²³² Dokumentacioni i nevojshëm që duhet t'i bashkëngjitet kërkesës për së ekstradimit për jashtë shtetit është :

1. Kopja e vendimit të dënimit me burgim ose dhe akte të tjera.
2. Të dhënat kryesore për veprën penale në ngarkim të personit që kërkohet të ekstradohet si dhe elementët bazik të saj si për shembull koha e veprës penale, vendi i kryerjes së saj etj.
3. Bazat ligjore të cilat janë zbatuar në rastin konkret në shtetin kërkues.
4. Të dhënat kryesore për identifikimin e personit të cilit i atribuohet vepra penale si dhe shtetësia e tij.²³³

Institucionet të cilat administrojnë procedurën e ekstradimit për jashtë shtetit janë Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria. Në nenin 489 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se *“Ekstradimi lejohet vetëm mbi bazën e një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë “*. Pra, nëpërmjet interpretimit të kësaj dispozite mund të themi që se Ministria e Drejtësisë është i vetmi autoritet që mund të vendosë lejimin ose jo të ekstradimit. Institucioni i cili i vjen në ndihmë Ministrisë së Drejtësisë për të vendosur lejimin ose jo të ekstradimit është gjykata, roli i të cilës duhet theksuar që është vetëm ndihmës. Pra, vendimi përfundimtar i takon Ministrisë së Drejtësisë edhe nëse i ndryshëm nga ai dhënë nga ana e gjykatës nuk mund të lejohet në asnjë rast ekstradimin pa kaluar me parë nëpërmjet procedurës gjyqësore.

²³²Panda .I,Hoxha .A Komentari *E Drejta e Procedures Penale* fq 708, Kodi i Procedures Penale Sesioni i 1 neni 489 Hoxha.A:Ekstradimi sipas instrumentave ligjorë te BE –se .Ngjashmeritë dhe ndryshimet me instrumentat e Keshillit tv Evropës, Tirane 2010 fq 128.

²³³Shih nenin 489 paragrafi 1 të Kodit të Procedures Penale.

Prokuroria është një institucion tjetër i rëndësishëm në procedurën e ekstradimit.²³⁴ Ministria vendos të procedoëj atëherë kur ajo ia përcjell aktet prokurorit pranë gjykatës kompetente. Veprimet e prokurorit bëhen nëpërmjet thirrjes dhe identifikimit të personit duke zbatuar rregullat e caktuar nga Kodi i Procedurës Penale, duke i komunikuar kështu personit kërkesën për ekstradim. Në nenin 492 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se prokurori ka 3 muaj kohë për të paraqitur kërkesën në gjykatë, që nga momenti që e ka marrë aktet nga Ministria e Jashtme.

6.6. Ekstradimi nga jashtë shtetit.

Ekstradimi nga jashtë shtetit është i lidhur ngushtësisht me shtetësinë. Kështu në nenin 6 të Kodit Penal sanksionohet shprehimisht se për veprat penale të kryera nga shtetas shqiptarë, apo shtetas të huaj ose pa shtetësi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë zbatohet ligji shqiptar.²³⁵ Por në disa raste ndodh që një shtetas shqiptar pasi kryen një vepër penale, largohet nga vendi dhe shkon në një shtet tjetër për ti shpëtuar ndjekjes penale. Në këtë rast institucioni i prokurorisë nis menjëherë procedimin penal. Një situatë e tillë sot zgjidhet nëpërmjet rrugës së ekstradimit nga jashtë shtetit, pra nëpërmjet kërkesës që i bëhet shtetit të huaj ku ndodhet personi që ka kryer një vepër penale dhe që duhet të përgjigjet për të sipas ligjit shqiptar.

Në këtë situatë është pikërisht Ministria e Drejtësisë autoriteti qëndror, që autorizohet sipas ligjit t'i drejtojë një kërkesë për ekstradim autoritetit kompetent ku ndodhet personi i kërkuar. Kërkesës së ministrisë duhet domosdoshmërisht t'i paraprij një kërkesë paraprake nga prokurori pranë gjykatës në territorin e të cilës procedohet ose është dhënë një vendim dënimi.

²³⁴Shih nenin 492 paragrafi 1 të Kodit të Procedures Penale.

²³⁵Shih nenin 6 të Kodit Penal të të Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se “Për vepra penale të kryera nga shtetas shqiptarë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë zbatohet ligji penal i Republikës së Shqipërisë. Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm edhe për shtetasin shqiptar që kryen krim në territorin e një shteti tjetër, kur krimi është njëkohësisht i dënueshëm dhe derisa nuk është dhënë për të një vendim përfundimtar nga një gjykatë e huaj. Kushti për dënueshmërinë e njëkohshme në territorin e shtetit tjetër nuk zbatohet në rastet e krimeve të korrupsionit në sektorin publik ose privat, si dhe të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm. Në kuptim të këtij neni shtetas shqiptarë do të konsiderohen edhe ata persona që përveç shtetësisë shqiptare gëzojnë edhe shtetësi tjetër.”

Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten të gjitha dokumentacionet e nevojshme. Në rastet kur shteti i huaj pranon kërkesën për ekstradimin e personit të kërkuar, por vendos disa kushte, atëherë është Ministria e Drejtësisë institucioni i cili vendos pranimin e kushteve ose jo. Nëse Ministria e Drejtësisë pranon ekstradimin me kushtet e vëna nga shteti tjetër atëherë prokuroria dhe gjykata janë të detyruara të respektojnë kushtin e pranuar.²³⁶

²³⁶Neni 504-505 i Kodit të Procedurës Penale sesioni i 2 Hoxha.A:Ekstradimi sipas instrumenteve ligjore të BE – se .Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentet e Këshillit të Evropës, Tirane 2010 fq 159 Komentari E drejta e Procedurës penale Hoxha .A .Panda .I fq 757

KAPITULLI VII. EKSTRADIMI NË LEGJISLACIONIN E BRENDSHËM. PROBLEMATIKAT AKTUALE NË LEGJISLACION DHE NË PRAKTIKË

7.1. Burimet parësore që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin tonë aktual.

Ekstradimi është hasur që me lindjen e krimin dhe burimet e para të ekstradimit kanë qenë marrëveshjet ose bashkëpunimi ndërmjet shteteve si formë më e përdorur për minimizimin e krimin. Ndryshimet ekonomike, sociale dhe politike kanë ndikuar në favorizimin e kriminalitetit dhe kapërcimin e kufijve territorial duke e shndërruar në faktor global. Globalizimi i kriminilitetit solli krijimin e institutit të ekstradimit dhe pasurimin e burime të cilat e rregullojnë atë.

Burimet parësore mbi të cilat ekstradimi mbështetet dhe gjen rregullim ligjor janë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ku parashikohen rregullat bazë të ekstradimit. Kushtetuta sanksionon një varg parimesh që lidhen me procesin e rregullt ligjor si: rastet e heqjes së lirisë dhe afatet maksimale në të cilat mund të kufizohet liria e individit. Kushtetuta përcakton dhe disa rregulla mjaft të rëndësishme në drejtim të normave ndërkombëtare, të cilat përbejnë burimet bazë që rregullojnë marrëdhëniet e ekstradimit. Kështu, Kushtetuta përben burimin kryesor që rregullon jo vetëm ekstradimin si institut po edhe marrëdhëniet e tij. Kushtetuta jep orientimet e duhura rreth procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve dhe për zbatimin e tyre në praktikë.
2. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, e trajtojnë ekstradimin si institut më vete dhe shërbejnë si burime ku mbështeten dhe sanksionohen rregullat bazë dhe procedurat kryesore të ekstradimit.
3. Marrëveshjet ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me shtetet e tjera, nisur nga fakti që ekstradimi është bashkëpunim i ndërsjellët ndërmjet

shtetit Shqiptar dhe shtetit tjetër. Pra marrëveshjet ndërkombëtare janë panorama e përgjithshme e kuadrit ligjor, që rregullojnë instrumentet dhe strukturat nëpërmjet të cilave realizohet ekstradimi.

4. Burim tjetër i rëndësishëm janë edhe marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga Shqipëria. Ky burim ligjor shërben për rregullimin e procedimit të ekstradimit kur Shqipëria i ka pranuar këto marrëveshje dhe kur këto marrëveshje kanë për objekt marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.

Në nenin 10 të Kodit të Procedurës Penale, do të përbejnë burim të së drejtës ato marrëveshje ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.²³⁷ Kjo zgjidhje e berë nga ligjvënësi është deri diku racionale pasi vetë ato marrëveshje ndërkombëtare, të cilat janë pranuar nga Shqipëria, mund të rregullojnë ekstradimin ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

7.2. Ekstradimi në legjislacionin e brendshëm

Me ligjin Nr.8322 datë 2.4.1998 Kuvendi i Shqipërisë miratoi “Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin”, dt. 13 Dhjetor 1957 dhe protokolleve shtesë, përkatësisht të 15 Tetorit 1957 dhe të 17 Marsit 1978, me deklaratimet dhe rezervat që parashikohen në këtë ligj. Në lidhje me rezervat në paragrafin 1 të nenit 2 të Konventës ,shteti shqiptar nuk njih kufij minimalë të masës të dënimit me burgim për efekt ekstradimi. Shteti shqiptar e njih të vlefshëm këtë deklaram vetëm në kushte reciprociteti.

Shteti shqiptar refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë²³⁸. Vendi ynë nuk lejon ekstradimin e personave që kanë kryer vepra penale në territorin shqiptar ose edhe jashtë

²³⁷Shih nenin 10 të Kodit të Procedurës Penale, Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Tiranë, Tetor, 2010.

²³⁸Shih nenin 6, pika 1, shkronja "a", Konventës Evropiane Për Ekstradimin

tij, kur vepra është kryer në dëm të interesave të shtetit ose shtetasve, përveç rastit kur arrihet marrëveshje e ndryshme me palën e interesuar.²³⁹ Sipas legjislacionit shqiptar kur personi që kërkohet të ekstradohet është duke vuajtur dënim për një vepër tjetër, me rastin e ekstradimit, lejohet të vuajë plotësisht dënimin në vendin kërkues.²⁴⁰

Në rastet e transitit ajror që nuk parashikon ulje në territorin shqiptar, nuk është i nevojshëm njoftimi paraprak. Deklarimet e pikave 1, 4 dhe 5 kanë vlerë vetëm në kushtet e reciprocitetit. Lidhur me nenin 12, pika 2, shteti shqiptar paraqet rezervën se kërkesa për ekstradim kurdoherë duhet të shoqërohet me tekstin origjinal ose të vërtetuar të ligjit që zbatohet. Shteti shqiptar garanton në këtë mënyrë në maksimum të drejtat dhe liritë themelore të njeriut duke paraqitur disa rezerva në lidhje me konventën dhe gjithashtu ka arritur një balancë ndërmjet respektimit të normave ndërkombëtare në përshtatje me normat e legjislacionit të brendshëm. Detyrimet ligjore të shtetit shqiptar pas nënshkrimit të Konventës dhe implementimi i frymës së kësaj konvente, gjeti përshtatje në legjislacionin e brendshëm dhe posaçërisht në Kodin e Procedurës Penale që parashikon kushtet dhe procedurën ligjore të ekstradimit të një personi si në rastin kur kërkues është vetë shteti shqiptar (ekstradim nga jashtë shtetit) dhe në rastin kur kërkues është një shtet tjetër (ekstradim për jashtë shtetit).

Konkretisht në nenin 488 të Kodit të Procedurës penale parashikohet kuptimi i ekstradimit *“Dorëzimi i një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale, mund të bëhet vetëm nëpërmjet ekstradimit.”* Ekzistenca e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, që ka dënuar një person për një vepër penale ose ekzistenca e një akti ligjor që mund të jetë fillimi i një procedimi nga organi i prokurorisë, janë kushte ligjore për të filluar një procedurë ekstradimi. Ekstradimi lejohet vetëm mbi bazën e një kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë. Ka mjaft raste që shteti

²³⁹Shih pikën 2 të nenit 19 Konventës Evropiane Për Ekstradimin

²⁴⁰Shih pikën 4, shkronja "a" të nenit 21 Konventës Evropiane Për Ekstradimin

kërkues i drejtohet edhe në rrugë diplomatike shtetit shqiptar nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme në raste të caktuara sipas marrëveshjeve dypalëshe të shtetit shqiptar me shtetin kërkues.

Në procedurën e zakonshme të parashikuar nga ligji procedural penal, kërkesës për ekstradim i bashkëngjiten: kopja e vendimit të dënimit me burgim ose e aktit të procedimit, një relacion mbi veprën penale që i ngarkohet personit për të cilin kërkohet ekstradimi, duke treguar kohën dhe vendin e kryerjes së veprës dhe cilësimin ligjor të saj, teksti i dispozitave ligjore që do të zbatohen, duke treguar nëse për veprën për të cilën kërkohet ekstradimi është parashikuar nga ligji i shtetit të huaj dënimi me vdekje, të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të mundshëm që shërben për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e personit, për të cilin kërkohet ekstradimi.

Këto kushte ligjore janë të detyrueshme për shtetin kërkues dhe ky rregull është në rezervën që shteti shqiptar ka paraqitur gjatë ratifikimit të Konventës së Ekstradimit. Një kërkesë shumë e rëndësishme, që ka të bëjë direkt me të drejtat dhe liritë themelore të individit, është edhe kushti ligjor garantues i shtetit kërkues i shprehur në dokumentacionin shoqëruar që personi i ekstraduar nuk do të dënohet me vdekje. Kjo është një kërkesë e rëndësishme në vazhdim të obligimit që ka shteti shqiptar gjatë protokollit shtesë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që hoqi dënimin me vdekje dhe që është pasqyruar edhe në legjislacionin e brendshëm penal.

Kur konkurrojnë disa kërkesa ekstradimi, Ministria e Drejtësisë cakton radhën e shqyrtimit. Për këtë qëllim ajo mban parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe veçanërisht datën e marrjes së kërkesës, rëndësinë dhe vendin e kryerjes së veprës penale ose shtetësinë dhe vendbanimin e personit të kërkuar, si dhe mundësinë e një riekstradimi nga shteti kërkues. Në qoftë se për një shkelje të vetme ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga shumë shtete,

ai i jepet shtetit ndaj të cilit është drejtuar vepra penale ose atij shteti mbi territorin e të cilit është kryer vepra.

Ekstradimi lejohet me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi, kur pala dorëzuese jep pëlqim të shprehur që i ekstraduari të ndiqet edhe për një vepër penale tjetër dhe i ekstraduari nuk ka kundërshtim, kur i ekstraduari, edhe pse ka patur mundësi, nuk ka lënë pasi e ka lënë atë është kthyer vullnetarisht. Në këtë rast kemi të bëjmë me një përgjegjësi personale dhe vullnet të personit për tu vënë përpara drejtësisë i cili edhe pse ka pasur mundësi për tu fshehur ai përsëri është treguar i gatshëm për të qenë para drejtësisë.

Ekstradimi nuk pranohet dhe refuzohet nga shteti shqiptar kur ai bëhet për qëllime të tilla siç janë: për një vepër me karakter politik ose kur rezulton që ai kërkohet për qëllime politike, kur ka arsye të mendohet se personi që kërkohet do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriu kur personi që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri, kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit, kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar, kur për veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar, kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje që të parashikojë ndryshe, kur është parashikuar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit që e kërkon.

Kur merr nga një shtet i huaj një kërkesë ekstradimi, Ministria e Drejtësisë, në qoftë se nuk e refuzon atë, ia dërgon bashkë me dokumentet prokurorit pranë gjykatës kompetente. Prokurori pasi merr kërkesën urdhëron paraqitjen e të interesuarit për të bërë identifikimin e tij dhe për të marrë pëlqimin eventual për ekstradimin. Të interesuarit i bëhet e ditur se ka të drejtë

të ndihmohet nga një mbrojtës. Prokurori u kërkon autoriteteve të huaja, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, dokumentacionin dhe informacionin që çmon të nevojshëm. Kërkesa e prokurorit depozitohet në sekretarinë e gjykatës, brenda 3-muajve nga data që ka ardhur kërkesa për ekstradim bashkë me aktet dhe sendet e sekuestruara. Sekretaria kujdeset për njoftimin e personit për të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësit të tij dhe përfaqësuesit eventual të shtetit kërkues, të cilët, brenda dhjetë ditëve, kanë të drejtë të shikojnë Neni 495 i K.Pr.Penale që ka të bëjë me Arrestimin nga policia gjyqësore u ndryshua me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002.

Në rastet e ngutshme, policia gjyqësore mund të bëjë arrestimin e personit, kundër të cilit është paraqitur kërkesa për arrestimin e përkohshëm. Ajo bën edhe sekuestrimin e provave materiale të veprës penale dhe të sendeve që i përkasin asaj. Autoriteti që ka bërë arrestimin njofton menjëherë prokurorin dhe Ministrinë e Drejtësisë. Brenda dyzet e tetë orëve prokurori e vë të arrestuarin në dispozicion të gjykatës në territorin e së cilës është bërë arrestimi, duke i dërguar edhe dokumentacionin përkatës. Gjykata, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi e miraton atë, kur janë kushtet ose vendos lirin e të arrestuarit. Për vendimin që merr ajo njofton Ministrinë e Drejtësisë. Masa e arrestit revokohet në qoftë se Ministria e Drejtësisë nuk kërkon, brenda dhjetë ditëve nga miratimi, mbajtjen e saj. Kopja e vendimit të dhënë nga gjykata për masat shtrënguese dhe sekuestrimet, në bazë të këtyre neneve, u njoftohet : prokurorit, personit të interesuar dhe mbrojtësit të tij, të cilët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit.

Kërkesa për ekstradim shqyrtohet me kërkesën e prokurorit nga gjykata e cila cakton seancën dhe njofton, të paktën dhjetë ditë përpara, prokurorin, personin me të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësin e tij dhe përfaqësuesin eventual të shtetit kërkues. Gjykata merr të dhëna dhe bën verifikimet që i çmon të nevojshme, si dhe dëgjon personat e thirrur në gjykim. Gjykata jep vendim në favor të ekstradimit kur ka të dhëna të rëndësishme fajësie ose

kur ekziston një vendim dënimi i formës së prerë. Në këtë rast, kur ka kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata vendos paraburgimin e personit që duhet të ekstradohet dhe që ndodhet në gjendje të lirë, si dhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale. Gjykata jep vendim kundër ekstradimit kur janë rastet e parashikuara për mospranimin e kërkesës së ekstradimit. Kur gjykata jep vendim kundër ekstradimit, ekstradimi nuk mund të bëhet.

Vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëpasshëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërkesë të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata. Ministria e Drejtësisë disponon për ekstradimin brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë. Me mbarimin e këtij afati, edhe kur nuk është disponuar nga ministri, personi për të cilin është kërkuar ekstradimi, në qoftë se është i burgosur, lirohet. Personi lirohet edhe në rast refuzimi të kërkesës së ekstradimit. Ministria e Drejtësisë i komunikon shtetit kërkuar vendimin dhe, kur ky është pozitiv, vendin e dorëzimit dhe datën nga fillimi i së cilës do të jetë e mundur të veprohet.

Afati i dorëzimit është pesëmbëdhjetë ditë nga data e caktuar dhe me kërkesë të arsyetuar të shtetit kërkuar mund të zgjatet edhe pesëmbëdhjetë ditë të tjera. Vendimi i ekstradimit e humbet fuqinë dhe i ekstraduari lirohet kur shteti kërkuar nuk vepron, në afatin e caktuar, për marrjen në dorëzim të të ekstraduarit.

7.3. Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare për ekstradimin të ratifikuara gjatë periudhës 2000-2010.

Traktati i parë për ekstradim është nënshkruar me Greqinë dhe pas tij janë nënshkruar një sërë traktatesh të tjerë ekstradimi me Britaninë e Madhe dhe me Mbretërinë e Serbisë,

Kroacisë e Sllovenisë. Gjatë periudhës së regjimit të monarkisë, Shqipëria ka miratuar një legjislacion modern duke shfrytëzuar modelet më të mira të kohës dhe konkretisht atë italian e francez. Një akt tjetër ndërkombëtar me rëndësi të veçantë për kohën, është Traktati i lidhur ndërmjet Mbretërisë Shqiptare dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pas luftës së dytë botërore, gjendur në këto rrethana politike e juridike, Shqipëria gjatë kësaj periudhe ka lidhur vetëm disa konventa dypalëshe dhe këto vetëm me shtetet e ish bllokut komunist. Ndërkohë, zhvillimin real e të rëndësishme në marrëdhëniet e bashkëpunimit me autoritetet e huaja e morën pas ndryshimeve që pësoi regjimi politik pas viteve '90. Nga ana tjetër, miratimi i një legjislacioni modern dhe konkretisht Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale, përkatësisht në vitet 1994 e 2000, mund të konsiderohen si akte normative që pasqyruan ekstradimin në harmoni me standardet evropiane të vendosura nga konventat e Këshillit të Evropës, protokollet e tyre shtesë, si dhe rekomandimet e miratuara në zbatim të tyre.²⁴¹ Marrëveshjet më të rëndësishme në këto vite janë marrëveshje dypalëshe mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë “Mbi transferimin e personave të dënuar”; Marrëveshje dypalëshe mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë “Për ekstradimin” dhe “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet penale”; Marrëveshje dypalëshe mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për njohjen e vendimeve penale të huaja”, Marrëveshje dypalëshe mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për ekstradimin” dhe “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet penale dhe civile”, Marrëveshje dypalëshe mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë “Për ndihmën e ndërsjelltë juridike në çështjet penale dhe civile” miratuar me ligjin nr. 8304, datë 12.03.1998; Marrëveshje dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve penale të huaja” miratuar ligjin nr. 8303, datë 12.03.1998; Marrëveshje dypalëshe

²⁴¹Softa E., Ekstradimi i një e drejtë, në kuadër të të drejtave të individit. (Kuadri ligjor shqiptar), Jus&Justicia, nr.12.2016.

midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë “Për ekstradimin”, e ratifikuar nga parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8299, datë 4.03.1998.

Shqipëria gjithashtu, duke qenë një vend gjeografikisht evropian gjatë periudhës 2000-2010 ka nënshkruar disa marrëveshje ndërkombëtare të rëndësishme në lidhje me ekstradimin.. Shqipëria në frymën e “Konventës Evropiane të Ekstradimit” të vitit 1957 dhe “Konventës Evropiane të Ndhmës së Ndërsjellte Juridike “ e vitit 1959 ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe rajonale edhe me shtetet ndërkufitare apo më gjerë siç është:

- Marrëveshje me Hungarinë për luftën kundër krimit, të vitit 2000;
- Marrëveshje me Rumaninë për luftën kundër krimit²⁴², të vitit 2002;
- Protokoll i mirëkuptimit me Italinë për bashkëpunim policor kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali²⁴³ të vitit 2003;
- Marrëveshje me Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale²⁴⁴ , të vitit 2003;
- Marrëveshje me Italinë për transferimin e personave të dënuar²⁴⁵, të vitit 2004;
- Marrëveshje me Maqedoninë për luftën kundër krimit²⁴⁶, të vitit 2004;

²⁴²Ratifikuar me ligjin nr. 8945, datë 03.10.2012, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme”.

²⁴³Ratifikuar me ligjin nr. 9019, datë 06.03.2013, Për ratifikimin e “Protokollit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Italisë për zhvillimin e programeve të mbështetjes së forcave të policisë shqiptare dhe të bashkëpunimit ndërmjet të dyja vendeve në luftë kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali”.

²⁴⁴Ratifikuar me ligjin nr. 9081 date 19.06.2013, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale”.

²⁴⁵Ratifikuar me ligjin nr. 9169, datë 22.01.2004, Për ratifikimin e Marrëveshjes shitesë të Konventës Evropiane të 21 Marsit 1983 “Për transferimin e personave të dënuar” ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë.

²⁴⁶Ratifikuar me ligjin nr. 9307, datë 04.11.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme”.

- Marrëveshje me UNMIK për transferimin e personave të dënuar²⁴⁷, të vitit 2005;
- Marrëveshje me Mbretërinë e Belgjikës për bashkëpunimin policor , të vitit 2005;²⁴⁸
- Marrëveshje me Bullgarinë për ndihmë të ndërsjellët juridike.²⁴⁹ të vitit 2005;
- Marrëveshje me Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit²⁵⁰, të vitit 2006;
- Marrëveshje me Italinë, për ekstradim të ndërsjellë të personave²⁵¹, të vitit 2008;
- Marrëveshje me Spanjën për bashkëpunim në luftën kundër krimit²⁵², të vitit 2009;
- Marrëveshje me Çekinë për bashkëpunim në luftën kundër krimit,²⁵³ të vitit 2009;

Duhet theksuar se këto marrëveshje rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale midis shteteve nënshkruese, lidhur me format e bashkëpunimit të ndërsjellë për çështjet penale, si: të kryerjes së këqyrjeve; të dërgimit dhe dorëzimit të provave materiale; të kryerjes së ekspertimeve; të pyetjes së të pandehurve, dëshmitarëve, ekspertëve, të pyetjes së palëve dhe të personave të tjerë; të këqyrjes drejt për drejtë nga Gjykata; të dorëzimit të dokumenteve; dorëzimi i fajtorëve

²⁴⁷Ratifikuar me ligjin nr. 9496, datë 20.3.2006, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për transferimin e personave të dënuar”.

²⁴⁸Ratifikuar me ligjin nr. 9427, datë 13.10.2005, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Belgjikës për bashkëpunimin policor”.

²⁴⁹Ratifikuar me ligjin nr. 9348, datë 24.02.2005, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile”.

²⁵⁰Ratifikuar me ligjin nr. 9505, datë 03.04.2006, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit”, të vitit 2006.

²⁵¹Ratifikuar me ligjin nr. 9871, datë 11.02.2008, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane për ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për ndihmë juridike për çështjet penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre”, hyrë në fuqi në 01.08.2011.

²⁵²Ratifikuar me ligjin nr. 10155, datë 15.10.2009, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”.

²⁵³Ratifikuar me ligjin nr. 10162, datë 15.10.2009, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në luftën kundër krimit”.

(ekstradimi), dhe rastet e refuzimit; njohja e ndërsjelltë e vendimeve penale, etj.

Në frymën e KEDNJ, ku ‘e drejta për liri dhe siguri’ i takon cdo individ si një e tërë dhe është e patjetërsueshme, ecën edhe Konventa tjetër evropiane, e titulluar “Për ekstradimin”, e cila është bërë pjesë përbërëse e legjislacionit shqiptar. Kështu, legjislacioni shqiptar, për ekstradimin bazohet mbi parime të mirëpërcaktuara dhe mirëpranuara, të cilat i sigurojnë individit që ekstradohet, respektimin e të drejtave dhe lirive të tij. Në këtë kontekst, shkon edhe ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, ku Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër respektimin dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara në marrëveshjet mes shteteve dhe ka si qëllim të saj parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, vënien e autorëve të veprave penale para drejtësisë dhe zbatimin ndaj tyre të dënimeve efikase. Nëpërmjet këtij ligji, rregullohet përcaktimi i rregullave plotësuese procedurale në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale, çka nënkupton se dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm: në procedimet që lidhen me veprat penale, të cilat, në çastin e paraqitjes së kërkesës, janë në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkues ose në Republikën e Shqipërisë; në procedimet që janë në juridiksionin e GJEDNJ ose gjykatave të tjera ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është pranuar nga Republika e Shqipërisë, në referencë të parimit kushtetues se as edhe një shtetas shqiptar nuk mund të dëbohet nga territori i shtetit, dhe ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor (neni 39).

7.3.1. Traktati i ekstradimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Marrëveshja e vetme e cila pranonte ekstradimin e shtetasve të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit, për shumë vite ka qenë Traktati i Ekstradimit me SHBA-të²⁵⁴. Kjo marrëveshje ka të bëjë me ekzekutimin në rrugë diplomatike. Praktika gjyqësore i ka dhënë të drejtë ekstradimit të shtetasve shqiptar, që kanë qenë të kërkuar nga drejtësia amerikane dhe që janë ekstraduar duke u proceduar në rrugë diplomatike bazuar në marrëveshjen dypalëshe. Me vendimin nr. 665 datë.17.12.2004 kolegji penal i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se “E drejta e ekstradimit nuk mund të rregullohet vetëm nga normat kombëtare dhe nga legjislacioni i brendshëm. Përcjellja e një personi për jashtë shtetit për tu ndjekur penalisht mund të bëhet minimalisht në bazë të një marrëveshje dypalëshe me shtetin kërkuar.”

Në rastin konkret që shqyrton Gjykata e Lartë, Shteti Shqiptar dhe ai Amerikan kanë nënshkruar një marrëveshje dypalëshe për ekstradim në 1 Mars viti 1933, e cila është ratifikuar në Senatin Amerikan në vitin 1934 dhe në Parlamentin Shqiptar në vitin 1935. Kjo marrëveshje nuk është denoncuar nga asnjë nga vendet dhe është pjesë e legjislacionit të brendshëm për sa kohë që edhe kushtetuta e vitit 1998 e lejon në nenin 181 të saj. Kjo marrëveshje nuk është antikushtetuese dhe është në fuqi të plotë. Sipas kësaj marrëveshje ekstradimi do të kryhet nga agjentët diplomatikë dhe në rrugë diplomatike. Në rastin konkret procedura e ekstradimit është ligjore dhe nuk ka asnjë shkelje për shkak të ekzistencës së një marrëveshjeje ndërkombëtare dypalëshe, e cila parashikon një shkurtim në kohë dhe në procedura të ekzekutimit të ekstradimit.

²⁵⁴Traktati u nënshkrua në Tiranë më datë 1 mars 1933. Senati e dhe pëlqimin për ratifikim më datë 2 shkurt 1934. Traktati u ratifikua nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara më 21 shkurt 1934. Traktati është ratifikuar nga Shqipëria më 20 prill 1935. Ratifikimet u shkëmbyen në Uashington DC, më 14 nëntor 1935. Traktati hyri në fuqi 14 nëntor 1935, dhe u shpall nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara më 19 nëntor 1935.

http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_United_States_extradition_treaties

Marrëveshjet ndërkombëtare për ekstradimin e personave që dyshohen ose kanë kryer një vepër penale, bashkëpunimi i shteteve për të luftuar kriminalitetin dhe për të krijuar bindjen se në asnjë vend të botës nuk mund ti shpëtosh drejtësisë dhe dhënies llogari për veprat penale, është mjaft i rëndësishëm. Ky bashkëpunim ndërmjet shteteve është konkretizuar me konventa, të cilat pasi janë ratifikuar nga shtetet janë bërë pjesë e brendshme e legjislacionit të tyre. Por krahas këtyre konventave shumëpalëshe, shpeshherë shtete të ndryshëm hyjnë në marrëveshje dypalëshe të cilën duhet ta respektojnë. Këto marrëveshje dypalëshe ka raste që bien ndesh me parimet, frymën dhe dispozitat e konventave shumëpalëshe. Rasti konkret është shteti Shqiptar, i cili në bazë të marrëveshjes me Amerikën në 1 Mars 1933 ekstradon shtetas të kërkuar nga drejtësia amerikane edhe në kundërshtim me normat dhe rregullat procedurale të konventave ndërkombëtare.

Gjykata Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, ka dënuar shtetin Shqiptar me 1500 euro gjobë për shkak se ka kryer ekstradime në kundërshtim dhe në shkelje të konventës të së drejtave të njeriut. Rasti konkret ka qenë i shtetasit shqiptaro-amerikan A.R i cili u ankua në gjykatë se ekstradimi i tij shkel nenet 2 (e drejta për jetën) dhe 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe Neni 1 i Protokollit nr. 13 (heqja e dënimit me vdekje) të Konventës. Gjithashtu ai u ankua se ekziston dhe rreziku t'i nënshtrohet dënimit me vdekje, i cili parashikohej në shtetin Amerikan. Ai më tej u ankua se ai ishte ekstraduar në shkelje të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut tregues sipas rregullës 39 të Rregullores së Gjykatës për qeverinë shqiptare që të mos ekstradojë atë, në shkelje të nenit 34 të Konventës (e drejta për aplikimet individuale). Për këto arsye gjykata vendos dënimin e shtetit shqiptar me një gjobë 1500 Euro”, argumenton vendimin e saj Gjykata e Strasburgut. Ky vendim i Gjykatës së Strasburgut është një goditje për drejtësinë shqiptare, e cila përdor dy standarde në vlerësimin e procedurave të ekstradimit dhe jo vetëm kaq, por ky vendim vë në dukje edhe një “zgjuarsi” juridike të shtetit Amerikan dhe një

“nënshttrim” të shtetit Shqiptar, i cili është gati të shkelë edhe konventa ndërkombëtare kur vjen puna për kërkesa të bëra nga shteti Amerikan.

Hyrja e traktatit ka parashikuar se Republika e Shqipërisë dhe SHBA-të janë të gatshme të bashkëpunojnë ndërmjet tyre në fushën e ekstradimeve. Neni 1 i këtij traktati ka parashikuar se palët kontraktuese angazhohen të marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet në kuadër të këtij traktati, ndërsa Neni 2 ka parashikuar tërësinë e veprave penale, autorët e të cilave mund të ekstradohen sipas këtij traktati. Në këtë artikull janë parashikuar një listë të gjatë prej 26 veprash penale. Neni 3 parashikon se dispozitat e këtij traktati nuk japin të drejtë të kërkohej ekstradimi për ndonjë çështje me karakter politik. Ky nen parashikon gjithashtu se *"Shteti prej të cilit kërkohej ekstradimi ose gjykatat e këtij shteti, do të vendosin nëse çështja ka karakter politik"*. Pra, i takon autoriteteve kompetente të shtetit të cilit i kërkohej ekstradimi të përcaktojë se kur një vepër penale ka natyrë politike. Ky nen është tepër i veçantë, pasi veprat e sipërcituara nuk duhen konsideruar si vepra penale me natyrë politike, dhe autorët e tyre mund të ekstradohen sipas rregullave të këtij traktati. Neni 6 rregullon ato raste kur personi, që kërkohej të ekstradohet sipas marrëveshjes është arratisur, por, për të cilin vazhdon ndjekja penale, dhe në rrethanat kur ky person është duke vuajtur dënimin në shtetin ku ka kërkuar strehim për një vepër penale të kryer në shtetin ku ka kërkuar strehim, në një situatë të tillë ekstradimi duhet të shtyhet deri në momentin kur personi në fjalë ezauron ndëshkimin sipas legjisllacionit të shtetit në të cilin ndodhet.²⁵⁵

Neni 7 nuk do të cenojë traktatet që janë lidhur qysh më parë prej njëres ose tjetres nga palët kontraktuese me shtetet e tjera. Sipas parashikimit që bën ky nen në rastin kur janë paraqitur disa kërkesa për ekstradimin e një kriminelit të arratisur, duhet të favorizohet kërkesa që është paraqitur më përpara në kohë, duke përjashtuar rastin kur hiqet dorë nga kërkesa. Ky nen i ka dhënë një zgjidhje mjaft të drejtë situatës kur janë paraqitur disa kërkesa për ekstradimin e të

²⁵⁵Shih nenin 6 të marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë me SHBA-në nënshkruar me 1 Mars 1933.

njëtit person, duke marrë parasysh faktin se të dyja shtetet palë në këtë traktat janë palë edhe në dokumente të tjera të rëndësishme në fushën e ekstradimeve, çka nënkupton se nuk mund të veprohet nëpërmjet preferencës në një rast të tillë.²⁵⁶ Neni 8 parashikon mungesën e detyrimit për ekstradimin e shtetasve respektivë, përveç kur shtetësia është marrë pas kryerjes së deliktit për të cilin kërkohet ekstradimi i takon shtetit të cilit i kërkohet ekstradimi të evidentojë, nëse personi që kërkohet është apo jo shtetas i tij.

Neni 9 i marrëveshjes midis SHBA-së dhe Republikës së Shqipërisë parashikon aspektet teknike ,që kanë të bëjnë kryesisht me detyrimin për të paguar shpenzimet përkatëse gjatë ndjekjes së ekstradimeve, dhe siç parashikohet në këto të fundit detyrohet t'i paguajë në masën e parashikuar shteti kërkues, gjithashtu është parashikuar se autoritetet kompetente të të dyja palëve duhet të asistojnë njëra-tjetrën gjatë ndjekjes së procedurave, por nga kjo ndihmë e ofruar këta nëpunës kanë edhe përfitime të tjera përveç atyre që ka parashikuar shteti të cilit i kërkohet ekstradimi. Neni i 12-të, në paragrafin e tij të parë parashikon shtrirjen territoriale të këtij traktati,duke nënvizuar se ky traktat është njësoj i vlefshëm për tërë territorin mbi të cilin secili nga shtetet ka pushtet efektiv. Në paragrafin e dytë ka parashikuar titullarin kompetent për të ngritur kërkesën për ekstradim kur personi që kërkohet të ekstradohet ka statusin e të arratisurit nga drejtësia. Në një rast të tillë sipas parashikimit që bën ky nen, ky titullar është një agjent diplomatik për secilin shtet, dhe në mungesë të tij kjo kërkesë mund të bëhet nga zyrtarët e pror konsullor. Në paragrafin e tretë të këtij neni është parashtruar se arrestimi dhe dorëzimi i personit, që kërkohet të ekstradohet, duhet të bëhet konformë ligjit në fuqi në të dy vendet.

Pra, në rastin e arrestimit të përkohshëm, secila palë e ndodhur në pozicionin e palës kërkuese duhet që brenda dy muajve t'i drejtoj shtetit të kërkuar kërkesën për ekstradim së bashku me dokumentet provuese, në të kundërt shteti i kërkuar liron personin e arrestuar

²⁵⁶Shih nenin 7 të marrëveshjes së Republikës së Shqipërisë me SHBA -nënshkruar më 1 Mars 1933.

përkohësisht. Në paragrafin e pestë është parashikuar se kur krimineli i arratisur është dënuar për veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi, duhet të paraqitet kopja autentike e vendimit të gjykatës që ka caktuar këtë dënim, dhe në rastin kur personi që kërkohet të ekstradohet është vetëm i akuzuar për një vepër penale, duhet të paraqitet një kopje autentike e mandatit të arrestit të shtetit ku është kryer delikti së bashku me provat që provojnë fajësinë e të arratisurit.²⁵⁷ Ky nen i fundit ka përcaktuar mënyrën e marrjes fund të këtij traktati. Kështu, ky nen parashikon një afat pesë vjeçar brenda të cilit palët kontraktuese kanë të drejtë të parashitrojnë qëllimin e vet për të dhënë fund këtij traktati, dhe nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë ky traktat do të vazhdojë të mbetet në fuqi. Deri më sot, ndonjë kërkesë për dhënien fund të këtij traktati nuk është bërë, dhe ky traktat vazhdon të mbetet në fuqi.

7.3.2. Marrëveshja e ekstradimit ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar marrëveshjen për ekstradim me Italinë²⁵⁸, sipas së cilës palët kontraktuese pranojnë ekstradimin e shtetasve të saj mbi baza reciprociteti në përputhje me normat dhe kërkesat e Konventës Evropiane "Për Ekstradimet", duke specifikuar gjithashtu edhe organet kompetente për ndjekjen e procedurave.²⁵⁹ Qëllimi që kanë palët, lidhet së pari me lehtësimin e zbatimit dhe me plotësimin e Konventës për Ekstradimet. Të dy shtetet heqin dorë nga e drejta për të refuzuar dorëzimin e shtetasve respektivë, siç parashikohet në nenin 6 paragrafi i 1 i "Konventës Evropiane për Ekstradimin". Sipas marrëveshjes, palët kontraktuese nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit²⁶⁰. Marrëveshja në fjalë, në

²⁵⁷Nenet 2-13, Traktati i ekstradimit midis SH.B.A dhe R.SH, nënshkruar më 1 Mars 1933.

²⁵⁸Ratifikuar me ligjin nr. 9872, datë 11.02.2008.

²⁵⁹Neni 18, pika 3 e Marrëveshjes parashikon se, kërkesat për ekstradimin bëhen drejtpërdrejt midis autoriteteve qendrore: për Republikën e Italisë nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë Penale, zyra II, pranë Ministrisë së Drejtësisë; ndërsa për Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë.

²⁶⁰Neni 18, pika 2 e Marrëveshjes.

nenin 18 të saj “Ekstradimet e shtetasve” ka parashikuar: “...Palët kontraktuese marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre, që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit, apo të një mase shtrënguese, në përputhje me normat apo kërkesat e Konventës Evropiane “Për ekstradimin”. Palët kontraktuese nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit.²⁶¹ Kërkesat për ekstradim bëhen drejtpërdrejtë midis autoriteteve qëndrore. Për Republikën e Italisë nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë Penale, zyra pranë Ministrisë së Drejtësisë; Për Republikën e Shqipërisë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë”.

Lidhur me ekstradimin, legjislacioni italian parashikon se, vendimi për ekstradimin e një shtetasi të huaji nuk mund t'i jepet pa vendimin favorit të Gjykatës së Apelit²⁶², ndërsa Neni 703 ka parashikuar vendimet e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili merr kërkesën për ekstradim nga Ministria e Drejtësisë, i kërkon autoritetit kompetent të huaj nëpërmjet ministrisë së Drejtësisë dokumentet dhe informacionin e nevojshëm, dhe ka detyrimin që brenda tre muajve nga data e paraqitjes së kërkesës nga Ministria e Drejtësisë t'ia kalojë çështjen për shqyrtim gjykatës,²⁶³ e cila ka detyrimin t'i komunikojë palëve datën e seancës gjyqësore dhjetë ditë përpara zhvillimit të saj, dhe vendos në dhomën e këshillimit pasi ka marrë të gjitha informacionet dhe pasi ka dëgjuar palët për lejimin ose jo të ekstradimit, dhe kur vendimi është në favor të ekstradimit caktohet data e dorëzimit të personit që do të ekstradohet.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë nga personi i interesuar, apo nga përfaqësuesi i tij, nga Prokurori i Përgjithshëm dhe nga

²⁶¹Neni 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane "Për ekstradimin" ka parashikuar se shtetet ratifikuese kanë të drejtë të heqin dorë nga ekstradimi i shtetasve të tyre, duke iu lënë mundësi që për një çështje të tillë, shtetet të mund të disponojnë mbi bazë reciprociteti.

²⁶²Neni 701 i K.Pr.P të Italisë ka parashikuar se Gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjeve të ekstradimit është Gjykata e Apelit, ndërsa Neni 704 ka parashikuar procedurën e kësaj gjykate.

²⁶³Nenet 700-722, Codice Penale e di Procedurale Penale e leggi complementari, Giustino Gatti, Raffaele Marino e Rossana Petrucci, edizioni Simone 1995.

përfaqësuesi i shtetit që e kërkon²⁶⁴. Pezullimin e dorëzimit të personit, që kërkohet të ekstradohet parashikohet në nenin 709, sipas së cilit pezullimi aplikohet në qoftë se personi duhet të gjykohet në territorin e shtetit të kërkuar, ose do t'i ulet dënimi për krimet e kryera para ose pas krimit për të cilin është dhënë ekstradimi, megjithatë pjesën e dënimit të mbetur (për një vepër penale të ndryshme nga ajo për të cilën kërkohet ekstradimi) personi mund ta vuajë në shtetin kërkues. Gjithashtu, legjislacioni procedural penal italian ka parashikuar edhe mundësinë e arrestimit të personit nga ana e policisë gjyqësore²⁶⁵, sipas të cilit autoriteti që bën arrestimin në një rast të tillë informon Ministrinë e Drejtësisë dhe jo më vonë se 48 orë pas arrestimit ky i fundit lajmëron kryetarin e Gjykatës së Apelit, i cili brenda 96 orëve nga arrestimi i jep informacion Ministrisë së Drejtësisë për arsyet e mos lirimit. Ndërsa lidhur me mundësinë e revokimit të kësaj mase sigurie nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Si përfundim mund të themi se kjo marrëveshje ka qenë e nevojshme për faktin se u nënshkrua nga dy vende fqinjë, ku shtetas të shumtë të tyre rezultojnë të përfshirë në aktivitete kriminale, dhe lufta kundër kriminalitetit e kërkonte një marrëveshje të tillë për ekstradimin e ndërsjelltë të shtetasve. Deri para hyrjes në fuqi të marrëveshjes në fjalë, një numër i konsiderueshëm shtetas shqiptarë kanë përfitur nga mungesa e një marrëveshje ekstradimi dypalëshe me Italinë, dhe për t'iu shmangur ndjekjes penale janë kthyer në Shqipëri. Aktualisht, nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje disa shtetas shqiptarë të cilët më parë ishin shpallur në kërkim nga autoritetet italiane, janë ekstraduar drejt Italisë, apo janë arrestuar për qëllim ekstradimi dhe janë duke iu nënshtruar procedurave gjyqësore për këtë qëllim.

Janë vërejtur probleme nga strukturat e policisë, lidhur me identifikimin e shpejtë të personave të shpallur në kërkim për të cilët është kërkuar arrestimi dhe ekstradimi i tyre drejt Italisë. Problemet kanë konsistuar në verifikimin e personave bazuar vetëm nga kartela daktiloskopike

²⁶⁴Neni 706 ka parashikuar një mundësi të tillë për rekurs në Gjykatën e Kasacionit.

²⁶⁵Neni 715 parashikon se në rastet e urgjencës policia gjyqësore autorizohet për arrestimin dhe sekuestrimin e personit dhe sekuestrimin e objekteve që kanë shërbyer për realizimin e veprës penale ose janë produkt i saj.

e ardhur nga shteti italian, pasi disa persona nuk kanë qenë *daktiloskopuar* më parë në Shqipëri, dhe gjeneralitetet e prezantuara nga pala italiane kanë qenë jo reale. Duhet thënë se në përgjithësi kontingjenti kriminal përdor identitete të ndryshme jashtë vendit, apo përfiton nga procedurat për të ndryshuar gjeneralitetet në zyrat e gjendjes civile në vendin tonë, ndryshime këto që në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile nuk evidentohen në ndonjë rubrikë të veçantë.²⁶⁶

7.3.3. *Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”*²⁶⁷

Marrëveshjet mes shteteve kanë karakteristika të ndryshme, në varësi të çështjeve për të cilat lidhen dhe në kuptimin e ligjit, ato përcaktojnë fusha të caktuara të së drejtës, së cilave ju nënshtrohen dhe sanksionojnë norma të detyrueshme për palët.

Marrëdhëniet juridiksionale me shtetet e huaja në fushën penale, janë një lloj i veçantë i këtyre marrëdhënieve, të cilat në themel të tyre kanë zbatimin e ligjit penal dhe atij procedural me efikasitet.

Termi “marrëdhënie juridiksionale” ka të bëjë me spektrin e marrëdhënieve që rregullohen dhe që kanë të bëjnë me dhënien e drejtësisë. Marrëdhëniet juridiksionale kanë në themel të tyre ndihmën dhe asistencën e ndërsjellë në fushën penale, e cila realizohet nëpërmjet rregullave të përcaktuara në marrëveshjet mes shteteve, dhe ka si qëllim të saj parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, vënien e autorëve të veprave penale para drejtësisë dhe zbatimin ndaj tyre të dënimeve efikase²⁶⁸.

²⁶⁶Elezi M, “*Agreement of Extradition*” *betëen Albania and Italia*”, “Academic Journal of Interdisciplinary Studies”, Vol. 2, No. 9, p. 68, October 2013, Romë, Itali. www.mcser.org

²⁶⁷Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, Fletore Zyrtare nr.181/2009

²⁶⁸Softa E., *Ekstradimi si një e drejtë, në kuadër të të drejtave të individit. (Kudri ligjor shqiptar)*, Jus&Justicia, nr.12.2016.

Ndihma juridike e ndërsjellë nënkupton, që me nënshkrimin e një marrëveshje, shtetet palë marrin përsipër të drejta dhe detyrime reciproke që duhet të zbatohen në secilin rast që lypet e nevojshme. Shtete nënshkruese palë në të, përveçse marrin përsipër një detyrim të tillë, veprojnë me përpikmëri brenda një kuadri ligjor, i cili ka si bazë të tij jo vetëm marrëveshjen, por edhe normat ndërkombëtare të adoptuara përgjithësisht nga shtetet, duke u bërë pjesë e së drejtës së brendshme.

Neni 39 i Kushtetutës ka parashikuar se: as edhe një shtetas shqiptar nuk mund të dëbohet nga territori i shtetit, dhe ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, dhe vetëm me vendim gjyqësor.

Në prizmin e këtij parimi, të njohur nga Kushtetuta dhe KEDNJ, duhet parë edhe kudri ligjor që vendos Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale“, i cili parashikon një sërë instrumentash ligjor, të cilët bëjnë të mundur ekstradimin e një personi, por në të njëjtën kohë i siguron atij edhe mbrojtjen ligjore të nevojshme, që autoriteti shtetëror është i detyruar të respektojë në funksion të procesit të ekstradimit.

Ky ligj, ka si objekt të rregullimit të tij: përcaktimin e rregullave plotësuese procedurale në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale (neni 1/1), çka nënkupton se dispozitat e këtij ligji do të zbatohen vetëm:

- në procedimet që lidhen me veprat penale, të cilat, në çastin e paraqitjes së kërkesës, janë në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkues ose në Republikën e Shqipërisë;
- në procedimet që janë në juridiksionin e GjEDNJ ose gjykatave të tjera ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, në funksion të zbatimit të këtij ligji, një rol të rëndësishëm zë instrumenti ligjor i ‘letër-kërkesës’, e cila është forma me të cilën paraqiten kërkesat që krijojnë marrëdhënie juridiksionale ndërkombëtare.

Kështu, vetë ‘letër-kërkesa’, si instrument ligjor, duhet të paraqitet në formën e caktuar, që nënkupton një: (a) ‘Letërporosi’, ku përfshihen njoftimet e akteve, si dhe marrja e akteve të tjera dhe provave të procedimit penal, ose (b) Kërkesa të tjera, ku përfshihen ekstradimi i personave të proceduar penalisht, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të huaja, transferimi i procedimeve penale dhe transferimi i personave të dënuar.

Letërkërkesa, paraqitet nga autoritet kompetente, i cili i referohet një autoriteti qëndror, sipas rastit:

1. Letërkërkesa e autoriteteve gjyqësore shqiptare i përcillet autoriteteve gjyqësore të huaja nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, përveç rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.
2. Në rast urgjence, autoritetet gjyqësore shqiptar mund t’i përcjellin letërkërkesat drejtpërdrejt, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm parashikon ndryshe. Në rast të përcjelljes së drejtpërdrejtë të letërkërkesave, autoriteti gjyqësor vendas njofton njëkohësisht edhe Ministrinë e Drejtësisë.
3. Letërkërkesat e autoriteteve gjyqësore të huaja i përcillen autoriteteve gjyqësore vendase nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm parashikon ndryshe.

Kur shteti shqiptar, merr një ‘Letërkërkesë’, nga një autoritet qëndror i huaj, ai procedon në këtë mënyrë:

1. Ministria e Drejtësisë i jep rrugë letërkërkesës së huaj pasi vlerëson kushtet e përcaktuara në legjislacionin e brendshëm. Në vijim, letërkërkesa i përcillet prokurorit të rrethit, ku duhet ekzekutuar letërkërkesa, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Nëse autoriteti gjyqësor vendas ka kompetencë për ekzekutimin e një prej disa veprimeve të kërkuara, atëherë ai mund të procedojë me ekzekutimin e të gjitha veprimeve, nëse një gjë e tillë është e përshtatshme.
3. Kur autoriteti gjyqësor vendas, që merr një letërkërkesë, nuk ka kompetencë për ekzekutimin e saj, ai ia përcjell kërkesën pa vonesë autoritetit gjyqësor vendas kompetent dhe njofton njëkohësisht Ministrinë e Drejtësisë.

Bazuar mbi parimin e reciprocitetit, letërkërkesa e autoritetit gjyqësor të huaj pranohet nëse përmban garancitë për reciprocitet, të dhëna nga shteti kërkuar, që përfshijnë pritshmërinë që ky shtet të ekzekutojë një kërkesë të ngjashme të drejtuar nga autoritetet gjyqësore vendase.

Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë dhe autoriteti kompetent gjyqësor shqiptar, me kërkesën e autoritetit gjyqësor të huaj, zbatojnë rregullat për ruajtjen e sekretit shtetëror dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionin e treguar në letërkërkesë.

Për sa më sipër, hapat e ndjekura nga autoritet shqiptarë të parashikuara nga Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale“, krijojnë garancitë procedurale për çdo individ, që ekstradimi i tij gjithmonë duhet të bëhet mbi baza të ligjshme.

Forma kryesore e shfaqjes së ‘letërkërkesës’ është ‘*letërporosia*’, e cila përbën një instrument të rëndësishëm në funksion të respektimit të ndërsjelltë të marrëdhënieve juridiksionale midis shteteve në çështjet penale.

Përcaktimi i ‘letërporosisë’, jepet në Konventën e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe protokollin e saj shtesë.²⁶⁹

²⁶⁹Ligji nr.8498, datë 10.6.1999 Për ratifikimin e konventes së Keshillit të Evropes “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” dhe protokollin e saj shtesë, Fletore Zyrtare nr.21/1999.

Kështu, pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal, që do t'i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese, dhe që kanë për objekt përmbushjen e akteve hetimore ose të kalimit të provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve (neni 3).

Në legjislacionin shqiptar, nuk kemi një përkufizim të 'letërporosisë', por ai në nenin 13 të tij, përcakton format e shfaqjes/llojet e letërporosë, të cila janë:

- a. njoftimi i aktit të thirrjes ndaj personit nën hetim, të pandehurit, dëshmitarit, ekspertit, të dënuarit apo palëve të tjera në procedimin penal;
- b. njoftimi i urëdrave, i vendimeve të autoriteteve gjyqësore dhe i dokumenteve të tjera të nevojshme që lidhen me procedimin penal në shtetin kërkues;
- c. masat e sigurimit pasuror për efekte të një procedimi penal;
- d. pyetja e personit nën hetim, të pandehurit, të dënuarit, dëshmitarit dhe ekspertit, qoftë edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me anë të lidhjeve telefonike dhe audiovizive;
- e. transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar, me qëllim pyetjen e tyre;
- f. veprime të tjera hetimore, të cilat nuk janë të ndaluara nga ligji.

Krahas rasteve të procedimeve penale të parashikuara nga ky ligj, ekzekutohen letërporositë e autoriteteve gjyqësore të huaja në procedimet administrative, nëse vendimi i dhënë në përfundim të tyre mund të ankimohet në një gjykatë me juridiksion penal. Ky rregull zbatohet deri në masën që parashikohet në marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

Letërporosia duhet të ekzekutohet, e cila nënkupton se:

1. Ministria e Drejtësisë, pas dhënies rrugë, ia përcjell aktet prokurorit të rrethit ku duhet të ekzekutohet letërporosia, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga marrja e akteve. Në raste urgjente, Ministria e Drejtësisë mund t'ia përcjellë aktet prokurorit të rrethit, duke njoftuar njëkohësisht Prokurorin e Përgjithshëm.
2. Prokurori i rrethit paraqet kërkesën në gjykatë për të disponuar ekzekutimin e letërporosisë me vendim, sipas rregullave të K.Pr.P. Ky rregull nuk zbatohet kur parashikohet ndryshe në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Në njoftimin e 'leterporosisë', autoritet kompetente, duhet të kenë në themel të punës së tyre, respektimin e të drejtave dhe lirive të individit. Kështu, ligji afirmon se 'Paprekshmëria e personit të thirrur', që nënkupton se: (1) Kur personi, për të cilin kërkohet njoftimi për t'u thirrur në procedim në Shqipëri, nuk arrin të veprojë në përputhje me aktin e thirrjes, të lëshuar nga shteti kërkues, ndaj tij nuk ndërmerret asnjë masë detyruese, shtrënguese apo sanksion penal; (2) Nëse autoritetet gjyqësore vendase thërrasin një dëshmitar ose ekspert me vendbanim ose vendqëndrim jashtë shtetit, ai, gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, nuk do t'i nënshtrohet procedimit penal për një vepër të kryer përpara paraqitjes në territorin shqiptar dhe as do të dërgohet të vuajë një dënim penal të dhënë me një vendim gjyqësor vendas, të dhënë përpara paraqitjes së tij.

Po ashtu, bazuar mbi bazë të 'leterporosisë', mund të realizohet edhe 'Kontrolli dhe sekuestrimi i sendeve', Kështu, me kërkesë të autoriteteve gjyqësore të huaja, autoriteti gjyqësor shqiptar mund të vendosë lejimin e kontrollit të vendeve ose sekuestrimin e sendeve të konfiskueshme që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në lidhje me faktet e përcaktuara në letërporosi, dhe autoriteti gjyqësor vendas kompetent kryen kontrollin dhe sekuestrimin në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

Bazuar në kërkesat e ‘letërporosisë’, bëhet edhe dorëzimi i sendeve të sekuestruara, të cilat i dërgohen autoritetit të huaj gjyqësor për t’u konfiskuar ose për t’iu kthyer pronarit të ligjshëm.

Këto sende përfshijnë:

- a. sendet e përdorura për kryerjen e një vepre penale;
- b. sendet që rrjedhin nga kryerja e një vepre penale, apo vlera e barabartë me to;
- c. fitimet nga një vepër penale, apo vlera e barabartë me to;
- d. sende të tjera të dhëna me qëllim nxitjen për kryerjen e një vepre penale, si edhe shpërblimet për një vepër penale.

Por krahas, kërkesave të parashikuara në një letërporosi, autoritetet gjyqësore shqiptare kryesisht i përcjellin autoriteteve gjyqësore të huaja informacion që lidhet me veprat penale, të mbledhur gjatë procedimit penal, nëse ato vlerësojnë se përcjellja e një informacioni të tillë mund të ndihmojë në fillimin e një procedimi penal apo në paraqitjen e një kërkesë për ndihmë juridike nga shteti i huaj. Përcjellja e këtij informacioni bëhet nëse nuk pengohet ecuria e procedimit penal në Shqipëri dhe duke respektuar kushtet e reciprocitetit.

Nga ana tjetër, autoriteti gjyqësor kompetent vendas mund të kërkojë nga autoritetet gjyqësore të huaja, që kanë marrë informacionin e mësipërm të dhëna për masat e marra në lidhje me informacionin e përcjellë.

7.4. Institucionet përgjegjëse për çështjet e ekstradimit në Shqipëri

Institucionet të cilat administrojnë ekstradimin në Shqipëri janë:

1. Ministria e Drejtësisë
2. Prokuroria
3. Gjykata

Më poshtë do të trajtojmë rolin e secilit nga këto institucione gjatë procedurave të ekstradimit.

7.3.1. Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë është organi kompetent dhe nga më të rëndësishmit në procesin e ekstradimit. Kështu, kërkesa e ekstradimit do të lejohet vetëm nëse i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë.²⁷⁰ Në rastin e konkurrimit të dy kërkesave për ekstradim, është Ministria e Drejtësisë institucioni i cili bazuar në të gjitha rrethanat e çështjes dhe veçanërisht datën e marrjes së kërkesës, rëndësinë dhe vendin e kryerjes së veprës penale ose shtetësinë dhe vendbanimin e personit të kërkuar, si dhe mundësinë e një riekstradimi nga shteti kërkuës.²⁷¹ Dhe nëse për një shkelje të vetme ekstradimi kërkohet në të njëjtën kohë nga shumë shtete, ai i jepet shtetit ndaj të cilit është drejtuar vepra penale ose atij shteti mbi territorin e të cilit është kryer vepra. Në nenin 490 të Kodit të Procedurës Penale për mbi të cilat do të realizohet ekstradimi dhe në paragrafin e fundit të këtij neni i lihet një hapësirë juridike interpretimi Ministrisë së Drejtësisë. Kjo për faktin sepse në këtë paragraf theksohet se “*Ministria e Drejtësisë mund të vërë edhe kushte të tjera që i çmon të përshtatshme.*”.

Pas shqyrtimit të kërkesës së ekstradimit Ministria e Drejtësisë, në qoftë se nuk e refuzon atë, ia dërgon bashkë me dokumentet prokurorit pranë gjykatës kompetente²⁷² dhe i përcjell autoriteteve të vendeve të huaja të gjitha kërkesat e organit të akuzës. Roli i Ministrisë së Drejtësisë në procesin e ekstradimit është determinant, pasi është pikërisht ky institucion i cili mund të marrë masa shtrënguese të paraqitur nëpërmjet ndaj personit për të cilin është kërkuar ekstradimi, me një kërkesë drejtuar prokurorisë për sekuestrimin e provave materiale dhe i sendeve që i përkasin veprës penale, për të cilën është kërkuar ekstradimi. Në nenin 494, paragrafi 5-të i Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se është Ministria e Drejtësisë organi i cili ka përgjegjësinë të njoftoj shtetin e huaj për zbatimin e përkohshëm të masës shtrënguese

²⁷⁰Shih nenin 489 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale.

²⁷¹Shih nenin 489 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale.

²⁷²Shih nenin 492 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale.

dhe të sekuestros eventuale. Ministria e Drejtësisë është institucioni i cili do ti komunikoj shtetit tjetër vendimin e pranimit ose të refuzimit të kërkesës së ekstradimit.²⁷³ Po kështu, edhe në lidhje me ekstradimin nga jashtë shtetit, është pikërisht Ministria e Drejtësisë organi i cili ka kompetencën për t'i kërkuar një shteti të huaj ekstradimin e një personi të proceduar ose të dënuar penalisht, ndaj të cilit duhet të ekzekutohet një masë që kufizon lirinë personale. Ministria e Drejtësisë është kompetente të vendosë në lidhje me kushtet e vëna eventualisht nga shteti i huaj për të dhënë ekstradimin, kur ato nuk vijnë në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik shqiptar. Autoriteti procedues detyrohet të respektojë kushtet e pranuar.²⁷⁴ Ministria e Drejtësisë mund të vendosë, për qëllimet e ekstradimit, kërkimin jashtë shtetit të personit të proceduar ose të dënuar dhe arrestimin e tij të përkohshëm.²⁷⁵

7.3.2. Prokuroria

Prokuroria është një institucion, që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Në lidhje me çështjen e ekstradimit mund të themi që prokurori është një ndër institucionet kyç në rolin e organizimit dhe të procedurës së ekstradimit. Kështu, në nenin 492 paragrafi 1 përcaktohet se kërkesën për ekstradim, Ministria e Drejtësisë ia dërgon bashkë me dokumentet prokurorit pranë gjykatës kompetente. Prokurori ka detyrimin që të gjej personin për të cilin ka ardhur kërkesa e ekstradimit, dhe të bëjë identifikimin e tij duke marrë pëlqimin për ekstradimin. Ky institucion ka të drejtën që të kërkojë të gjithë dokumentacionin përkatës për ekstradimin nëpërmjet MD-së shtetit kërkues, dhe brenda tre muajve nga data kur ka ardhur kërkesa për ekstradim, prokurori i paraqet gjykatës kërkesën për shqyrtim.²⁷⁶ Në nenin 494 paragrafi 1 përcaktohet se “*Me kërkesën e shtetit të huaj, të paraqitur nga Ministria e*

²⁷³Shih nenin 499 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale.

²⁷⁴Shih nenin 504 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale.

²⁷⁵Shih nenin 504 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale.

²⁷⁶Shih nenin 492 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale.

Drejtësisë nëpërmjet prokurorit pranë gjykatës kompetente, gjykata mund të vendosë për kohësisht një masë shtrënguese para se të vijë kërkesa e ekstradimit.” Në rastin e kërkesave të ekstradimit nga jashtë shtetit është pikërisht prokurori pranë gjykatës në territorin e së cilës procedohet ose është dhënë vendim-dënimi, i cili i bën kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, duke i dërguar aktet dhe dokumentet e nevojshme.²⁷⁷

7.3.3. Gjykata

Në vendin tonë, pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm nga Gjykatat në përputhje me Kushtetutën dhe kompetencat që u ngarkohen atyre me ligj. Gjykata ka kompetencën që të shqyrtojë çështje penale, civile etj. Gjykatat kanë kompetencë që përpos çështjeve të tjera të shqyrtojnë edhe kërkesat për ekstradim. Kërkesa për ekstradimin e një shtetasi depozitohet nga ana e prokurorit në gjykatë për shqyrtim.²⁷⁸ Gjykata e rrethit me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, ndaj personit për të cilin është kërkuar ekstradimi mund të merren masa shtrënguese dhe të vendoset sekuestrimi i provave materiale dhe i sendeve që i përkasin veprës penale, për të cilën është kërkuar ekstradimi.²⁷⁹ Gjykata mund të vendosë revokim e masës së sekuestros nëse brenda tre muajve nga fillimi i ekzekutimit të tyre nuk ka përfunduar procedimi para gjykatës. Po kështu, në nenin 494 paragrafi 1 përcaktohet se “*Me kërkesën e shtetit të huaj, të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet prokurorit pranë gjykatës kompetente, gjykata mund të vendosë për kohësisht një masë shtrënguese para se të vijë kërkesa e ekstradimit.*” Në lidhje me kompetencën e Gjykatës, që do të shqyrtoj vendimin ky nen në paragrafin 3 përcakton se “Kompetenca për të vendosur masën u takon, sipas radhës, gjykatës së rrethit në territorin e së cilës personi ka vendbanimin, vendqëndrimin apo banesën ose gjykatës së rrethit gjyqësor ku ai gjendet. Në qoftë se kompetenca nuk mund të përcaktohet në

²⁷⁷Shih nenin 504 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale.

²⁷⁸Shih nenin 492 paragrafi 4 të Kodit të Procedurës Penale.

²⁷⁹Shih nenin 493 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale.

mënyrat e treguara më sipër, kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.” Në rastin e arrestimit nga ana e policisë gjyqësore gjykata, brenda dyzet e tetë orëve nga arrestimi e miraton atë, kur janë kushtet ose vendosëlidhjen e të arrestuarit dhe njofton Ministrinë e Drejtësisë për vendimin e marrë.²⁸⁰ pas marrjes së kërkesës së ekstradimit nga ana e prokurorit gjykata cakton seancën dhe njofton, të paktën dhjetë ditë përpara, prokurorin, personin me të cilin është kërkuar ekstradimi, mbrojtësin e tij dhe përfaqësuesin eventual të shtetit kërkues.²⁸¹ Në varësi të rastit gjykata vendosë në favor ose të rrëzoj kërkesën e ekstradimit vendimi i gjykatës në lidhje me kërkesën e ekstradimit²⁸²

²⁸⁰Shih nenin 495 paragrafi 3të Kodit të Procedurës Penale.

²⁸¹Shih nenin 497 paragrafi 1të Kodit të Procedurës Penale.

²⁸²Shih nenin 498 paragrafi 1dhe 2të Kodit të Procedurës Penale ku thuhet se “Gjykata jep vendim në favor të ekstradimit kur ka të dhëna të rëndësishme fajësie ose kur ekziston një vendim dënimi i formës së prerë. Në këtë rast, kur ka kërkesë nga Ministria e Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata vendos paraburgimin e personit që duhet të ekstradohet dhe që ndodhet në gjendje të lirë, si dhe sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që i përkasin veprës penale.Gjykata jep vendim kundër ekstradimit kur janë rastet e parashikuara për mospranimin e kërkesës së ekstradimit.”

KAPITULLI VIII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione

Liberalizimi i marrëdhënieve shoqërore, sociale-politike dhe juridike të ndërsjellë kërkonte domosdoshmërisht një institucionalizim të këtyre marrëdhënieve, për shkak rritjes dhe zhvillimit të kriminalitetit në nivel global. Pikërisht, globalizimi i marrëdhënieve përherë e në rritje të kriminalitetit, kërkonte thyerjen e kornizave procedurale juridike konservatore të mbështetura në parimin e territorialitetit e të drejtave juridike kombëtare. Në këto kushte lindi nevoja për një bashkëpunim të ndërsjellë midis shteteve, të cilat u institucionalizuan në Konventat Evropiane të karakterit njëpalësh dhe shumëpalësh në kuadër të komunitetit evropian, duke bërë të mundur bashkëpunimin në çështjet penale, karakteristike kjo vetëm për vendet evropiane perëndimore.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën penale konsiston në parimin e solidaritetit midis shteteve të ndryshme të botës. Në procesin e vështirë të dhënies së drejtësisë, secili shtet duhet të japë kontributin e tij dhe njëkohësisht të ndihmohet nga shtetet e tjera. Vetëm në këtë mënyrë do të përmbushet me sukses sfida për drejtësi. Nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar penal shtetet, bëjnë të mundur realizimin e një procedimi penal edhe përtej territorit ku ata shtrijnë juridiksionin e tyre. Format në të cilat shfaqet bashkëpunimi ndërkombëtar penal janë: njohja dhe ekzekutimi i vendimeve penale të huaja, ndihma e ndërsjellë juridike, transferimi i procedimeve penale dhe ekstradimi.

Ekstradimi është një mjet efikas për luftimin e kriminalitetit, kjo për faktin sepse nëpërmjet këtij institucioni realizohet dënimi i krimit në çdo shtet, në të cilin një individ që ka kryer një vepër penale, mund të fshihet ndaj dënimit të tij. Ekstradimi në nivel ndërkombëtar bazohet mbi marrëveshjet ndërmjet shteteve. Ai ka një formë të veçantë në vendet e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës në nivel rajonal. Këto rende juridike gjithsesi ndërthuren me njëri tjetrin.

Format e para të ekstradimit i gjemë në shekullin e XIII, në qytet-shtetet dhe principatat italiane. Ky lloj bashkëpunimi embrional në fushën penale i krijonte mundësinë monarkëve të merrnin masa dhe të ndëshkonin armiqtë e tyre personalë, kur ata largoheshin në territorin e një shteti tjetër. Ashtu si dhe aktualisht, në varësi të motiveve të ekstradimit vendimin për pranimit ose mospranimin e ekstradimit të të kërkuarit e jepte monarku i shtetit, ku strehohej i kërkuari nga shteti tjetër dhe të drejtat e personit të kërkuar nuk merreshin në konsideratë. Në periudhën e mesjetës, ekstradimi realizohej vetëm nëpërmjet marrëveshjeve të bazuara në interesat e monarkëve. Instituti i ekstradimit do të përfshihej në legjislacionin e shteteve më vonë dhe traktati më i vjetër në fushën e ekstradimit është konsideruar, sipas disa studiueseve, traktati ndërmjet Italisë dhe Monakos. Shtetet e Benelux-it, si Belgjika, Luksemburgu dhe Holanda, e çuan institutin e ekstradimit në një stad më të avancuar, duke i zgjeruar marrëdhëniet e tyre dypalëshe në marrëdhënie shumëpalëshe, në lidhje me bashkëpunimin e ndërsjelltë penal ndërkombëtar. Në shekullin e XX, në kushtet ku u rrit ndjeshëm qarkullimi i individëve, u shfaq një fytyrë e re e krimit, parandalimi i të cilit rriti nevojën e bashkëpunimit mes shteteve. Kështu, për t'iu shmangur dënimit autorët e veprave penale mund të largoheshin lehtësisht nga vendi ku kishin kryer veprën, duke u zhvendosur në një vend tjetër, duke gjetur një terren të përshtatshëm ose një rrugëdalje për t'iu shmangur drejtësisë. Në këto kushte, ishte evidente që kontrolli i krimit dhe parandalimi i tij nuk mund të realizohej dot vetëm duke u bazuar në parimet tradicionale të së drejtës penale.

Në të Drejtën Ndërkombëtare me ekstradim kuptohet një veprim juridik midis shteteve me të cilin shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi i dorëzohet shtetit tjetër me qëllim që atje të gjykohet, apo ndaj tij të ekzekutohet dënimi apo lloj tjetër sanksioni penal. Ekstradimi bëhet sipas kontratave ndërkombëtare, zakonisht sipas kontratave bilaterale. Nëse midis shteteve nuk ekziston kontrata ndërkombëtare, ekstradimi bëhet sipas ligjit të vendit nga i cili kërkohet dorëzimi i kryesit të veprës penale.

Në legjislacionin tonë, me ekstradim do të kuptohet dorëzimi i një personi të një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim, ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale, mund të bëhet vetëm nëpërmjet ekstradimit. Ekstradimi, si institucion i të drejtës penale, ka si qëllim ndëshkueshmërinë e autorit të veprës penale në rastet kur arratiset nga një shtet në një shtet tjetër, ose vuajtjen e dënimit të caktuar në rastet kur ai përpiket që t'i shmanget dënimit. Pra, ekstradimi konsiderohet si mekanizmi juridik i së drejtës penale kombëtare dhe asaj ndërkombëtare penale nëpërmjet të cilit shtetet ndihmojnë njeri-tjetrin për zhvillimin e procedurës penale apo ekzekutimin e sanksioneve penale. Ekstradimi, si një ndër institutet me të vjetër të bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale, përben aktualisht një domosdoshmëri në luftën kundër kriminalitetit, sidomos në planin ndërkombëtar. Ekstradimi realizohet kur një person kryen një vepër penale në një shtet të caktuar dhe gjatë procedurës penale, apo pas caktimit të dënimit, largohet në një shtet tjetër qëllim shmanjien e dënimit. Në këtë rast shteti ku gjendet i kërkuari, i'a dorëzon personin shtetit kërkues, ku ai ka kryer veprën penale, dhe kur një person kryen një vepër penale në shtetin e huaj kundër një shteti tjetër ose shtetasve të huaj. Sipas Konventës Evropiane për Ekstradim ka disa parime mbi të cilat mbështetet ekstradimi. Parimi i reciprocitetit realizohet kryesisht në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe, si rrjedhojë, ekstradimi bazohet në të drejtën e brendshme, dhe ekstradimi do të realizohet vetëm në rast se shteti kërkues, ka realizuar më përpara kërkesa ekstradimi ndaj shtetit, që po i parashtron kërkesën ose do të realizojë në të ardhmen. Parimi i specialitetit i siguron mbrojtje personit ndaj të cilit është paraqitur kërkesa e ekstradimit, për veprat penale të kryera pas kërkesës së ekstradimit. Në themel të këtij parimi qëndron pohimi se një person mund të ndiqet penalisht apo të ndëshkohet vetëm për atë vepër penale për të cilën kërkohet të ekstradohet, dhe jo për vepra penale, të cilat nuk janë objekt i kërkesës së ekstradimit. Parimi i ekstradibilitetit konsiston në pranimin e kërkesës së ekstradimit vetëm për raste kur janë vepra penale për të cilat personat mund të ekstradohen. Pra, lejohet ekstradimi

vetëm për vepra penale për të cilat është parashikuar ekstradimi me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare, ose me legjislacionin e brendshëm. Parimi i identitetit të normave ka lindur si domosdoshmëri për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve për të mos u privuar nga liria dhe të drejtat e tjera në shtetin ku është duke banuar, për shkak të kërkesës për ekstradim për një vepër që nuk konsiderohet si krim në atë shtet. Këtë parim e gjemë të sanksionuar në të gjitha marrëveshjet dypalëshe dhe në Konventën Evropiane për Ekstradimin, ku në nenin 2 të saj përcakton se ekstradimi do të lejohet për veprat penale, që janë të dënueshme në të dyja shtetet sepse nëpërmjet ekstradimit nënkuptohet se ndërmjet dy shteteve ekziston një marrëveshje mbi vlerat që duhen mbrojtur.

Sikundër legjislacionit ndërkombëtar edhe legjislacioni shqiptar ka disa parime për ekstradimin. Parimi i veçorisë ose specialitetit, ka të bëjë me procedimin e personit të kërkuar vetëm për atë vepër penale që parashikohet në kërkesën për ekstradim. Shteti kërkuar do të procedojë vetëm për veprën penale, që i atribuohet personit në kërkesë dhe do të bëjë drejtësi vetëm për të. Ky parim rregullohet në nenin 14 të Konventës dhe nenin 490 të K.Pr.P. Parimi i fajësisë së dyfishtë, ka të bëjë me parashikimin e veprës penale si të tillë në legjislacionin e të dy vendeve në marrëdhënie ekstradimi. Në legjislacionin shqiptar ky parim rregullohet nga neni 2/1 i Konventës Evropiane për Ekstradimi, neni 11 i K.P., dhe neni 491 i K.Pr.P. Parimi i mosdorëzimit për një vepër me karakter politik. Sipas nenit 3/1 të Konventës Evropiane “Për Ekstradim”, neni 11, gërma (b) të K.P., neni 491 gërma (a) të K.Pr.P., ekstradimi nuk do të jepet në rastet e kryerjes së një veprë me karakter politik. Parimi i mos ekstradimit të personit kur vlerësohet se ekstradimi i tij kërkohet në mënyrë që t’i nënshtrohet persekutimeve, apo diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, bindjeve politike, gjendjes personale apo shoqërore ose dënimeve apo trajtimeve të egra, çnjerëzore apo poshtëruese ose veprimeve që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore. Suprimimi i parimit *prima facie*. Ky parim nënkupton faktin, se gjykimi i zhvilluar për një kërkesë ekstradimi, nuk përbën në vetvete një

gjykim themeli për veprën penale që i atribuohet personit të kërkuar për ekstradim. Parimi i mosekstradimit të shtetasve. Ky është një parim i rëndësishëm i ekstradimit, dhe i ka themelet në ushtrimin e sovranitetit të shtetit në të gjithë territorin dhe veçanërisht mbi njerëzit, që jetojnë dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre në të. Shtetasit e një shteti kanë një status të veçantë në lidhje me qeverinë dhe territorin në të cilin ata jetojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre.

Këshilli i Evropës zhvillon një bashkëpunim të gjithanshëm për një numër të madh çështjesh si : edukimi, kohezioni shoqëror, mbrojtja shëndetësore, lufta kundër të gjitha formave të intolerancës dhe kriminalitetit. Në këto kushte Këshilli i Evropës parashikoi forma dhe mekanizma konkretë të cilët do të vendosnin bazat e marrëdhënieve të bashkëpunimit. Fillimisht vendet e Evropës, kishin operuar në fushën e ekstradimit me anë të marrëveshjeve dypalëshe, por ardhja gjithmonë e në rritje e kriminalitetit kërkonte në mënyrë emergjente harmonizimin e legjislacionit në nivel komunitar dhe në këto kushte Këshilli i Evropës hartoi dhe miratoi me vullnetin e shteteve anëtare një sërë konventash në fushën e bashkëpunimit gjyqësor dhe penal në veçanti.

Konventa kryesore në fushën e ekstradimit është Konventa mbi Ekstradimin e 1957 me dy protokollat shtesë të saj. Me hartimin e Konventës Evropiane për Ekstradimin, u krijua një regjim juridik unik për ekstradimin midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Konventa shfuqizon traktatet dypalëshe dhe harmonizon legjislacionet e brendshme të shteteve në lidhje me këtë institut. Burimet parësore mbi të cilat ekstradimi në vendin tonë mbështetet dhe gjen rregullim ligjor janë: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, marrëveshjet ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale të Shqipërisë me shtetet e tjera dhe marrëveshjet ndërkombëtare të pranura nga Shqipëria.

Bashkëpunimi ndërshtetëror ka karakter evropian dhe ndërkombëtar dhe mbështetet në marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat sjellin avantazhe të shumta dhe i detyrojnë palët që në kushte të caktuara të ofrojnë ndihmën e ndërsjelltë. Marrëveshjet ndërkombëtare përcaktojnë

procedurën ndërshtetërore, që duhet të zbatohet dhe lehtësojnë komunikimin e organeve që janë të integruara direkt në poçes. Dokumentet ndërkombëtarë, të cilët sanksionojnë ekstradimin si formë për të luftuar kriminalitetin, janë: Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit.

Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar nxit bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet vendeve anëtare lidhur me çështje globale, me qëllim marrjen e masave kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, dhe formave të tjera të krimit. Konventa identifikon bashkëpunimin, dhe krijon detyrime për shtetet nënshkruese lidhur me çështje të tilla si: grumbullimi dhe shkëmbimi i informacionit kriminal, ndihma e ndërsjelltë juridike lidhur me ekstradimin, transferimin e çështjeve penale, dhe transferimin e personave të dënuar etj. Sipas kësaj konvente, nëse një shtet merr një kërkesë ekstradimi nga një shtet me të cilin nuk ka asnjë traktat dypalësh ekstradimi, atëherë ky shtet mund ta konsiderojë këtë konventë si bazën ligjore për ekstradimin për çdo vepër penale ndaj të cilës aplikohet neni 16.

Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit synon bashkëpunimin ndërkombëtar për veprat penale në fushën e korrupsionit, dhe harmonizon kryerjen e veprimeve për parandalimin dhe goditjen e këtij fenomeni, që shfaqen në shoqëritë demokratike në forma të ndryshme, të tilla si: dhënia ryshfet nëpunësve për të përfituar lehtësira, abuzimi me detyrën dhe me fondet publike nëpërmjet tenderëve dhe forma të tjera, shpërdorimi i funksionit nga nëpunësit e administratës publike dhe private, vjedhja e përvetësimi i realizuar me shpërdorim të pozitës, falsifikimi i dokumenteve, krijimi i privilegjeve të padrejta etj. Konventa cilëson si shkelje penale pengimin e drejtësisë në lidhje me kryerjen e shkeljeve të sipërcituara, dhe parashikon masa parandaluese në sektorin publik dhe atë privat, për të cilat shtetet palë detyrohen të bashkëpunojnë në këtë drejtim lidhur me mbledhjen e provave për tuu përdorur në ndjekjen penale, gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të vëna me korrupsion, deri në

ekstradimin e autorëve. Ekstradimi si formë e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër korrupsioni është sanksionuar në nenin 44 të Konventës së OKB-së kundër korrupsionit.

Lufta kundra kriminalitetit kërkon krijimin e institucioneve, të cilat do të zbatojnë aktet juridike që krijohen për këtë qëllim. Kështu, INTERPOLi është organizata e parë policore ndërkombëtare më e madhe, që lehtëson bashkëpunimin policor ndërkombëtar, ndihmon dhe asiston të gjithë autoritetet dhe shërbimet, misioni i të cilave është parandalimi dhe lufta kundër krimit ndërkombëtar. Kjo organizatë nuk merr veprime të karakterit politik, apo ushtarak sepse qëllimi i saj është promovimi i asistencës ndërmjet të gjitha autoriteteve të policisë kriminale brenda kornizës ligjore së Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, dhe krijimi i institucioneve që kontribuojnë në parandalimin kriminalitetit. Bashkëpunimi policor në nivel komunitar realizohet nëpërmjet EVROPOL-it. EVROPOL-I ka si objektiv përmirësimin e efektivitetit dhe bashkëpunimit të autoriteteve kompetente²⁸³ në shtetet anëtare për të parandaluar dhe luftuar krimin e rëndë ndërkombëtar, nëse ka të dhëna që: është e përfshirë një strukturë e organizuar kriminale, dhe preken dy ose më shumë shtete anëtare dhe kërkohet përjasje e përbashkët nga shtetet anëtare. Misionii kësaj agjencie policore është të japë një kontribut të rëndësishëm në veprimin e zbatimit të ligjit të BE-së kundër veprave të rënda kriminale trans-nacionale, duke vënë theksin në goditjen e organizatave kriminale.

Në Shqipëri funksionon një Zyrë Kombëtare për komunikimin me EVROPOL-in, e cila shkëmben informacion të klasifikuar nëpërmjet kanalit të sigurt SIENA.

Për të luftuar kriminalitetin në sistemin evropain, Këshilli i Ministrave hartoi Konventën Evropiane të Ekstradimit. Në këtë konventë parashikohet mundësia e refuzimit të ekstradimit nga ana e shteteve nënshkruese të shtetasve të saj. Në lidhje me procedurën, që

²⁸³Për qëllim të kësaj Konvente “autoritete kompetente” do të thotë të gjitha organet publike që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të cilat janë përgjegjëse sipas legjislacionit të brendshëm për të parandaluar dhe luftuar veprat penale. Neni 2 i zëvendësuar nga Akti i Këshillit që miraton në bazë të nenit 43(1) të Konventës për Krijimin e Evropol-it, një Protokoll që ndryshon atë Konventë (2004/C 2/01), Akt i Këshillit i 27 Nëntorit 2003 (Fletore Zyrtare 002, 06/01/2004, fq. 0003)

shtetet duhet të ndërmarrin për shqyrtimin e kërkesave për ekstradim, duhet të themi që Konventa për Ekstradimin nuk shprehet duke ia lënë kompetencës territoriale të shteteve. Shumica e shteteve kanë shprehur rezerva ndaj Konventës. Rezervat e shprehura kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit shtetëror, mbrojtjen e shteteve dhe mungesën e vlerave të përbashkëta. Pengesë për ekstradimin është ekzistenca e rretheshme juridike të ndryshme, si dhe nga shumëllojshmëria e koncepteve që ekzistojnë mbi kufijtë e vendosur për sjelljet sociale dhe mbi masën e ndërhyrjes së pushtetit politik në çështjet personale. Konventa e vitit 1957 ka bërë një hap të madh drejt harmonizimit të të drejtës evropiane në fushën e ekstradimit, ajo akoma nuk ka arritur të bëjë një njehsim të vërtetë.

Shteti shqiptar refuzon ekstradimin e shtetasve të vet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në marrëveshje ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë. Vendi ynë nuk lejon ekstradimin e personave, që kanë kryer vepra penale në territorin shqiptar ose edhe jashtë tij, kur vepra është kryer në dëm të interesave të shtetit ose shtetasve, përveç rastit kur arrihet marrëveshje e ndryshme me palën e interesuar. Sipas legjislacionit shqiptar, kur personi që kërkohet të ekstradohet, është duke vuajtur dënim për një vepër tjetër, me rastin e ekstradimit, lejohet të vuajë plotësisht dënimin në vendin kërkues. Ekstradimi nuk pranohet dhe refuzohet nga shteti Shqiptar, kur ai bëhet për qëllime të tilla siç janë : për një vepër me karakter politik , kur rezulton që ai kërkohet për qëllime politike, kur ka arsye të mendohet se personi, që kërkohet do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve, që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut, kur personi, që kërkohet ka kryer një vepër penale në Shqipëri, kur ka filluar procedimi ose është gjykuar në Shqipëri edhe pse vepra është kryer jashtë shtetit, kur vepra penale nuk parashikohet si e tillë nga legjislacioni shqiptar, kur për veprën penale është dhënë amnisti nga shteti shqiptar, kur personi i kërkuar është shtetas shqiptar dhe nuk ka marrëveshje

që të parashikojë ndryshe, kur është parashikuar ndjekja penale ose dënimi sipas ligjit të shtetit që e kërkon.

Procedura e ekstradimit është e ndryshme nga shteti në shtet, kjo për sa i përket kushteve të ekstradimit dhe legjislacionit të brendshëm të vendeve. Kushtet e ekstradimit të parashikuar në Konventën Evropiane të Ekstradimit janë shumë të rëndësishme dhe luajnë një rol kryesor duke përbërë bazën për procedimin e ekstradimit. Kështu, ekstradimi lejohet, nëse i ekstraduari: nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do t'i dorëzohet një shteti tjetër për një veprë penale, që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi, kur pala dorëzuese jep pëlqimin se i ekstraduari do të ndiqet edhe për veprën penale tjetër, dhe për këtë i ekstraduari nuk ka kundërshtim. Procedura e ekstradimit përmban një tërësi veprimesh, të cilat duhen të ndërmerren nga organet e autorizuara të shtetit kërkues dhe shtetit të kërkuar. Ajo zhvillohet në dy faza: në fazën e parë përgatitet kërkesa për ekstradim nga shteti kërkues për shtetin e kërkuar, kurse në fazën e dytë shqyrtohet kërkesa për ekstradim nga ana e shtetit të kërkuar. Sipas legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar, rezultojnë dy lloje ekstradimi; ekstradim për jashtë ose ekstradim pasiv, dhe nga jashtë brenda ose aktiv. Kërkesa për ekstradim është një dokument i formuluar me shkrim, që i drejtohet shtetit të kërkuar në rrugë diplomatike. Është kusht që shteti kërkues të jetë palë e marrëveshjes në kuadrin e Konventës së Evropës dhe protokolleve shtesë të saj.

Procedura e ekstradimit përmban dhe detyrimet që duhet të respektohen gjatë procedurës së ekstradimit. Gjatë procedurës së ekstradimit, si shteti kërkues po ashtu dhe ai pritës, kanë detyrime të cilat duhet t'i përmbahen dhe respektojnë. Detyrimet e shtetit, që i është drejtuar kërkesa, janë dorëzimit të personit të kërkuar nëpërmjet ekstradimit dhe dorëzimi i objekteve. Detyrimi i shtetit kërkues të ekstradimit është pëlqimi për riekstradim. Nisur nga fakti që legjislacione të ndryshme kanë nivel të ndryshëm zhvillimi, po kështu dhe sistemet politike nuk janë të njëjta, në respektim të të drejtave të individëve lindin dhe kufizimet në procedurën

e ekstradimit. Kështu, përveç kushteve materiale juridike, ka edhe disa shkaqe të tjera të cilat mund të mos lejojnë ekstradimin e personave të cilat përcaktohen edhe nga legjislacioni i ynë i brendshëm. Pengesat e ekstradimit do të klasifikojmë sipas autorit të veprës penale, llojit të veprës penale, procedurës së ekstradimit, parimeve të ekstradimit, legjislacionit të shtetit të kërkuar, dhe kur ka arsye të mendohet se personi, që kërkohet, do t'u nënshtrohet persekutimeve ose diskriminimeve për shkak të racës, fesë, seksit, shtetësisë, gjuhës, bindjeve politike, gjendjes personale a shoqërore ose dënimeve a trajtimeve të egra, çnjerëzore a poshtëruese ose veprimeve ,që përbëjnë shkelje të një të drejte themelore të njeriut.

Në momentin e dakortësisë për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare në fushën e ekstradimit dhe të ndihmës juridike, shtete kanë mundësin e zgjedhjes ndërmjet marrëveshjes bilaterale dhe konventave multilaterale, të cilat në varësi të përpilimit të tyre kane avantazhe dhe disavantazhe. Kështu, marrëveshjet dy paleshe kërkojnë veprim vetëm me një partner, dhe në këtë mënyre është me e lehte për t'u lidhur dhe mund të shtohen edhe rregulla të reja, me shumë nga ç'mund të shtohen kur janë një numër i madh shtetesh. Por ka disavantazh faktin që mbulon vetëm një zone të ngushte. Në situata të caktuara, jurisprudenca ka treguar se janë të rëndësishme dhe të domosdoshme, dhe hartimi i marrëveshjeve ndërmjet disa shteteve, të cilat në varësi të hollësirave janë të ndryshme. Çdo marrëveshje duhet të parashikojë procedurën ligjore të aprovimit në të gjitha shtetet, dhe të jetë e ratifikuar nga të gjitha këto shtete. Në çështjet ligjore penale ndërkombëtare bashkëpunimi ndërmjet shteteve zbatohet në kuadrin e ndihmës së ndërsjelltë. Përpos të drejtave penale të një vendi ekzistojnë edhe e drejta penale në nivel komunitar, e cila gjen zbatim në disa vende duke u konsideruar si të drejta penale ndërkombëtare. Në fushën penale, sistemi i bashkëpunimit ndërkombëtar përbehet si nga normat penale të legjislacionit të brendshëm, ashtu dhe nga norma penale ndërkombëtare, që veprojnë në këtë fushë ku të fundit kanë rëndësi të madhe në dobësimin e parimit të sovranitetit. Kështu, në fushën penale janë krijuar disa akte të karakterit rajonal dhe ndërkombëtar, të cilat

do të ndihmojnë në këtë drejtim dhe aktualisht në forma më e lartë e bashkëpunimit ndërkombëtar rajonal, që sot aplikohet në BE dhe është Urdhëri Evropian i Ndalimit . EAN-ja u krijua për të zgjidhur problematikën e ekstradimit të shtetasve, me qëllim që të thjeshtonin procedurën klasike të ekstradimit mes shteteve anëtare. UEN-ja është stadi më i lartë i bashkëpunimit në fushën penale ndërmjet shteteve evropiane, i cili u miratua më anë te Vendimit –kuadër nr. 584, të datës 13 Qershor 2002. Urdhëri zëvendëson procedurën klasike të ekstradimit në shtetet anëtare të BE-së, me përjashtim të rasteve, kur disa shtete anëtare kanë deklaruar që do të vazhdojnë të zbatojnë konventat e ekstradimit. Në këtë moment, procedura e ekstradimit u zëvendësua më një procedure më të thjeshtë të ngjashme më procedurën e arrestit, që aplikohet nga autoritetet përkatëse në një vend anëtar. Kështu, duke filluar nga 1 Janari 2004 ndërmjet shteteve anëtare të BE-së, nuk zbatohen më marrëveshjet dypalëshe apo shumëpalëshe ndërkombëtare të ekstradimit, por funksionon UEN-ja.

Aktualisht, nisur nga fakti që vendi ynë aspirojnë hyrjen në BE, është duke punuar intensivisht për të përafuar legjislacionin kombëtar me atë evropian. Me hartimin e MSA-së, vendi ynë ka bërë hapa konkrete në përafrimin e legjislacionit me *aquis communautaire* në përgjithësi e atij penal në veçanti. Kështu, shteti shqiptar ka ratifikuar një sërë konventash, të cilat kanë bërë të mundur që dispozitat e Kodit penal dhe procedural penal që parashikojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale, të jenë në sinkron me *aquis communautaire* . Nisur nga fakti që në BE procesi i ekstradimit rregullohet nëpërmjet UEN-së, lind nevoja e implantimit të këtij vendimi në legjislacionin e brendshëm. Lidhur me UEN, strukturat ligj-zbatuese në vend duhet të jenë të përgatitur për implementimin e tij, në një të ardhme të afërt. Përgatitja konsiston në njohjen e UEN dhe procedurat ligjore për përfshirje në legjislacionin tonë penal, duke analizuar më parë përputhshmërinë me Kushtetutën, dhe me nevojën për ndryshime kushtetuese ose jo, për të parë nëse dhe në çfarë mase UEN do të jetë i pajtueshëm me parimet e rendit juridik shqiptar, si dhe procedurat e ndjekura nga vende të tjera, para përfshirjes së UEN në

legjislaconin e tyre të brendshëm. Për implementimin e njëvendimi –kuadër, i cili teknikisht nuk është drejtpërdrejt i zbatueshëm, duhet një ligj për ta implementuar i cili duhet të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të rendit tonë juridik. Kuadri ligjor, që do të rregullojë UEN-në në të drejtën tonë ,duhet t’i nënshtrohet parimeve kushtetuese. Në praktikën e gjykatave shqiptare nuk ka shumë çështje që të kenë trajtuar ekstradimin. Në vijimësi, do të trajtojmë të vetmet çështje, që lidhen me ekstradimin në republikën e Shqipërisë, që janë :Çështja Rrapo kundër Shqipërisë dhe Çështja Haxhia kundër Shqipërisë. Duhet të ndryshohet teknika legislative tepër strikte dhe jo elastike, që përdoret për ndryshimin e kuadrit të legjislaconit të brendshëm. Ligjvënësit kombëtarë tregohen tepër strikt dhe joelastik në përthithjen e direktivave dhe udhëzimeve, apo në përmbushjen e detyrimeve të rrjedhura nga traktatet, apo konventat ndërkombëtare duke bërë pjesë të legjislaconit të brendshëm dispozitat e këtyre akteve “mutatis mutandis”. Kjo është një teknikë e gabuar dhe e rrezikshme, e cila gradualisht çon në minimin e sistemeve të brendshme. Detyrat, që e kanë burimin në akte ndërkombëtare, duhet të jenë tepër të studiuara, pra duhet të kalojnë më parë në analizën e pozicionimit të saktë brenda sistemit të brendshëm. Në këtë mënyrë rritet jo vetëm efikasiteti i dispozitave në kuadrin e luftës së përbashkët ndaj krimit në nivel ndërkombëtar, por realizohet me përpikmëri edhe garancitë që ofron sistemi i brendshëm ndaj abuzivitetit me sanksionet penale sepse dy misionet e të drejtës penale, siç i kemi parashtruar edhe më sipër, në një shtet me demokraci të zhvilluar dhe liberale, jo vetëm që nuk kanë hierarki ndaj njeri-tjetrit, por janë totalisht të barazvlefshëm, dhe krejtësisht të ndërvarur midis tyre.

Rekomandime

Miratimi i një legjislaconi kombëtar, në përmbushje të objektivit të krijimit të një hapësire lirie, sigurie e drejtësie dhe harmonizimi i legjislaconin kombëtar me standartet Evropiane, ka qenë dhe vazhdon të mbetet një sfidë për shumë shtete.

Procesi i harmonizimit është i domosdoshëm për të siguruar zbatimin efikas të një politike penale të caktuar të BE-së dhe në nivel ndërkombëtar. Nisur nga perspektiva e harmonizimi të legjislacionit të brendshëm me atë ndërkombëtar dhe kombëtar atëherë duhet të themi se e drejta penale dhe procedurale penale po kështu dhe procedura e ekstradimit do të jenë në evolucion të vazhdueshëm.

Sikurse kemi trajtuar në brendësi të punimit, janë bërë disa hapa në këtë drejtim në fushën e së drejtës penale e procedurës penale, por këto arritje janë zhvilluar nën trysinë e momentit dhe kanë pasur opinione që i kanë kundërshtuar ato. Për këtë arsye rekomandimet tona konkrete janë:

1. Nisur nga fakti që në të drejtën evropiane ka akoma diversitet normash mes vendimesh kuadër, konventash etj dhe të gjitha këto akte kanë në fokusin e tyre një numër të limituar veprash penale dhe sjellin një veprim kaotik në zbatimin e së drejtës, sugjerojmë krijimin e një akti, i cili do të përmblihte bashkëpunimin për të gjitha llojet e veprave penale dhe do të unifikohej nga të gjitha shtetet. Kjo dhe për shkak të mbivendosjeve që kanë krijuar konventat dhe traktatet e Këshillit të Evropës dhe rregullimeve të BE-së.
2. Me qëllim që të arrihet harmonizimi i legjislacionit të brendshëm të çdo shteti pa vështirësi, duhet të largohet vëmendja nga orientimet kombëtare në këtë fushë të së drejtës.
3. Duhet të gjendet një konsensus jo vetëm për sa i përket kushteve të bashkëpunimit ndërmjet shteteve anëtare, por edhe në çështjet themelore të së drejtës penale, si materiale ashtu edhe procedurale.
4. Duhet të minimizohet mundësia e ndikimit të kulturave e traditave të Shteteve të ndryshme, të cilat ndikojnë negativisht që procesi i harmonizimit të sistemeve ligjore

kombëtare të mund të garantojë në të gjitha rastet faktin se zbatimi praktik do të ndjekë të njëjtat standarte.

5. Procesi i harmonizimit të legjislacionit kërkon krijimin e një institucioni të centralizuar si një mundësi e mirë për të mbledhur të dhëna të nevojshme, të cilat mund t'i nënshtrohen lehtësisht një studimi të krahasuar, i cili nga ana e tij do të ndihmonte procesin e harmonizimit.
6. Krijimi i një kuadri ligjor më të detajuar në Shqipëri, i cili do të administronte të gjithë procedurën e ekstradimit.
7. Duhet të krijohen lehtësira në lidhje me ekstradimin duke e nxjerrë jashtë kornizave të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.
8. Të gjithë organizmat shtetërorë duhet të orientohen dhe t'i referohen gjithmonë e më shumë rekomandimeve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian lidhur me ekstradimet.
9. Po ashtu, gjykatat në mënyrë të veçantë duhet medoemos të mbajnë parasysh jurisprudencën e GJEDNJ-së lidhur me çështjet që implikon garantimi i të drejtës së jetës (neni 2) dhe mos nënshtimit të torturës dhe trajtimit çnjerezor dhe degarduar (neni 3). Një vlerë të veçantë në këtë drejtim pati vendimi *Rrapo kundër Shqipërisë*, ku GJEDNJ-ja tërhoqi vemendjen gjykatave dhe në përgjithësi shtetit shqiptar. Për këtë qëllim gjyqtarët duhet të trajnohen në vazhdimësi mbi këtë jurisprudencë dhe praktike gjyqësore. Po ashtu, duhet patur parasysh që çështjet e ekstradimit të shtetasve shqiptarë, kur përfshihet dënimi me vdekje në një shtet tjetër ku individi ka kryer krime, duhet të trajtohen më me kujdes nga gjyqtarët shqiptarë dhe nga Ministria e Jashtme.
10. Në këtë drejtim, gjyqtarët dhe gjithë autoritetet shtetërore që përfshihen në çështjet e ekstradimit edhe me qëllim integrimin e vendit në BE, duhet të orientohen dhe të njohin mirë edhe jurisprudencën e Strasburgut dhe të ndjekin nga afer zhvillimet e fundit në

shoqëritë demokratike. Sa i takon ekstradimeve duhen ndjekur nga afer zhvillimet e fundit dhe të kemi një përjasje të plotë me këto rende juridike mbikombëtare.

11. Duhet të ndryshohet teknika legjislative tepër strikte dhe jo elastike që përdoret për modifikimin/ndryshimin e dispozitave të veçanta të legjislacionit të brendshëm. Pra, duhet të jemi më fleksibël në hartimin e dispozitave.

BIBLIOGRAFIA

1. Burimet Parësore:

- 1- Kodifikim i Përgjithshëm i Legjislacionit në Fuqi të Republikës Popullore të Shqipërisë (1945-1957) Vëllimi III – Botim i Kryeministrisë, Tiranë 1958
- 2- Konventa Evropiane "Për ekstradimin" dhe tre protokollet e saj shtesë. Këshilli i Evropës, viti 1957, ratifikuar me Ligjin nr. 8322, datë 02.04.1998.
- 3- Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve
- 4- Konventa Evropiane e Ndhmës Juridike në Fushën Penale
- 5- Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale
- 6- Konventa Evropiane "Për parandalimin e torturës"
- 7- Konventa "Për transferimin e procedimeve penale", të vitit 1972
- 8- Konventa Evropiane "Për shtypjen e terrorizmit"
- 9- Konventa "Për transferimin e personave të dënuar", të vitit 1983
- 10- Konventa "Për ndihmën e ndërsjellët juridike" dhe Protokollin e Dytë shtesë, të vitit 1978
- 11- Konventa Evropiane "Për të drejtat e njeriut"
- 12- Konventa "Për ndjekjen e tregtisë së qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit të korrupsionit të tjerëve", e vitit 1951,
- 13- Konventën Penale Evropiane për Korrupsionin
- 14- Konventa për ndihmë juridike me Gjermaninë, të vitit 1959;
- 15- Konventa për ndihmë juridike me Çekosllovakinë, të vitit 1959;
- 16- Konventa për ndihmë juridike me Rumaninë, të vitit 1961, etj.
- 17- Konventa me Greqinë për transferimin e të burgosurve, të vitit 1993;
- 18- Konventa me Greqinë për zbatimin reciprok të vendimeve penale, të vitit 1993;
- 19- Konventa për ndihmë gjyqësore me Greqinë, të vitit 1993;

- 20- Marrëveshje ekstradimi me Greqinë, të vitit 1993;
- 21- Marrëveshje ekstradimi me Maqedoninë, të vitit 1998;
- 22- Marrëveshje ekstradimi me Republikën Arabe të Egjiptit të vitit 2004;
- 23- Marrëveshje ekstradimi me Republikën e Italisë të 2011,
- 24- Marrëveshje ekstradimi me Republikën e Kosovës, të vitit 2013, etj.
- 25- Marrëveshje ekstradimi me Kroacinë, në vitin 1926;
- 26- Marrëveshje ekstradimi me Britaninë e Madhe të vitit 1927;
- 27- Marrëveshje ekstradimi me SHBA-në, të vitit 1935.
- Marrëveshje për ndihmë juridike me Turqinë, të vitit 1995;
- 28- Marrëveshje me Slloveninë për luftën kundër krimit, të vitit 1998;
- 29- Marrëveshje me Maqedoninë për ekzekutimin e vendimeve penale, të vitit 1998;
- 30- Marrëveshje për ndihmë juridike me Maqedoninë, të vitit 1998;
- 31- Marrëveshje me Hungarinë për luftën kundër krimit, të vitit 2000;
- 32- Marrëveshje me Rumaninë për luftën kundër krimit, të vitit 2002;
- 33- Protokoll i mirëkuptimit me Italinë për bashkëpunim policor kundër kriminalitetit, nëpërmjet zyrës ndërlidhëse italiane në Shqipëri dhe oficerit ose oficerëve shqiptarë të kontaktit në Itali” të vitit 2003;
- 34- Marrëveshje me Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale”, të vitit 2003;
- 35- Marrëveshje me Italinë për transferimin e personave të dënuar të vitit 2004;
- 36- Marrëveshje me Maqedoninë për luftën kundër krimit, të vitit 2004;
- 37- Marrëveshje me UNMIK për transferimin e personave të dënuar, të vitit 2005;
- 38- Marrëveshje me Mbretërinë e Belgjikës për bashkëpunimin policor , të vitit 2005;
- 39- Marrëveshje me Bullgarinë për ndihmë të ndërsjellët juridike. të vitit 2005;

- 40- Marrëveshje me Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit, të vitit 2006;
- 41- Marrëveshje me Italinë, për ekstradim të ndërsjellët të personave, të vitit 2008;
- 42- Marrëveshje me Spanjën për bashkëpunim në luftën kundër krimit, të vitit 2009;
- 43- Marrëveshje me Çekinë për bashkëpunim në luftën kundër krimit, të vitit 2009;
- 44- Ligji nr 8322 datë 02.04.1998 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Ekstradimin dhe të dy Protokolleve Shtesë”
- 45- Ligji nr 8498 datë 10.06.1999 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Ndihmën e Ndërsjellët Juridike në Fushën Penale dhe Protokollin e Saj Shtesë”
- 46- Ligji nr 8883 datë 18.04.2002 “Për Ratifikimin e Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës së Këshillit të Evropës për Ndihmën e Ndërsjellët Juridike në Fushën Penale”
- 47- Ligji nr 10 426 datë 02.06.2011 “Për Ratifikimin e Protokollit të Tretë Shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimin”
- 48- Përmbledhës i Përgjithshëm i Legjislacionit në Fuqi të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1945-1985) Vëllimi II , Kreu XIII (Aktet në lidhje me marrëdhëniet me jashtë) – Tiranë 1986
- 49- QPZ - Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Prill 2009
- 50- QPZ - Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, Prill 2009
- 51- QPZ - Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- 52- QPZ - Përmbledhje e Akteve Ndërkombëtare për Drejtësinë, Tiranë 2006
- 53- Ligji nr. 9214, datë 01.04.2004, për ratifikimin e "Marrëveshjes së ekstradimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Arabe të Egjiptit".

- 54- "Traktati për ekstradim ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës", nënshkruar në Tiranë më datë 1 mars 1933, dhe ratifikuar nga Shqipëria më 20 prill 1935.
- 55- "Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Evropiane mbi Ekstradimin e 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Evropiane për Ndihmën Juridike për Çështjet Penale të 20 prillit 1959", ratifikuar me Ligjin nr. 9871, datë 11.2.2008.
- 56- Ligji nr. 8497, date 10.06.1999 "Për ratifikimin e konventës se Këshillit te Euro "Për transferimin e procedimeve ne çështjet penale".
- 57- Ligji nr. 8137, date 31.07.1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane "Per mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe lirive themelore".
- 58- Ligji nr. 8641, date 13.07.2000 "Për ratifikimin e protokollit te VI-rt te "Konventës Evropiane "Për mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe lirive themelore".
- 59- Ligji nr. 8322, date 2.04.1998 "Per ratifikimin e Konventës se Këshillit te Evropës "Për Ekstradimin dhe dy protokollet shtese".
- 60- Ligji nr. 8499, date 10.06.1999 "Per ratifikimin e Konventës se Këshillit te Evropës "për transferimin e peronave te Dënuar".
- 61- Ligji nr. 8642, date 13.07.2000 "Për ratifikimin e Konventës se Këshillit te Evropës "Përshtypjen eterrorizmit".
- 62- Raport i GJDN,07.09.1927, NR.10 , Rasti Lotus.
- 63- . Ligji nr. 8498, date 10.06.1999 "Për ratifikimin e Konventës se Këshillit te Evropës "Për ndihmën e ndërsjellët juridike ne fushën penale dhe protokollin shtese".

Burimet Dytësore

- 1- Abadinsky, H. (2010) *Organized Crime*, Wadsworth
- 2- Artan Hoxha, “Ekstradimi dhe Urdhri Evropian i Ndalimit”, shtëpia botuese “Morava”, Tiranë 2011.
- 3- Canaj E., Bana S. E drejta e Bashkimit Evropian, Tirane, 2014.
- 4- Canaj E., Levizja e lire e personave ne Bashkimin Evropian, Tirane, 2014.
- 5- Cools, M., Easton, M., Lieven, P. & Paul, P. (2010) *EU and International Crime Control: Topical Issues*, Maklu
- 6- Dixon. M– E Drejta Ndërkombëtare, AIIS, Tiranë
- 7- Shefqet Muci, E Drejta Penale (Pjesa e përgjithshme) - Botimet Universitare Dudaj. Tiranë,2007.
- 8- Ismet Salihu, E Drejta Penale Ndërkombëtare- Prishtinë, 2005.
- 9- Gerspacher, N. (2008) The History of International Police Cooperation: *a 150-Year Evolution in Trends and Approaches*”, *Global Crime* 9, no. 1.
- 10- Giraldo, J. & Trikunas, H.(2013) tek Alan Collins, Studime bashkëkohore të Sigurisë, *Krimi Transnacional*
- 11- Gruda. Z - E Drejta Ndërkombëtare Publike, Universiteti i Prishtinës 2003
- 12- H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, “Procedura Penale -Komentar”, shtëpia botuese “Morava”, Tiranë 2003.
- 13- Halim Hasalami, Artan Hoxha, Ilir Panda: "Procedura Penale", Shtëpia Botuese "MORAVA", Tirane 2006
- 14- Hoxha. A – Ekstradimi sipas instrumentave ligjore të Bashkimit Evropian. Ngjashmëritë dhe ndryshimet me instrumentat e Këshillit të Evropës, Morava, Tiranë 2010

- 15- Hysi, V., Penologjia, Tiranë 2009.
- 16- Hysi, V.: Penologjia, Tiranë 2009.
- 17- Islami. H, Hoxha. A, Panda. I - Procedura Penale, Botimet Morava Tiranë 2007
- 18- Jola Xhafo, “E Drejta Penale Ndërkombëtare”, shtëpia botuese “GEER”, Tiranë 2007.
- 19- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, në nenin 488.fq 243. Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Tiranë, Tetor, 2010.
- 20- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare. Tiranë 2005. Në nenin 11 të tij.
- 21- Korff, D, Shegani, A dhe Cela, K. Vështrim mbi sistemin ligjor anglez, Tiranë 2005.
- 22- Lemieux, F. (2010) *International Police Cooperation, Emerging Issues, Theory and Practice*.
- 23- Martenczuk, B. (2008) *Justice, Liberty, Security: New Challenges for EU External Relations*, Asp / Vubpress / Upa, faqe 368.
- 24- Mici .A - Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja – Shkolla e Magjistraturës, 2004
- 25- Muci. Sh, E - Drejta Penale (pjesa e përgjithshme)- Botimet Dudaj, Tiranë 2007
- 26- Myrtja. Y - Revista Juridike nr 2 viti 2005 (Studime Juridike), Universiteti i Tiranës
- 27- Ndrepepaj, V dhe Kullojka, N.: Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar në përgjithësi e atij doganor në veçanti me aquis communautaire, Tiranë 2010
- 28- Njohuri për ligjin- Libër për të gjithë. Fondacioni Soros & Horizont. Tiranë, 2001. faqe 105.
- 29- Pradel, J., Corstens, G. & Vermeulen, G. (2009) *E Drejta Penale Evropiane*, Botimet Papirus, Tiranë.
- 30- Puto, A.: E drejtë ndërkombëtare publike, Tiranë 2010.
- 31- Revista Juridike Shkencore “ Jeta Juridike” – Shkolla e Magjistraturës. Nr 1, Viti VII i botimit. Tiranë, Mars, 2010. Botimet “ Morava” fq 113.

- 32- Shegani,A.:E drejtë penale e krahasuar,Tiranë 2008.
- 33- Xhafo. J - E Drejta Penale Ndërkombëtare, Tiranë 2009, Geer
- 34- Zajmi,I.,E drejtë evropiane,Tiranë 2010.
- 35- Zajmi,I.:Leksion rreth MSA_së,Tiranë 2011.

3 - Burime nga Interneti

- <http://www.interpol.int>
- <http://www.evropol.evropa.eu/>
- <http://www.secicenter.org/>
- <http://www.secicenter.org/m485/SELEC>
- <http://www.asp.gov.al/>
- http://en.wikipedia.org/wiki/Southeast_European_Cooperative_Initiative
- <https://www.evropol.evropa.eu/content/page/history-149>
- <https://www.evropol.evropa.eu/content/page/evropol-information-system-eis-1850>
- <http://www.justice.gov.al/?fq=brenda&kid=231>
- http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_United_States_extradition_treaties
- <http://www.15min.lt/en/article/world/european-prosecutor-s-office-to-be-set-up-during-lithuania-s-eu-presidency-529-258970#ixzz29MMwn9kE>
- <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/182.htm>
- www.evropol.evropa.eu/content/page/strategic_analysis_reports
Strategic Analysis Reports.
- <http://www.interpol.int/Interpol-expertise/Data-exchange/I-24-7>